

Aljula Jubani

Linda Mëniku

Adriana Bejko

*Mësojmë*

# Shqip

Niveli **A1**  
Libri i mësuesit







Dr. Adriana Bejko  
Prof. dr. Aljula Jubani  
Prof. asoc. dr. Linda Mëniku

# *Mësojmë Shqip*

Niveli **A1**

**Libri i mësuesit**



*Përgatitur për platformën digjitale “Mëso shqip”  
bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës,  
miratuar me vendim të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, nr. 160 Prot., datë 16.04.2020  
për “Miratimin e krijimit të Platformës online për mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë”.*

*Ky libër jep drejtimit e përgjithshme të Planit Mësimor Kornizë që rekomandohet të ndiqen nga mësuesit  
e Shkollave Shqipe në diasporë, por nuk pretendon të japë përgjigje për çdo situatë në çdo shkollë shqipe  
në diasporë. Autorët shprehin që këto parime të përgjithshme didaktike do të ndihmojnë kolegët tanë të  
nderuar për të gjetur mënyrat më të përshtatshme për situatat konkrete në shkollat shqipe kudo në botë.*

*Niveli Fillestar*

*(A1, sipas Kornizës së Referencës së Gjuhëve të Bashkimit European)*

Botim online

Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD)

**Adresa:**

Rruga “Vilat Gjermane”, Vila nr. 6, Tiranë, Shqipëri

E-mail: [info@qbd.gov.al](mailto:info@qbd.gov.al)

Web: <http://www.qbd.gov.al>

**© Qendra e Botimeve për Diasporën, 2021**

Të gjitha të drejtat për këtë botim janë të rezervuara.

Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë pa lejen me shkrim të botuesit.

Shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale dënohet me ligj, sipas nenit nr. 179

të Ligjit “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

BOTIME SHKOLLORE

**Redaktor:**


Qendra e Botimeve për Diasporën

**Përgatiti:**

Spektori i botimit pranë QBD-së

## PËRMBAJTJA

1. Abstrakt .....	5
2. Qëllimet e platformës .....	7
3. Koncepte didaktike dhe idetë kryesore.....	8
4. Parimet didaktike.....	10
5. Ndërgjegjësimi i nxënësve ndaj mësimit të gjuhëve.....	13
6. Qëllimet orientuese.....	15
7. Informacion për platformën “Mëso Shqip” .....	21
8. Mësimi 1 “Atdheu, shqipja, shqiptaria”.....	32
9. Mësimi 2 “Familja ime, bisedoj me gjyshin”.....	53
10. Mësimi 3 “Lojërat kombëtare, pjesët e trupit”.....	74
11. Mësimi 4 “Shëtis përmes qyteteve të vendit tim”.....	89
12. Mësimi 5 “Festat kombëtare: tradicionale dhe bashkëkohore”.....	106
13. Mësimi 6 “Njerëz të shquar të vendit tim. Personalitete historike”.....	125
14. Mësimi 7 “Njerëz të shquar të vendit tim. Personalitete të kohës sonë” .....	141
15. Mësimi 8 “Simbole kombëtare”.....	157
16. Mësimi 9 “Vizatojmë dhe përdorim teknika të ndryshme artistike për të paraqitur vendin tonë” .....	175
17. Mësimi 10 “Objekte e histori antike” .....	193
18. Mësimi 11 “Kuzhina e shëndetshme e gjyshes” .....	207
19. Mësimi 12 “Kujdesi për shëndetin” .....	219



21. Mësimi 13 “Sënduku i gjyshes (histori të vjetra)” .....	233
22. Mësimi 14 “Koha e lirë dhe aktivitetet e mia” .....	249
23. Mësimi 15 “U prezantoj shokëve vendin tim” .....	263

# PLANI MËSIMOR KORNIZË PËR GJUHËN DHE KULTURËN E ATDHEUT

## ABSTRAKT

### HYRJE

Një vështrim i përgjithshëm i objektivave gjuhësore, kulturore dhe didaktike për platformën “Mëso Shqip”

Zhvillimi i kompetencave shumëgjuhësore dhe ndërkulturore tek nxënësit përbën detyrën themelore të shkollave shqipe në diasporë. Këtë qëllim ndjek mësimi i gjuhës dhe kulturës së atdheut në shkollat shqipe. Në këto shkolla kuptohet që dygjuhësia i zgjeron kompetencat, si në gjuhën amtare, ashtu edhe në gjuhën e vendit pritës për nxënësit, të cilët përbëjnë brezin e dytë të emigrantëve. Veç kësaj, platforma “Mëso Shqip” i ndihmon nxënësit të fitojnë njohuri mbi botën në të cilën jetojnë dhe mbi kulturën shqiptare, p.sh.: mbi historinë, gjeografinë, literaturën dhe traditat e trevave ku jetojnë shqiptarët. Është e udhës që mësimdhënia në shkollat e diasporës organizohet dhe drejtohet nga Bordi i Shkollës, ku marrin pjesë mësues dhe prindër. Ky bord siguron përdorimin krijues të Planit Mësimor Kornizë në përshtatje me kushtet konkrete të shkollës. Vendimet për përdorimin e këtij dokumenti merren me pjesëmarrjen e anëtarëve të bordit dhe të profesionistëve në fushën e mësimdhënies. Planit Mësimor Kornizë, përmes një procedure konstruktive, merr miratimin e bordit; ai mund të miratohet apo të përmirësohet në fund të muajit gusht dhe të përdoret për vitin shkollor vijues.

Në bazë të numrit të nxënësve dhe dinamikës konkrete të shkollës, Planit Mësimor Kornizë mund t’i bëhen ndryshimet dhe përshtatjet e duhura, ndërmjet të cilave mund të përfshihet edhe emërtimi i niveleve, p.sh.: “Yllkat” (fëmijë 4-9-vjeçarë), “Shqiponjat” (fëmijë 10-14-vjeçarë) etj. Njëkohësisht, plani mësimor duhet pasqyrojë përmirësime në përmbajtje, materiale kulturore dhe gjuhësore, të cilat zgjidhen në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe profesionistët e tjerë të jashtëm.

Ky dokument do të përshkruajë idetë kryesore udhëheqëse, “skelën” pedagogjike, rezultatet e pritshme dhe bazat didaktike të këtij programi, por është e pamundur t’i japë përgjigje çdo situatë në çdo shkollë shqipe, në cepa të ndryshëm të globit. Kapituj të ndryshëm në këtë platformë u kushtohen fushave mësimore, si: “Gjuha“, “Kultura” dhe “Njeriu dhe mjedisi“. Aty përshkruhet, së pari, kuptimi i kësaj fushe dhe pastaj jepen qëllimet orientuese, “skela” pedagogjike dhe rezultatet e pritshme, të cilat duhet të arrihen në përfundim të kursit të platformës “Mëso Shqip” Niveli I. Qëllimet të detajuara për nivele dhe klasa nuk janë të përfshira në këtë plan. Formulimi i tyre u është lënë mësimdhënësve përkatës sipas kushteve të ndryshme, në të cilat ofrohet kjo platformë.

Fjalorthi i kërkuar (që i rekomandohet mësuesit në Librin e Mësuesit, si dhe në programin *Quizlet.com* në internet) sqaron në detaje të gjitha përkufizimet e fjalëve, të cilat gjenden në librin e nxënësit me shkronja të pjerrëta për lehtësi identifikimi. Më të rëndësishmet këtu janë përkufizimet e duhura pasi gjuha shqipe, e cila do të mësohet në këto shkolla, është për shumicën e fëmijëve gjuha e tyre e dytë, pasi për disa fëmijë të lindur në diasporë, gjuha e parë (teknikisht) është gjuha e vendit pritës. Për hir të thjeshtësisë të interpretimit, në disa raste, ky Plan Mësimor Kornizë e emërton gjuhën shqipe si gjuhën amtare (gjuha e nënës) të nxënësve. Termi “dygjuhësh” do të emërtojë edhe fëmijët të cilët flasin më shumë se dy gjuhë. Koncepti “kulturë e origjinës së një fëmije” i përdorur në këtë kontekst, do të thotë “kulturë e vendit të prindit (Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina)”, ku i ka rrënjët familja e tij – edhe pse vetë fëmija ka lindur dhe është rritur në diasporë.

## Qëllimi i Planit Mësimor Kornizë

---

Ky plan mësimor është ngritur me qëllimin që të informojë objektivat e kurseve të Gjuhës Shqipe sipas nevojave aktuale të fëmijëve dygjuhësh. Qëllimi i përdorimit të këtij teksti është i trefi shtë:

*Së pari*, Plani Mësimor Kornizë u shërben mësuesve për t'i zhvilluar më tej planet e tyre ditore për mësimet që ofrojnë në shkollat e diasporës. Këtu janë përfshirë pikënisje të ndryshme; mësuesit mund ta përdorin këtë dokument si orientim për të hartuar planet e tyre. Ata mund t'i harmonizojnë planet e tyre mësimore, nëse është e nevojshme, në mënyrë që të zgjedhin materialet plotësuese dhe metodat më të rëndësishme mësimore të planit mësimor kornizë dhe të mos jenë në kundërshtim me to, por të mbeten krijues dhe t'u përgjigjen nevojave konkrete të shkollës së tyre. Të gjithë mësuesit kanë një hapësirë të lirë, që qëllimet dhe temat veç e veç të planit mësimor kornizë t'i peshojnë dhe aplikojnë në mënyrë krijuese sipas nevojave dhe kushteve konkrete të shkollave të tyre. Fakti që shkollat shqipe në diasporë ofrojnë vetëm dy orë mësimi në javë dhe grupmoshat dhe niveli i njohurive të nxënësve në klasat e tyre janë të ndryshme, e bëjnë të domosdoshme që mësuesit të vendosin prioritetet për klasën e tyre.

*Së dyti*, Plani Mësimor Kornizë shërben si një kërkesë për shkollën për ta përdorur këtë tekst si një platformë shkencore dhe didaktike që ndihmon në unifikimin (njësimin) e mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. Në përdorimin e tij, shkollat do të vendosin nëse objektivat e tyre përputhen me planin mësimor kornizë të platformës “Mëso Shqip”, pasi materiali i kësaj të fundit është bazuar në Kurrikulën e Përbashkët të miratuar nga Ministritë e Arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës (2018), si dhe në standardet e vendosura nga Komisioni i Përbashkët (2020). Ky plan mësimor përcakton kornizat, brenda të cilave shkollat vendosin përmbajtjen dhe qëllimet e tyre gjuhësore, kulturore dhe didaktike.

*Së treti*, Plani Mësimor Kornizë u shërben të gjithë pjesëmarrësve apo mbështetësve të tij si bazë fillestare komunikimi dhe vendimmarrjeje. Ai u ofron mësuesve, institucioneve lokale dhe arsimore një bazë të përbashkët shkencore dhe didaktike, e cila mund të përshtatet për kushtet, qëllimet, përmbajtjet dhe nocionet konkrete të mësimi të gjuhës shqipe në shkollat e ndryshme të diasporës. Plani mësimor është i orientuar nga rrethanat aktuale dhe kushtet paraprake të fëmijëve shqiptarë në qytetin apo shtetin ku do të aplikohet.

## *Konceptet didaktike dhe idetë kryesore*

Konceptet didaktike. Në mësimin e gjuhës dhe të kulturës së vendlindjes, fëmijët dhe të rinjtë shumëgjuhësh i zgjerojnë njohuritë e tyre në gjuhën amtare (jo anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, greqisht etj.). Mësuesit do të përdorin gjuhën e vendit pritës për të shpjeguar kërkesat e ushtrimeve ose drejtimet e lojërave gjuhësore apo projekteve të ndryshme. Veç kësaj, nxënësit thellojnë njohuritë e tyre mbi kulturën, origjinën dhe botën në të cilën ata jetojnë. Gjithashtu, ata zgjerojnë aftësinë për t'u integruar në shoqëri: qoftë në vendin pritës, qoftë apo në vendin e të parëve në trevat shqiptare (nëse më vonë vendosin të kthehen atje). Përmes mësimin të gjuhës shqipe, ata do të përfshihen në zhvillimin e tyre gjuhësor, njohës, social dhe emocional. Koncepti “Gjuha dhe kultura e vendlindjes” do të mbetet në planin mësimor kornizë të pranishëm, edhe nëse kuptimi i fjalës “vendlindja” mund të tingëllojë i “pasaktë”, pasi vendi i origjinës është në të vërtetë vendi ku “na ka rënë koka”, por disa nga nxënësit mund të kenë lindur në diasporë. Përsëri, në kontekstin e platformës “Mëso Shqip”, me vendlindje do të kuptojmë trevat shqiptare nga e kanë origjinën prindërit dhe familjet shqiptare në diasporë.

- Mësimi mbështetet në dhjetë parime didaktike:
- interesi për dituri të reja
- ndjenja e përgjegjësisë
- gatishmëria për sukses
- aftësia dialoguese dhe solidariteti
- vetëdija për traditën
- vetëdija për mjedisin
- aftësia gjykuese dhe kritike
- çiltërsia
- argëtimi



## Idetë kryesore:

- Mësimi i gjuhës dhe kulturës së vendlindjes i ndihmon nxënësit të flasin në gjuhën amtare dhe ofrohet në përputhje me moshën, njohuritë dhe nivelin e tyre gjuhësor.
- Mësimi e forcon vetëdijen se dygjuhësia formon një potencial plotësues, të cilin nxënësit mund ta shfrytëzojnë për të arritur rezultate më të larta në shkollë në vendin pritës. Nxënësi do ta konsiderojë shumëgjuhësinë si një të mirë shoqërore me vlera pozitive, një vlerë të shtuar dhe kontribuese në pasurinë kulturore të shoqërisë ku jeton.
- Mësimi i gjuhës shqipe do t'i ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të mirëkuptojnë modelet e ndryshme të identiteteve, që vijnë nga përkatësi sociale, kultura, tradita dhe histori të ndryshme të përjetuara nga individë të ndryshëm. Kështu kapen, thellohen dhe reflektohen përvojat dhe njohuritë, si për sa i përket kulturës amtare, ashtu edhe asaj të vendit pritës. Këtu përfshihen pikëpamjet për vlerat, normat, historia dhe besimi. Megjithatë, platforma “Mëso Shqip” është laike dhe dhënia e mësimëve fetare dhe e ideologjive politike (partiake) nuk është pjesë e mësimin të gjuhës shqipe.
- Mësimi i ndihmon nxënësit në aftësimin e tyre për të zgjidhur konfliktet, të menduarit kritik ndërton kompetencat e duhura ndërkulturore dhe aftësitë e tyre për të gjykuar drejt e objektivisht, me paanësi dhe pa paragjykime. Nxënësi përqafton një qëndrim plot respekt, të hapur, tolerant dhe jodiskriminues për të tjerët.
- Mësimi ndihmon integrimin e fëmijëve në shkollën publike në vendet pritëse.
- Mësimi i gjuhës shqipe krijon parakushtet që nxënësit të mund t'i shfrytëzojnë kompetencat e tyre ndërkulturore dhe shumëgjuhësore në arsimimin e mëvonshëm dhe në profesion, si në vendin pritës, ashtu edhe në vendin amtar.
- Mësimi i gjuhës shqipe u jep mundësinë nxënësve që të ndihen sa më mirë në kontaktet me njerëzit e tyre në vendin amë dhe të përgatitur për një integrim me dinjtet, në rast kthimi të mundshëm në vendin e origjinës.

## *Parimet didaktike*

Mësimdhënësi i gjuhës dhe i kulturës së atdheut përshtat materialet e mësimdhënies në përputhje me vlerat edukative dhe njohëse të kulturës dhe traditave shqiptare. Ai zgjon interesat e nxënësve për të bërë pyetje dhe për t'i përpunuar njohuritë e nxënësve në mënyrë të vetëdijshme. Mësimi nisët nga përvojat dhe interesi i nxënësve dhe zgjon interesa të reja tek ata. Platforma “Mëso Shqip” u siguron nxënësve (sipas mundësisë) kontakt të drejtpërdrejtë me lëndën e trajtuar dhe lidh të mësuarit e tyre me përdorimin personal gjuhësor të materialit gjuhësor të paraqitur në mësimet të ndryshme. Përparimi në aftësitë në përdorimin e gjuhës dhe detyrat gjuhësore i përshtaten mundësisht nivelit të secilit nxënës. Kjo arrihet me ndihmën e mësuesit, i cili ndërton “skelën e sigurisë” gjuhësore (scaffolding) me anën e përvetësimit të njohurive të reja gjuhësore, nëpërmjet rritjes së fjalorit aktiv, fjalorit të rimarrë dhe atij pasiv. Mësimet në platformën “Mëso Shqip” shfrytëzojnë mundësitë reale për mësimin e gjuhës, të cilat rezultojnë nga fakti i veçantë që nxënësit lëvizin e jetojnë në botë jetësore dhe gjuhësore të ndryshme. Prandaj, materiali i platformës përqendrohet në përvojat individuale të nxënësve dhe bën kujdes për bërë krahasime të fjalëve dhe të koncepteve, mbështetur në parimet bazë didaktike:

- Përmes krahasimit të gjuhës shqipe me gjuhën e vendit pritës, nxënësi thëllon kompetencat në të dyja gjuhët;
- Përmes krahasimit të përvojave të ndryshme, nxënësi thëllon një kuptim të drejtë të karakteristikave të përbashkëta, dallimeve dhe veçantive të rëndësishme, gjë që zhvillon të menduarit kritik;
- Ndhimuese për këto sensibilizime gjuhësore dhe ndërkulturore janë konceptet, të cilat prezantohen përmes teksteve të zgjedhura me shumë kujdes nga autorët;
- Mësimet në platformën “Mëso Shqip” u japin hapësirë elementeve të lojës dhe të të shprehurit me gojë, gjë që e bën të mësuarit e gjuhës

shqipe argëtues dhe të interesant për nxënësit. Gjithashtu, mësimi i aftëson nxënësit të mësojnë në mënyrë të pavarur dhe të zgjerojnë më tej njohuritë me forma të nxëni jashtë klase (muzikë, filma, personalitete shqiptare etj.);

- Vlerësimi i nxënësve (që nga klasa e dytë) për përparimin e tyre në gjuhën shqipe. Në fund të çdo semestri, mësuesi e shënon vlerësimin për secilin fëmijë në regjistër. Në nivelin parashkollor dhe në klasën e parë, nxënësit nuk marrin vlerësim, por vetëm certifikatë;
- Mësuesit mund t'u japin prindërve informacione mbi përparimin e fëmijës së tyre në biseda dhe takime. Vlerësimet japin informacion për shkallën e arritjes së qëllimeve mësimore, si dhe për përvetësimin e njohurive nga nxënësit. Sipas dëshirës, mësimdhënësi mund t'i vlerësojë kompetencat veç e veç:
  - o të kuptuarit e dëgjimit
  - o të kuptuarit e leximit
  - o të folurit
  - o të shkruarit

Vlerësimi i njohurive jep informacion për sukseset e për përpikërinë në gjuhë dhe jo për sjelljen e nxënësit apo pjesëmarrjen aktive në mësim. Vlerësimi pasqyron jo vetëm sukseset në testimet formale, por përfshin edhe vëzhgimet që bën mësuesi në mësim. Megjithatë, mund të jetë me vend që në vlerësim të mbahet në konsideratë edhe niveli i kompetencave të prindërve në gjuhën shqipe, pasi kjo mund të përbëjë një faktor të rëndësishëm në përvetësimin e gjuhës nga nxënësit: nëse prindi ka njohuri të mira të gjuhës shqipe, ai mund ta ndihmojë fëmijën për detyrat me dialogë, për projekte apo lojëra gjuhësore. Është e natyrshme që prindërit të interesohen për të mësuarit e fëmijëve të tyre në kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut, por ka raste kur prindërit nuk kanë mundësi të ndihmojnë, nxënësit vijnë nga familje të “përziera”, njëri nga prindërit nuk flet shqip etj. Nxënësit bëhen pjesë, partnerë të procesit mësimor, duke paraqitur nevojat e interesat e tyre në vende të ndryshme ku mësohet gjuha, duke u dhënë atyre mundësinë, fuqinë, autorizimin për të marrë në dorë arsimimin e tyre në shqip.

### **Mjetet mësimore dhe ndihmat mësimore.**

Mjetet mësimore do të zgjidhen dhe do të vihen në dispozicion nga institucionet arsimore dhe bordi i shkollës dhe do të pasurohen nga mësuesit. Përdorimi i tyre merr parasysh aftësitë e ndryshme në të mësuar si dhe situatat specifike të nxënësve. Ato ndihmojnë që të plotësohen kërkesat e planit mësimor kornizë

duke u drejtuar përmes kompetencave që duhen arritur sipas tij. Këtu përfshihet në mënyrë të veçantë përdorimi i platformave digjitale dhe mjeteve të tjera elektronike që mund të shërbejnë në mësimdhënie.

## Zgjedhja e metodës së mësimdhënies

Gjatë përgatitjes për mësim, mësuesit janë të lirë në zgjedhjen e metodës. Ata zgjedhin metodën, e cila në situata të caktuara mësimore i përgjigjet më së miri qëllimeve dhe përmbajtjes, si dhe vetë nxënësve e mësuesve. Ata marrin parasysh që të zbatojnë një mori metodash, si: mësimdhënia e drejtpërdrejtë, të mësuarit zbulues, punë në grupe ose çifte, mësim përmes projekteve, punë në të mësuarit në partneritet etj. Megjithatë, mund të jetë me vlerë që në këto zgjedhje të mbahet parasysh dhe të përfshihet edhe niveli i kompetencave të prindërve në gjuhën shqipe. Shpresohet që prindërit të interesohen për të mësuarit e fëmijëve të tyre në kurset e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare. Mësuesit marrin parasysh gjatë dhënies së detyrave mundësitë dhe nivelin e suksesit të nxënësve. Në këtë mënyrë ata mënjanojnë mbingarkimin e tyre dhe i motivojnë me sfida të përshtatshme për moshën dhe nivelin gjuhësor të nxënësve. Zgjedhja e metodës u përgjigjet rrethanave, ngaqë përbërja e klasës është shpesh heterogjene. Nxënësit vijnë nga klasa të ndryshme, u përkasin niveleve të moshave të ndryshme, kanë një të kaluar biografike dhe një nivel gjuhësor të ndryshëm.

## Detyrat e shtëpisë

Detyrat e shtëpisë mund të konsiderohen si pjesë e procesit mësimor dhe mund t'i krijojnë mundësi fëmijës që të përforcojë njohuritë e marra në klasë. Fëmijët duhet të kenë mundësi që t'i zgjidhin detyrat e shtëpisë me ndihmën e prindërve, pa qenë mbingarkesë për ta.

## *Ndërgjegjësimi i nxënësve ndaj mësimit të gjuhëve*

Sipas zbulimeve shkencore të dy dekadave të fundit dhe në mënyrë të veçantë të të mësuarit me bazë trurin, rezulton se nxënësi duhet të aftësohen në përdorimin e koncepteve dhe jo në mësimin përmendësh të fjalorit apo të rregullave gramatikore. Pra, edhe mësimi i gjuhës shqipe nuk do të fokusohet në mësimin e thellë të gjuhës dhe të strukturave gramatikore gjuhësore; mësimdhënia në shkollat shqipe do të përqendrohet më tepër tek hulumtimi, komunikimi, krahasimi dhe “zbulimi” i kulturës dhe traditave shqiptare. Platforma “Mëso Shqip” do të fokusohet në aftësimin për përdorimin praktik të gjuhës për komunikim, dhe ky qëllim do të arrihet nëpërmjet koncepteve, temave të ndryshme e të përshtatshme mësimore.

Kuptimi dhe veçoritë e fushës mësimore me platformën “Mëso Shqip” zhvillohen mbi bazat e gjuhës letrare shqipe. Si rrjedhojë, gjuha që do të përdoret në shkollë do të jetë gjuha standarde shqipe. Kjo platformë merr parasysh nivelin aktual të njohurive të nxënësve në gjuhën shqipe, të cilat janë individuale dhe mund të kenë edhe forma dialektore. Gjithashtu, platforma merr parasysh faktin që kompetencat në gjuhën amtare (shqip) të një fëmije mund të pasqyrohen në rritjen e kompetencave në gjuhën e dytë (atë të vendit pritës). Prandaj, mësuesi e individualizon mësimin aq sa është e mundur dhe e nevojshme për situatën konkrete. Edhe njohuritë për kulturën e traditat e bukura amtare që përforcojnë ndjenjën e krenarisë, përkatësisë dhe identitetit kombëtar nxit e motivon për të mësuar më shumë gjuhën e kulturën.

Puna me leksikun i aftëson nxënësit që të shprehen në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme dhe për tema të ndryshme. Për këtë arsye mësuesit marrin parasysh propozimet e nxënësve si dhe ngjarjet aktuale që ndodhin në jetën e tyre. Nxënësit mësojnë përmes teksteve të zgjedhura letrare, klasike e moderne. Nxënësit orientohen pak në analizën gramatikore të gjuhës amtare, duke i kushtuar më shumë vëmendje shkathtësive dhe shprehive bazë komunikuese, të cilat i përdorin në përditshmëri dhe që ndryshe quhen “Aftësi Bazë të Komunikimit” (Basic Interpersonal Communicative Skills) (BICS).

Në shkollat shqipe në diasporë, nxënësit do të fitojnë në mënyrë plotësuëse edhe kompetencat gjuhësore, të cilat janë vendimtare për të mësuarit njohës

(konjitiv) në shkollë: “Aftësitë Akadematike për Përdorimin e Gjuhës” (Cognitive Academic Language Proficiency) (CALP). Këto kompetenca i lejojnë nxënësit që të kuptojnë fakte komplekse dhe mendimin abstrakt, të njohin marrëdhëniet shkakore ose të ndërtojnë një tekst të vetin. Prandaj mësimi në shkollat shqipe do të mbështetet në aftësitë e nxënësit për të kaluar nga regjistrat e nivelit BICS (të folurit e përditshëm) tek regjistrat CALP (aftësitë për të shprehur koncepte intelektuale më komplekse, duke përdorur trurin dhe abstraksionin). Ai e forcon vetëdijen e nxënësve për dallimet mes regjistrave të fjalëve dhe i mëson se si mund t’i përdorin ato në mënyrë korrekte, nëpërmjet strategjive të përshtatshme të të mësuarit. Nxënësit shohin si në një pasqyrë se si ndryshon dhe zhvillohet gjuha shqipe nga niveli BICS në nivelin CALP. Nxënësit mësojnë edhe alfabetin e gjuhës shqipe edhe atë të gjuhës së vendit pritës dhe këto dy procese rrjedhin të pavarur nga njëri-tjetri, ndaj në çdo rast duhen bashkërenduar me kujdes. Mësuesi duhet të njohë dhe të paraqesë dallimet midis alfabetit shqip dhe atij të vendit pritës. Për këtë ai/ajo mund të përdorë elemente nga didaktikat moderne, të cilat trajtojnë gjuhën e vendit pritës si gjuhë të parë, gjuhën shqipe si të dytë ose gjuhë të huaj. Fëmijët dhe të rinjtë e zgjerojnë të kuptuarit e tyre gjuhësor, duke bërë krahasimin mes gjuhës shqipe dhe gjuhës tjetër, në bazë të nivelit të tyre. Ata i kuptojnë interferencat dhe krahasimet e rëndësishme mes këtyre gjuhëve dhe janë në gjendje të shpjegojnë modalitetet karakteristike të secilës gjuhë. Norma gjuhësore që përdoret në vendin amtar e lidhur ngushtë me kulturën e vendit amë, është përcaktuese për dhënien e rregullave gramatikore dhe ortografike. Nxënësit, megjithatë, nuk e mësojnë ortografinë dhe gramatikën si qëllim në vetvete, por si mjet për të komunikuar qartë dhe të mbështetur në kontekst.

## *Qëllimet orientuese “gjuha” dhe rezultatet e pritshme*

Qëllimet orientuese të kësaj platforme duhet të arrihen me përfundimin e vitit shkollor. Në platformën “Mëso Shqip” nxënësit fitojnë kompetenca të tilla gjuhësore dhe kulturore, të cilat jo vetëm do të mbajnë gjallë, konsolidojnë, ndërgjegjësojnë e forcojnë krenarinë për vendin e origjinës tek brezi i dytë i mërgimtarëve, por mund t’i përdorin për perfeksionimin e gjuhës së vendit pritës. Pra, në qendër të kësaj platforme qëndrojnë të kuptuarit dhe të komunikuarit, në formë gojore dhe në lexim. Përsosmëria gjuhësore në shkrimin e gjuhës në këtë platformë luan një rol të dorës së dytë. Kjo zgjedhje është bërë në mënyrë të ndërgjegjshme nga autorët, duke mbajtur në qendër të vëmendjes nevojat konkrete të diasporës dhe me synimin qendror praktik të një përdorimi të saktë të gjuhës standarde shqipe të niveleve A1-A2-B1-B2-C1 dhe jo me fokus në gjuhën akademike të shkruar të nivelit C2. Ky nivel i lartë i të shkruarit akademik të gjuhës (C2) mund t’i shtohet lehtësisht nivelit praktik në rastet kur mësimi i gjuhës në nivelin C2 është i nevojshëm.

**Të dëgjuarit dhe të kuptuarit.** Nxënësit mund të kuptojnë se çfarë po flitet në gjuhën shqipe. Ata janë në gjendje t’i ndjekin diskutimet, referatet, programet e radios dhe të televizionit, për tema të përgjithshme dhe mësojnë të mbajnë një qëndrim kritik ndaj asaj që kanë dëgjuar. Ata mësojnë gjithashtu të interpretojnë çka shprehet përmes gjuhës së gjesteve.

**Të lexuarit.** Nxënësit lexojnë me dëshirë. Librat me ilustrime e figura zënë pjesën më të madhe të leximeve të tyre. Ata “zbulojnë” se të lexuarit mund të jetë zbatimës dhe i këndshëm. Letërsia artistike për fëmijë ka aspekt edukativ në çdo kulturë. Nxënësit do të prezantohen me gjini të ndryshme letrare, pa u futur në analiza të holla letrare. Lexojnë për të kuptuar mesazhin, tregimin në përgjithësi pa kaluar në mësim të detajuar të çdo fjale. Mësohen, inkurajohen të marrin me mend kuptimin e fjalëve nga konteksti. Ata mësojnë se si dhe ku mund të gjejnë libra në gjuhën shqipe. Ata njihen me media të ndryshme dhe lloje të ndryshme

tekstesh. Ata aftësohen që të nxjerrin informacione me qëllime të caktuara prej teksteve, kurse për fjalën që nuk e kuptojnë nxiten të pyesin ose të kërkojnë në fjalorë.

**Të folurit.** Mësuesi krijon situata bashkëbiseduese, të cilat janë një përshtatje me rëndësi për fëmijët dhe të rinjtë dhe kërkon një dialogim gjuhësor mes tyre duke përdorur shumë mjete pamore të përgatitura edhe nga vetë fëmijët. Nxënësit janë të aftë që të formulojnë situata faktike dhe të shprehin mendimet e ndjenjat e tyre, pëlqimet e mospëlqimet, të ndjekin instruksione, të realizojnë gjëra të ndryshme. Ata janë gjithashtu të aftë që thënie e të tjerëve t'i kuptojnë dhe të shtrojnë pyetje rreth tekstit/dialogut që dëgjojnë apo të shprehin qartë dhe në mënyrë të kuptueshme nevojat apo kërkesat e tyre. Ata mund të tregojnë ngjarje, si dhe të lexojnë tekste, të hartojnë tregime të shkurtra dhe të prezantojnë lirshëm mendimet e tyre.

**Të shkruarit.** Nxënësit shkruajnë me qëllim që të mësojnë të flasin, por nuk do të jetë ky qëllimi kryesor i mësimdhënies. Ata i lexojnë njëri-tjetrit rregullisht tekste që i kanë krijuar vetë dhe mundohen të shkruajnë komentet rreth tyre me një gjuhë të saktë, por jo shumë të ndërlikuar. Në këtë mënyrë, ata kuptojnë se të shkruarit është një proces social. Ndërkohë, mësuesi nuk përqendrohet në gabimet e mundshme gramatikore, por në realizimin e komunikimit me shkrim. Ata janë në gjendje që t'i formulojnë mendimet e veta, faktet e vërteta dhe fiktive, duke përdorur fjali të thjeshta dhe të shkurtra (kryefjalë + kallëzues + kundrinor i drejtë/zhdrejtë + rrethanor). Ata mundën, në varësi të moshës së tyre, të shkruajnë tekste në mënyrë të saktë (nëse është e nevojshme edhe me ndihmën e fjalorëve), por ky nuk është fokusi kryesor i kursit të gjuhës për nivelin A1 dhe A2. Fokusi i këtij kursi është zhvillimi i aftësive dhe shprehive për të bashkëbiseduar dhe për të krijuar një rezervë modeste fjalori praktik; në nivelin B1-B2 do të diskutohen rregulla të thjeshta gramatikore, gjithmonë jo në teori, por në kontekst.



## *Qëllimet orientuese "Njeriu dhe mjedisi"*

Individi dhe shoqëria. Në kontakt me njerëzit, nxënësit mësojnë të dëgjojnë, të perceptojnë ndjenjat dhe të futen në botën e bashkëbiseduesit. Ata shqyrtojnë dhe rishqyrtojnë kuptimin e fjalëve për të sqaruar kuptimin e tyre për vete dhe për të tjerët. Ata përballen në mënyrë virtuale me situatat në Shqipëri/Kosovë/Maqedoni dhe me ato në vendin pritës dhe, gjithashtu, zhvillojnë mendime dhe reagime për një botëkuptim të caktuar ndaj këtyre ngjarjeve. Ata mësojnë të reflektojnë ndjenjat e tyre të përkatësisë në raport me situata të ndryshme dhe i integrojnë këto ndjenja si pjesë të personalitetit të tyre.

Përmes përvojave të përshkruara nga familja, nga shokët/shoqet, nga shkolla, nga vendi amtar, nga bashkatdhetarët, media dhe institucionet, ata krijojnë një vështrim të gjerë për larminë e lidhjeve të ndërsjella sociale dhe ndikimeve të ndërsjella të ngjarjeve mbi njerëzit. Ata pikasin se individi është pjesë e shoqërisë, prej së cilës ai ndikohet dhe të cilën ai e ndikon. Duke përdorur platformën "Mëso Shqip", nxënësit krijojnë përvojën se bashkëjetesa njerëzore edhe midis vetë komunitetit shqiptar, me larminë e tij, përkujdesja e dyanshme, si dhe përfillja e rregullave janë të domosdoshme për një bashkëjetesë shoqërore.

Njëkohësisht, nxënësit bëhen të vetëdijshëm se rregullat mbështeten në konceptimin e vlerave dhe të normave shoqërore, të cilat janë të ndryshueshme. Ata kuptojnë se përgjigjet për shumë pyetje themelore varen nga perceptimi personal i vlerave dhe botëkuptimi personal. Ata njohin kriteret e vlerave dhe traditat e kulturës së origjinës dhe të vendit pritës gjithashtu. Ata kthehen në qytetarë të botës, duke respektuar njëkohësisht edhe kulturën e tyre shqiptare (respekti, qëndrimi i hapur edhe për larminë brenda kulturës shqiptare etj.)

Njëkohësisht ata bëhen më të hapur ndaj kulturës së vendit pritës. Ata mësojnë se është e rëndësishme që ndjenjat e përkatësisë së tyre në të dyja hapësirat jetësore (vendi i origjinës dhe vendi pritës) t'i integrojnë njëkohshëm në personalitetin e tyre, duke u integruar (jo asimiluar) në kulturën e vendit pritës. Të përjetuarit e vetëdijshëm të të dyja përvojave mënjanon konfliktet e mundshme. Gjatë fazës fillestare të mësimit me platformën "Mëso Shqip", nxënësit mësojnë t'i emërtojnë ndjenjat e veta në gjuhën shqipe dhe të bisedojnë për sfidat e reja në përpjekjet e tyre për të përvetësuar leksikun e duhur në gjuhën shqipe në mënyrë që të arrijnë një mirëkuptim të thelluar të individit dhe rolit të tij në shoqëri.

## Qëllimet orientuese “Atdheu dhe bota”

Nxënësit ndeshen me rrethin e tyre të drejtpërdrejtë familjar, si dhe me vendin amtar në mënyrë të vetëdijshme dhe të hapur. Përmes hulumtimit të vetëdijshëm dhe me ndihmën e fotografive, hartave dhe të mediave të tjera ata fitojnë një njohje të thellë të vendit amtar, kjo falë reflektimit dhe krahasimit që bëjnë me vendin pritës. Informacioni me përmbajtje gjeografike, historike, ekonomike dhe ekologjike u zgjeron njohuritë e tyre mbi vendin amtar. Këto njohuri themelore orientuese i ndihmojnë ata për ta vëzhguar vendin amtar në tërësinë dhe larminë e tij, si dhe për t’i renditur dhe peshuar informacionet që marrin nga burime të ndryshme. Kjo i ndihmon ato për t’u orientuar më mirë edhe në vendin e origjinës, nëse një ditë vendosin të kthehen në atdhe. Kësisoj, ata ndërgegjësohen për paragjykimet e huaja dhe të vetat rreth botës në përgjithësi dhe atdheut në veçanti dhe mësojnë që të merren me situata antagonistë në mënyrë konstruktive.

## *Qëllimet orientuese*

### *"E Kaluara, e tashmja, e ardhmja"*

Nxënësit njohin dhe kanë respekt për historinë dhe traditat kulturore të vendit amtar, të kohës sonë dhe të kaluarës. Në bazë të njohurive orientuese elementare të ngjarjeve historike, ata mund të bëjnë një renditje kohore të ngjarjeve, zhvillimeve dhe dëshmimeve nga historia dhe nga e sotmja e vendit amtar. Historia e emigrimit të grupit të cilit i përkasin luan këtu një rol të rëndësishëm. Ata mësojnë përmes shembujve të zgjedhur, se çdo histori është subjektive si dhe mënyrat se si bashkatdhetarë të suksesshëm kanë përballuar sfidat e mërgimit. Ata e kuptojnë se qëndrimet dhe interesat e ndryshme mund të kuptohen më mirë kur shikohen në sfondin e tyre historik. Ata pikasin se njerëzit përmes të të menduarit dhe të vepruarit ndikojnë në zhvillime të ndryshme dhe kontribuojnë si në vendin pritës, ashtu edhe në atë të origjinës. Kësisoj, nxënësit kuptojnë dhe merren me problemet globale, nacionale dhe rajonale dhe i perceptojnë më mirë ndikimet e tyre të drejtpërdrejta në ambientin ku jetojnë. Ata kanë një kuptim më të gjerë për raportet e ndërsjella mes politikës, ekonomisë dhe kulturës. Ata i njohin mundësitë e tyre për të ndikuar vetë në zhvillimet e tashme dhe ato të ardhme, si dhe për të marrë bashkëpërgjegjësi për vendimet e tyre. Ata i njohin të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e fëmijëve dhe i respektojnë ato.

Filozofia e platformës "Mëso Shqip". Si rezultat i sa më lart, programi i zhvillimit gjuhësor dhe rritja e njohurive për Atdheun në moshë sa më të re shkollore, janë të domosdoshme për çdo fëmijë që rritet në emigracion. Ky program përfshin disa linja të rëndësishme të gjuhës amtare, të cilat janë: komunikimi, të menduarit, lidhja e tingujve me shkronjat, të shkruarit, njohuri për kulturën dhe traditat e vendit tonë etj.. Të gjithë këto linja synojnë t'i pajisin nxënësit e shkollave shqipe në diasporë me njohuritë, aftësitë dhe shprehjet e domosdoshme për të përballuar kërkesat për një komunikim të natyrshëm me gjyshërit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes në vendin amë. Si dhe për ata që përballen me më shumë se dy kultura për arsye të prindërve me prejardhje të ndryshme. Duke marrë parasysh problemet, aftësitë, prirjet e tyre, ky program do të plotësojë jo vetëm boshllëqet gjuhësore të fëmijëve që po rriten larg atdheut, por dhe do të përmirësojë dhe të stimulojë

aftësitë e atyre që nuk e përdorin gjuhën shqipe rregullisht në komunikimin me prindërit e tyre. Në këtë kuptim, ky program mund të duket i lehtë për ata fëmijë që kanë qenë gjithmonë të pranishëm në veprimtaritë mësimore në shkollat shqipe. Megjithatë, trajtimi, ngarkesa gjuhësore dhe njohëse, si dhe mënyra se si do të zhvillohet konkretisht mësimi i mbështetur në gjetjet e fundit në shkencat njohëse të trurit që jep “Libri i Mësuesit” për platformën “Mëso Shqip”, do të pajisin mësuesit e shkollave shqipe në diasporë me një paketë të pasur me njohuri leksikore dhe didaktike. Kjo është një mundësi e mirë, e cila kontribuon që të gjithë fëmijëve t’u jepet një mundësi e barabartë për sa i takon një formimi gjuhësor, kulturor dhe intelektual të mbështetur mbi baza shkencore.

## OBJEKTIVI THEMELOR I PLATFORMËS “MËSO SHQIP” A1

**ZHVILLIMI DHE RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR PËRMES MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE, KULTURËS SË ORIGINËS SI DHE NJOHJA ME TRASHËGIMINË DHE THESARIN KULTUROR, NATYROR DHE HISTORIK KOMBËTAR TË TREVAVE KU JETOJNË SHQIPTARËT**

### Informacion për platformën “Mëso Shqip”

*Ndërtuar për të arritur sukses në mësimin e gjuhës shqipe në diasporë  
Mësimi i balancuar i të dëgjuarit dhe të folurit, si fokusi kryesor i mësimit  
Mbështetur te Kurrikula e Përbashkët Kosovë-Shqipëri, si dokumenti ligjor kryesor  
Mbështetur te parimet e mësimit të gjuhës shqipe si gjuhë e dytë, me bazë trurin.*

Kjo platformë mbështetet fuqimisht në nevojat e mësimit të gjuhës shqipe në diasporë, duke përdorur metoda dhe filozofi bashkëkohore për mësimin e gjuhës së dytë dhe duke u mbështetur tek zbulimet shkencore të shekullit XXI në mësimin me bazë trurin. Materialet dhe fokusi i kësaj platforme mbështeten në strategji dhe ushtrime që do t’i aftësojnë nxënësit të përdorin gjuhën shqipe për të njohur kulturën e prindërve dhe për të komunikuar me familjen në trevat shqiptare.

### Përvetësimi i gjuhës shqipe në nivelin A1

Nxënësit në këtë nivel mund të kenë pasur përvoja të ndryshme, kryesisht në të dëgjuarit e gjuhës shqipe, dhe mund të jenë në nivele të ndryshme të aftësive njohëse dhe gjuhësore. Këto grupe nxënësish mund të përbëjnë një sfidë fillestare

për mësuesin. Mësimet e kësaj platforme janë ndërtuar në mënyrë të tillë, që nxënësit të angazhohen në dialog aktiv me shokët. Në këtë mënyrë, ata i krijojnë vetë fjalitë në vend që të përsërisin në mënyrë mekanike atë që dëgjojnë. Një qasje e tillë ndihmon nxënësin të fillojë nga fjalitë e thjeshta për të kaluar në ato më të ndërlikuara në mënyrë graduale, gjë që ndërton besimin se objektivat gjuhësore të platformës “Mëso Shqip” janë të matshme dhe të mundshme për t’u arritur.

Një nga parimet për të përvetësuar gjuhën e dytë është përfshirja në një mjedis të pasur gjuhësor; i cili është i qëllimshëm, me një shumëllojshmëri formash (pamore, digjitale, filma, muzikë, bisedime etj.) dhe me materiale të përshtatshme për nivelin e nxënësit. Gjithashtu, veprimtaritë e rekomanduara didaktike janë të larmishme; duke përfshirë dëgjimin e leximit nga mësuesja, prindërit dhe shokët e klasës; pjesëmarrjen në lexim dhe të folur që drejtohet dhe ndihmohet nga mësuesi; dëgjimin e teksteve në formë elektronike; aftësimin për të komunikuar në situata reale nëpërmjet dialogut dhe bisedës.

Nxënësit do të inkurajohen të marrin nismën për të folur pa pasur frikë se bëjnë gabime apo se mësuesi do t’i kritikojë për gabimet që bëjnë. Ato do të sigurohen se si mësuesi, ashtu edhe prindërit, besojnë që nxënësi do të arrijë sukses. Kjo do të arrihet duke përdorur shprehje të tilla si “unë e di që ti e di këtë fjalë/ fakt etj.” apo duke i shpjeguar me gjuhë të thjeshtë dhe të qartë si kërkesat e ushtrimeve, ashtu edhe detyrat e nxënësve për të marrë pjesë në dialogun e temës kryesore, në diskutimet me shokët apo dramatizimet e vjershave e tregimeve.

Përshkrimi dhe emri i kursit	Mësimi i gjuhës dhe kulturës së atdheut
Orë mësimi	30 seanca 2-orëshe

### PLANI VJETOR për NIVELIN 1 (A1 DHE A2)

Muaji		A1				A2							
		Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor		
M u a j i	T	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2
	e m a	3	4	3	4	3	4	3	4	3	4	3	4

### **Përshkrimi i kursit**

Ky kurs synon t'i pajisë fëmijët shqiptarë në diasporë me njohuritë, aftësitë e domosdoshme për të përballuar kërkesat në fushën e komunikimit në shqip, si dhe të mundësojë një përfshirje të natyrshme në njohjen e kulturës amtare nga të gjithë fëmijët e shkollave shqipe. Duke marrë parasysh problemet, aftësitë dhe prirjet e tyre, ky program synon të plotësojë jo vetëm mangësitë gjuhësore dhe njohëse të fëmijëve që nuk kanë vijuar rregullisht mësimin e gjuhës shqipe, por dhe të përmirësojë dhe të stimulojë aftësitë e atyre që kanë vijuar rregullisht mësimin e gjuhës shqipe, sipas programeve të mësimin plotësues.

Në këtë kuptim, ky program mund të duket i lehtë për ata fëmijë që kanë qenë gjithmonë të pranishëm në veprimtaritë mësimore në shkollë, por trajtimi, ngarkesa e kësaj fushe, si dhe mënyra se si do të mund të zhvillohet konkretisht në klasë, është një mundësi e mirë që të gjithë fëmijët të mbajnë gjallë identitetin e tyre, duke pasur një mundësi të barabartë për sa i takon kërkesave dhe mundësive për një formim gjuhësor të vlefshëm për perspektivën e tyre si nxënës në shkollat e vendit ku jetojnë.

### **LINJAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT GJUHËSOR**

Gjuhë për komunikim  
Gjuhë për të menduar  
Lidhja e tingujve me shkronjat  
Të lexuarit  
Të shkruarit

Kolegë të nderuar le të fillojmë rrugën e bukur të mësimin të gjuhës sonë të shenjtë bashkë me nxënësit tanë.

## TRI QASJET E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE NË PLATFORMËN “MËSO SHQIP”:

Pavarësisht nga moshja e studentit, në mësimdhënien e gjuhës së dytë (shqipe) ekzistojnë tri qasje mësimore me bazë të trurin (RN Caine & G. Caine, 1990, 2002), të cilat mësuesi i përdor në mënyrë të qëllimshme dhe janë si vijon:

1. Përfshirja gjuhësore e orkestruar. Në mësimin e gjuhës së folur mësuesi krijon një mjedis mësimi që angazhon plotësisht studentët në përvetësimin e shumë aftësive gjuhësore.
2. Përfshirje gjuhësore graduale dhe e shtruar. Ndërsa largon frikën e së panjohurës tek nxënësit, mësuesi ende ruan një mjedis shumë stimulues gjuhësor, ku nxënësit i jepet mundësia të eksplorojnë gjuhën pa frikën e gabimeve gjuhësore. Mësuesi nisët nga njohuritë që nxënësit kanë aktualisht dhe i ndërton e i zgjeron këto njohuri, duke krijuar njëkohësisht skela mbështetëse për njohuritë e reja (scaffolding) dhe duke ricikluar vazhdimisht materialin/njohuritë e dhëna.
3. Përpunimi aktiv i materialit gjuhësor. Duke e lënë nxënësin të ndërthurë dhe të marrë përsipër të folurin aktiv dhe duke praktikuar në mënyrë aktive njohuritë, mësuesi siguron që informacioni ruhet në kujtesën afatgjatë, më shumë sesa në kujtesën afatshkurtër.

Parametra orientues për përgatitjen e mësuesit/ mësueses para orës së mësimin

Mësuesi i shkollës shqipe që përdor platformën “Mëso Shqip” duhet:

- a) të njohë kurrikulën për mësimin plotësues dhe t’u referohet kërkesave të saj për të hartuar planin mësimor;
- b) të përgatitet seriozisht për mësim, duke ndjekur parimet e mësimin të gjuhës së dytë me bazë trurin;
- c) të jetë i/e zhdërvjelltë, krijues e novator (të sjellë risi) në teknikat e përdorura në mësimdhënie;
- d) të ketë objektiva gjuhësorë të qartë, që do të arrihen në çdo orë mësimi, si dhe në çdo nivel (këto objektiva gjuhësorë duhet të jenë të qartë dhe të matshëm).

Një rubrikë e caktuar në fund të çdo mësimi, duhet të bëjë “inventarin e dijeve” për secilën orë mësimi, p.sh.: aftësitë gjuhësore të fituara dhe rezultatet e pritura.



Në fund të këtij mësimi, studentët do të njohin dhe përdorin fjalët e mëposhtme: do të jenë në gjendje të përshkruajnë familjen, të shkruajnë një kartolinë, të prezantojnë veten etj.

## Planifikimi ditor i mësuesit

Autorët e platformës nuk pretendojnë të japin “receta” që mund të përdoren në çdo situatë dhe për çdo nxënës në shkollat shqipe në diasporë. Me këtë platformë ne përpiqemi të japim parametrat kryesorë linguistikë dhe didaktikë dhe ia besojmë planifikimin konkret të orëve të mësimi kolegëve tanë të nderuar, të cilët njohin dinamikën e grupeve të nxënësve.

Planifikimi ditor është përgatitje ditore e mësuesit, e cila drejton dhe orienton mësuesin drejt një mësimdhënieje të suksesshme dhe me objektiva të qartë (të cilët mund të jenë të njëjta për disa orë mësimi). Plani ditor duhet të mbajë në konsideratë karakteristikat e grupmoshave të fëmijëve, nivelin e tyre gjuhësor dhe kërkesat e kurrikulës. Fushat e të nxënësve të dhëna në Librin e Mësuesit parashikojnë qartë kompetencat kyçe që do të përvetësojë nxënësi në fund të çdo mësimi.

Kompetencat shprehen nëpërmjet shkathtësive, njohurive dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave dhe teksteve. Kompetencat kyçe janë ato kompetenca që i duhen çdo individit për zhvillimin e një bashkëbisedimi personal, qytetar, komunikimi në komunitet si dhe për përfshirje në jetën sociale apo për punësim, në rastet kur nxënësit mund të vendosin të kthehen në atdhe.

Cilat janë kompetencat kyçe?

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- Kompetenca e të menduarit;
- Kompetenca e të mësuarit;
- Kompetenca për jetesën dhe mjedisin;
- Kompetenca personale;
- Kompetenca qytetare;
- Kompetenca digjitale.

Rezultatet e të nxënësve: Kjo është një “deklaratë”, e cila përshkruan atë se çfarë duhet të dinë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit në saje të kësaj mësimdhënieje cilësore dhe të parashikuar mirë, por edhe dinamike në bazë të kushteve konkrete.

Koha e mësimi (e rekomanduar): Nxënësit/et e vijojnë mësimin 2 orë në javë, zakonisht, çdo të diel në orën 11:00-13:00 (me një pushim të shkurtër në

mes). Megjithatë, orari mund të jetë i ndryshëm në shtete të ndryshme. Mësuesit këshillohen të marrin parasysh modelet e dhëna në këtë tekst dhe të përpiqen të zgjedhin modelin më të përshtatshëm për kushtet konkrete të mësimit në shkollën e tyre.

Struktura e rekomanduar e 2 orëve të mësimit të përjavshëm: Ky plan është vetëm orientues dhe nuk pretendon të jetë përcaktues (as favorizues, as përjashtues) në aspektin e rëndësisë së organizimit të veprimtarive mësimore në shkollat e diasporës. Vetë karakteri bashkëbisedues në angazhimin aktiv të nxënësit (student based) me fokus kryesor të folurit dhe metodat e një mësimdhënieje ndërvepruese, e cila në të shumtën e herës ka tiparet e një mësimi të diferencuar, nuk na jep mundësi të përgatisim “receta didaktike” të përcaktuara paraprakisht për çdo situatë mësimore, që përjetojnë mësuesit në shkollat e diasporës. Pra, në këtë kontekst shmanget edhe rreziku i krijimit të përshtypjes së gabuar se mësuesit nuk i lejohet mundësia të jetë krijues përmes mësimdhënies së kësaj lënde.

Bisedim, zhvillim i të folurit (Krijimi i një rutine të parapritur/parashikuar nga nxënësit rrit besimin dhe sjell kënaqësi tek ata.):

“Çfarë ndodhi gjatë javës?” “Çfarë mësuam javën e kaluar?”	10 minuta
Lexim dhe shkrim (materiali kryesor i ditës sipas planit)	50 minuta
Gramatika (punë në grupe)	20 minuta
Dialogu i mësimit (sipas temës së mësimit)	20 minuta
Personalitete nga trevat ku jetojnë shqiptarë “A e dini se?”	10 minuta
Inventari i të mësuarit (përforcimi i njohurive)	
“Çfarë ndodhi në klasë sot?”	10 minuta
Si detyrë shtëpie mund të rekomandohet një fletë pune ku nxënësit shkruajnë diçka që kanë mësuar në këtë mësim ( 3-5 fjalë, 2-3 fjali etj.)	

## PLANI DITAR (i rekomanduar)

Data

<b>Lënda:</b>	<b>Klasa:</b>
<b>Tema mësimore – Objektivat:</b>	
<b>Situata e të nxënit:</b>	<b>Fjalët kyçe:</b>
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	<b>Burimet:</b>
<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Puna e diferencuar:</b>	
<b>Metodologjia:</b>	
<p><b>Organizimi i orës së mësimit:</b></p> <p><u>Struktura e 2 orëve të mësimit të përjavshëm:</u></p> <p><i>Çfarë</i> mësuam të shtunën e kaluar? <i>Çfarë</i> mbani mend: fjalë, shprehje përmbajtje...</p> <p>Bisedim, zhvillim të të folurit: “<i>Çfarë ndodhi gjatë javës?</i>” <b>10 minuta</b></p> <p>Lexim dhe shkrim (materiali kryesor i ditës sipas planit) <b>50 minuta</b></p> <p>Gramatika (punë në grupe) <b>20 minuta</b></p> <p>Dialogu i mësimit (<i>sipas temës së mësimit</i>) <b>20 minuta</b></p> <p>Personalitete të trevave shqiptare “A e dini se?” <b>10 minuta</b></p> <p>Inventari i të mësuarit “<i>Çfarë ndodhi në klasë sot?</i>”  <i>Përforcimi i materialit të ri të mësuar .</i> <b>10 minuta</b></p>	Detaje:
<b>Vlerësimi:</b>	
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>	

Çdo mësim është ndërtuar mbi bazën e rubrikave të mëposhtme:

- ➔ LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË
- ➔ SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI GRAMATIKË
- ➔ NJOHIM TRASHËGIMINË TONË
- ➔ FJALORI

---

# MËSIMI 1

Atdheu im, shqipja, shqiptaria

Kush jam unë?

---

## Qëllimet mësimore:

- Si të prezantohemi
- Si të përshëndetemi
- Gramatikë: alfabeti; përemrat vetorë; foljet jam, kam; lidhëzat dhe, por; fjali të thjeshta pohore, pyetëse, mohuese.
- Punë e diferencuar: “Kënga e Alfabetit”, “Atdheu”, “Gjuha Shqipe”, “Parashqevi Qiriazi”.

LIDHJA ME KURRIKULËN – 1.1. Unë jam... 1.5. Unë dhe mjedisi 1.6. Atdheu

Objektivi mësimor. Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

**LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË:** Mësimi 1 prezanton “personazhet”, me të cilat nxënësit do të takohen në çdo mësim të kësaj platforme; personazhet modelojnë fjalitë që përdoren në gjuhën shqipe në raste prezantimi dhe përshëndetjet më të zakonshme.

**SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI:** Dy fjalëkryqe ku përdoren fjalët e marra nga dialogët në mes mësuese Teutës dhe nxënësve të saj

## GRAMATIKË: Mësimi 1 ka këto aspekte gramatikore:

- i. përemrat vetorë unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato
- ii. foljet jam, kam
- iii. lidhëzat por, dhe
- iv. ndajfoljet mirë, shumë mirë, keq, shumë keq

**NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Parashqevi Qiriazi, Kënga e Alfabetit, poezitë “Atdheu” dhe “Gjuha shqipe”

**FJALORI:** atdhe, çka, dhe, Ditën e mirë!, Gëzohem!, jam, kam, kam lindur, flas, keq, bëj, ku, kush, mirë, nga, Mirëdita!

Mirëmbërëma! Mirëmëngjesi! Mirupafshim! Natën e mirë!

Përsëndetje, si, shqip, shqiptar, shqiptare, shumë keq, shumë mirë, unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato

Materialet e nevojshme për këtë mësim. Përveç librit të nxënësit dhe librit të ushtrimeve (në varësi të grupmoshës), nxënësit duhet të kenë një qese me materiale të ndryshme për të punuar (disa nga materialet gjenden në çdo shtëpi dhe disa të tjera mund të blihen). Koleksionet që nevojiten (në varësi të grupmoshës së nxënësit): objekte të formave, madhësive dhe ngjyrave të ndryshme, si: kopsa, lapsa me ngjyra, kukulla plastike; fotografi nga kalendarë të vjetër, revista, zare, monedha lodra, kapëse letre, modele orësh, kalendar i përdorur, termometra, telefona të vjetër etj.

### **Cilat janë konceptet e reja?**

Koncepti i ri në këtë mësim është të mësojmë si të prezantohemi dhe të përsëndetemi në gjuhën shqipe. Gjithashtu, në këtë mësim nxënësit do të mësojnë edhe si të përdorin përsëndetjet në përshtatje më kohën dhe situatën ku ndodhen. Në aspektin e mësimin praktik të gramatikës, kemi 3 koncepte të reja: foljet jam, kam; lidhëzat dhe, por; dhe ndajfoljet mirë, shumë mirë, keq, shumë keq. Në fushën e shkrimit, në këtë mësim punohet me alfabetin e gjuhës shqipe me ilustrime dhe me fokus të veçantë tek germat dyshe.

## Si do t'i bëjmë ushtrimet?

Duke mbajtur parasysh që takimet në shkollat shqipe nuk janë të përditshme, por vetëm dy herë në javë dhe me fokus të dëgjuarit dhe të folurit, edhe ushtrimet do të konsiderohen në funksion të këtij fokusi dhe duhet të jenë sa më praktike dhe ndërvepruese. Në çdo aktivitet në klasë mësuesi do të informohet nga rregullat e mësimit të gjuhës së huaj. Për mësimet e para rekomandojmë që ushtrimet të paraqiten në bazë të parimit “Përgjigje Totale Fizike” (PTF) - ku lidhet gjuha me lëvizjet fizike/trupore. Në këto veprimtari nxënësi reagon ndaj komandave dhe fjalorit të ri që mëson dhe vepron sipas të kuptuarit të të dhënave gjuhësore që merr. Për detaje më të hollësishme shihni rekomandimet didaktike më poshtë.

## Si të kontrollojmë dijet?

Fokusi qendror i kësaj platforme “Mëso Shqip” është që nxënësit të “shijojnë” mësimin e gjuhës shqipe dhe jo të tremben prej saj. Për këtë arsye, si mësimi, ashtu edhe kontrolli i nivelit të progresit në përdorimin e gjuhës shqipe duhet të bëhen në një mjedis bashkëpunimi gazmor, ku nxënësit do të ndihen të qetë për të testuar veten në përdorimin e fjalorit të mësuar, qoftë edhe duke bërë ndonjë gabim, sepse ata e dinë që askush nuk do të tallet me gabimet e tyre. Kjo mund të arrihet nëpërmjet “vënies në skenë” dhe interpretimit të dialogut, lojërave gjuhësore (anagrame, fjalëkryqe etj.) apo konkurseve të njohurive (kuriozitete dhe fakte shkencore për trevat shqiptare apo shqiptarë të shquar).

# MËSIMI 1

*Atdheu im, shqipja, shqiptaria  
Kush jam unë?*

## **Qëllimet mësimore:**

- a) Si të prezantohemi
- b) Si të përshëndetemi
- c) Gramatikë: alfabeti; përemrat vetorë; foljet *jam, kam*; lidhëzat *dhe, por*; fjali të thjeshta pohore, pyetëse, mohuese.
- d) Punë e diferencuar: “Kënga e Alfabetit”, “Atdheu”, “Gjuha Shqipe”, “Parashqevi Qiriazi”.

## **LIDHJA ME KURRIKULËN *Identiteti im***

Unë jam...

Unë dhe mjedisi

Atdheu



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOKJMË

PREZANTOHEMI



Unë jam mësuese Teuta.



Unë jam Dardani.



Unë jam Redona.



Unë jam Vesa.



Unë jam Egini.



Mësuese Teuta: **Mirëmëngjesi**, të dashur nxënës!  
Unë **jam** mësuesja juaj.

E **kam** emrin Teuta dhe jam **nga** Shqipëria. Ne **flasim** shqip. Po **ju**, **kush jeni**?



*Dardani:* Unë **e kam** emrin Dardan. Unë jam **nga** Kosova, nga Drenica. Kosova është **atdheu** im, **por tani** nuk **jetoj** në Kosovë.



*Vesa:* Unë e kam emrin Vesa. Unë jam nga Shqipëria, nga Himara. Shqipëria është atdheu im, por tani nuk jetoj në Shqipëri.



*Egini:* Unë e kam emrin Egin. Unë jam nga Maqedonia e Veriut, nga Tetova. Maqedonia e Veriut është atdheu im, por tani nuk jetoj në Maqedoninë e Veriut.



*Redona:* Unë e kam emrin Redona. Unë jam nga Mali i Zi, nga Podgorica. Mali i Zi është atdheu im, por tani nuk jetoj në Mal të Zi.




### 1. Përgjigjuni pyetjeve.

**Nga** je ti? \_\_\_\_\_

**Ku** jeton ti? \_\_\_\_\_

**Rekomandim didaktik 1:** Meqenëse ky është takimi i parë me nxënësit, mësuesi përpiqet të krijojë një mjedis të ngrohtë. Kjo mund të arrihet në fillim me një aktivitet ku mësuesi “modelon” dialogun për të prezantuar veten me fjali të shoqëruar me foto apo me anë të gjestikulacioneve dhe të lëvizjeve të trupit për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë fjalët që nuk dinë dhe pastaj i fton nxënësit të zgjedhin “personazhin” e preferuar dhe të lexojnë dialogun. Meqenëse fjalori i nxënësve është i kufizuar, mësuesi duhet të përdorë foto, shumë gjeste dhe në ndonjë rast edhe të përkthejë në gjuhën e vendit ku ata jetojnë.

## PËRSHËNDETEMI



*Mësuese Teuta:* Të dashur nxënës, le të bëjmë disa dialogë së bashku.



*Dardani:* **Mirëmëngjesi!** Unë jam Dardani. **Kush** je ti?



*Vesa:* Mirëmëngjesi, Dardan! Unë jam Vesa. **Nga** je ti?



*Dardani:* Unë jam nga Kosova, nga Prishtina. Po ti, Vesa, nga je?



*Vesa:* Unë jam nga Shqipëria. Jam nga Tirana.



*Dardani:* Sa mirë! Ne flasim shqip.



*Redona:* **Mirëdita!** Unë jam Redona. Kush jeni ju?



*Egini:* Mirëdita! Unë jam Egini. Nga jeni ju, Redona?



*Redona:* Unë jam nga Shqipëria, nga Vlora. Po ju?



*Egini:* Unë jam nga Mali i Zi, nga Ulqini.



*Redona:* **Ditën e mirë!**



*Egini:* **Mirupafshim!**



*Vesa:* **Mirëmbërëma!** A je ti Dardani?



*Dardani:* Mirëmbërëma! Po, unë jam Dardani. A je ti Redona?



*Vesa:* Jo, unë nuk jam Redona. Unë jam Vesa.



*Dardani:* Kush janë ata?



*Vesa:* Redona dhe Egini.



*Dardani:* **Faleminderit! Mirupafshim!**

**Rekomandim didaktik 2:** Në këtë ushtrim, mësuesi ka rastin të kontrollojë nëse nxënësit kanë përvetësuar, si mënyrën për të bërë një prezantim të thjeshtë, ashtu edhe përdorimin e përshëndetjeve në situatat e përshtatshme. Ky ushtrim mund të bëhet edhe më interesant dhe ndërveprues, duke i vënë nxënësit në rolin e mësuesit (duke i kërkuar “nxënësit-mësues” të shkojnë tek një shok dhe të prezantohet ose t’u tregojë fotot shokëve dhe ata t’i japin përshëndetjen e përshtatshme sipas fotove).



## 1. Plotësoni përgjigjet sipas bisedës së mësuese Teutës me nxënësit.



Vesa: Cili është atdheu yt?



Dardani: Atdheu im është \_\_\_\_\_.



Dardani: A është Egini nga Kosova?



Redona: Jo, Egini është nga \_\_\_\_\_.



Redona: Nga është Vesa?



Egini: Vesa është nga \_\_\_\_\_.



Egini: A është Dardani nga Kosova?



Vesa: Po, Dardani është nga \_\_\_\_\_.

## 1. Lidhni fotot me përshëndetjet.



Mirëmëngjesi!

Mirëdita!



Mirëmbërëma!

Mirupafshim!



Natën e mirë!

Ditën e mirë!



**Rekomandim didaktik 3:** Mësuesi modelon përshëndetjet duke përdorur foto të ndryshme ose duke i përkthyer shprehjet në gjuhëne vendit. Pas kësaj, ai përdor “Përgjigjen Totale Fizike” (PTF). Kjo veprimtari organizohet në këtë mënyrë: nxënësit vendosen në dy rreshta përballë njëri-tjetrit; mësuesi tregon foto të kohëve të ndryshme të ditës/natës dhe kërkon që nxënësit të përdorin përshëndetjet e duhura me njëri-tjetrin. Në fund, mësuesi fton nxënësit të dalin vullnetarë për të “lojën me role” tre dialogët e mësipërm dhe i inkurajon ata të punojnë në çifte.

### Si të mësojmë alfabetin shqip?

Kjo mund të realizohet në forma të ndryshme, gjithmonë duke i kushtuar vëmendje të veçantë shkronjave dyshe, si një element i veçantë i alfabetit të gjuhës shqipe. Mësuesi do të organizojë ushtrime të ndryshme p.sh.: mund t’i kërkohe nxënësit që të recitojë/këndoje alfabetin; të identifikojë shkronjat e mëdha apo të vogla; të dallojë shkronjat dyshe; të identifikojë tingujt për secilën shkronjë etj. Mësuesi duhet të bëjë sa më shumë paraqitje vizuale në klasë, nëse është e mundur.





Mësuese Teuta: Le të mësojmë alfabetin e gjuhës shqipe.



A [a]  
ARRË



B [b]  
BALONË



C [ts]  
CIRK



Ç [tʃ]  
ÇOKOLLATË



D [d]  
DISK



DH [ð]  
DHJETË



E [e]  
ENGJËLL



Ë [ə]  
ËMBËLSIRË



F [f]  
FAR



G [g]  
GUR



GJ [j]  
GJYSH



H [h]  
HARTË



I [i]  
IRIQ



J [j]  
JASTËK



K [k]  
KOMPJUTER



L [l]  
LUAN



LL [ɬ]  
LLAMBË



M [m]  
MAMA



N [n]  
NATË



NJ [ɲ]  
NJERI



O [o]  
ORË



P [p]  
PJATË



Q [c]  
QEN



R [r]  
RAKETË



RR[r]  
RROBË



S [s]  
SAPUN



SH [ʃ]  
SHALL



T [t]  
TOP



TH[θ]  
THES



U [u]  
URË



V [v]  
VEZË



X [dz]  
XIXË



XH [dʒ]  
XHAKETË



Y [y]  
YLL



Z [z]  
ZEBËR



ZH [ʒ]  
ZHAPIK



**1. Shkruani dhe lexoni 10 fjalë të gjuhës shqipe.**

1 \_\_\_\_\_

6 \_\_\_\_\_

2 \_\_\_\_\_

7 \_\_\_\_\_

3 \_\_\_\_\_

8 \_\_\_\_\_

4 \_\_\_\_\_

9 \_\_\_\_\_

5 \_\_\_\_\_

10 \_\_\_\_\_



## 1. Plotësoni fjalën me shkronjën e duhur: ll, dh, gj, xh, ç, q.

\_ampa



\_jetë



\_ysh



\_aketë



\_okollatë



\_endër



**Rekomandim didaktik 4:** Qëllimi i këtij aktiviteti didaktik është që nxënësi të mësojë alfabetin shqip, me fokusin kryesor tek njohja e shkronjave të përbëra ll, dh; gj, xh; ç, q (të cilat ngatërrohen në shqiptim) dhe lidhja mes germave të përbëra me tingujt e tyre (marrëdhënia grafemë p/ u/ sh/ dhe fonemë /p/, /u/, /s/). Ky është një element i rëndësishëm për gjuhën shqipe dhe që nuk gjendet në shumë gjuhë të tjera. Pra, nxënësi i shkollës shqipe, i cili mëson alfabetin e një gjuhe tjetër duhet ta mësojë këtë veçori linguistike. Kjo do të arrihet shumë këndshëm me ushtrimin e mësipërm, të cilin mësuesi mund ta organizojë si konkurs mes nxënësve që zhvillohet jo më shumë se 5 minuta. Fituesi i konkursit merr një dhuratë simbolike. Një mënyrë tjetër është puna në çifte, ku njeri nxënës luan rolin e “mësuesit” dhe pyet “Çfarë germe duhet tek fjala e parë... e dytë... e tretë etj.” dhe partneri përgjigjet duke zgjedhur shkronjat e duhura. Mësuesi mund të mbështetet tek faja e Alfabetit Fonetik Ndërkombëtar IPA për ata tingujt të vështirë për t’u shqiptuar. Gjithashtu, nxënësit vihen në dy skuadra që të shkruajnë shkronjën e thënë në dërrasë, p.sh.: skuadra A thotë fjalën, skuadra B e shkruan shkronjën e përbërë të kësaj fjale e kështu me radhë.



## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI


**Gjeni fjalën e fshehur.**



**Qarkoni emrat e qyteteve:** *Drenica, Peja, Podgorica, Tetova, Tirana, Vlora.*

H	M	P	C	B	A	F	H	Y	H	Q	G	N	O	E
U	T	E	T	O	V	A	P	U	I	O	P	A	E	P
E	Q	M	N	B	B	E	R	P	I	Q	R	T	L	K
C	Q	Q	L	M	F	F	O	I	O	G	L	R	Q	Z
P	G	R	M	F	E	D	U	Q	N	H	T	D	G	X
Z	U	R	R	P	G	E	T	X	A	Y	M	H	G	C
L	H	Q	V	O	V	N	E	B	T	Z	V	I	P	N
Z	S	C	R	D	L	L	T	O	D	H	Z	H	J	L
V	U	I	V	G	I	O	O	F	T	D	T	V	J	I
Q	C	E	N	O	S	T	V	T	I	R	A	N	A	N
A	E	M	E	R	N	T	A	V	G	K	I	E	M	J
X	J	V	E	I	Q	K	E	L	R	I	O	E	O	D
Y	R	J	G	C	Z	Z	B	O	E	P	E	J	A	D
V	A	G	H	A	K	I	S	R	Z	V	J	Y	L	G
D	R	E	N	I	C	A	A	A	N	H	G	S	Y	H

### 7. Gjeni dhe plotësoni fjalëkryqin.



**Rekomandim didaktik 5:** Dy ushtrimet e mësipërme janë rasti më i mirë ku mësuesi mund të paraqesë konceptin e lojës gjuhësore. Me ushtrime të këtij lloji, mësuesi në mënyrë të natyrshme arrin ta bëjë mësimin shumë tërheqës për fëmijët. Ai mund të krijojë çifte fëmijësh që mund të punojnë bashkë për të gjetur fjalët “sekrete” ose për të zgjidhur fjalëkryqin. Një mënyrë tjetër, mund të jetë edhe një minikonkurs në mes të dy skuadrave. Mësuesi mat kohën që i duhet secilës skuadër për të përfunduar ushtrimin dhe shpall fituesin. Veprimtari të tilla didaktike e bëjnë mësimin shumë interesant dhe sigurojnë kalimin e informacionit në kujtesën afatgjatë, gjë që ndihmon në mënyrë të dukshme përvetësimin e gjuhës së dytë.



## GRAMATIKË

### ❖ PËREMRA VETORË

Veta	Njëjës	Shumës
veta I	unë	ne
veta II	ti	ju
veta III	ai, ajo	ata, ato

### 8. Plotësoni dialogun me përemra vetorë.

- Mirëdita, Dardan! \_\_\_\_ jam Redona. Nga je \_\_\_\_?
- \_\_\_\_ jam nga Kosova. Po \_\_\_\_ nga je?
- \_\_\_\_ jam nga Shqipëria.
- Gëzohem.

❖ **FOLJA JAM**

unë jam	ne jemi
ti je	ju jeni
ai, ajo është	ata, ato janë

**FOLJA KAM**

unë kam	ne kemi
ti ke	ju keni
ai, ajo ka	ata, ato kanë

**9. Shkruani përemrat vetorë dhe zgjedhoni foljet *jam* dhe *kam*.**

përemri	jam	kam

❖ **LIDHËZA DHE, POR**

Joni **dhe** Era janë nga Tetova. Unë jam nga Tirana, **por** banoj në Vlorë.

Ato janë Amla **dhe** Gresa. Unë jam nga Tirana, **por** banoj në Ulqin.

**10. Vini lidhëzat *por/dhe* aty ku duhet.**

Unë jam nga Tirana, \_\_\_\_\_ jetoj në Gjakovë.

Gresa \_\_\_\_\_ Guri janë nga Prishtina.

Ai është nga Kërçova, \_\_\_\_\_ unë jam nga Ohri.

Unë \_\_\_\_\_ ata jetojmë në Ulqin.

## ❖ DISA NDAJFOLJE



mirë



shumë mirë



keq



shumë keq

### 11. Vini foljen *jam* dhe ndajfoljet *mirë* ose *keq*.

*Si jeni ju? Mirë, faleminderit!*

- Dea, si \_\_\_\_\_ ti?
- \_\_\_\_\_, faleminderit.
- Po ti, si \_\_\_\_\_?
- \_\_\_\_\_ faleminderit.
- A flet shqip \_\_\_\_\_ Gresa?
- Ajo flet \_\_\_\_\_. Po ti, si flet \_\_\_\_\_?
- Unë shkruaj \_\_\_\_\_, por flas \_\_\_\_\_.



### Si të pyesim e si të përgjigjemi

*Kush je ti?* Unë jam Erza. Jam Erza.

1. *Nga je ti?* Unë jam nga Shqipëria. Jam nga Gjilani.
2. *Po ti, nga je?* Unë jam nga Shqipëria. Jam nga Tirana.
3. *Si je?* Mirë, faleminderit. Shumë mirë, faleminderit!

### 12. Plotësoni fjalitë me fjalët e dhëna.

- *Kush është*
- *jeni nga Peja*
- *janë Drini dhe Vjosa*
- *nga jeni*
- *Nga je*
- *jam nga Mitrovica*
- *Si*

Unë \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_ ti  
 \_\_\_\_\_ nga Drenica?  
 Po ju \_\_\_\_\_?  
 Ju \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_ janë ata?

❖ **LLOJET E FJALIVE**

– A je ti Dardani? – Jo, unë nuk jam Dardani. Jo, unë s’jam Dardani.

**13. Plotësoni vendet bosh sipas shembullit të dhënë.**

– A je ti nga Durrësi? – Po, unë jam nga Durrësi. Jo, unë nuk jam nga Durrësi.  
 – A është ai nga Tirana? – \_\_\_\_\_  
 – A flet shqip ti? – \_\_\_\_\_  
 – \_\_\_\_\_ Po, unë jam nga Gjakova.  
 – \_\_\_\_\_  
 – Jo, unë nuk jam nga Peja.  
 – A janë ata? – \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 – \_\_\_\_\_  
 – Po, ne jemi mirë. \_\_\_\_\_

**Rekomandim didaktik 6:** Fokusi didaktik në ushtrimet e mësipërme është në aspektin gramatikor të gjuhës shqipe. Megjithatë, dhënia e njohurive gramatikore në platformën “Mëso Shqip” mbështetet më shumë në parime pragmatike të njohjes dhe përdorimit korrekt të gjuhës, sesa në njohjen përmendësh të rregullave gramatikore. Nëse duam t’i konsiderojmë metodat e mësimdhënies si metoda të zhërvjellta me fokus tek zhvillimi i shprehive për të komunikuar, kjo do të thotë që gramatikën e mësojmë në kontekst dhe nxënësit i japim sa më shumë raste të jetë e mundur që ta praktikojë atë.





## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË

Dëgjojmë këngën “Jam krenare që jam shqiptare” dhe shkruajmë fjalët që njohim.



*“Jam krenare se jam shqiptare  
Kam lënë gjurmë në histori”*

[https://www.youtube.com/watch?v=bSEiJKjho\\_E](https://www.youtube.com/watch?v=bSEiJKjho_E)

Dëgjojmë këngën “Kënga e alfabetit” të shkruar nga Parashqevi Qiriazi.

<https://www.youtube.com/watch?v=dMvnJ19Bj9Q><https://www.youtube.com/watch?v=dMvnJ19Bj9Q>

**Rekomandim didaktik 7:** Pasi dëgjohet kënga dhe nxënësit përpiqen të shkruajnë disa fjalë që i njohin ose mund t'i “deshifrojnë” vetëm duke i dëgjuar, mësuesi do të përpunojë edhe mesazhin e këngës – krenarinë që jam shqiptar! Kjo mund të arrihet shumë bukur, duke u mësuar fëmijëve se si të vizatojnë flamurin tonë me shqiponjën dykrenore. Kjo mund të arrihet me forma të ndryshme, në faqen tjetër kemi vënë disa rekomandime se si mund të përdoret një vizatim i thjeshtë i flamurit dhe pastaj të ngjyroset ose si mund të bëhet shqiponja duke ndërthurur gishtat. Për lehtësinë tuaj, këtu kemi përfshirë edhe dy adresa videosh në YouTube, të cilat shpjegojnë hap pas hapi si mund të vizatohet dhe ngjyroset flamuri shqiptar. [https://www.youtube.com/watch?v=A-uC3WAp174&ab\\_channel=ExpertVillageLeafGroup](https://www.youtube.com/watch?v=A-uC3WAp174&ab_channel=ExpertVillageLeafGroup)

[https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=4RKYVIOgXLE&ab\\_channel=DrawingMa](https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=4RKYVIOgXLE&ab_channel=DrawingMa)



### *A e dini se...*

Parashqevi Qiriazi është e vetmja grua që mori pjesë në Kongresin e Alfabetit, në Manastir, në vitin 1908. Parashqevi Qiriazi është një nga themelueset e shoqërisë së parë të grave shqiptare “Yll’ i Mëngjesit”, në Korçë, në vitin 1909.

## 15. Lexoni fragmentet e poezive dhe qarkoni fjalët që njihni.

### Atdheu

O Atdhe! Më je i dashur sa më s’ka  
Më je nënë, më je motër, më je vëlla.  
Nga ç’ka rrotull më i shtrenjti ti më je,  
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhé.

(Naim Frashëri)

### Gjuha shqipe

Geg’ e tosk’, malsi, jallia  
jan’ një komb, m’u da, s’duron;  
fund e maj’ një a Shqipnia  
e një gjuh’ t’gjith’ na bashkon.

(Ndre Mjeda)

### FJALË TË URTA

*Fillimi i mirë është gjysma e punës.*

**Rekomandim didaktik 8:** Përmes materialeve të mësipërme, nxënësi arrin të bashkërendojë të dhënat dhe njohuritë e domosdoshme mbi figura të ndritura të kombit shqiptar dhe ngjarje të rëndësishme të historisë shqiptare. Aty janë bashkërenditur historia, arti, muzika, trashëgimia kulturore, si nëpërmjet rubrikës “A e dini se?”, ashtu edhe me anë të këngës së alfabetit të shkruar nga Parashqevi Qiriazi. Mësuesi mund të jetë shumë krijues në këtë aspekt të njohjes me trashëgiminë kombëtare – ai mund t’u mësojë fëmijëve këngën e alfabetit; mund t’u shfaqë filmin “Mësonjëtorja” (këtu mund të krijohet një mjedis intim ku fëmijët mund të sjellin një jastëk apo batanije të vogël nga shtëpia, mësuesi të përgatisë ca kokoshka dhe nga një gotë me lëng frutash, dhe klasa kthehet në një kinema të vogël). Veprimtari të tilla didaktike zhvillojnë një qëndrim pozitiv të nxënësve dhe ndjenjën e krenarisë për identitetin e tyre kombëtar, bashkë me qëndrimin tolerant e dashamirës ndaj popujve të tjerë dhe traditave të tyre.

**PROJEKT:** Pyesni prindërit ose gjyshërit tuaj për vendlindjen e tyre dhe bëni një poster të vogël me fotografi të ndryshme (vende, veshje, ushqime etj.)

**Rekomandim didaktik 9:** Në varësi të grupmohës së nxënësve, mësuesi mund të organizojë një ekspozitë me posterat e nxënësve dhe të ftojë prindërit dhe nxënësit që të votojnë për posterin më të mirë. Mësuesi mund të ftojë edhe sponsor që mund të japin dhurata për fituesit. Një projekt tjetër interesant që do të përfshinte edhe prindërit dhe do të ndihmonte në përgatitjen për festimet kombëtare mund të jetë edhe qepja e bluzave me flamurin kombëtar (thjesht bashkohen, me të qepur dy flamuj, duke lënë dy hapje për të futur krahët dhe kështu krijohet një bluzë me shqiponjën e flamurit në gjoks dhe në kurriz; kur hapen krahët e fëmijëve për të vallëzuar, duket sikur shqiponja “fluturon”).

## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
ai		fletore
ajo		gomë
ata		laps
ato		lind
atdhe		libër
bëj		motër
çka		mprehëse
dhe		nënë
ditë		notoj
flas		originë
gëzohem		prind
jam		stilolaps
ju		tenis
kam		vëlla
lind		vizore
keq		
ku		
kush		
lind		
mirë		
mirëdita		
mirëmbërëma		
mirëmëngjesi		
mirupafshim		
natë		
ne		
nga		
përsëndetje		
si		
shqip		
shqiptar		
shumë		
unë		
ti		

**Rekomandim didaktik 10:** Këtu duhet theksuar që mësuesi duhet të bëjë “inventarin e dijeve” në fund të çdo mësimi. Në këtë mënyrë realizohet qëllimi i platformës “Mëso Shqip” për të pasur rezultate të matshme dhe evitohet krijimi i mangësive gjuhësore para se të vazhdohet në mësimin e ardhshëm. Për sa i përket njohurive të fjalorit, duhet mbajtur parasysh që kemi tre lloje fjalori:

- a) Fjalori i ri: Fjalori i ri i synuar që nxënësi duhet ta zotërojë në mësim, ta kuptojë dhe ta përdorë lirshëm në të folur.
- b) Fjalori i përsëritur: Fjalori i mësuar më pare, i cili ripërdoret në një kontekst gjuhësor të ri.
- c) Fjalori shtesë: Ky fjalor i referohet fjalëve ndaj të cilave nxënësi vetëm ekspozohet, i kupton por nuk është në gjendje t’i përdorë në situata konkrete.

*SHËNIM: Nxënësi duhet të jetë në gjendje të zotërojë fjalorin e ri dhe të rishikojë fjalorin e përsëritur, por vetëm të identifikojë apo të ketë një ide për fjalorin shtesë. Në mësimin e parë nuk kemi “fjalor të përsëritur” pasi nuk kemi asnjë mësim para tij.*

# MËSIMI 2

## *Familja ime* *Bisedoj me gjyshin*

### Qëllimet mësimore:

- a) Familja ime
- b) Bisedoj me gjyshin
- c) Gramatikë: shkronjat dyshe, shqiptimi i tyre; foljet *punoj, tregoj, njoh, them, dua*; disa emra të familjarëve në trajta të ndryshme; parafjalët *në, me*.
- d) Punë e diferencuar: “Libra për gjyshërit”, “Musine Kokalari”.

### LIDHJA ME KURRIKULËN *Identiteti im*

- Flas për familjen
- Marrëdhënia mes brezave
- Trashëgimia përmes letërsisë

Objektivi mësimor. Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË: Mësimi 2 na ndihmon të mësojmë fjalët që lidhen me familjen dhe marrëdhëniet e lidhjet brenda anëtarëve të familjes.
- SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI: Për ta bërë mësimin më interesant, në këtë rubrikë do të kemi disa lojëra gjuhësore, si: fjalëkryq, bashkimin e pikave për të krijuar figurën dhe për të përdorur fjalorin e mësuar në rubrikën “Lexojmë, kuptojmë dhe bisedojmë” për të përshkruar pikturën e kompletuar.
- GRAMATIKË: Mësimi 2 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. Emrat e gjinisë femërore dhe mashkullore, numri njëjës dhe shumës;
  - ii. Foljet bëj, punoj, njoh, tregoj, dua;
  - iii. Parafjalët në, me;
  - iv. Përemrat pronorë im, yt, e mi, e tu, ime, jote, e mia, e tua;
  - v. Mbiemra i/e vogël, i/ e madh/e, i/e gëzuar;
  - vi. Numërorët 1-20.
- NJOHIM TRASHËGIMINË TONË: “Kënga e gjyshes”, “Librat për gjyshin dhe gjyshen”, “Musine Kokalari”
- FJALORI: vjeç, album, babi, bëj, dajë, dua, e madhe, e vogël, familje, gjysh, gjyshe, hallë, i gëzuar, kushërirë, mami, më merr malli, motër, njoh, surprizë, teze, them, tregoj, vëlla , xhaxha, numërorët 1-20.

**Koncept i përgjithshëm didaktik:** Fokusi kryesor i mësimdhënies në platformën “Mëso Shqip” është të mësuarit me bazë trurin, pra jo vetëm duke u bazuar në kujtesën, e cila nxit vetëm të mësuarit përmendësh. Mësimi i bazuar në tru është një metodë e përparuar e mësimdhënies që synon të rrisë shpejtësinë dhe efikasitetin e të mësuarit të gjuhës shqipe. Në vend të të mësuarit për të riprodhuar dijet në mënyrë mekanike, mësuesi duhet të shikojë zbulimet më të fundit të shkencës didaktike, si frymëzim për mbajtjen e mësimin në të ardhmen. Dialogu i sotëm akademik dhe kërkimi shkencor rreth të mësuarit që bazohet në tru përqendrohet në zbulimet e neuroplasticitetit, aftësisë dhe zhdërvjelltësisë së trurit për të NDRYSHUAR DHE PËRSHTATUR gjatë gjithë jetës së individit. Truri i njeriut ka aftësinë e mahnitshme të riorganizohet, duke formuar lidhje të reja midis qelizave të trurit (neuroneve) nëpërmjet krijimit të dendriteve “degët e pemës” së trurit, vendi ku neuroni lidhet me qelizat e tjera. Dendritet degëzohen, ndërsa lëvizin drejt majave të tyre, ashtu si degët e pemëve, dhe lidhin informacionin e vjetër me atë të riun që sapo mësohet. Përveç faktorëve gjenetikë, mjedisi në të cilin jeton një person, si dhe veprimet e tij, luajnë një rol të rëndësishëm në plasticitetin (veprimtarinë) apo plakjen e dendriteve, e cila shkakton mbajtjen apo prishjen e kujtesës.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOKMË



Mësuese Teuta: Të dashur nxënës, mirëdita! Sot do të flasim për **gjyshërit** tanë dhe **familjen** tonë. Redona ka **albumin** e familjes.



**Redona:** Kjo është **familja** ime.




**Vesa:** Kush është **ky**? Kush është **kjo**?



**Redona:** Ky është \_\_\_\_\_. Kjo është \_\_\_\_\_.

**Emri im:**

\_\_\_\_\_



**Rekomandim didaktik 1:** Mësuesi duhet të përpiqet të krijojë emocione sa më pozitive në klasë (mendje të hapur ndaj të mësuarit). Emocionet janë çelësi i kujtesës, kuptimit dhe vëmendjes. Një mendje e lumtur është në gjendje të funksionojë më me efektshmëri sesa një mendje e pakënaqur. Falënderimet pozitive janë, pra, një mjet efektiv për ngritjen e vetëvlerësimit pozitiv të nxënësit në klasë. Kur nxënësit ndihen të aftë, ata mbeten të motivuar. Kështu, në këtë ushtrim mësuesi, pasi punon fjalët e reja në lidhje me anëtarët e familjes në skemën e mësipërme, u kërkon nxënësve të punojnë në çifte dhe të shkruajnë emrat e trungut të familjes së tyre. Pas kësaj, ata bashkëbisedojnë me shokun/shoqen, duke i treguar emrin e xhaxhait, hallës, gjyshes etj. Nëse munden, edhe me ndihmën e mësueses, japin edhe një përshkrim të thjeshtë sipas modelit: “Gjyshi im quhet Dritan. Ai jeton në Drenicë. Unë e dua gjyshin shumë...” Mësuesi përgëzon nxënësit për suksesin në përdorimin e fjalëve të mësuara. Në këtë mënyrë realizohet objektivi didaktik i “rimarrjes” së fjalorit të mësimin të parë dhe përdorimit të tyre në një situatë të re në mësimin e dytë. Shfrytëzoni humorin, tregimin, lëvizjen dhe lojërat në mësimin e gjuhës. Kjo stimulon qendrën emocionale të trurit, amigdalën. Ka dy amigdala në tru, një në secilën hemisferë ose anë të trurit. Amigdala është vendi ku emocioneve u jepet kuptim, mbahen mend dhe u bashkëngjiten lidhjeve të njohura më parë nga truri. Në vijim emocionet reagojnë ndaj këtyre lidhjeve (kujtime emocionale). Kjo ndihmon në organizimin e mësimin në mënyrë që truri i nxënësit të mund ta përpunojë materialin e ri gjuhësor në mënyrë më efektive.





## 1. Vini emrat e anëtarëve të familjes suaj në kutizat e skemës së mësipërme.

### Redona flet me gjyshin

Redona: Mirëmëngjes, **gjysh!** Unë e di: ti ke një surprizë. Çfarë do të më **tregosh** sot?

Gjyshi: Sot kam në dorë albumin e familjes. Do të shohim babin tënd të vogël.

Redona: Sa mirë! Të **dua** shumë, gjysh!

Gjyshi: Pulushja (emri që gjyshi i thërret me përkëdheli) ime, sa **i gëzuar** jam **sot**.

Redona: Ha-ha-ha, gjysh! Vetëm ti më thërret, ashtu si thosha unë fjalën lepurush kur isha e vogël.

Gjyshi: E vogla e gjyshit je. Ti je si **halla**.

Redona (duke përqafuar gjyshin): Gjysh, **kam** shumë **mall për hallën**.



## 2. Përgjigjuni e pyetjeve.

- Kush po bisedon? \_\_\_\_\_
- Cila është surpriza e gjyshit për Redonën?
- Si e thërret gjyshi Redonën me përkëdheli? \_\_\_\_\_

### Lexoni dialogët me zë të lartë.



Dardani: Vesa, ke **motër** ti?



Vesa: Po, Dardan. Unë kam dy motra. Po ti?



Dardani: Jo, unë nuk kam motër. Unë kam një vëlla, por kam edhe dy **kushërira**.



Vesa: Unë kam edhe një **dajë** edhe një **hallë**.



Dardani: Unë kam dy **teze**, dy halla dhe një **xhaxha**. Ne jemi një **familje** e madhe.

### Sa motra ka Dardani? \_\_\_\_\_



Egini: Redona, me kë po vjen në kinema?



Redona: Po vij me motrën.



Egini: Me motrën e vogël, apo me motrën e madhe? Sa vjeç është ajo?



Redona: Me motrën e madhe. Ajo është njëzet vjeç. Është studente.



Egini: Si ti është ajo? E njoh unë?



Redona: Jo, nuk e njeh. Ajo nuk është si unë. Motra është e gjatë e ka flokë të verdhë dhe sy gri. Po ti, **vetëm** je?



Egini: Po, unë jam vetëm. Mirupafshim!



Redona: Mirupafshim!

**Redona shkon në kinema me \_\_\_\_\_.**  
**Motra e Redonës është \_\_\_\_\_.**

**Rekomandim didaktik 2:** Përpiquni të përdorni sa më shumë punën në çifte ose në grupe të vogla, sidomos në leximin e dialogut. Kjo ndihmon dukshëm tek çlodhja e trurit, pasi nxënësi punon me një shok (që ka të njëjtin nivel njohurish) dhe jo direkt me mësuesen. Kur nxënësit mësojnë njëri-tjetrin rritet kujtesa aktive dhe kjo ndihmon në zhdërvjelltësinë e të folurit.

Nxënësit që kanë mundësi të ndajnë njohuritë e tyre me bashkëmoshatarët zbulojnë se ata, në fakt, dinë më shumë informacion sesa mendonin në fillim, gjë që i gëzon shumë. Inkurajimi i nxënësve për t'i dhënë mësim njëri-tjetrit nxit të nxënit më efektiv. Bashkëveprimi me të tjerët krijon një ndërlidhje të domosdoshme të dijeve gjuhësore në trurin e nxënësit. Planifikimi i aktiviteteve në grupe, si brenda dhe jashtë klasës, i ndihmon nxënësit të mësojnë nga njëri-tjetri. Një bashkëpunim i tillë është një mënyrë shumë efektive për të mësuar. Në këtë mënyrë neuronet krijojnë lidhjet e duhura në tru dhe kjo e dërgon informacionin gjuhësor në kujtesën afatgjatë - ky rezultat është objektivi i mësuesit.





#### 4. Rilexoni dialogët dhe përcaktoni nëse fjalitë janë të sakta: V (e vërtetë), G (e gabuar).

	V	G
Dardani ka një motër.	_____	_____
Vesa ka një dajë edhe një hallë.	_____	_____
Redona po vjen me motrën e vogël.	_____	_____
Dardani ka një teze, një hallë dhe një xhaxha.	_____	_____
Redona ngjan shumë me motrën.	_____	_____
Egini po vjen vetëm.	_____	_____

**Rekomandim didaktik 3:** Mësimi i bazuar në tru bëhet edhe më i qëllimshëm përmes angazhimit, zbatimit të strategjive të të mësuarit dhe respektimit të disa parimeve bazë. Mësimi i bazuar në tru bazohet në neuroshkencën. Këto rekomandime didaktike janë të nevojshme për një angazhim të qëllimshëm dhe gjithëpërfshirës të parimeve të mësimdhënies. Këto parime rrisin drejtpërdrejt aftësinë e trurit për të punuar dhe për të mësuar në mënyrë të shkëlqyer. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur mbajmë parasysh se nxënësit kanë stile të ndryshme të mësuarit. Pra, mësuesi duhet të njohë trurin dhe stilin e të mësuarit të nxënësit për të transmetuar dijet në mënyrën e duhur. Stilet e ndryshme të të mësuarit nuk duhet të konsiderohen si përjashtime, ato duhet të jenë të dhënat kryesore që duhet të informojnë mësimdhënien tonë. Në mësimin e bazuar në tru, ndryshimet duhet të konsiderohen si rregulla, jo si përjashtime. Ato duhet të vlerësohen, duke siguruar që një mësimdhënie e zhdërvjelltë adreson çdo stil të të mësuarit. Stilet e ndryshme të të mësuarit duhet të konsiderohen thelbësore për të mësuarit e shkëlqyer të gjuhës shqipe. Gjetjet shkencore kanë çuar në përfundimin se NUK ka dy njerëz me tru saktësisht të ngjashëm; gjithsecili nga ne ka një tru unik. Prandaj, të gjithë mësojmë ndryshe. Në rastin e ushtrimit 4, mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të japin përgjigjet ("e vërtetë" ose "e gabuar") dhe pastaj të lëvizin nëpër klasë dhe të krahasojnë përgjigjet e tyre me ato të shokëve. Kjo mënyrë i ndihmon nxënësit që të mësojnë në mënyrë kinestetike (pra, duan të lëvizin që të mësojnë).

4. Shkruani dhe shqiptoni shkronjat dyshe të alfabetit shqip, duke emërtuar figurat e mëposhtme.




---



---



---



---



---




---



---



---



---

**SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI**


*Gjeni fjalën e fshehur.*

5. Qarkoni fjalët: *babi, daja, gjyshi, mami, motra, nëna, tezja.*

N	G	J	Y	S	H	I	O	B	I
S	L	Y	M	O	T	R	A	U	Q
V	Q	P	A	I	D	X	O	Q	D
D	I	A	H	D	A	J	A	A	X
L	O	I	N	Z	H	O	L	K	M
D	O	B	P	A	V	A	F	Y	A
A	N	Ë	N	A	B	A	B	I	M
J	K	E	I	T	E	Z	J	A	I
A	N	R	E	V	I	Y	E	B	H

**Rekomandim didaktik 4:** Ky ushtrim do të jetë një pushim aktiv i këndshëm dhe argëtues për nxënësin, sepse përmban edhe ndjesinë e një konkursi të vogël edhe i ndan njohuritë në copëza të vogla informacioni. Truri lodhet kur ka mbingarkesë, pasi të mësuarit është më shumë se veprim mendor, është edhe ushtrim fizik. Truri ka nevojë të çlodhet, pasi një tru i lodhur nuk është në gjendje të përpunojë informacionin. Si rezultat, të mësuarit nuk është i suksesshëm. Ndarja e informacionit në copa të vogla, dhënia e tij në hapësira të vogla kohore dhe variacioni i ushtrimeve ndihmojnë dukshëm në mbajtjen e dijeve në kujtesën afatgjatë. Për lehtësinë tuaj kemi dhënë edhe përgjigjet e këtij fjalëkryqi. Fjalët “sekrete” janë të gjitha fjalët të mësuar në Mësimin 3. Për lehtësinë tuaj po përfshijmë edhe një lojë gjuhësore tjetër përsëri për të gjetur “fjalët sekrete” që lidhen me familjen.

**6. Bashkoni pikat dhe qarkoni fjalën e duhur në tekstin A dhe B. Shkruani nga një fjali për figurat.**






### Puzzle “Familja”

a	k	Gj	y	sh	j	a	f	Ll	l	p	a
f	g	s	A	m	r	d	y	z	k	e	p
c	r	w	q	b	i	s	k	m	a	i	b
t	u	k	e	a	a	e	v	g	a	t	e
c	e	w	m	b	r	v	w	n	r	m	y
s	d	e	r	i	f	u	y	a	s	w	i
d	a	j	a	q	t	e	z	j	a	t	e
h	e	n	a	e	t	e	d	w	P	q	v
m	o	t	r	a	e	k	u	t	e	s	i
f	y	r	a	k	s	i	h	a	ll	a	p
q	m	z	u	a	t	x	v	ë	ll	a	i
M	a	k	u	sh	ë	r	i	t	a	m	y
h	Gj	y	sh	i	l	xh	a	xh	i	b	a

Gjej: Babi, mami, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, xhaxhi, teza, halla, daja

**Rekomandim didaktik 5:** Në këtë ushtrim mund të shihen disa fjalë të reja (mjek, dentist, pensionist), të cilat mund të mos lidhen direkt me temën e mësimit. Në këtë rast, mësuesi u kërkon nxënësve të lëvizin dhe të kërkojnë ndihmë tek shokët e klasës për të kuptuar fjalët. Inkurajoni lëvizjet gjatë veprimtarive mësimore, është e rëndësishme që fëmijët dhe adoleshentët të lëvizin. Lëvizja është një aktivitet që ndihmon në rritjen e neuroneve të reja në tru. Megjithëse në këto rekomandime në përpiqemi të diskutojmë stile të ndryshme të të mësuarit, kjo pasi vetë mësuesi është gjykatësi më i mirë për përdorimin e tyre. Edhe pse mësimi i përputhshëm me trurin rekomandohet, ai nuk është një ilaç ose plumb magjik për të zgjidhur të gjitha problemet e mësimit, pasi mësuesit duhet t'i kuptojnë këto parime dhe t'i përdorin si strategji efektive në mënyra të qëllimshme, të mbështetura në kushtet konkrete të klasës së tyre. Në ushtrimet e mësipërme këto parime mund të zbatohen me të tilla ushtrime: Mësuesi mund t'i vendosë nxënësit në çifte; njëri nxënës plotëson vizatimet duke ndjekur numrat dhe tjetri thotë numërorët në gjuhën shqipe.

A. Përshëndetje! Unë jam Egini, jam 15 vjeç dhe jam nga Tetova. Unë kam një motër dhe dy vëllezër. Ata janë **nxënës** dhe shkojnë në **shkollë**. Mamaja ime është mjeke, kurse babai im është dentist. Gjyshi dhe gjyshja janë pensionistë.



B. Unë jam Redona. Unë jam 8 vjeç. Jam nga Podgorica, nga Mali i Zi. Unë shkoj në shkollë. Mamaja ime është ekonomiste, kurse babai im është profesor. Gjyshja ime është pensioniste. Kam vetëm një motër. Ajo shkon në kopsht.

7. Përshkruani veten me pak fjali si në shembujt e mësipërm.

---



---



---



---




---



**8. Lexoni sërish dy prezantimet e mësipërme dhe lidhni me shigjetë grupet e fjalëve.**

Egini	15 vjeç
Redona	dentist
Mamaja e Redonës	mjeke
Babai i Eginit	nga Tetova
Redona	ekonomiste
Mamaja e Eginit	8 vjeç
Egini	nga Podgorica

**9. Ndiqni linjën dhe gjeni pyetjen për çdo figurë. Cila është përgjigja?**



**Kush është ai?**

**Kush janë ata?**

**Kush është ajo?**

**Kush janë ato?**



## 10. Shkruani pyetjet për përgjigjet e dhëna.

- \_\_\_\_\_? Unë kam dy motra.
- \_\_\_\_\_? Motra ime e vogël është pesë vjeç.
- \_\_\_\_\_? Vëllai im i madh është dhjetë vjeç.
- \_\_\_\_\_? Unë kam një hallë.

**Rekomandim didaktik 6:** Ushtrimet e mësipërme janë ndërtuar në formën e lojërave gjuhësore. Përdorimi i tyre rrit interesin e nxënësve, sepse ngjall ndjenjën e hulumtimit për të zgjidhur problemet gjuhësore. Kjo është një strategji interesante për të përshpejtuar të mësuarit, pasi lojërat shtojnë nivelin e dopaminës në tru, gjë që ndihmon rritjen e neurogjenezës. Dopamina është një lloj neurotransmetuesi që prodhohet në trupin e njeriut dhe që sistemi nervor e përdor për të dërguar mesazhe midis qelizave nervore. Kjo është arsyeja pse nganjëherë dopamina quhet “lajmëtar kimik”. Dopamina luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si ndiejmë kënaqësi. Pra, nëse nxënësi ndihet i kënaqur, truri është i gatshëm të mësojë gjëra të reja. Nga ana tjetër, neurogjenezja është procesi me të cilin formohen neuronet e reja në tru. Kjo filozofi mund të aplikohet në ushtrimet e mësipërme në forma të ndryshme:

- a) mësuesi mund ta ndajë klasën në dy skuadra, ku njëra skuadër bën pyetjet, kurse tjetra jep përgjigjet; mësuesi e shpall fituesin në bazë të përgjigjeve të sakta;
- b) mësuesi organizon një konkurs në mes të dy skuadrave, u jep pyetjen dhe mat kohën që duhet për të zgjidhur problemet gjuhësore. Skuadra më e shpejtë fiton një çmim të caktuar nga mësuesi.

**kë, kjo, kush, ku****➤ Disa emra. Familja.**

Gjinia femërore				Gjinia mashkullore			
Numri njëjës		Numri shumës		Numri njëjës		Numri shumës	
Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
(një) mama	mamaja	(disa) mama	mamatë	(një) baba	babai	(disa) baballarë	baballarët
(një) motër	motra	(disa) motra	motrat	(një) vëlla	vëllai	(disa) vëllezër	vëllezërit
(një) gjyshe	gjyshja	(disa) gjyshe	gjyshet	(një) gjysh	gjyshi	(disa) gjyshër	gjyshërit
(një) teze	tezja	(disa) teze	tezet	(një) dajë	daja	(disa) daja	dajat
(një) hallë	halla	(disa) halla	hallat	(një) xhaxha	xhaxhai	(disa) xhaxhallarë	xhaxhallarët
(një) kushërirë	kushërira	(disa) kushërira	kushërirat	(një) kushëri	kushëri	(disa) kushërinj	kushërinjtë

**11. Përcaktoni nëse fjalët e mëposhtme janë në numrin njëjës apo në numrin shumës.**

Babai (\_\_\_\_), hallat (\_\_\_\_), disa motra (\_\_\_\_), xhaxhai (\_\_\_\_), tezja (\_\_\_\_), gjyshi (\_\_\_\_), (\_\_\_\_), një motër (\_\_\_\_), kushërirat (\_\_\_\_), gjyshet (\_\_\_\_), mamaja (\_\_\_\_).

**12. Vendosini në numrin njëjës emrat e mëposhtëm.**

dy gjyshe / një gjyshe/gjyshja

tre daja/një \_\_\_\_\_

dy xhaxhallarë/një \_\_\_\_\_

hallat/një \_\_\_\_\_

dy vëllezër/një \_\_\_\_\_

dy teze/një \_\_\_\_\_  
 mamatë/një \_\_\_\_\_  
 kushërinjtë/një \_\_\_\_\_  
 dy gjyshër/një \_\_\_\_\_  
 tri motra/një \_\_\_\_\_

➤ **Foljet** *bëj, punoj, tregoj, njoh, dua.*

unë	bëj	punoj	tregoj	njoh	them	dua
ti	bën	punon	tregon	njuh	thua	do
ai, ajo	bën	punon	tregon	njuh	thotë	do
ne	bëjmë	punojmë	tregojmë	njohim	themi	duam
ju	bëni	punoni	tregoni	njihni	thoni	doni
ata, ato	bëjmë	punojnë	tregojnë	njohin	thonë	duan

➤ **Parafjalët** *në, me*

Shkoj **në** shkollë. Shkoj **në** universitet.

Shkoj **me** motrën. Shkoj **me** autobus.

### 13. Plotësoni fjalitë me foljen dhe parafjalën e duhur, sipas shembullit të dhënë.

Ata shkojnë në shkollë. (shkoj) (në/me)

Vëllezërit \_\_\_\_\_ pishinë. (shkoj) (në/ me)

Motra \_\_\_\_\_ not. (bëj)

Ti e \_\_\_\_\_ gjyshin. (dua)

Kushërinjtë \_\_\_\_\_ një shok. (punoj) (në/ me)

Ju e \_\_\_\_\_ motrën time. (njoh)

Çfarë pune \_\_\_\_\_ prindërit? (bëj)

Ne \_\_\_\_\_ bibliotekë. (studioj) (në/ me)

Halla \_\_\_\_\_ kopsht. (punoj) (në/ me)

Tezja \_\_\_\_\_ dajën. (punoj) (në/ me)

Ajo \_\_\_\_\_ një artist. (njoh)

**Rekomandim didaktik 7:** Teoritë e mësimit të gjuhëve, historikisht kanë qenë si një lavjerrës që ka kaluar herë nga e majta dhe herë nga e djathta. Të gjitha teoritë në një mënyrë a tjetër kanë diskutuar aspektin e shpjegimit teorik të gramatikës së gjuhës së re. Teoritë e mësimit të gjuhës si mjet komunikimi (shumë të njohura në shekullin XX-XXI) pothuajse e neglizhojnë plotësisht mësimin e gramatikës. Në kushtet e platformës “Mëso Shqip”, rekomandojmë që fokusi kryesor i mësimit plotësues do të jetë përgatitja e nxënësve kryesisht për të komunikuar. Në këtë këndvështrim, rekomandojmë që mësuesi ta vendosë nivelin e shpjegimit teorik të gramatikës në varësi të grupmohës së nxënësve, ndërsa fokusi të mbetet në gramatikën e aplikuar në kontekst. Ushtrimet e mësipërme janë shembull praktik në mësimin për kalimin e emrave nga numri njëjës në numrin shumës. Mësuesi vetëm praktikon njëjësin dhe shumësin, foljet apo parafjalët në ushtrime, pa shpjeguar rregulla gramatikore, por vetëm duke dhënë sa më shumë shembuj përdorimi.

#### 14. Nënvizoni emrat e të afërmeve dhe qarkoni mbiemrat në dialogët e ushtrimit 3.

##### ➤ Numërorë

1	një	11	njëmbëdhjetë
2	dy	12	dymbëdhjetë
3	tre	13	trembëdhjetë
4	katër	14	katërmëdhjetë
5	pesë	15	pesëmbëdhjetë
6	gjashtë	16	gjashtëmbëdhjetë
7	shtatë	17	shtatëmbëdhjetë
8	tetë	18	tetëmbëdhjetë
9	nëntë	19	nëntëmbëdhjetë
10	dhjetë	20	njëzet



**15. Numëroni sa breshka, peshq, lepuj, kuaj, zogj, mace etj., janë.**



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË

*Tregon gjyshja ngaherë:*



*“Na ishte seç na ishte...”*

**Dëgjoni këngën “Kënga e gjyshes” dhe shënوني fjalët që dini.**

<https://www.youtube.com/watch?v=3beAUR7qDek>

**Rekomandim didaktik 8:** Filozofia e mësimdhënies me bazë mësimin e trurit thekson se truri mëson natyrshëm dhe mësuesit duhet të bazohet në zbulimet shkencore që ne aktualisht dimë dhe t’i lidhë ato me temat që po mësojmë. Në këtë ushtrim nxënësit dëgjojnë 3 ose 4 herë këngën “Tregimi i gjyshes”. Pas dëgjimit, u bëhen pyetjet e mëposhtme: Çfarë ke imagjinuar kur dëgjove këngën? A të bëri kënga të ndihesh i lumtur apo i pakënaqur? Para dëgjimit të këngës, nxënësit mund të dëgjojnë leximin e tekstit të këngës nga mësuesi. Pas kësaj u kërkohet t’u përgjigjen pyetjeve: Për çfarë është kënga? Sa fjalë kuptove? Këto pyetje mund të bëhen edhe në gjuhën e vendit ku jetojnë. Para aktivitetit, nxënësve mund t’u kërkohet të sjellin foto të familjes në klasë. Atyre u kërkohet të tregojnë ku është gjyshja në foto, çfarë mbajnë mend nga tregimet e gjyshes etj. Kjo do t’i ndihmonte nxënësit ta kuptonin këngën me lehtësi edhe pse kanë një fjalor të kufizuar.

**17. Këta janë disa libra për gjyshen dhe gjyshin. A keni lexuar ndonjë libër të tillë?**








*A e dini se...*

*Musine Kokalari është  
shkrimtarja e parë shqiptare.*

*Librin e parë ia kushtoi gjyshes  
“Siç më thotë nënua plakë”*

*...10 ujeç, nisa të kopjoj nëpër fletore bisedat dhe përrallat që dëgjoja në familje. Ishte diçka fantastike! Fjalët e shtëpisë, që deri atëherë vetëm shqiptoheshin si tinguj, po i hidhja në letër përmes shkronjave e po lidheshin mes tyre në fjali. “Eja, bijë, e puno”, - më thotë gjyshja ime hokatare kur më sheh që mbaj fshehtazi shënim fjalët e saj..., nis qëndismat.”*

*Ndërsa unë vazhdoj të shkruaj e të shkruaj ato që thotë ajo dhe qesh me lot nën zë. (Musine Kokalari, sipas P. Asllanit).*



## 18. Plotësoni fjalitë me fjalët që mungojnë.


Nisa të kopjoj nëpër fletore \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

“Eja, \_\_\_\_\_, e puno”, - më thotë \_\_\_\_\_ ime hokatare.

\_\_\_\_\_ vazhdoj të shkruaj. Unë \_\_\_\_\_ me lot nën zë.

**Rekomandim didaktik 9:** Në këtë veprimtari didaktike, mësuesi i fton nxënësit, që t'i referohen tekstit të mësipërm nga Musine Kokalari për të plotësuar fjalët që mungojnë. Kjo është ndihma e duhur që i "detyron" nxënësit të lexojnë paragrafin edhe njëherë dhe të identifikojnë se cilat fjalë mungojnë. Në këtë mënyrë ata do të lidhin njohuritë e vjetra me kërkesat e reja të ushtrimit, mënyrë shumë interesante kjo për të ndërtuar dendrite kaq të nevojshme për të ruajtur njohuritë gjuhësore në kujtesën afatgjatë.

Projekti i rekomanduar :



**Rekomandim didaktik 10:** Në këtë veprimtari didaktike, mësuesi mund të ftojë nxënësit, në bashkëpunim me prindërit, të krijojnë pemën e tyre familjare, sipas modelit të mësipërm. Përveç vlerave patriotike dhe gjuhësore, ky projekt do të ndihmojë nxënësit të njohin edhe lidhjet e tyre familjare me familjen e madhe në vendin Amë, xhaxhai, tezja, kushëriri etj. Njëkohësisht, ky projekt do t'i ndihmojë nxënësit të përdorin fjalët e reja, të mësuara në këtë mësim dhe t'i përdorin ato në një kontekst krejt të ri. Një mënyrë shumë efektive për të zhvilluar aftësitë komunikuese, edhe pse kanë një fjalor shumë të kufizuar.





## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
album	ai	ekonomiste
babi	ajo	dentist
bëj	ata	gri
dajë	ato	e madhe
dua	bëj	mjeke
familje	dhe	notoj
i gëzuar	ju	pensioniste
gjysh	jam	studente
gjyshe	kam	i vogël
hallë	keq	i verdhë
kushërirë	kush	luaj
mami	mirë	tenis
mall	mirëmëngjesi	
motër	mirëdita	
numëror	ne	
njoh	nga	
teze	si	
tregoj	shqip	
them	shqiptare	
vetëm	unë	
vëlla	ti	
vjeç		
xhaxha		

**Rekomandim didaktik 11:** Në këtë veprimtari didaktike, mësuesi siguron që nxënësit kanë përvetësuar fjalët e reja duke e ndarë fjalorin në:

- kolonën e parë (fjalori i ri), fjalë që duhet të mësohen mirë nga nxënësit;
- kolonën e dytë (fjalori i përsëritur), fjalë që janë rimarrë (ri-ciklimi i fjalëve nga mësimi 1)
- kolonën e tretë (fjalori shtesë), fjalë ndaj të cilave nxënësit vetëm janë ekspozuar dhe që janë vendosur në mënyrë të qëllimshme pasi të përdoren nga autorët e platformës “Mëso shqip” në mësimet e ardhshme.

# MËSIMI 3

## *Lojërat kombëtare* *Trupi im*

### **Qëllimet mësimore:**

- a) Flasim për lojërat tona
- b) Emërtojmë pjesët e trupit
- c) Gramatikë: emrat e pjesëve të trupit; disa ndajfolje kohe dhe vendi *sot, tani, gjithmonë, shpesh, këtu, atje*; zgjedhimi i foljeve *luaj, dhuroj, gjuaj, pres, hedh, rrëshqas, zë, eci*; disa shprehje.
- d) Punë e diferencuar: “Klubet e para sportive”, **Kënga** “Hapadollapa”.


### **LIDHJA ME KURRIKULËN** *Loja dhe koha e lirë*

Tradita

Koha e lirë

Lojërat e fëmijëve

- **LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË:** Mësimi 3 na ndihmon të mësojmë fjalët që lidhen me lojërat kombëtare dhe me pjesët e trupit të njeriut. Këtu fokusi do të jetë në përdorimin e fjalorit praktik, i cili do të shoqërohet me vizatime dhe pjesëmarrjen në këto lojëra.
- **SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI:** Në këtë rubrikë, nxënësit do të mësojnë lojëra të ndryshme si: ngriva-shkriva, loja me peta etj. Gjithashtu një ushtrim interesant është edhe ushtrimi ku nxënësi vizaton trupin dhe emërton pjesë e tij.
- **GRAMATIKË:** Mësimin 3 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. Emrat e pjesëve të trupit: koka, trupi, gjymtyrët;
  - ii. Ndajfoljet: sot, tani, gjithmonë, shpesh, këtë, atje;
  - iii. Foljet: luaj, dhuroj, gjuaj, pres, hedh, rrëshqas, eci;
- **NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Klubi i parë i futbollit, kënga "Hapa-Dollapa" [https://www.youtube.com/watch?v=9oN\\_Zr2V0e0](https://www.youtube.com/watch?v=9oN_Zr2V0e0) dhe fjala e urtë "O djalë, në vend të huaj, si të bjerë daullja luaj".
- **FJALORI:** hedh topin, pres topin, gjuaj topin, pasoj topin, kërcej/luaj me litar, vrapoj, i jap biçikletës, notoj, rrëshqas në akull bëj ski, rrëshqas me patina, zhytem.



**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Përdorimi didaktik i veprimtarisë mësimdhënëse të quajtur “Përgjigja Totale Fizike” (PTF), (Total Physical Response - TPR). Kjo është një metodë e mësimdhënies së gjuhës ose koncepteve të fjalorit, duke përdorur lëvizjen fizike për të reaguar ndaj të dhënave që jep me gojë mësuesi. Procesi i veprimtarisë PTF imiton mënyrën sesi foshnjat mësojnë gjuhën e tyre të parë, zvogëlon “frikën” e nxënësve dhe ul stresin e përdorimit të gjuhës në kushtet e një fjalori shumë të kufizuar. Qëllimi i PTF-së është të krijojë një lidhje në tru (ndërtohet dendriti) midis fjalës dhe veprimit për të rritur aftësitë gjuhësore dhe për të pasuruar fjalorin. Përgatitja. Së pari, përcaktoni fjalorin që do t’u mësoni nxënësve me PTF (jo çdo fjalë mund të mësohet me PTF). Mblidhni mjete, veshje, kostume ose fotografi që do t’ju duhen për të ilustruar kuptimin e fjalëve para se të filloni lëvizjet.

Mësuesi modelon. Thoni fjalën e re, ndërsa thoni fjalën, shoqërojeni me gjeste, shprehje të fytyrës ose lëvizje të trupit për të ilustruar kuptimin e fjalës. Ftoni nxënës vullnetarë që të imitojnë të njëjtat gjeste, shprehje të fytyrës ose të shoqërojnë me lëvizjen e trupit, ndërsa mësuesi thotë fjalën.

Pjesëmarrja e nxënësve. Ftoni të gjithë nxënësit të imitojnë gjestet e njëjta, shprehjet e fytyrës ose lëvizjen e trupit të modeluar nga mësuesi dhe nxënësit vullnetarë. Nxënësit duhet të thonë fjalën, ndërsa po bëjnë lëvizjen. Pastaj, ndryshojeni këtë aktivitet në formën e anasjellë: mësuesi bën veprimin dhe nxënësit thonë fjalën e re që mësuan.

Kur përdoret. Përgjigja Totale Fizike (PTF) mund të përdoret për të mësuar shumë lloje fjalori, por funksionon më mirë kur shpjegohet fjalor i ri (për fjalët abstrakte nuk mund të përdoret PTF) që mund të lidhet me lëvizjet. Kjo është një strategji efektive për t’u përdorur me nxënësit e çdo gjuhe të huaj, si dhe me folësit e gjuhës amtare kur mësohen fjalë të reja. Nëse keni interes për të vëzhguar PTF-në në veprim, ju rekomandojmë këtë video në YouTube:

[https://www.youtube.com/watch?v=rIIVWLLFxEO&ab\\_channel=ESCRegion13](https://www.youtube.com/watch?v=rIIVWLLFxEO&ab_channel=ESCRegion13)



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



Mësuese Teuta: Le të mësojmë shqip, duke luajtur me shokët



hedh topin



pres topin



gjuaj topin



pasoj topin



kërcej/luaj me litar



vrapoj



i jap biçikletës



notoj



rrëshqas në akull



bëj ski



rrëshqas me patina



zhytem

### 1. Çfarë po bën djali në foto?



- a. Djali po gjuan topin.
- b. Djali po hedh topin.
- c. Djali po pret topin.

- a. Djali po noton.
- b. Djali po zhytet.
- c. Djali po vrapon.

**Rekomandim didaktik 1:** Përdorimi i mjeteve pamore në mësimdhënien e gjuhës është gjithmonë i rekomanduar, por në këtë nivel ku nxënësit kanë një fjalor shumë të kufizuar, përdorimi i fotove, objekteve apo strategjisë PTF kthehet në domosdoshmëri. Kombinimi i mjeteve pamore dhe lëvizjes trupore me gjuhën e “re” është i lidhur natyrshëm me të mësuarit cilësor. Objektivi i mësuesit është që nxënësit të përdorin në mënyrë aktive të dyja anët e trurit të tyre (hemisferën e majtë dhe hemisferën e djathtë). Aspekti praktik i këtij rekomandimi didaktik është i rëndësishëm pasi mësuesi ka mundësi të ndihmojë nxënësit, duke i vendosur të punojnë me çifte, me grupe të vogla dhe të mëdha. Pra, përdorimi i figurave/vizatimeve/fotove nga autorët e platformës “Mëso Shqip” në këtë dokument ka pikërisht këtë qëllim.

Gjithashtu, përdorimi i bollshëm i mjeteve pamore të kombinuara me PTF-në mpreh aftësitë e përqendrimit dhe të dëgjimit të nxënësit. Kjo shton dëshirën e nxënësit për të marrë pjesë në veprimtaritë gjuhësore, pasi atyre nuk u kërkohet të flasin derisa të ndihen gati; për këtë arsye mjetet pamore dhe PTF-ja krijojnë një “zonë të sigurt”, çka tek nxënësit ul shumë frikën dhe stresin se “mos bëjnë gabime”.

Një përfitim tjetër nga përdorimi i mjeteve pamore dhe PTF-së lidhet me nxënësit që kanë një stil të mësuarit “kinestetik” (të cilët mësojnë mirë kur marrin pjesë në aktivitete fizike) dhe nxënësit me stil të të mësuarit “pamor” (të cilët mësojnë më mirë me mjete pamore). Këtu duhet theksuar se mësuesi duhet të njohë thellë mënyrën se si mëson çdo nxënës. Gjithashtu, meqenëse me këtë metodë askush nuk vihet në “qendër të vëmendjes” individualisht, PTF-ja është një strategji e shkëlqyer për nxënësit introvertë (të ndrojtur/turpshëm) sepse ata ndihen të qetë të marrin pjesë në të tilla veprimtari. P.sh.: mësuesi mund të tregojë foto të ndryshme me pamjet e fjalëve të reja (si më sipër) ose mund të përdorë metodën PTF për të treguar si noton, gjuan topin, vrapon, pret topin etj. Pastaj i vendos nxënësit në çifte që do të bëjnë të njëjtën gjë dhe të shoqërojnë lëvizjet duke thënë fjalën e re.



**Mësuesja:** Mirëdita! Sot do të flasim për **lojërat** dhe **sportet**. Unë luaj shpesh shah. Po ju?



**Dardani:** Mua **më pëlqen futboli, noti dhe tenisi**.



**Vesa:** Unë **i jap biçikletës** dhe më pëlqen të luaj me litar **tani**.



**Redona:** Mua më pëlqejnë lojërat elektronike më shumë. Në dimër më pëlqen të bëj ski.



**Egini:** Unë rrëshqas **gjithmonë** me patina. Luaj shpesh **basketboll**.



## 2. Përgjigjuni pyetjeve.

A luan Redona basketboll? Jo \_\_\_\_\_ Redona luan \_\_\_\_\_

A i jep shpesh biçikletës Egini? Egini luan shpesh \_\_\_\_\_.

Kush rrëshqet me patina? \_\_\_\_\_ rrëshqet me patina.

**Rekomandim didaktik 2:** Në këtë veprimtari didaktike, mësuesi siguron që nxënësit të kenë rastin të flasin me modele fjalish të thjeshta. Duke qenë se: a) nxënësit duhet të marrin pjesë në leximin e dialogut dhe b) do t'i japin përgjigje pyetjeve që shoqërojnë dialogun, mësuesi siguron jo vetëm leximin, por dhe (mundësisht) të kuptuarit të asaj çka lexojnë nxënësit. Kjo arrihet duke i siguruar çdo nxënësi mundësinë për të folur ose për t'ju përgjigjur pyetjeve. Mësuesi mund ta bëjë këtë veprimtari me grupe prej 4 vetash dhe nxënësit lexojnë në rolin e Vesës, Redonës, Dardanit dhe Eginit.

### Loja “Ngriva-shkriva”

Njëri lojtar vrapon dhe ndjek shokët. Ai duhet t'i prekë me **dorë** para se ata të thonë fjalën “ngriva”. Kur thotë “ngriva”, lojtari ndalon. Loja vazhdon sërish kur ai thotë fjalën “shkriva” dhe vrapon përsëri.



### Loja me peta

Në dysheme vizatojmë katrorë (■) me numra (nga 1 deri në 10). Marrim një gur petashuq (të cilin e quajmë peta) dhe e shtyjmë, duke u hedhur më një **këmbë**, nga fillimi deri në fund të katrorëve.

## Loja “Telefoni i prishur”

Lojtarët vihen në rresht. Lojtari i parë i thotë një fjalë në **vesh** atij që ka ngjitur, ai ia thotë tjetrit e kështu me radhë, deri në fund. Qëllimi është që fjala të përcillet e saktë. Ai që gabon, del nga loja.

## Kriporja

Në një letër shkruajmë 4 numra dhe nga një cilësi për secilin numër, për shembull (i bukur, i shkathët). Për çdo numër shkruhen dy fjalë. Letra paloset në formën e kriporës (si në figurë) dhe fëmijët zgjedhin njërin numër dhe sa herë e duan, për shembull: nëse njëri lojtar thotë: “katrën pesë herë”, atëherë lojtari që ka kriporën në gishta e hap dhe e mbyll atë (një herë për së gjati dhe një herë për së gjeri) 5 herë radhazi dhe në fund thotë fjalën që është shkruar te numri 4.

Shihni videon “Si të bëjmë një kriporë”.

## Loja “Hapadollapa”

Në lojën “Hapadollapa”, një nga lojtarët mbyll sytë, të tjerët fshihen. Mbasi mbyll sytë në një vend të caktuar, ai fillon të thotë me zë të lartë këto fjalë: “Hapadollapa, kush është fshehur mbrapa? Dil se të kapa! Se unë sytë i hapa!” ...Lojtari vazhdon, duke numëruar deri në 10. Pastaj hap sytë dhe kërkon shokët e fshehur. Mbasi gjen të parin, shkon atje ku ka mbyllur sytë dhe bën pasin (prek me dorë vendin). Mbasi i gjen të gjithë, radhën për të mbyllur sytë e ka ai që është gjetur i pari. Në qoftë se njëri nga të fshehurit shkon më përpara dhe bën pasin, atëherë personi që i kërkon duhet të mbyllë sytë përsëri.

**Rekomandim didaktik 3:** Lojëra të tilla jo vetëm ndihmojnë në argëtimin e nxënësve, por edhe shtojnë fjalorin praktik në gjuhën shqipe. Gjithashtu, në këtë mënyrë nxënësit njihen me lojëra karakteristike të trevave shqiptare dhe janë në lëvizje, gjë që ndihmon për një jetë aktive dhe jo vetëm “argëtim” para ekranit të kompjuterit/televizorit. Mësuesi mund të përdorë forma të ndryshme për të organizuar këto lojëra gjuhësore. P.sh.: “Për lojën ngriva-shkriva”, mësuesi shpjegon rregullat e lojës me fjali shumë të thjeshta dhe modelon vetë veprimet e duhura. Njëri vrapon dhe ndjek shokët dhe duhet t’i prekë me dorë para se ata të thonë fjalën “ngriva”. Kur lojtari thotë “ngriva”, ndalon. Loja vazhdon sërish kur lojtari i së njëjtës skuadër e prek dhe thotë fjalën “shkriva” dhe vrapon përsëri. Pas kësaj nxënësit fillojnë lojën. Kështu mund të zhvillohen edhe lojëra të tjera (Ja, çfarë na rekomandon Atë Donat Kurtit) Lojërat janë të thjeshta: Fëmijët kapen dorë për dorë; ecin njëri pas tjetrit, flasin me gëzim: “Kemi zënë rrugën!”, hapin gropa e bëjnë shtëpi në rërë; mbajnë ujë me enë të shpuara; topa me baltë; luajnë “Nana plakë”, “Rozarozina” e “Mica e miu”; imitojnë kafshët. Bisedat e tyre janë pa fund. Se ku i gjejnë gjithë ato fjalë, gjithë ato pyetje, veç ata e dinë. Nisin me përrallat e vogla të gjyshes; kalojnë pastaj në punë të vogla të shtëpisë e të shokëve.



### 3. Zgjidhni përgjigjen e saktë.

- *Cilat nga këto veprime bëjmë në lojën “Ngriva-shkriva”?*
  - a. Vrapojmë, prekim, ndalojmë.
  - b. Flasin, ecim, punojmë.
- *Si luhet me peta?*
  - a. Me dy këmbë.
  - b. Me një këmbë.
  - c. Me një dorë.
- *Si luhet loja “Telefoni i prishur”?*
  - a. Duke kënduar.
  - b. Duke folur në vesh.
  - c. Duke biseduar.
- *Çfarë bëjmë në lojën “Hapadollapa”?*
  - a. Mbyllim gojën.
  - b. Mbyllim sytë.
  - c. Mbyllim veshët.
- *Si e bëjmë lojën me “Kripore”?*
  - a. Me letër.
  - b. Me sy.
  - c. Me krahë.



### 4. Bisedoni në klasë.

Cilën nga këto lojëra luan ti me shokët? Po në shtëpi?

**Rekomandim didaktik 4:** Për këtë ushtrim, në varësi të grupmoshës së nxënësve, mësuesi mund të përdorë teknika të ndryshme për ta bërë interesant dhe ndërveprues mësimin e pjesëve të trupit. Ja, disa rekomandime për nxënës të vegjël:

- a) Mësuesi i kërkon fëmijëve të sjellin nga një lodër (kafshë apo kukull) në klasë në ditën kur ai planifikon këtë mësim. Ai u mëson fëmijëve, që fillimisht t'i japin nga një emër lodrës së tyre.
- b) Ai thotë: “Qenushi im quhet Pafi. Si quhet lodra jote?” Nxënësi përgjigjet: “Kukulla ime/arushi im quhet...”
- c) Mësuesi pretendon se qenushi i thotë diçka në vesh dhe u thotë nxënësve “Pafi me thotë: preke kokën... Pafi më thotë “preke hundën” etj.
- d) Nxënësit imitojnë veprimet e mësuesit dhe/ose prekin pjesët e trupit të lodrës së tyre ose ato të trupit të tyre. Pas kësaj, mësuesi i vendos fëmijët në çifte dhe njëri “jep komandat” dhe tjetri bën veprimet. Për fëmijë më të rritur mund të përdoren objekte të trupit nga laboratorit i anatomisë ose të vizatohet një model trupi në tabelë.

## ➤ Pjesët e trupit




### 5. Emërtoni pjesët e trupit, duke shkruar fjalën përkatëse në secilën kuti.



**Rekomandim didaktik 5:** Për këtë ushtrim, mësuesi mund të organizojë një garë mes nxënësve se kush do të plotësojë më shpejt kuadratet me fjalët për pjesët e trupit. Fituesit i jepet një çmim simbolik në përshtatje me moshën e nxënësve. Mund të thirren prindërit për të ndihmuar për çmimet, për shembull një mama mund të bëjë disa gurabije shtëpie dhe t'i sjellë në shkollën shqipe. Gurabijet duhet të jenë të mjaftueshme për të gjithë klasën, por fituesit mund t'i jepet mundësia të zgjedhë i pari apo t'ua shërbejë gurabijet shokëve etj. Vërtetë kjo veprimtari mund të kërkojë pak organizim në fillim, por me kalimin e kohës kthehet në një traditë shumë të bukur dhe përfshin natyrshëm edhe prindërit në mbarëvajtjen e veprimtarive të shkollës shqipe.

### 6. Vizatoni trupin e njeriut dhe emërtoni gjymtyrët, duke formuar e shkruar fjali si në shembullin e mëposhtëm.

*Kjo është dora ime.*



**Rekomandim didaktik 6:** Një aktivitet i tillë mund të bëhet me nivele të ndryshme vështirësie. Kjo e ndihmon mësuesin të bëjë punë të diferencuar në klasë, pasi është e pamundur t'i kesh në të njëjtin nivel 100% të nxënësve. Ushtrimin e mësipërm, mësuesi mund ta bëjë, sipas dy niveleve:

a) Niveli më i thjeshtë. Mësuesi thotë fjalinë dhe nxënësi ose tregon pjesën e trupit, ose e vizaton atë. Këtu mësuesi mund të përdorë një dërrasë/karton të sheshtë dhe ta mbulojë me fanellatë. Në vijim pret pjesët e trupit në letër punëdoreje dhe në njërën anë ngjit letër smerili (zumpara). Nxënësi merr pjesët e trupit, siç ia thotë mësuesi, dhe në copën e fanellatës ngjit me letër smerili pjesët e trupit. Letra e mban pjesën e trupit të ngjitur tek fanellata. E njëjta gjë mund të bëhet edhe në ekranin e kompjuterit.

b) Niveli më i vështirë. Nxënësi shkruan fjali ku përshkruan pjesët e trupit sipas modelit të mësipërm. Këtë paragraf e lexon para klasës dhe e shoqëron edhe me një pikturë të trupit me pjesët e tij. Gjatë leximit nxënësi tregon se për cilat pjesë të trupit po flet.



## GRAMATIKA

### ➤ Emërtimet e pjesëve të trupit

KOKA		TRUPI		GJYMTYRËT	
njëjës	shumës	njëjës	shumës	njëjës	shumës
kokë, koka	kokë, kokët	trup, trupi	trupa, trupat	gjymtyrë, gjymtyra	gjymtyrë, gjymtyrët
sy, syri	sy, sytë	sup, supi	supe, supet	krah, krahu	krahë, krahët
vesh, veshi	veshë, veshët	qafë, qafa	qafë, qafat	bërryl, bërryli	bërryla, bërrylat
gojë, goja	gojë, gojë	kraharor, kraharori	kraharorë, kraharorët	dorë, dora	duar, duart
hundë, hunda	hundë, hundët	bark, barku	barqe, barqet	gisht, gishti	gishta, gishtat
faqe, faqja	faqe, faqet	kërthizë, kërthiza	kërthiza, kërthizat	këmbë, këmbe	këmbë, këmbët
dhëmb, dhëmbi	dhëmbë, dhëmbët			gju, gjuri	gjunjë, gjunjët
gjuhë, gjuha	gjuhë, gjuhët			kyç, kyçi	kyçe, kyçet
flok, flok	flokë, flokët			kofshë, kofsha	kofshë, kofshët
buzë, buza	buzë, buzët				

### 7. Plotësoni fjalitë e mëposhtme.

Unë kam \_\_\_\_\_ sy.

Ti ke \_\_\_\_\_ hundë.

Ai ka \_\_\_\_\_ gishta.

Ne kemi \_\_\_\_\_ flokë.

Ajo shkruan me \_\_\_\_\_.

Ju ecni me \_\_\_\_\_.

Ata flasin me \_\_\_\_\_.

Ato dëgjojnë me \_\_\_\_\_.

**Rekomandim didaktik 7:** Të njëjtat fjalë që u mësuan më lart për pjesët e trupit, përsëriten në këtë ushtrim, por kërkohet që të vendosen në numrin shumës dhe duke i “rimarrë” në situata të reja. Megjithëse titulli është “Gramatikë”, mësuesi nuk shpjegon gramatikë, vetëm praktikon përdorimin e saktë të shumësit në fjali. Edhe këtu ai mund të përdorë foto, objekte, gjeste etj., ose t’u kërkojë nxënësve t’i përdorin ato për të ilustruar çfarë po thonë. Qëllimi didaktik këtu është që nxënësit të përdorin sa më shumë shqisa lidhur me fjalët e reja, pasi vetëm kështu garantohet kalimi i informacionit të ri gjuhësor në kujtesën afatgjatë.

## 8. Ktheni fjalët e dhëna në numrin shumës.

syri \_\_\_\_\_  
 një vesh \_\_\_\_\_  
 një krah \_\_\_\_\_  
 dora \_\_\_\_\_  
 dhëmbi \_\_\_\_\_

buza \_\_\_\_\_  
 një gisht \_\_\_\_\_  
 këmba \_\_\_\_\_  
 një faqe \_\_\_\_\_  
 bërryl \_\_\_\_\_

### ➤ Disa ndajfolje: *sot, tani, gjithmonë, shpesh, këtu, atje*



**këtu**

Dardani: Unë shkoj në shkollë. Shkolla është **atje**. Shtëpia është **këtu**. Unë notoj **shpesh**. **Sot** kam futboll. **Gjithmonë** luaj tenis.



**atje**



## 9. Plotësoni fjalitë me ndajfoljet *atje, këtu*.

Motra është \_\_\_\_\_. Shtëpinë e kam \_\_\_\_\_.  
 Shoku është \_\_\_\_\_. Shkollën e kam \_\_\_\_\_.  
 Mamaja është \_\_\_\_\_. Ju mësoni \_\_\_\_\_.  
 Mësuesja është \_\_\_\_\_. Ata bëjnë ski \_\_\_\_\_.

## 10. Plotësoni fjalitë me ndajfoljet *sot, gjithmonë, shpesh*.

Redona: - Unë mësoj \_\_\_\_\_ në shkollë. - Po ty, Vesa, çfarë të pëlqen të bësh?

Vesa: - Unë lexoj \_\_\_\_\_, por \_\_\_\_\_ po shkoj në kinema. Po ti, Egin?

Egini: - Unë nuk shkoj \_\_\_\_\_ në kinema, por shkoj \_\_\_\_\_ në bibliotekë.

**Rekomandim didaktik 8:** Përsëri, këtë nxënësit vetëm prezantohen me ndajfoljet për t’u dhënë mundësinë atyre të fillojnë të ndërtojnë fjali më të gjata. Mësuesi e arrin këtë vetëm me anë të lëvizjeve, vizatimeve apo fotove të ndryshme, pa shpjeguar gramatikë.

➤ **Zgjedhimi i foljeve *luaj, dhuroj, gjuaj, pres, hedh, rrëshqas, zë, eci* në kohën e tashme të mënyrës dëftore**

unë	luaj	dhuroj	gjuaj	pres	hedh	rrëshqas	zë	eci
ti	luan	dhuroj	gjuan	pret	hedh	rrëshqet	zë	ecën
ai, ajo	luan	dhuroj	gjuan	pret	thotë	rrëshqet	zë	ecën
ne	luajmë	dhurojmë	gjuajmë	presim	hedhim	rrëshqasim	zëmë	ecim
ju	luani	dhuroni	gjuani	prisni	hidhni	rrëshqisni	zini	ecni
ata, ato	luani	dhurojnë	gjuajnë	presin	hedhin	rrëshqasin	zënë	ecin

**11. Plotësoni fjalët me mbaresat e duhura.**

ti lua \_\_\_\_\_ ne dhuro \_\_\_\_\_ ti pre \_\_\_\_\_ ai zë \_\_\_\_\_  
 ne hedh \_\_\_\_\_ ju lua \_\_\_\_\_ ata gjuaj \_\_\_\_\_ ne pres \_\_\_\_\_  
 ai lua \_\_\_\_\_ unë rrëshq \_\_\_\_\_ ata ec \_\_\_\_\_ ju \_\_\_\_\_  
 hidh \_\_\_\_\_

**12. Shkruani një fjali për çdo figurë.**



\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



**13. Plotësoni fjalitë me një nga foljet: *luaj, dhuroj, gjuaj, pres, hedh, rrëshqas, eci*.**

Ne \_\_\_\_\_ futboll. Mësuesja më \_\_\_\_\_ një libër.  
 Ata \_\_\_\_\_ topin me këmbë. Ti \_\_\_\_\_ me patina.  
 Unë \_\_\_\_\_ makinën. Ai \_\_\_\_\_ topin gjithmonë.

➤ **Disa shprehje: *i jap biçikletës/ makinës; më pëlqen noti / të notoj***

**14. Shkruani 3 fjali për çfarë ju pëlqen dhe 3 fjali për çfarë ju pëlqen të bëni, si në shembullin e dhënë.**

*Mua më pëlqen noti. Mua më pëlqen të notoj.*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *A e dini se...*

*Ndeshja e parë e futbollit në Shqipëri është luajtur në vitin 1921 mes dy klubeve të para: "Vllaznisë" së Shkodrës (1919) dhe "Agimit" të Tiranës (1920). Klubi i parë në Kosovë është "Vllaznimi" i Gjakovës (1927). Federata Shqiptare e Futbollit u themelua në vitin 1932.*

### 15. Përgjigjuni pyetjeve.

A është "Vllaznimi" klubi i parë i futbollit në Shkodër?

A është themeluar në Tiranë klubi i parë i futbollit në Shqipëri?

Çfarë u themelua në vitin 1932?

**Rekomandim didaktik 9:** Kuriozitetet të tilla të lidhura me historikun e futbollit dhe klubeve sportive në Shqipëri janë një informacion interesant, në mënyrë të veçantë për djemtë që mund të kenë në klasën tuaj. Këtu mësuesit i jepet një mundësi interesante për t'i "ngacmuar" nxënësit (veçanërisht djemtë) të flasin për përvojat e tyre me sporte të ndryshme. Një mësues i mirë fillon të luajë rolin sikur nuk di asgjë për sportin që merr pjesë nxënësi dhe i kërkon atij t'i shpjegojë mësuesit rregullat e atij sporti etj. Kjo i ndihmon nxënësit të ndihen si "ekspertë" dhe të përqendrohen tek dhënia e informacionit më shumë sesa tek fakti që e kanë fjalorin e kufizuar. Të jeni të sigurt për suksesin e këtij aftësimi të trurit për të gjetur fjalët që i duhen.

*“Hapa-dollapa  
kush është fshehur mbrapa?”*

**Dëgjoni këngën “Hapadollapa” dhe përpquni të këndon  
bashkë disa vargje.**

Shkruani fjalët që kuptoni:

[https://www.youtube.com/watch?v=9oN\\_Zr2V0e0](https://www.youtube.com/watch?v=9oN_Zr2V0e0)



**PROJEKT:** Pyesni gjyshërit dhe prindërit për lojërat që bënin kur ishin të vegjël dhe përgatisni një prezantim.

#### FJALË TË URTA

*O djalë, në vend të luaj,  
si të bjerë daullja luaj.*

**Rekomandim didaktik 10:** Nxënësve u lexohet/shkruhet së pari teksti i këngës dhe mësuesi i ndihmon ata ta vënë këngën në “skenë”, duke lëvizur sipas tekstit që dëgjojnë. Në dëgjimin e parë të këngës, mësuesi i inkurajon nxënësit të shkruajnë fjalët që njohin. Së fundi, ua jep të gjithë këngën dhe e këndojnë së bashku. Ndërsa për fjalën e urtë, ai vetëm i ndihmon nxënësit ta lexojnë fjalinë saktë dhe ua shpjegon në gjuhën e vendit ku jetojnë.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
bark buzë dhëmb dorë eci faqe flok gisht gju gjuaj gjuhë gojë hedh hundë këmbë kokë krah luaj pres qafë rreshqas sy vesh vrapoj zë zhytem	album gjysh familje gjyshe babi mami motër tregoj dua them	bërryl bibliotekë biseda dhuroj dysHEME e verdhë gëzim katror kraharor kyç kërthizë kinema kofshë kripore ngriva njëri-tjetri palos petë qëllim rrugë secili shembull shkriva sup zgjedh

**Rekomandim didaktik 11:** Së fundi, mësuesi bën “inventarin e dijeve” e veçanërisht të njohurive të fituara në pasurimin e fjalorit. Mësuesi mund ta arrijë këtë në mënyra të ndryshme, si: duke i vënë nxënësit në çifte për të lexuar fjalorin e ri, të përsëritur apo shtesë. Nxënësit identifikojnë fjalët që njohin ose i kërkojnë mësuesit ndihmë për fjalët për të cilat nuk janë të sigurt. Një mënyrë tjetër shumë interesante është përdorimi i website-it [quizlet.com/abejko](http://quizlet.com/abejko) ku mund të gjeni të gjitha fjalët e fjalorit të ri dhe mund të përdorni 6 ushtrime të ndryshme që lidhen me këtë fjalor. Mësuesi mund ta përdorë këtë website lirshëm dhe me sukses, pasi mjafton vetëm një informacion i mësuesit dhe website-i gjeneron 6 ushtrime interesante në internet.



# MËSIMI 4

*Shëtis me imazhe në qytetet  
e vendit tim. Klima dhe moti.  
Stinët e vitit*

## Qëllimet mësimore:

- a) Si të përshkruaj qytetin tim
- b) Klima dhe moti, Stinët e vitit
- c) Gramatikë: përemrat dëftorë *ky, kjo, këta, këto*; trajta e shquar dhe e pashquar; gjinia femërore dhe mashkullore; përemri pyetës *ç'*; ndajfoljet *ftohtë, ngrohtë, nxehtë*; mbiemrat *i ftohtë, i ngrohtë, i nxehtë*.
- d) Punë e diferencuar: “Shkrimtarët dhe qytetet”, “Arkitekt Sinani”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë*

Flas për motin

Unë dhe mjedisi

Qytetet

Objektivi mësimor. Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- **LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË:** Mësimi 4 ndihmon në mësimin e fjalëve që lidhen me përshkrimin e qyteteve dhe fshatrave në trevat ku banojnë shqiptarë. Nxënësit mësojnë të flasin për motin dhe stinët e vitit.
- **SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI:** Nëpërmjet ushtrimit që kërkon të lidhen fotot me përshkrimin e tyre të saktë ose në gjëzën gjuhësore (fjalëkryq), rruga që ndjek dragoi për të kapur fluturën etj., mësuesi krijon te nxënësit ndjenjën e lojës dhe të konkursit. Kjo risi e platformës “Mëso Shqip” është e pranishme në çdo mësim dhe siguron rritjen e interesit të fëmijës për të marrë pjesë në shkollat shqipe, duke qenë se edhe mësojnë, edhe argëtohen.
- **GRAMATIKË:** Mësimi 4 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. Emrat e stinëve, numri njëjës dhe shumës, gjinia e emrit;
  - ii. Përemrat dëftore kjo, ky, këto, këta (kur janë afër); ajo, ai, ato, ata (kur janë larg); përemri pyetës ç’ + emër;
  - iii. Ndajfoljet ftohtë, ngrohtë, nxehtë;
  - iv. Mbiemrat i ftohtë, i ngrohtë, i nxehtë.
- **NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Në këtë rubrikë flitet për shkrimtarin e njohur Ismail Kadare dhe mënyrën e bukur me të cilën ai përshkruan jetën në qytetin e tij të gurtë, Gjirokastër tek romani “Kronikë në gur”. Fjala e urtë “Duaje atdhenë si shqiponja folenë”.
- **FJALORI:** qytet, fshat, bregdet (plazh), vend bregdetar, vend malor, lume, liqen, det, pyll, stinët e vitit, pranverë, verë, vjeshtë, dimër, qiell, tokë, diell, re, bie shi, bie borë, fryn erë.

## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



qytet



fshat



bregdet (plazh)  
vend bregdetar



vend malor




lumë



liqen



det



pyll



stinët



pranverë



verë



vjeshtë



dimër



qiell



tokë



diell



re



bie shi



bie borë



fryn erë



*Mësuese Teuta:* Të dashur nxënës, gëzohem që po takohemi përsëri. Sot kemi një temë interesante: “Shëtisim me imazhe në **qytete** të vendit tonë.”



*Dardani:* Unë mezi po pres. Kosova, ka shumë qytete të bukura. Do t’ju tregoj Drenicën, Prishtinën.



*Vesa:* Në Shqipëri do të shikoni vende të mrekullueshme. Le të shohim si është Himara dhe Tirana.



*Egini:* Mua më ka marrë shumë malli për qytetin tim. Shihni sa të bukur janë Tetova dhe Shkupi.



*Redona:* Sa **plazhe** të bukura ka Mali i Zi. Le të shohim si janë Ulqini dhe Podgorica.



### 1. Përgjigjuni pyetjeve.

Kush flet për plazhe të bukura? \_\_\_\_\_

A është Shkupi në Kosovë? \_\_\_\_\_

Pse gëzohet mësuesja? Si thotë ajo? \_\_\_\_\_



*Mësuese Teuta:* **Shumë bukur.** Fillojmë. Çfarë fotografish kemi?



*Dardani:* Po filloj unë me qytetin tim. Sa shumë dua të them!



**Drenica** është në qendër të Kosovës. Dimri është **i ftohtë**, kurse vera **e nxehtë**.

Drenica është qyteti i Adem Jasharit.



**Pristina** është kryeqyteti i Kosovës.

Këtu është Universiteti i Prishtinës, Teatri Kombëtar, Galeria e Arteve, Muzeu Kombëtar, Biblioteka Kombëtare, Parku i Gërmisë.




*Vesa:* Mësuese, jam **shumë e gëzuar** të flas për **vendin** tim.



**Himara** e bukur është në breg të detit Jon.

Himara ka **plazhet** e bukura të Dhërmiut dhe të Palasës.

Këtu janë hapur shkollat e para shqipe në shekullin XVII.



**Tirana** është kryeqyteti i Shqipërisë, që prej 9 shkurtit të vitit 1920. Është qyteti më i madh i Shqipërisë. Tirana ka klimë të ngrohtë, me dimër jo shumë të ftohtë dhe verë të **nxehtë**.








*Redona:* Mali i Zi ka shumë vende të bukura.



**Podgorica** është kryeqyteti i Malit të Zi. Në Podgoricë gjendet muzeu i qytetit, Muzeu i Historisë Natyrore.



**Ulqini** është një qytet **bregdetar**. Disa vende të tij shumë të bukura janë: Qyteti i Vjetër i Ulqinit, Ada Bojana dhe Lumi Bojana, Gjiri i Valdanos etj.



*Egini:* Dy qytete që i dua shumë: Shkupi dhe Tetova.

Kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut është **Shkupi**. Ai është qyteti **më i madh**. Vende interesante janë Kalaja, Ura e Gurtë mbi lumin Vardar. Nënë Tereza ka lindur në Shkup.

**Tetova** është një nga qytetet **më të vjetra** në Maqedoninë e Veriut. Aty mund të vizitoni Kalanë e Tetovës, Muzeun Etnografik etj.



## 2. Plotësoni përgjigjet sipas bisedës së mësuese Teutës me nxënësit.

*Vesa:* Nga është Adem Jashari?

*Dardani:* Ai është nga \_\_\_\_\_.

*Dardani:* Himara është vend bregdetar apo malor?

*Vesa:* Himara është \_\_\_\_\_.


*Redona:* A është Ulqini kryeqyteti i Malit të Zi?

*Egini:* Po/ Jo \_\_\_\_\_, është \_\_\_\_\_.

*Egini:* A është Nënë Tereza nga Tirana? *Vesa:* Po/ Jo \_\_\_\_\_, është nga \_\_\_\_\_.


**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Një këtu mësim do të përpigemi të përdorim strategjinë “Tregoj dhe Shpjegoj” (Show and Tell), e cila nga pikëpamja didaktike, ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre të folurit në publik. Koncepti “Tregoj dhe Shpjegoj” mund të zbatohet gjithashtu për mësimdhënien dhe stërvitjen kur përdorni demonstrime në foto apo diagramë gjatë një mësimi ose praktike që ndihmon nxënësit të flasin duke lidhur objektin me shpjegimin e funksionit apo përshkrimin të tij. Ndër vite janë bërë një mori kërkimesh mbi të mirat e të mësuarit të gjuhës, duke përdorur demonstrimet (tregimi pamor i objektit, TREGOJ/SHFAQ) dhe shpjegimet verbale (SHPJEGO çfarë shihet në objektin e prezantuar) për të lehtësuar të mësuarit e një gjuhe të re. Mësuesi që i beson teorisë se mësimi është një aktivitet social, do ta gjejë të dobishme përdorimin e strategjisë “Tregoj dhe Shpjegoj”, pasi demonstrimi i një aftësie ose përshkrimi/ shpjegimi i objektit krijon një imazh mendor me të cilin nxënësit mund t’i kalojnë lehtësisht njohuritë në kujtesën afatgjatë. Koncepti “një fotografi vlen sa një mijë fjalë”, tregon pikërisht vlerat e demonstrimit të aktiviteteve të aftësive për të “Treguar dhe Shpjeguar” gjatë mësimdhënies në shkollat shqipe. Shtimi i shpjegimeve verbale, së bashku me një demonstrim apo paraqitje të objektit, i ndihmon më tej nxënësit të asimilojnë informacionin që u mësohet. Konkretisht për ushtrimet e mësipërme, nxënësit mund të sjellin kujtime (foto, artifakte etj.) nga qytetet e tyre. Duke i treguar këto foto ata shpjegojnë gjërat më të bukura të fshatit apo qytetit ku jetojnë gjyshi apo gjyshja në trevat shqiptare. Nxënësit mund të sjellin fletëpalosje nga qendrat turistike, video nga festivale apo këngëtarë, atletë etj., që vijnë nga vendlindja e prindërve dhe t’ua shpjegojnë shokëve ato në prezantimin e tyre.

### 3. Lidhni fotot me përshkrimet.




Durrësi

Ata janë në Kalanë e Rozafës.



Shkodra

Liqeni në një ditë me diell.



Berati

Këto janë shtëpi të gurta.



Gjirokastra

Ky është bregdeti i Durrësit.



Pogradeci

Ky është lumi Osum.



### 4. Renditni germat të formojnë fjalë dhe gjeni se cilat prej tyre janë mbiemra.

Q T T E Y

\_\_\_\_\_

Ë P A R N V R E

\_\_\_\_\_

B R T G D E A E R

\_\_\_\_\_

M O L A R

\_\_\_\_\_



**Rekomandim didaktik 1:** Bota e mrekullueshme e lojërave gjuhësore, si p.sh.: anagramet (shkronjat e ngatërruara të një fjale) janë strategji shumë interesante për t’u mësuar fjalorin dhe drejtshkrimin nxënësve. Ka vetëm një problem që duhet mbajtur parasysh nga mësuesi: nëse nxënësit nuk tregojnë inteligjencë gjuhësore (verbale) mund të jetë e vështirë dhe zhgënjyese për ta të zhvillojnë gjuhë të folur dhe të shkruar. Në këtë rekomandim, mësuesit udhëzohen që për të ndihmuar nxënësit që nuk kanë të lehtë mësimin e gjuhës, t’i organizojnë lojërat me anagrame (enigma gjuhësore), duke i pasuruar me imazhe që mund të ndihmojnë nxënësin të gjejë fjalën “sekrete”. Pra, diçka duhet të bëhet për të bërë këtë veprimtari gjuhësore interesante dhe të lehtë për nxënësit, sepse anagramet kanë potencial të madh në zhvillimin intelektual. Do të ishte humbje nëse anagramet nuk përdoren në mësimin e gjuhës shqipe. Çështja është se si të përdorim vlerat e lojës për përfitimet tona në mësimdhënie, duke përdorur vizualizimin si ndihmë shtesë për anagramet. Anagramet ndihmojnë nxënësit të mësojnë dhe të argëtohen në të njëjtën kohë.


Konkretisht, mësuesi i paraqet anagramet si një listë fjalësh me shkronja të ngatërruara dhe nxënësit përpiqen ta gjejnë fjalën sekrete, duke vendosur radhazi shkronjat e dhëna derisa të gjejnë rendin e saktë, p.sh.: qytet.

Q	T	T	E	Y
---	---	---	---	---

## KLIMA DHE MOTI. STINËT E VITIT



*Mësuese Teuta:* Të shohim stinët e vitit dhe muajt e stinëve. Le të flasim. Ç'stinë na pëlqen më shumë?



*Dardani:* Unë e dua shumë dimrin. Në dimër bie shi, bën ftohtë, bie borë. Qielli është me re. Ne shkojmë në vende malore dhe rrëshqasim në akull, bëjmë ski.



*Vesa:* Pranvera është stina ime. Ditët janë të ngrohta. Natyra na përshëndet me shumë lule dhe ngjyra. Zogjtë vijnë dhe këndojnë. Mali, fusha, deti, lumi, liqeni janë shumë të bukur në pranverë.



*Egini:* Mua më pëlqen vjeshta. Bie pak shi, fryn erë dhe bien gjethet. Unë shkoj në fshat dhe ha shumë fruta. Luaj me shokët hapadollapa dhe ngriva-shkriva. Në vjeshtë fillon shkolla.




*Redona:* Unë e dua shumë verën. Është stina e pushimeve. Ditët janë të gjata dhe të nxehta. Unë me prindërit shkojmë te gjyshërit në plazh dhe notojmë në det. Neve na pëlqen edhe mali, edhe pylli.

**Rekomandim didaktik 2:** Sipas konceptit “Tregoj dhe Shpjegoj”, mësuesi mund të presë foto të stinëve nga kalendare të vjetër dhe të caktojë një nxënës (të përparuar në gjuhë) që të luajë rolin e meteorologut dhe të bëjë “parashikimin e motit”. Mësuesi mund të përgatisë një rrotë prej kartoni ku të shkruajë: vera, vjeshta, dimri pranvera. Tek secila stinë duhet të vendosen fjalët e mësuara më lart: bie shi, fryn erë, bie borë, nxehtë, ftohtë etj. Në mes të rrotës së stinëve, vendosni një gjilpërë me kokë dhe nguleni rrotën në mur (mund të vendosni një gozhdë të madhe apo një laps në qendër të rrotës dhe ta mbajë një nxënës, ndihmës i meteorologut). Gjithashtu mësuesi mund të përgatisë foto (diell, re, shi etj.) me ngjitime dhe një nxënës i tretë mund të vendosë fotot dhe të thotë një fjalë ose fjali për foton dhe stinën ku e vendos.







# SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI



5. Ndhmoni dinozaurin të arrijë te flutura duke ndjekur numrat.




6. Plotësoni fjalitë me fjalën e duhur dhe lexojini ato me zë.

Në  \_\_\_\_\_ fillon shkolla. Unë e dua shumë  \_\_\_\_\_.

Në  \_\_\_\_\_ ditët janë të ngrohta.  \_\_\_\_\_ është stina e

pushimeve. Bie pak  \_\_\_\_\_. Unë shkoj në  \_\_\_\_\_ dhe

ha shumë fruta. Ne shkojmë te  \_\_\_\_\_ në plazh.

## 8. Shkruani muajt e vitit për çdo stinë.

---



---



---



---



**Rekomandim didaktik 3:** Në këtë ushtrim mësuesi mund të përdorë strategji shumë interesante ku nxënësit mund të tregojnë aftësitë e tyre në fusha të ndryshme (vizatim, gjeste, humor etj.). P.sh.: Mësuesja mund t'i vendosë nxënësit në grupe të vogla dhe t'u thotë të shtojnë disa vizatime tek diagrami i dinozaurit apo të vendosin fjalët që mësuan në këtë mësim (lumë, fshat, liqen, det, shi, pyll) dhe të "Tregojnë dhe Shpjegojnë" udhëtimin e dinozaurit deri tek flutura. Pasi mbaron, grupi bën "Trego dhe Shpjego" para klasës. Mësuesi mund të bëjë foto apo video të prezantimeve, mund t'i vendosë në "Facebook", "YouTube" etj. Bëhuni sa më krijues që t'i bëni nxënësit të vijnë me shumë dëshirë në klasën tuaj.



## GRAMATIKË

### Trajta e shquar dhe e pashquar; gjinia femërore dhe mashkullore

Gjinia femërore				Gjinia mashkullore			
Numri njëjës		Numri shumës		Numri njëjës		Numri shumës	
Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
(një) stinë	stina	(disa) stinë	stinët	(një) vit	viti	(disa) vite	vitet
(një) ditë	dita	(disa) ditë	ditët	(një) muaj	muaji	(disa) muaj	muajt
(një) erë	era	(disa) erëra	erërat	(një) shi	shiu	(disa) shira	shirat
(një) kala	kalaja	(disa) kala	kalatë	(një) fshat	fshati	(disa) fshatra	fshatrat
(një) verë	vera	(disa) vera	verat	(një) qytet	qyteti	(disa) qytete	qytetet
(një) shkollë	shkolla	(disa) shkolla	shkollat	(një) lumë	lumi	(disa) lumenj	lumenjtë

### 9. Përcaktoni nëse fjalët e mëposhtme janë të gjinisë femërore apo mashkullore. (Emrat femërorë mbarojnë me -a/-ja, emrat mashkullore mbarojnë me -i/-u.)

muaji (\_\_\_\_), dita (\_\_\_\_), viti (\_\_\_\_), stina (\_\_\_\_), shiu (\_\_\_\_), vera (\_\_\_\_), dimri (\_\_\_\_), qyteti (\_\_\_\_), mali (\_\_\_\_), era (\_\_\_\_), dëbora (\_\_\_\_), kalaja (\_\_\_\_), akulli (\_\_\_\_), mali (\_\_\_\_).

❖ Përemrat dëftorë *ky, kjo, këta, këto*.

Afër			
Njëjës		Shumës	
Femërore	Mashkullore	Femërore	Mashkullore
kjo	ky	këto	këta

10. Plotësoni fjalitë me përemrat dëftorë *ky, kjo, këta, këto*.

Mua më pëlqen \_\_\_\_\_ stinë. Ç'stinë të pëlqen ty?

Mua më pëlqen dimri. \_\_\_\_\_ dimër nuk është shumë i ftohtë.

\_\_\_\_\_ ditë është ngrohtë. \_\_\_\_\_ janë muajt e pranverës.

11. Ktheni fjalitë në numrin shumës.

Kjo është ditë interesante. \_\_\_\_\_

Ky fshat është në mal. \_\_\_\_\_

Ky është muaj me shi. \_\_\_\_\_

Kjo vajzë shkon në shkollë. \_\_\_\_\_

Ky djalë noton në lumë. \_\_\_\_\_

❖ Përemri pyetës ç'.

Ç' +

vite
muaj
shira
fshatra
qytete
lumenj

Ç' +

stinë
ditë
erë
kala
verë
shkollë

12. Shkruani 5 pyetje me përemrin pyetës ç' dhe` përgjigjuni atyre.

---

---

---

---

---

❖ Ndajfoljet *ftohtë, ngrohtë, nxehtë*; mbiemrat *i ftohtë, i ngrohtë, i nxehtë*.


emër + mbiemër

folje+ ndajfolje

Ditë e ftohtë/ e ngrohtë/ e nxehtë.

Sot është ftohtë/ ngrohtë/ nxehtë.

13. Plotësoni fjalitë me mbiemër ose ndajfolje.



Maji është muaj \_\_\_\_\_  
Dhjetori është muaj \_\_\_\_\_  
Gushti është stinë \_\_\_\_\_

Në maj është \_\_\_\_\_  
Në dhjetor është \_\_\_\_\_  
Në gusht është \_\_\_\_\_

**Rekomandim didaktik 4:** Të gjitha ushtrimet e mësipërme duhen trajtuar VETËM si një rast që u jepet nxënësve për të përdorur gjuhën në mënyrë korrekte. Shpjegimet apo analizat gramatikore në këtë nivel duhet të mbeten në minimum. Shpjegime të mirëfillta të gramatikës do të bëhen në nivelet C1 dhe C2. Ne rekomandojmë që këto ushtrime të bëhen në bashkëpunim të dy ose me shumë nxënësve, sepse në këtë mënyrë jo vetëm ndihmojnë njëri-tjetrin, por edhe fillojnë të komunikojnë shqip (qoftë edhe me gabime).




## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË

Shumë shkrimtarë shkruajnë për qytetin e tyre.



Ismail Kadare shkruan për Gjirokastrën në romanin “Kronikë në gur”.

Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla) shkruan për Shkodrën në “Novelat e qytetit të veriut”.




### 14. Përpiquni të gjeni disa libra ku autorët shkruajnë për vendin e tyre.



#### ***A e dini se...***

*Arkitekt Sinani, arkitekti i parë i perandorisë osmane, ishte shqiptar. Lindi më 29 maj në vitin 1489. U rrit buzë lumit të Vjosës, ku kalonte rruga Vlorë-Selenicë-Kullës-Lopës-Tepelenë.*



**Rekomandim didaktik 5:** Në informacionet dhe ushtrimet e mësipërme fokusi kryesor i mësimdhënies është njohja me personalitete shqiptare, historike apo të reja), të cilët i bëjnë nder kombit tonë. Në varësi të moshës së nxënësve, mësuesi mund të japë edhe me shumë informacion për Kadarenë (gjendet lehtë në internet) apo për arkitekt Sinanin (disa studiues kanë cituar origjinën shqiptare të tij). Sipas studiuesit britanik Percy Brown dhe studiuesit indian Vidya Dhar Mahajan, Perandori Mughal Babur ishte shumë i pakënaqur me arkitekturën dhe planifikimin lokal indian, kështu që ai ftoi “disa nxënës të arkitektit kryesor osman Sinan, gjeniut shqiptar, për të kryer skemat e tij arkitektonike.



## 15. Lexoni poezinë dhe diskutoni për mallin për atdheun. Qarkoni fjalët që kuptoni.

### Shko dallëndyshe

Udha e mbarë se erdh pranvera,  
shko, dallëndyshe tue fluturue,  
prej Misirit n' dhena tjera,  
fusha e male tue kërkue;  
n' Shqipni shko, pra, fluturim,  
shko në Shkodër, n' qytetin tim.  
Shëndet prej meje të m' i falësh  
asaj shpisë vjetër ku kam le,  
me ato vende rreth t' përfalesh,  
ku kam shkue kohën e re;  
atje shko, pra, fluturim,  
fal me shndet qytetit tim.  
Me ato male, me ato kodra,  
me ato proje rreth t' përfalesh  
n' ato fusha që m' ka Shkodra  
të lulzueme, aty t' ndalesh;  
tue kndue me ambëlçim,  
fal me shndet qytetit tim.  
T' mujsha dhe un' me fluturue  
dojsa dhe un' me u nisë me ty,  
dojsa n' Shkodër me kalue,  
m' e pa prap at' vend me sy!  
Por... ti shko atje... fluturim  
e ti qajma fatin tim.

### *Filip Shiroka*



**PROJEKT:** Kërkoni fotografi të ndryshme nga qyteti juaj dhe përgatisni një prezantim (vende, veshje, ushqime etj.)

**FJALË TË URTA**

*Duaje atdhenë si shqiponja folenë!*





## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
bregdet det dhjetor diell dimër erë fshat ftohtë gusht janar korrik liqen lumë maj mal mars muaj nëntor ngrohtë nxehtë pranverë prill pyll qershor qiell qytet re shi shkurt shtator stinë tetor verë vit vjeshtë	gjysh akull bëj dua flas gëzohem jam kam lind luaj mall notoj përshtëndes pres prindër rrëshqas ski shkoj shoh them	gëzohem giethe i ftohtë i mrekullueshëm i ngrohtë i nxehtë interesant kontinental lule mesdhetar mezi ngjyra përsëri temë vizitoj

**Rekomandim didaktik 6.** Në këtë veprimtari didaktike, mësuesi siguron që nxënësit kanë përvetësuar fjalët e fjalorit në kolonën e parë (fjalori i ri); kanë rimarrë fjalët e kolonës së dytë (riciklimi i fjalëve nga mësimi 1) dhe janë ekspozuar fjalët e kolonës së tretë (fjalori shtesë), i cili në mënyrë të qëllimshme do të përdoret nga autorët e platformës “Mëso Shqip” në mësimet e ardhshme.

# MËSIMI 5

*Festat kombëtare: tradicionale  
dhe bashkëkohore  
Ditët e javës. Sa është data? Sa është ora?*

## **Qëllimet mësimore:**

- a) Bisedoj për festat në vendin tim
- b) Ditët e javës. Sa është ora? Sa është data?
- c) Gramatikë: përemra të pacaktuar të gjithë, njëri-tjetri; ndajfolje pyetëse *kur? pse?*; lidhëza *edhe, sepse*; numërorët *1-60*.
- d) Punë e diferencuar: “28 Nëntori”, “Ismail Qemali”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë*

Flas për motin

Unë dhe mjedisi

Qytetet

Objektivi mësimor. Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË: Mësimi 5 ndihmon që të mësohen fjalët që lidhen me festat kombëtare dhe me ditët e javës. Fokusi është përdorimi i informacionit për ditën e flamurit dhe fjalorin praktik, i cili do të shoqërohet me vizatime dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë festive që organizohen nga shoqatat në vendet ku banojnë nxënësit. Ndoshta këtu është momenti kur mësuesit fillojnë përgatitjet për montazhet muziko-letrare apo koncerte për 28-29 Nëntorin.
- SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI: Nëpërmjet anagramëve dhe fjalë kryqeve, nxënësit përsërisin dhe rimarrin fjalorin e mësuar në këtë mësim.
- GRAMATIKË: Mësimi #3 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. Numërorët 20-60 (1-20 janë mësuar më parë);
  - ii. Përemrat pyetës kush? cili? cila? cilët? cilat?, çfarë?;
  - iii. Përemrat e pacaktuar të gjithë, njëri-tjetri;
  - iv. Ndajfolje pyetëse kur? pse?
  - v. Lidhëzat edhe, sepse.
- NJOHIM TRASHËGIMINË TONË: Dëgjohe kënga “Një lahutë e një flamur” dhe nxënësit përpiqen të mësojnë tekstin e saj <https://www.youtube.com/watch?v=FLgd0Z4zZKA> Flitet për Nëntorin e Parë, 1443 kur Skënderbeu ngriti flamurin në Krujë dhe Nëntorin e Dytë, 1912 kur Ismail Qemali ngriti flamurin në Vlorë.
- FJALORI: Viti i Ri, Festa e Pavarësisë, Festa e Punëtorëve, Krishtlindje, Pashkë, Bajram, Sulltan Novruz, Festa e Nënës, Festa e Mësueses, Dita e Verës, Shenjtërimi i Nënë Terezës, Festa e Kosovës, Dita e Verës, ndahemi, flasin, cila, mars, shkëlqen, festojmë, ballokume, dhurata, krenare, historia, interesant, e hënë, e martë, e mërkure, e enjte, e premte, e shtunë, e diel, ora, fiks, çerek, gjysmë.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Mësimdhënia në nivelin bazik (A1) duhet të mbështetet ose të përqendrohet në aspektin e të folurit nëpërmjet bashkëbisedimit. Koha që u jepet nxënësve për të biseduar gjatë orës së mësimi është thelbësore kur mësohet gjuha e dytë, në rastin konkret gjuha shqipe. Në shumë raste, mësuesi priret të flasë më shumë vetë dhe fillon t'i ndërpresë diskutimet e nxënësve nëse bëjnë gabime. Koha e të folurit për mësuesin në një orë mësimi duhet të jetë më e kufizuar. Ai duhet të përdorë strategji që i inkurajojnë nxënësit të flasin. Në fakt, rekomandohet që koha e të folurit të mësuesit të jetë 15 deri në 20 për qind gjatë orëve të bisedës, duke u lënë nxënësve 80-85% të kohës për të folur. Një strategji tjetër e rëndësishme kur mësohet gjuha e dytë me anën e bashkëbisedimit lidhet me mënyrën se si mësuesi bën korrigjimet e gabimeve. Nxënësit në këtë nivel kanë një fjalor të kufizuar dhe mund shqiptojnë dobët fjalët ose madje mund të mos përdorin fjalën e duhur në fjalitë e tyre. Sado e vështirë të jetë për mësuesin që të mos ndërhyjë për të shpjeguar gabimet, në këtë fazë të mësimi të gjuhës kufizimi i korrigjimeve tuaja është thelbësor për rritjen e vetëbesimit tek nxënësit tuaj. Kjo është e domosdoshme për rritjen e aftësive bashkëbiseduese të nxënësve të nivelit A1.

## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOKJMË



Mësuese Teuta: Mirëdita! Sot kemi një mësim plot gëzim.

Flasim për festat. Shikoni disa prej tyre.



Viti i Ri



Festa e Pavarësisë




Festa e Punëtorëve



Krishtlindjet



Pashkë



Bajram



Sulltan Novruzi



Festa e Nënës



Festa e Mësueses



Dita e Verës



Shenjtërimi  
i Nënë Terezës



Mësuese Teuta: Ja, si urojmë:

**Gëzuar** +

Festën e Pavarësisë!  
Krishtlindjet!  
Bajramin!  
Vitin e Ri!  
Pashkët!  
Sulltan Novruzin!  
Ditën e Verës!

Data	Festa zyrtare në Shqipëri	Festa zyrtare në Kosovë
1 Janar	<b>Viti i Ri</b>	<b>Viti i Ri</b>
17 Shkurt		<b>Pavarësia e Kosovës</b>
7 Mars	<b>Festa e Mësueses (jo zyrtare)</b>	
8 Mars	<b>Festa e Gruas (jo zyrtare)</b>	
14 Mars	<b>Dita e Verës</b>	
22 Mars	<b>Festa e Sulltan Novruzit</b>	
9 Prill		<b>Kushtetuta e Kosovës</b>
4 Prill (Kjo datë ndryshon çdo vit.)	<b>Pashkët Katolike</b>	<b>Pashkët Katolike</b>
1 Maj	<b>Dita Ndërkombëtare e Punës</b>	<b>Dita Ndërkombëtare e Punës</b>
2 Maj (Kjo datë ndryshon çdo vit.)	<b>Pashkët Ortodokse</b>	<b>Pashkët Ortodokse</b>
9 Maj		<b>Dita e Evropës</b>
13 Maj	<b>Bajrami i Madh</b>	<b>Bajrami i Madh</b>
1 Qershor	<b>Dita e Fëmijëve (jo zyrtare)</b>	
12 Qershor		<b>Dita e Paqes</b>
5 Shtator	<b>Shenjtërimi i Nënë Terezës</b>	
28 Nëntor	<b>Festa e Pavarësisë</b>	<b>Dita e Shqiptarëve (Dita e Pavarësisë së Shqipërisë)</b>
29 Nëntor	<b>Festa e Çlirimit</b>	
8 Dhjetor	<b>Dita e Rinisë</b>	
25 Dhjetor	<b>Krishtlindjet</b>	<b>Krishtlindjet</b>

**Rekomandim didaktik 1:** Për t'u dhënë mundësi nxënësve të flasin me njëri-tjetrin, mësuesi mund të krijojë skeda ku:

a) në një palë vendos emrin e festës dhe në tjetrën të vendosë fjalët "Shqipëri" dhe "Kosovë" – me qëllim që nxënësit të identifikojnë cilat festa festohen në secilën anë të kufirit;

b) në një palë skeda vendosen festat dhe në një palë tjetër urimet përkatëse.

Me këto skeda mund të krijohen veprimtari didaktike nga më të ndryshmet, p.sh.: nxënësit mund të vendosen në çifte dhe të luajnë rolin e njerëzve që takohen dhe pyesin njëri-tjetrin: Ku festohet kjo festë? ose Si përshëndesim në këtë festë? Në ndonjë rast, mësuesi mund të kërkojë që nxënësit të krijojnë dialog të shkurtër në lidhje me festën dhe ta vënë në skenë. Pavarësisht se cila veprimtari e mësimdhënjes do të përdoret, fokusi mbetet një - mësuesi u krijon mundësinë nxënësve të flasin 80% dhe vetë flet vetëm 20%.

1. Shkruani disa festa zyrtare që festohen në vendin ku jetoni.

---

---



*Mësuese Teuta:* Le të **ndahemi** në grupe dhe të **flasim** për festat që na pëlqejnë.

*Dardani:* Vesa, **cila** festë të pëlqen më shumë?

*Vesa:* Më pëlqen shumë Dita e Verës.

*Dardani:* **Kur** është kjo festë? Çfarë bëni atë ditë?

- Vesa:* Më 14 **mars** dhe është pranverë. Dielli **shkëlqen** në qiell dhe lulet **festojnë** me ne. Hamë ballokume dhe vëmë në dorë veroren e gjyshes.
- Dardani:* Çfarë janë ballokumet?
- Vesa:* Janë disa biskota **shumë të mira** për Ditën e Verës. Po ty, Dardan, **cila** festë të pëlqen **më shumë?**
- Dardani:* Për mua, festa **më e bukur** është Viti i Ri, sepse dajat e mi vijnë te gjyshi dhe ne festojmë bashkë.
- Vesa:* Merr edhe shumë **dhurata?**
- Dardani:* Hahaha, po, Vesa. Të gjithë bëjnë dhurata. Unë jam **më i vogli** dhe marr më shumë.
- Vesa:* Sa qejf! **Edhe** unë i dua shumë dhuratat.

**Rekomandim didaktik 2:** Mësuesi mund të krijojë veprimtari shumë praktike për të zhvilluar të folurit e gjuhës shqipe në këto ushtrime. Një mënyrë shumë interesante do të ishte që nxënësit të ndaheshin në grupe, të diskutonin dialogun dhe pastaj të zgjidhnin të mësonin të bënin një verore ose një kartolinë për Vitin e Ri apo Shën Valentinin. Për këtë mund të shfrytëzohet edhe një video nga "YouTube" Si të bësh një byrzylyk veror - YouTube ose për kartolinën e Shën Valentinit tek Si Të Bëni Një Kartolinë Për ShënValentinin !!!! - YouTube dhe për kartolinën e Vitit të Ri te Si të bëjmë kartolina për vitin e ri - YouTube. Gjithashtu, nxënësit mund të mësojnë si të bëjnë ballokume dhe pastaj t'i shijojnë së bashku. Kjo veprimtari mund të bëhet në bashkëpunim me nënat e nxënësve. Pavarësisht nga zgjedhja e veprimtarisë, kjo strategji u jep mundësinë nxënësve që të dëgjojnë, kuptojnë dhe të flasin vetë me gjithë fjalorin e kufizuar. Fakti që videot drejtohen nga fëmijë që flasin shqip dhe përdorin një fjalor të thjeshtë, bën që të përdoren me lehtësi nga nxënësit tanë.







## 2. Përgjigjuni pyetjeve.


Pse i pëlqen Dardanit festa e Vitit të Ri? \_\_\_\_\_

Çfarë bën Redona Ditën e Verës? \_\_\_\_\_

A është Dita e Verës më 14 Shkurt? \_\_\_\_\_

*Egini:* Redona, e di cila është festa më e bukur për mua?

*Redona:* Nuk e di, por për mua është 28 Nëntori.

*Egini:* Edhe për mua, Redona. Sa bukur është: të gjithë shqiptarët në botë festojnë “kuq e zi”  më 28 Nëntor.

*Redona:* Po, Egin. Ne jemi **krenarë** për **historinë** tonë, jemi krenarë që jemi shqiptarë.

*Egini:* Unë shkoj gjithmonë me prindërit në Vlorë më 28 Nëntor.

*Redona:* Muzeu i Pavarësisë në Vlorë është shumë **interesant**.



## 3. Përgjigjuni pyetjeve.

Cila festë i pëlqen më shumë Redonës dhe Eginit? \_\_\_\_\_

Ku është Muzeu i Pavarësisë? \_\_\_\_\_

Cila është data e pavarësisë? \_\_\_\_\_



**Rekomandim didaktik 3:** Pas dialogut të mësipërm mundësitë për veprimtari didaktike që nxisin bashkëbisedimin janë të shumta. Mësuesi mund të sjellë fotografi të ndryshme dhe të kërkojë që nxënësit t'i rendisin sipas ngjarjeve historike, p.sh.: Nëntori i Parë – Skënderbeu; Nëntori i Dytë – Ismail Qemali etj. Mund të flitet për Marigonë dhe qëndisjen e flamurit duke parë videon: *Pjesa teatrale "Qëndisja e Flamurit" nga kl.8 -25/11/2011 - YouTube ose ndërtimin e një mozaiku të flamurit të Kosovës duke shfrytëzuar Qëndisje me gure e Flamurit te Kosovës 17.02.2016 - YouTube*

Me veprimtari të tilla interesante mësuesi garanton rritjen e krenarisë kombëtare dhe dëshirën për të ardhur në mësimin e gjuhës shqipe nga ana e nxënësve. Në aspektin gjuhësor, kjo strategji i detyron nxënësit që të përdorin disa vatra të trurit, duke përfshirë edhe atë të të parit, të të dëgjuarit, të të kuptuarit dhe të të folurit. Kjo është mënyra më e mirë për të ndërtuar dendrite, gjë që siguron një komunikim të qëllimshëm dhe e kalon informacionin në kujtesën afatgjatë.



#### 4. Përshkruani me 3-4 fjali festën që ju pëlqen më shumë.

Mësuese  
Teuta:


Tani do t'ju tregoj për një festë tjetër. Atë Bernardin Palaj shkruan dhe na **regon** se Dita e Shën Gjergjit është si dita e kremtimit të pranverës dhe festohet më 23 prill. Dyer shtëpish, djepat e fëmijëve **rrethohen** me lule. Në Dukagjin vënë kurora në bel dhe në kokë. Në Malësi të Madhe përshëndeten në këtë ditë me **njëri-tjetrin**, duke hedhur lule të njoma. Në këtë ditë, në agim, barinjtë gjithë bimët dhe lulet e freskëta ia japin bagëtisë. Kjo është edhe festa e bjeshkëve, që e quajnë Shna Prendja. Në çdo shtëpi gatujnë fërluk dhe provojnë mjaltin e ri. ("Bota e maleve shqiptare", Botime Françeskane, Shkodër, 2017).



## 5. Zgjidhni përgjigjen e saktë.

- *Kur festohet Shën Gjergji?*
  - Më 23 qershor.
  - Më 3 mars.
  - Më 23 prill.
- *Ku vënë kurora me lule?*
  - Në Shkodër.
  - Në Dukagjin.
  - Në Malësi të Madhe.
- *Në Malësi të Madhe përshëndeten:*
  - duke i hedhur lule të njoma njëri-tjetrit;
  - duke i hedhur ujë njëri-tjetrit;
  - duke i dhënë kurora njëri-tjetrit.
- *Në çdo shtëpi provojnë:*
  - fasulet e reja;
  - bukën e re;
  - mjaltin e ri.

*Mësuese Teuta:* Ne takohemi ditën e shtunë, në orën 9.  
Sa është ora tani?



*Dardani:* Unë zgjohem në orën 8. Vij në orën 9. Tani është ora 10.

*Vesa:* Unë e dua shumë ditën e diel. **Dita e diel** është pushim.

*Redona:* Mua më pëlqen dita **e shtunë**, sepse fle në orën 23 në darkë.

*Egini:* Mua më pëlqen dita **e enjte**, sepse shkoj në kurs në orën 18.

*Mësuese Teuta:* Po ditën e **hënë**, çfarë bëni?

*Vesa:* Ditën e hënë fillon java, shkojmë në shkollë, në orën 8.  
Mbarojmë në orën 15.

*Egini:* Ditën e **martë** unë shkoj në kinema në orën 19.

*Redona:* Unë shkoj në tenis ditën e **enjte** dhe ditën e **premtë**, në orën 17.

**6. Rilexoni dialogët dhe përcaktoni nëse fjalitë janë të sakta:  
V (e vërtetë), G (e gabuar).**

**V G**

Vesa shkon në tenis ditën e enjte.

Egini shkon në kinema ditën e martë, në orën 19.

Mësimi i gjuhës shqipe fillon në orën 10.

Ditën e shtunë, Redona fle në orën 23.


Java fillon ditën e diel.

Ditën e shtunë Dardani zgjohet në orën 8.



*Mësuese Teuta:* Ja, si e tregojmë orën në gjuhën shqipe.


**Ora është 12 (dymbëdhjetë).**



**Ora është 12 (dymbëdhjetë) e 5 (pesë) minuta.**




**Ora është 12 (dymbëdhjetë) pa 5 (pesë).**






**Kujdes!**

Kur ora është 9:00, themi edhe 9 (nëntë) **fiks**.



Kur ora është 9 e 15 themi edhe 9 (nëntë) **e një çerek**.

Kur ora është 9 e 30 themi edhe 9 (nëntë) **e gjysmë**.



Kur ora është 9 e 45 themi edhe 10 (dhjetë) **pa një çerek**.



### 7. Lidhni fotot me përshkrimet.



tre e njëzet



dhjetë e dhjetë



dy e gjysmë



një pa njëzet e pesë



një pa dhjetë



katër e një çerek

**Rekomandim didaktik 4:** Në mësimet e mëparshme nxënësit kanë mësuar numërorët nga 1-60, si pjesë e gramatikës. Tani, ato njohuri do të riciklohen duke i përdorur për të treguar orën në gjuhën shqipe. Për këtë, mësuesi mund të vizatojë disa rrathë (që do të përdoren për të krijuar orën), do të sjellë “bukë peshku/sfungjer” dhe disa gozhda që do të mbajnë “akrepat e orës” në qendër të rrethit. Një mënyrë tjetër është që nxënësit të përdorin orën e tyre si mjet për të treguar orën në shqip. Nxënësit ndahen në çifte dhe pasi krijojnë “orën” e tyre fillojnë të lëvizin akrepat sipas komandave të mësueses apo shokut të tyre në çift. Kjo mënyrë ndërvepruese jep rezultate të mira.

*Mësuese Teuta:* Këto janë ditët e javës:



## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

E hënë	Monday
E martë	Tuesday
E mërkurë	Wednesday
E enjte	Thursday
E premte	Friday
E shtunë	Saturday
E diel	Sunday

**8. Gjeni emrat e ditëve të javës dhe vini numrin, sipas rendit që kanë.**

E N J E E T \_\_\_\_\_

E Ë K R U E M Ë \_\_\_\_\_

E R T E P E M \_\_\_\_\_

E Ë Ë N H \_\_\_\_\_


E U T S H Ë N \_\_\_\_\_

E I D E L \_\_\_\_\_

E R T Ë A M \_\_\_\_\_



### 9. Shkruani ditën e zgjedhur në kalendar.




### 10. Plotësoni fjalëkryqin.

*Horizontalisht:*

- 1. Muaji 5.
- 4. Muaji 11.
- 5. Muaji 10.

*Vertikalisht:*

- 2. Muaji 1.
- 3. Muaji 3.



**Rekomandim didaktik 5:** Lojërat e mësipërme mund të përdoren si për punë individuale, ashtu edhe në çifte. Mësuesi mund ta ndërtojë këtë veprimtari si një konkurs i vogël ose nxënësit mund të postojnë në mur zgjidhjet e tyre. Në këtë mënyrë krijohet një ekspozitë e këndshme ku shokët e klasës mund të bëjnë komente ose të rekomandojnë përmirësime në komentet e tyre.



**Rekomandim didaktik 6:** Përgjigjet për ushtrimin e mësipërm janë: dyzet, nëntë, tetë, pesë. Kjo qasje interesante fut aspektin e lojës, gjë që e bën mësimin tërheqës dhe të këndshëm.

12. Formoni 10 numra me dy shifra dhe shkruajini me fjalë.



	_____	_____
	_____	_____
	_____	_____
	_____	_____

❖ Përemra pyetës *kush? cili? cila? cilët? cilat? çfarë?*

Vetëm për njerëz	Për njerëz, qenie të tjera, objekte, dukuri				Për objekte dhe dukuri
<b>kush</b> (çdo numër dhe gjini)	<b>cili</b> (numri njëjës, gjinia mashkullore)	<b>cila</b> (numri njëjës, gjinia femërore)	<b>cilët</b> (numri shumës, gjinia mashkullore)	<b>cilat</b> (numri shumës, gjinia femërore)	<b>çfarë</b> (numri njëjës, gjinia femërore)

❖ Përemra të pacaktuar të gjithë, njëri-tjetri; ndajfolje pyetëse *kur? pse?*; lidhëza *edhe, sepse*.

**Pse** shkon atje? - **Sepse** luajmë të gjithë me njëri-tjetrin.

**Kur** luan tenis? - Unë luaj tenis **edhe** të mërkurën, **edhe** të dielën.



**13. Plotësoni me fjalën që mungon: cili? çfarë? kur? pse? sepse, cilat.**

\_\_\_\_\_ është ai? Ai është shoku im.  
\_\_\_\_\_ nuk vjen në kinema? Sepse po bie shi.  
\_\_\_\_\_ fillon filmi? Filmi fillon në orën 19.  
\_\_\_\_\_ të pëlqen? Më pëlqen të luaj.  
\_\_\_\_\_ janë shoqet e klasës? Vesa dhe Redona janë shoqet e mia të klasës.

**Rekomandim didaktik 7:** Edhe pse kjo rubrikë quhet “Gramatikë”, mësuesi duhet të bëjë kujdes që konceptet gramatikore të mësipërme të përvetësohen vetëm me anën e situatave praktike dhe të mos bëhen sqarime teorike.



**NJOHIM TRASHËGIMINË TONË**

**14. Dëgjoni këngën “Një lahutë e një flamur” dhe përpiquni të shkruani e të mësoni disa vargje të saj.**

<https://www.youtube.com/watch?v=FLgd0Z4zZKA>

*Në dhomë të pritjes ndrit në mur  
i qëndisur një flamur  
pranë tij lahuta rri  
bashkë bëjnë Shqipëri.  
Një stërgjyshe nga kjo tokë  
endi shqipen me dy kokë  
në lahutë stërgjyshi im  
gdhendi shqipen n'fluturim...*



**Rekomandim didaktik 8:** Duke përdorur adresën digjitale të dhënë më sipër, mësuesi mund të përdorë strategji të ndryshme për të kuptuar tekstin e këngës. Mësuesi mund të projektojë në ekran tekstin e këngës nga e cila ka hequr fjalët që kanë mësuar nga mësimet e mëparshme (shih fjalët e shënuara me të verdhë në tekstin e mësipërm). Pas kësaj, mund t'u kërkojë nxënësve që të dëgjojnë dhe të plotësojnë boshllëqet në tekst. Kjo mund të kërkojë që kënga të dëgjohet më shumë se një herë nga nxënësit. Në fund të gjithë e këndojnë këngën së bashku.



### *A e dini se...*

*Më 28 nëntor 1443, Gjergj Kastriot  
Skënderbeu,*

*ngriti flamurin në Kallanë e Krujës.*

*Më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali ngriti flamurin  
në Vlorë dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë.*



**PROJEKT:** Kërkoni fotografi të ndryshme nga qyteti juaj dhe përgatitni një prezantim (vende, veshje, ushqime etj.)

### **FJALË TË URTA**

*Atë që sjell çasti, s'e sjell moti!*

**Rekomandim didaktik 9:** Në shumë shkolla në këtë kohë mund të fillojnë provat për festimet e 28-29 Nëntorit, ndaj mësuesi mund ta shfrytëzojë këtë mësim për të zbuluar talente dhe për të filluar përgatitjet për koncertin e festës.

Një ide interesante mund të jetë edhe shfaqja e filmit "Nëntori i Dytë" ku nxënësit të ftojnë edhe prindërit e tyre.

Ka shumë shembuj interesantë të shfaqjeve të bukura, si nga: shoqata "Ardhmëria" në Mbretërinë e Bashkuar, shkolla "AlbaLife" në Nju-Jork, disa shkolla në Itali, Greqi, Zvicër, Austri, Slloveni etj.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
cili	det	Bajram
çerek	diell	ballokume
çfarë	ditë	katolik
çlirim	ftohtë	kremtoj
e diel	gusht	Krishtlindje
dhurata	interesant	kushtetuta
edhe	janar	ndërkombëtar
e enjte	maj	ortodoks
festoj	mars	paqe
fiks	muaj	Pashkë
të gjithë	nëntor	shenjtërim
gjysmë	numëror	verore
e hënë	pranverë	zyrtar
krenarë	qiell	
kur	shi	
e martë	tetor	
e mërkurë	verë	
ndahem	vit	
njëri-tjetri	vizitoj	
pavarësi		
e premte		
pse		
sepse		
shkëlqen		
e shtunë		
tregoj		

**Rekomandim didaktik 10:** Mësuesi mund të bëj gjeje forma të ndryshme për të parë përvetësimin e fjalorit në këtë mësim. Këtu mund të përdoret *Quizlet.com*, *Jeopardy*, *Kahoon* etj.

Fokusi këtu duhet të jetë në përforcimin e fjalorit të ri, rimarrjen e fjalorit të njohur në situata të reja dhe ekspozimin ndaj fjalorit shtesë.

# MËSIMI 6

## *Njerëz të shquar të vendit tim* *Profesionet*

### **Qëllimet mësimore:**

- a) Njerëz të shquar të vendit tim
- b) Profesionet
- c) Gramatikë: disa përemra pronorë, disa mbiemra, ndajfolje pyetëse *ku*, përemri pyetës *çfarë*, disa folje të lidhura me profesionet, folja *jam* në kohën e pakryer.
- d) Punë e diferencuar: “Gjergj Kastriot Skënderbeu”, “Kthimi i Skënderbeut në Krujë”

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Kultura dhe shoqëria, Puna*

Shqiptarët në ditët e sotme      Profesionet

Objektivi mësimor: Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDJOJMË: Mësimi 6 na ndihmon të flasim rreth profesioneve të ndryshme dhe të njohim personalitete shqiptare që kanë bërë emër në fusha të ndryshme të shkencës, teknologjisë dhe artit.
- SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI: Njëpërmjet anagrameve dhe fjalëkryqeve, nxënësit përsërisin dhe rimarrin fjalorin e mësuar në këtë mësim.
- GRAMATIKË: Përemrat pronorë im, ime, e mi, e mia; foljet luaj, ndërtoj, gatuaj, shuaj në kohën e tashme; folja jam në të pakryerën.
- NJOHIM TRASHËGIMINË TONË: “Kthimi i Skënderbeut në Krujë”.
- FJALORI: mësuese, këngëtar, mjek/ doktor, zjarrfikës, kuzhinier, fotografe, infermiere, kopshtar, aktor, arkitekt, inxhinier, piktor, profesor, kamerier, shitës, kozmonaut, shkencëtar, gazetar, teatër, laborator, spital, restorant, dyqan, shëron, shuan, gatuan, punon, ndërton, luan.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Nëse ka një gjë që nxënësit e bëjnë me shumë dëshirë është që të luajnë në role, të vënë në skenë dialog apo një pjesë teatrale. Në fakt, Dr. Maria Montessori thekson se “nxënësit nuk janë në gjendje të mësojnë nëse nuk janë gjithashtu në gjendje të lëvizin”. Përveç kësaj, përfshirja e të gjithë trupit në mësimin e gjuhës është një metodë e dobishme mësimore. Sa më shumë që lëvizin nxënësit e gjuhës, aq më mirë dhe më shpejt do ta kuptojnë atë që ju po u mësoni dhe aq më lehtë ata mund ta regjistrojnë informacionin në kujtesën afatgjatë. Përdorimi i materialit praktik është gjithashtu një mënyrë e shkëlqyer për t’i bërë nxënësit tuaj të lëvizin, ndërsa mësojnë gjuhën shqipe. Në veprimtari të tilla didaktike ju mund të përdorni tema të thjeshta, si: stacione (“tek doktor”, “në bankë” “në dyqan” etj.), por gjithashtu edhe të jeni krijuar lidhur me to.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



*Mësuese Teuta:* Të dashur fëmijë, sot kemi një mësim shumë interesant. Flasin për profesionet. Le të shohim disa:



mësuese



këngëtar



mjek/doktor



zjarrfikës



kuzhinier



fotografe



infermiere



kopshtar



aktor



arkitekt



inxhiniere



piktor



profesor




kamerier




shitës



kozmonaut



shkencëtar



gazetar


## Vende ku punojmë:



teatër



laborator



spital



restorant



dyqan

*Dardani:*

Vesa, ku punon një mjek?

*Vesa:*

Mjeku **punon** në spital, na **shëron**. Ku punon një mësuese?

*Dardani:*

Mësuesja punon në shkollë. Babi im është profesor dhe punon në universitet. Ku punon një shkencëtar?

*Vesa:*

Në laborator. Cili profesion të pëlqen, Dardan?

*Dardani:*

Vesa, mua më pëlqen zjarrfikësi, ai **shuan** zjarrin. Cila punë të pëlqen, Vesa?

*Vesa:*

Mua më pëlqen puna në laborator.

*Egini:*

Çfarë profesioni ka babi?

*Redona:*

Babi është kuzhinier. Ai **gatuan**. Punon në restorant. Po vëllai yt?

*Egini:*

Vëllai është piktor. Bën piktura të bukura. Çfarë bën motra jote?

*Redona:*

Motra ime është studente në universitet. Ajo do të bëhet gazetare.

## 1. Lidhni profesionin me figurën.



fotograf

kopshtar

kuzhinier

marinar

mjek

këngëtar

piktor

infirmier





## 2. Përgjigjuni pyetjeve.

Ku punon babi i Dardanit? \_\_\_\_\_

Çfarë është motra e Redonës? \_\_\_\_\_

Ku punon babi i Redonës? \_\_\_\_\_

Çfarë pune bën vëllai i Eginit? \_\_\_\_\_



*Mësuese Teuta: Mbani mend!*



Ç'punë bën? Ç'profesion ke?

Çfarë pune bën? Çfarë profesioni ke?



**Unë punoj në teatër.**

**Unë jam aktore.**



## 3. Tregoni profesionet në familjen tuaj.

Mami është \_\_\_\_\_.

Babi punon \_\_\_\_\_.

Vëllai \_\_\_\_\_.

Motra \_\_\_\_\_.

Gjyshja \_\_\_\_\_.

Tezja \_\_\_\_\_.

Daja \_\_\_\_\_.

Xhaxhai \_\_\_\_\_.

Halla \_\_\_\_\_.



#### 4. Zgjidhni përgjigjen e saktë.

- *Ku punon mjeku?*
  - Në spital.
  - Në shkollë.
  - Në universitet.
- *Ku punon profesori?*
  - Në universitet.
  - Në shkollë.
  - Në spital.
- *Ku punon kamerieri?*
  - Në teatër.
  - Në restorant.
  - Në dyqan.
- *Ku punon aktori?*
  - Në teatër.
  - Në restorant.
  - Në dyqan.

**Rekomandim didaktik 1:** Për të siguruar një pjesëmarrje aktive të nxënësve në veprimtaritë didaktike të mësipërme, mësuesi mund të përgatisë skeda me “detyrat” e secilit nxënës në lidhje me ushtrimet e mësipërme (disa skeda do të kenë pyetjet dhe disa përgjigjet e dialogut). Mësuesi i vendos skedat përmbys dhe secili nxënës zgjedh skedën e tij. Nxënësit ndahen në dy grupe (grupi i “pyetësve” dhe ai i “përgjigjësve”), vendosen në dy rreshta dhe komunikimi fillon: një pyetje, një përgjigje. Mësuesi mund të ndërhyjë për të ndihmuar nxënësit që japin përgjigje të gabuar. E njëjta veprimtari mund të ndryshohet: nxënësit lëvizin nëpër klasë për të gjetur përgjigjen për pyetjen në skedën e tyre ose anasjellas (pyetjen për përgjigjen). Kjo veprimtari jo vetëm shërben për të ndihmuar nxënësit që kanë stil të mësuarit kinestetik, por njëkohësisht edhe nxit bashkëbisedimin mes njëri-tjetrit: Mos e ke pyetjen/përgjigjen time? Çfarë pyetjeje/përgjigjeje ke ti? etj.



*Mësuese Teuta:* Ka shumë shqiptarë të njohur në botë. Le të njohim disa. Kush na tregon?

*Egini:* **Anjezë Gonxhe Bojaxhiu/ Shën Nënë Tereza** lindi në Shkup, në vitin 1910 dhe jetoi në Indi Nëna Tereza fitoi çmimin “Nobel” për Paqen.

*Redona:* **Karl Gega** lindi më 10 janar të vitit 1802. Shkoi në Universitet, në Padova, në Itali. Ai ishte inxhinier.

Karl Gega **ndërtoi** hekurudhën e parë malore në Austri.

*Vesa:* **Gjon Mili** lindi në vitin 1904, në Korçë. Ishte fotograf dhe për dori teknikë të re. Një fotografi e njohur në Francë është “Pikaso që vizaton me dritë”.


*Dardani:* **Ibrahim Kodra** lindi në vitin 1918, në Durrës. Piktori kishte miq Picasso-n, Eluard-in, Heminguej-in, Montale-n, Moravia-n etj. Flamurin shqiptar e mbajti me vete edhe në spital.

*Vesa:* **Aleksandër Moisiu** lindi në vitin 1879, në Trieste të Italisë. Ishte aktor i njohur austriak me origjinë shqiptare. **Luajti** rolin e Hamletit, të Edipit, të Jedermanit etj.



*Redona:* **Bekim Fehmiu** ishte një aktor shumë i njohur nga Kosova. Babai i tij, ishte mësues në Kosovë. Një rol i rëndësishëm ishte Uliksi në filmin “Odisea”.

*Vesa:* **Hasan Tahsini**, ishte nga fshati Ninat, në Çamëri dhe jetoi në Stamboll. Ai u bë rektori i parë i Universitetit të Stambollit.



**Rekomandim didaktik 2:** Për ushtrimet e mësipërme mësuesi mund të printojë fotot dhe jetëshkrimet e personaliteteve të dhëna dhe të kërkojë që nxënësit të kombinojnë foton me jetëshkrimin. Pasi njihen mirë me informacionin, nxënësit mund të ndahen në çifte dhe të flasin me njëri-tjetrin për personalitetet e përmendura. Mësuesi mund t’i ndihmojë duke u dhënë fillimet e fjalive që do të përdorin, p.sh.: jam krenar që...; është e çuditshme që...; nuk më besohet se...; sa bukur që... Në këtë mënyrë, nxënësit do ta përdorin informacionin e dhënë nga mësuesi për të ndërtuar aftësitë e tyre bashkëbiseduese për profesione të ndryshme.

## 5. Tregoni profesionin e Karl Gegës, Ibrahim Kodrës, Bekim Fehmiut dhe Gjon Milit.

_____	_____
_____	_____
_____	_____

## 6. Përgjigjuni pyetjeve.

Ku jetoi Karl Gega? \_\_\_\_\_

Ku jetoi Hasan Tahsini? \_\_\_\_\_

Ku jetoi Aleksandër Moisiu? \_\_\_\_\_

## 7. Zgjidhni personalitetin që ju pëlqeu më shumë dhe përshkruajeni me dy fjali.

---

---

## 8. Thoni profesionet që lidhen me këto vende.



universitet



teatër



laborator



spital



restorant



dyqan

**Rekomandim didaktik 3:** Këtu mësuesi mund të paraqesë nëpërmjet PowerPoint-it fotografi të ndërtesave të ndryshme dhe të bëjë pyetjen: Kush punon këtu? Nxënësit do ta kenë të lehtë të përgjigjen, por duke parë imazhin dhe duke thënë profesionin e personit që punon atje, ata krijojnë dhe bashkërendojnë imazhin me kuptimin leksikor në të njëjtën kohë, gjë që ndihmon në dërgimin e fjalorit në kujtesën afatgjatë.

## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

### 9. Plotësoni fjalitë.

Aleksandër Moisiu lindi në vitin 1879 në \_\_\_\_\_.


Karl Gega ndërtoi hekurudhën e parë \_\_\_\_\_ në Austri.

Nënë Tereza mori çmimin “Nobel” për \_\_\_\_\_.

Ibrahim Kodra kishte miq \_\_\_\_\_.

Bekim Fehmiu ishte \_\_\_\_\_ nga Kosova.

## 10. Plotësoni fjalëkryqin.



**Rekomandim didaktik 4:** Pasi ka prezantuar dhe rimarrë fjalorin e ri e disa forma, nxënësi është i gatshëm të përdorë mendimin e tij të pavarur për të dhënë përgjigjet për ushtrimet e mësipërme. Kjo veprimtari jo vetëm përmirëson shprehitë e bashkëbisedimit, por edhe forcon besimin e nxënësit tek aftësitë e tij. Kjo ndihmon në dëshirën për të vazhduar punën për mësimin e gjuhës shqipe dhe mban të ndezur interesin e nxënësit për mësim.



## 11. Gjeni emrat e personaliteteve dhe shkruani profesionin.

K R L A \_\_\_\_\_

H S N A A \_\_\_\_\_

I R B H A I M \_\_\_\_\_

GJ N O \_\_\_\_\_

**Rekomandim didaktik 5:** Nxënësit tashmë janë mësuar me të tilla ushtrime dhe e kanë të lehtë të zgjidhin si fjalëkryqin, ashtu edhe anagramin e mësipërm. Këto veprimtari didaktike ngjallin kureshtjen e nxënësit për të provuar veten dhe aftësinë për të përdorur fjalorin e mësuar.



## GRAMATIKË

### ➤ Disa përemra pronorë

	Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
	numri njëjës	numri shumës	numri njëjës	numri shumës
Veta I	vëllai <b>im</b>	vëllezërit <b>e mi</b>	motra <b>ime</b>	motrat <b>e mia</b>
Veta II	vëllai <b>yt</b>	vëllezërit <b>e tu</b>	motra <b>jote</b>	motrat <b>e tua</b>

### 12. Vendosini përemrat pronorë *im, ime, e mi, e mia* si në shembullin e mëposhtëm.

Vëllai im është inxhinier.

Motrat \_\_\_\_\_ shkojnë në spital.

Prindërit \_\_\_\_\_ punojnë në laborator.

Babi \_\_\_\_\_ është infermier.

Tezja ime \_\_\_\_\_ punon në restorant.

Xhaxhai \_\_\_\_\_ është arkitekt.

Daja \_\_\_\_\_ është inxhinier.

Xhaxhallarët \_\_\_\_\_ janë në universitet.

Kushërinjtë \_\_\_\_\_ shkojnë në kopsht.

Gjyshja \_\_\_\_\_ është pensioniste.

➤ **Disa mbiemra**

<b>numri njëjës/gjinia mashkullore</b>	<b>numri njëjës/gjinia femërore</b>
(qytet) malor	(hekurudhë) malore
(profesion) interesant	(pikturë) interesante
(vëllai) i madh	(motra) e madhe
(djalë) i njohur	(vajzë) e njohur

**13. Shkruani katër fjali me mbiemrat e mësipërm.**

---



---



---



---

➤ **Disa folje në kohën e tashme**

unë	luaj	ndërtoj	gatuaj	shuaj
ti	luan	ndërton	gatuan	shuan
ai, ajo	luan	ndërton	gatuan	shuan
ne	luajmë	ndërtojmë	gatuajmë	shuajmë
ju	luani	ndërtoni	gatuan	shuani
ata, ato	luajnë	ndërtojnë	gatuajnë	shuajnë

➤ **Folja *jam* në të pakryerën**

unë	isha
ti	ishe
ai, ajo	ishte
ne	ishim
ju	ishit
ata, ato	ishin

**14. Lidhni format e foljes që i përkasin së njëjtës vetë.**

ishim  
ishte  
ishin  
isha  
ishit  
ishe

jam  
jeni  
je  
jemi  
është  
janë



15. Plotësoni pyetjet me fjalën që mungon: *kur, ku, sa, çfarë* dhe shkruani përgjigjet e tyre.

- \_\_\_\_\_ është ai? \_\_\_\_\_.
- \_\_\_\_\_ është sot? \_\_\_\_\_.
- \_\_\_\_\_ është doktori? \_\_\_\_\_.
- \_\_\_\_\_ është ora? \_\_\_\_\_.
- \_\_\_\_\_ fillon vera? \_\_\_\_\_.
- \_\_\_\_\_ janë shoqet e klasës? \_\_\_\_\_.

**Rekomandim didaktik 6:** Mësuesi është i ndërgjegjshëm për rëndësinë e mësimit saktë të gjuhës dhe domosdoshmërinë e gramatikës, por njëkohësisht është i ndërgjegjshëm se shpjegimi teorik i rregullave gramatikore nuk është i përshtatshëm për këtë nivel të nxënësve. Këto veprimtari mund të kthehen në lojëra vërtet interesante ku një nxënës luan rolin e mësuesit dhe tjetri të nxënësit që gjen përgjigjet.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *A e dini se...*

*Gjergj Kastrioti Skënderbeu lindi në Dibrë, më 6 maj të vitit 1405. Ai ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit, princi i Shqipërisë së Veriut. Gjergj Kastrioti bashkoi shqiptarët dhe mbrojti gjithë Europën për 25 vjet. Skënderbeu zhvilloi 30 beteja dhe humbi vetëm një. Përkrenarja e tij me kokën e dhisë është një simbol, që sipas legjendave përdorej edhe nga Pirroja i Epirit, edhe nga Aleksandri i Madh.*

## Lexoni së bashku poezinë

### Kthimi i Skënderbeut në Krujë

Krujë, o qytet i bekuar,  
prite, prite Skënderbenë!  
Po vjen si pëllumb i shkruar  
të shpëtojë mëmëdhenë.  
Shqiptarët t' i shpëtojë  
nga zgjedh' e keqe e Turqisë  
edhe ty të të nderojë,  
që je kreu i Shqipërisë.  
Ka pas trima shqipëtarë,  
që s' u trembej syri kurrë,  
në zemër të tij ka zjarrë,  
është i urtë e trim, e burrë.  
Mirë se erdhe, o verë  
që na prure mirësinë,  
dhe për shumë vjet të tjerë  
e zbukurofsh Shqipërinë!...  
O moj vash' e Shqipërisë,  
që më rri duke mejtuar,  
pa i zhvish rrobat e zisë,  
arriti dit' e uruar.  
Zbardhi fusha, ndriti mali,  
nga armët e trimërisë,  
hingëllin e s' mbahej kali,  
që sill mbretinë e Shqipërisë.

*Naim Frashëri*

#### FJALË TË URTA

*Që në gusht e nga një grusht.*

**Rekomandim didaktik 7:** Këtu një veprimtari interesante do të ishte Konkursi i Fjalës Artistike.



**PROJEKT:** Kërkoni informacione të thjeshta dhe imazhe për Skënderbeun dhe diskutojini në klasë.







## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
aktor	baba	amerikan
arkitekt	çfarë	austriak
doktor	dajë	çmim
dyqan	flamur	greke
fotografe	fshat	kozmos
gatuaj	hallë	mik
gazetar	e hënë	originë
infermiere	të gjithë	paqe
inxhiniere	janar	i parë
kamerier	kur	i pestë
këngëtar	motër	rektor
kopshtar	pensioniste	rol
kozmonaut	pranverë	teknikë
kuzhinier	qytet	
laborator	teze	
mësuese	tregoj	
mjek	vëlla	
ndërtoj	vend	
piktor	xhaxha	
profesor		
restorant		
spital		
shitës		
shkencëtar		
shuaj		
zjarrfikës		

**Rekomandim didaktik 8:** Mësuesi mund të përdorë *website* të ndryshme për të punuar me fjalorin. Një veprimtari interesante është përdorimi i shembullit nga loja “Jeopardy”. Një model i saj:



 <b>fias</b> speak	 <b>loj</b> wash
 <b>nxënësit</b> students	 <b>ndihmoj</b> help

<b>DOKTOR B. ËSHTË _____ IME.</b>	
MRS. BEJKO IS MY _____.	
 <b>mësuesja</b> teacher	 <b>gëzuar</b> happy
 <b>mirë</b> good	 <b>embel</b> sweet

# MËSIMI 7

## *Shqiptarë të shquar të kohës sonë* *Shoqja ime/shoku im*

### **Qëllimet mësimore:**

- a) Njerëz të shquar të vendit tim.
- b) Shoqja ime e ngushtë ose shoku im i ngushtë
- c) Gramatikë: disa forma me kohën e tashme të mënyrës lidhore; emra mashkullorë dhe femërorë shoqëruar nga mbiemra.
- d) Punë e diferencuar: “Ku jetojnë shqiptarët sot?”, “Shoku im”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Kultura dhe shoqëria*

Shqiptarët në ditët e sotme      Unë dhe bashkësia e ngushtë

Objektivi mësimor: Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË: Mësimi 7 do t'i ndihmojë nxënësit të njihen me personalitete të njohura bashkëkohëse, të cilat nderojnë kombin kudo në botë. Gjithashtu, nxënësit do të mësojnë si të përshkruajnë dhe të flasin për shokun apo shoqen e tyre.
- SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI: Nëpërmjet lojërave gjuhësore, mësuesi do të sjellë ndjenjën e lojës dhe të konkursit në veprimtari të ndryshme didaktike.
- GRAMATIKË: Mësimi 7 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. Foljet shkoj, punoj, këndoj, flas, ha në kohën e tashme të mënyrës lidhore
  - ii. Emra mashkullorë dhe femërorë shoqëruar nga mbiemra: aktor i njohur, djalë i shkathët, mjek i suksesshëm, sy bojë qielli, aktore e dashur, vajzë e turpshme, mjeke e talentuar.
- NJOHIM TRASHËGIMINË TONË: Nxënësit do të mësojnë vjershën "Shoku im" të Adelina Mamaqit.
- FJALORI: i gjatë, i shkurtër, i dobët, i shëndoshë, i vogël, e re, i rritur, i moshuar, flokë kaçurrela/ të drejtë/ të gjatë/ të shkurtër/ të verdhë/ gështenjë/ të zinj, sy të kaltër, jeshil, të zinj.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Mësuesi përdor një strategji të quajtur PSMNV për të mbajtur gjallë diskutimet në klasë. PSMNV-ja nënkupton:

Pyetja – Mësuesi shtron një pyetje, pastaj i jep kohë të mjaftueshme nxënësit për të menduar përgjigjen.

Sinjali – Një lëvizje e caktuar, si ngritja e gishtit, diçka me të cilën nxënësi tregon se është gati të përgjigjet.

Modelimi – Mësuesi modelon një fjalë për përgjigje, për shembull, për: "Cili është vendi juaj i preferuar për të lexuar një libër?" Modeli mund të jetë: "Vendi im i preferuar për të lexuar një libër është kopshti".

Ndarja – Nxënësit fillojnë të japin përgjigjet e tyre për pyetjet e bëra.

Vlerësimi – Të gjithë së bashku analizojnë gabimet e mundshme dhe japin mendime si të përmirësohen fjalitë.




## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOKJMË



*Mësuese Teuta:* Si jeni, të dashur fëmijë? Sa të bukur jeni sot! Tani do të mësojmë të përshkruajmë shoqen, shokun, njëri-tjetrin.




i gjatë i shkurtër



e dobët e shëndoshë




e vogël e re e rritur e moshuar



të drejtë/kaçurrela



flokë të verdhë bojëkafe të kuq të zinj



sy të kaltër

sy jeshil



sy të zinj

bojëkafe

*Egini:* Mësuese, unë **dua të përshkruaj** Dardanin. Ai është i gjatë, me flokë të zinj, kaçurrela dhe sy bojëkafe. Dardani është gjithmonë i qeshur, i shkathët, i talentuar, por ndonjëherë pak përtac.

*Vesa:* Unë dua të flas për Redonën. Ajo është e pak e gjatë, me flokë bojëkafe, të drejtë, sy jeshil. Redona është e dashur, e qetë, e sjellshme, por i **pëlqen të flasë** shumë.





**1. Bëni dialogë me shokun e ngushtë dhe shihni sa e njihni njëri-tjetrin. Përdorni pyetjet mëposhtme.**

- Kur është ditëlindja ime?
- Cila kafshë më pëlqen më shumë?
- Cili është sporti që luaj unë?
- Çfarë dhurate më pëlqen?
- Cili është talenti im?
- Sa vëllezër apo motra kam? Si i kanë emrat?
- Cilat janë dy tipare pozitive që kam?
- Çfarë nuk bëj mirë?

**Rekomandim didaktik 1:** Për pyetjet e mësipërme, mësuesja ose zgjedh t'i drejtojë vetë, ose cakton një nxënës të thotë pyetjet për shokët. Pavarësisht se kush e bën pyetjen, mësuesi duhet të sigurojë kohën e mjaftueshme që nxënësi të përgjigjet. Përpara se të kërkojë përgjigjet e nxënësit, mësuesi e modelon vetë përgjigjen dhe pastaj nxënësit thonë përgjigjet e tyre. Në fund, bëhet një diskutim për gabimet e mundshme dhe se si mund të përmirësohen fjalitë, të gjitha këto sipas strategjisë PSMNV.



## 2. Gjeni 10 mbiemra për tiparet fizike dhe të karakterit.



---

---

---

---

---

---

---

---



### 3. Kush është?

I qeshur, i shkathët, i talentuar, por edhe pak përtac. \_\_\_\_\_

E sjellshme, e zgjuar, e qetë. \_\_\_\_\_

Pak e gjatë, me flokë bojëkafe, të drejtë, sy jeshil. \_\_\_\_\_



### 4. Gjeni shokun.

Njëri prej fëmijëve të mendojë njërin nga shokët dhe të tjerët ta gjejnë duke bërë pyetje për të, si: *A ka flokë të drejtë? A ka sy të kaltër?*

**Rekomandim didaktik 2:** Në këtë veprimtari didaktike mësuesi mund të përdorë artin e vizatimit. Veprimtaria mund të ndahet në dy etapa:

- 1) Mësuesi rifreskon fjalorin e mësuar dhe mënyrën se si mund të përshkruhet vetja, duke përshkruar tiparet e tij fizike dhe të karakterit. Duke folur, mësuesi vizaton dhe shkruan tiparet e tij me shigjeta rreth autoportretit. Pas kësaj, mësuesi u kërkon nxënësve të bëjnë portretin e tyre dhe të shkruajnë karakteristikat e tyre. Në cep të faqes nxënësi shkruan emrin e tij dhe e fsheh duke e palosur fletën. Autoportretet hidhen në një kuti dhe secili nxënës merr një autoportret për të “zbuluar” autorin.
- 2) Pasi nxënësit kanë marrë autoportretin, e studiojnë dhe përpiqen të identifikojnë autorin e tij (mësuesi u jep kohën e nevojshme për t’u përgatitur). Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe bëjnë pyetje të tipit: A ka flokë të drejtë...? A ka sy të kaltër...? Në fund, i gjithë grupi mblidhet dhe secili nxënës jep mendimin e tij për autoportretin sekret. Pas kësaj, mësuesi lejon që të hapet palosja e fletës dhe të verifikohet autori i autoportretit. Përfitimet e një veprimtarie të tillë janë në shumë plane gjuhësore.



*Mësuese Teuta:* Tani do të flasim për disa shqiptarë të njohur sot në botë. A njihni ju?

*Redona:* Mësuese, mund të flas unë? Këngëtarja ime më e dashur është **Rita Ora**. Rita Orakalindurnë Kosovë. Ajo ka **shitur** shumë **disqe**. Rita Ora është aktore dhe **stiliste**. Ritës i pëlqejnë ushqimet pikante.

*Dardani:* Ai është një djalë i fortë. **Luan Krasniqi** e ka origjinën nga Kosova. Ai është **boksier i suksesshëm** dhe jeton në Gjermani.

*Vesa:* **Eliza Patricia Dushku** lindi më 30 dhjetor 1980 në Boston, *Masaçutes*. Ajo është një aktore amerikane me origjinë nga Shqipëria. Eliza ka tre vëllezër. U bë e njohur me rolet në filmat “Buffy” dhe “Angel”.

*Egini:* **Ferid Murad**, është një mjek biolog amerikan me origjinë shqiptare. Në vitin 1998, ai fitoi çmimin “Nobel”. Ai është edhe profesor në disa universitete.

*Vesa:* Egin, unë njoh edhe **James Bellusci-n**. E njeh ti?

*Egini:* Jo, nuk e njoh. Çfarë bën ai? Ku jeton?

*Vesa:* Ai është aktor amerikan me origjinë shqiptare.

*Egini:* Në cilët filma ka luajtur?

*Vesa:* “Blues Brothers”, “Redhead”.

*Egini:* Po **Dua Lipan** e njeh ti?

*Vesa:* Po. Mua më pëlqejnë këngët e saj.

*Egini:* E di që ajo luan basketboll? Cila këngë të pëlqen?

*Vesa:* Më pëlqen “Pretty Please”.





**5. Tregoni profesionin duke formuar një fjali, p.sh.: Anna Oxa është këngëtare me origjinë shqiptare në Itali.**

James Bellushi \_\_\_\_\_

Dua Lipa \_\_\_\_\_

Ferid Murat \_\_\_\_\_

Rita Ora \_\_\_\_\_

Eliza Dushku \_\_\_\_\_

### **6. Gjeni kush është dhe vizatojeni.**


Ka flokë të verdhë dhe kaçurrela.

Është e qeshur.

Jeton në Angli.

Ka origjinë nga Kosova.

Është këngëtare, por edhe aktore e stiliste.



### **7. Zgjidhni përgjigjen e saktë.**

- *Rita Ora ka shitur shumë:*
  - a. filma;
  - b. libra;
  - c. disqe.
  
- *Çmimin “Nobel” e ka fituar:*
  - a. Rita Ora;
  - b. Ferid Murad;
  - c. Luan Krasniqi.

- *Eliza Dushku ka:*
  - a. një motër;
  - b. dy vëllezër dhe një motër;
  - c. tre vëllezër.
  
- *Luan Krasniqi është:*
  - a. mjek i suksesshëm;
  - b. boksier i suksesshëm;
  - c. aktor i suksesshëm.

**Rekomandim didaktik 3:** Ushtrimet e mësipërme i japin mësuesit një mundësi shumë të mirë për të parë nivelin e të lexuarit dhe të të kuptuarit të dialogëve dhe të informacionit për këto personalitete nga ana e nxënësve. Kjo mund të bëhet në mënyrë shumë interesante, duke përdorur shabllonin e lojës “Jeopardy”, sipas modelit të mëposhtëm.



### 8. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

- Si i ke flokët? \_\_\_\_\_
- Je i/e gjatë? \_\_\_\_\_
- Si i ke sytë? \_\_\_\_\_
- Je i/e qeshur apo serioz/e? \_\_\_\_\_
- Je i/e shkathët? \_\_\_\_\_
- Je gjumash/e? \_\_\_\_\_



### SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

### 9. Shkruani tiparet fizike të shoqes apo të shokut tuaj.

---




---



---

**10. Bashkoni pikat. Vizatoni dhe ngjyrosni dhe shkruani pesë mbiemra për djalin dhe pesë për vajzën.**



_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

**Rekomandim didaktik 4:** Këtu mësuesi mund t'i vendosë nxënësit në çifte që të punojnë së bashku për të plotësuar dhe ngjyrosur figurën. Ky është një rast shumë i mirë ku nxënësit mund të rifreskojnë ato që kanë mësuar për numrat: njëri thotë numrin dhe tjetri e bashkon atë me laps për të formuar figurën. Pas kësaj partnerët fillojnë përshkrimin dhe përdorin mbiemrat e mësuar në Mësimin 7. Pasi u jep një kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur, mësuesi kërkon që nxënësit të ndajnë informacionin me grupin e shokëve, të cilët do të dëgjojnë dhe do të bëjnë sugjerimet e rastit për të përmirësuar fjalitë që mund të kenë gabime, sipas strategjisë PSMNV.



➤ **Disa folje në mënyrën lidhore**

Unë dua të shkoj/ të punoj/ të këndoj/ të flas/ të ha.

Ti do të shkosh/ të punosh/ të këndosh/ të flasësh/ të hash.

Ai, ajo do të shkojë/ të punojë/ të këndojë/ të flasë/ të hajë.

Ne duam të shkojmë/ të punojmë/ të këndojmë/ të flasim/ të hamë.

Ju doni të shkoni/ të punoni/ të këndoni/ të flisni/ të hani.

Ata, ato duan të shkojnë/ të punojnë/ të këndojnë/ të flasin/ të hanë.

Unë mund të shkoj/ të punoj/ të këndoj/ të flas/ të ha.

Ti mund të shkosh/ të punosh/ të këndosh/ të flasësh/ të hash.

Ai, ajo mund të shkojë/ të punojë/ të këndojë/ të flasë/ të hajë.

Ne mund të shkojmë/ të punojmë/ të këndojmë/ të flasim/ të hamë.

Ju mund të shkoni/ të punoni/ të këndoni/ të flisni/ të hani.

Ata, ato mund të shkojnë/ të punojnë/ të këndojnë/ të flasin/ të hanë.

**11. Plotësoni fjalitë me foljet shkoj, këndoj, flas, ha, punoj, ka në mënyrën lidhore.**

Ata mund \_\_\_\_\_ në teatër në orën 9 e gjysmë.

Ne duam \_\_\_\_\_ një këngë.

Ku mund \_\_\_\_\_ pica ne?

Ajo do \_\_\_\_\_ shqip.

Ata duan \_\_\_\_\_ pak.

Ju mund \_\_\_\_\_ në shkollë në orën 8.

Unë mund \_\_\_\_\_ në festë.

Pse di \_\_\_\_\_ shqip ti?

## 12. Lidhni përemrat me foljen në formën e duhur.

unë		të flasësh
ti		të flasin
ai, ajo		të flisni
	mund	
ne		të flas
ju		të flasë
ata, ato		të flasim

### ➤ Disa emra dhe mbiemra

një aktor i njohur	aktori i njohur	një aktore e dashur	aktorja e dashur
një djalë i shkathët	djali i shkathët	një vajzë e turpshme	vajza e turpshme
një mjek i suksesshëm	mjeku i suksesshëm	një mjeke e talentuar	mjekja e talentuar
një sy i kaltër	syri i kaltër	një fytyrë e qeshur	fytyra e qeshur

## 13. Qarkoni fjalët sipas llojit përkatës dhe formoni fjali me fjalët e dhëna.

<b>Emër</b>
serioz, (djale), flas, të kaltër, malor
<b>Mbiemër</b>
vrapoj, i qeshur, mësoj, vajzë, sy
<b>Folje</b>
flokë, të verdhë, është, mjek, jeshile

**Rekomandim didaktik 5:** Nëpërmjet ushtrimeve të mësipërme mësuesi ndihmon nxënësit të mësojnë përdorimin e saktë të foljeve në mënyrën lidhore. Me gjithë rëndësinë e njohurive gramatikore për ta folur gjuhën shqipe në mënyrë korrekte, në këtë fazë, çdo gjë mbetet në aspektin praktik dhe mësuesi frenohet nga çdo shpjegim teorik të gramatikës. Qëllimi i vetëm në këtë fazë është rritja e fjalorit praktik dhe e shprehjeve të sakta të të folurit shqip.



## 14. Lidhni emrat me mbiemrat.

djalë  
aktore  
kozmonaut  
gazetar  
sy  
flokë  
vajzë

të shkurtër  
të kaltër  
serioz  
e njohur  
i shëndoshë  
e dobët  
i suksesshëm

## 15. Shtoni një mbiemër dhe plotësoni fjalinë.

Ajo ka flokë \_\_\_\_\_.

Ai ka trup \_\_\_\_\_.

Unë njoh një aktor \_\_\_\_\_.

Motra ime është gazetare \_\_\_\_\_.


Mamaja ime është gjithmonë \_\_\_\_\_.

Sytë e mi janë \_\_\_\_\_.

Ai nuk punon shumë dhe është \_\_\_\_\_.

## 15. Plotësoni tabelën.

Përshkruaj shokët (Shih shokët në klasë dhe plotëso tabelën.)				
Emri	Trupi	Flokët (gjatësia)	Flokët (forma)	Sytë (ngjyra)



**Rekomandim didaktik 6:** Me anën e ushtrimeve të mësipërme mësuesi synon të përdorë fjalorin e prezantuar në këtë mësim në situatë të reja dhe të panjohura. Kjo do ta ndihmojë nxënësin që ta kalojë fjalorin e ri në kujtesën afatgjatë, pasi fjalori po përdoret (jo mësohet përmendësh) në situata të reja për nxënësin. Kështu, në trurin e nxënësit ndërtohen lidhje të reja logjike (dendrite) ndërmjet njohurive të “vjetra” dhe të qëndrueshme dhe njohurive të sapomësuara në Mësimin 7.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *A e dini se...*

*Shqiptarët jetojnë në shumë shtete të botës: Australi, Austri, Belgjikë, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Gjermani, Estoni, Irlandë, Islandë, Greqi, Spanjë, Francë, Kanada, Kroaci, Indi, Itali, Qipro, Letoni, Lituani, Lihtenshtein, Luksemburg, Hungari, Maltë, Mbretëri e Bashkuar, Norvegji, Holandë, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Suedi, Sh.B.A, Zvicër etj.*

## *Lexoni së bashku poezinë*

### SHOKU IM

Kam një shok, të dy tok,  
shkojmë orë pa mërzi,  
me tregon me mëson,  
shumë gjëra që s'i di,

Pa përtim me durim,  
shoku im me ndihmon,  
dhe ky është, kush e di?  
Libri im që me mëson!

### FJALË TË URTA

*Miku i mirë në ditë të vështira.*

(Adelina Mamaqi)



**PROJEKT:** Mblidhni fotografi dhe kujtoni ngjarjet më të bukura që keni kaluar me shokun ose shoqen e ngushtë.

Bëni një album elektronik me to.

**Rekomandim didaktik 7:** Mësuesi mund ta shfrytëzojë këtë projekt për të organizuar një konkurs të fjalës artistike të shoqëruar me një ekspozitë virtuale të momenteve më të bukura të nxënësve me shokët dhe shoqet e tyre.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
bojëkafe	aktor	amerikan
boksier	fotografe	biolog
i dashur	gazetar	fizike
e dobët	jeton	fitoj
të drejtë	këngëtar	karakter
i gjatë	kopshtar	përshkruaj
gjumash	kozmonaut	pikant
jeshil	ku	i qetë
kaçurrela	lind	i sjellshëm
i kaltër	interesant	i suksesshëm
i kuq	mjek	shes
e moshuar	i njohur	origjinë
përtac	pak	ushqim
punëtor	profesor	tipare
i qeshur	restorant	
e rritur	spital	
serioz	stilist	
i sjellshëm	universitet	
stiliste	teatër	
e shëndoshë	vëlla	
i shkathët		
i shkurtër		
i talentuar		
i turpshëm		
i verdhë		
e vogël		
i zgjuar		
i zi		

**Rekomandim didaktik 8:** Si në çdo mësim, mësuesi mund të përdorë forma të ndryshme (*quizlet.com* apo *Kahoot*) për t'u siguruar se njohuritë e marra në këtë mësim janë përvetësuar nga nxënësit.

# MËSIMI 8

## *Simbole kombëtare Në pëlqen të udhëtoj*

### **Qëllimet mësimore:**

- a) Simbole kombëtare
- b) Më pëlqen të udhëtoj (mjetet e udhëtimit, vende, popuj, gjuhë)
- c) Gramatikë: ngjyrat; përemrat vetorë *ti, ju*.
- d) Punë e diferencuar: “Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare”, “Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Një botë për të gjithë*  
Integrimi dhe globalizimi      Të ndryshëm dhe të njëjtë

Objektivi mësimor: Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË: Mësimi 8 ndihmon nxënësit të identifikojnë dhe të flasin për simbolet kombëtare dhe të njohin mjetet e transportit, vendet dhe popujt e ndryshëm me simbolet e tyre,
- SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI
- GRAMATIKË: Mësimi 1 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. Përemrat vetorë ti, ju.
  - ii. Foljet fluturon, ecën, lundron.
- NJOHIM TRASHËGIMINË TONË: Nxënësit do të mësojnë historinë dhe simbolizmin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, si dhe faktin se kur është shkruar fjalia e parë në gjuhën shqipe.
- FJALORI: flamuri shqiptar, stema e RSH-së, flamuri i Kosovës, stema e RK-së, Gjergj Kastrioti, Nënë Tereza, lahuta, xhubleta, aeroplani, treni, anija, makina, motori, biçikleta, autobusi, fluturon, ecën, lundron.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Interpretimi ose vënia në skenë e dialogut është një metodë e parapëlqyer dhe e suksesshme në Nivelin A1. Një lojë me role është shumë e ngjashme me një skicë, ku nxënësit e vendosin veten në një situatë imagjinare. Kjo strategji i ndihmon nxënësit në aftësitë e të folurit në gjuhën që po mësohet, të ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe të zhvillojnë një komunikim “real”. Për shembull, në mësimin e luajtur me role me temën “në restorant” nxënësit bëhen si kamerierë apo si konsumatorë. Ata mësojnë si të komunikojnë për t’u shërbyer të tjerëve dhe të shërbehen. Kjo strategji ka disa avantazhe të dukshme:

- a) është një aktivitet tërheqës për nxënësin;
- b) i lejon të gjithë nxënësit të kenë një rol dhe të shprehen pa frikë;
- c) siguron situata aktive, gjë që i lejon studentët të shohin rëndësinë e të mësuarit të aftësive dhe të një fjalori të caktuar;
- d) është një strategji argëtuese.

Për ta bërë edhe me argëtuese, provoni të shtoni rekuizita (veshje) sipas rolet të tregimit që do të vini në skenë. Kjo strategji preferohet si nga nxënësit, ashtu edhe nga mësuesit, pasi është një mënyrë ndërvepruese interesante për të zhvilluar komunikimin pa u ndrojtur se bën gabim, duke qenë se teksti është i hartuar paraprakisht nga folësit e gjuhës që po mësohet.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



*Mësuese Teuta:* Të dashur fëmijë, sot do të flasim për një temë shumë të dashur për ne: simbolet kombëtare. Çdo **popull** ka simbolet e tij. Kur ne i shohim, e kuptojmë cilit vend i përkasin.



flamuri shqiptar



stema e RSH-së



flamuri i Kosovës



stema e RK-së



Gjergj Kastrioti



Nënë Tereza



lahuta



xhubleta



aeroplani  
fluturon



treni  
ecën



anija  
lundron



makina  
ecën



motori  
ecën



biçikleta  
ecën



autobusi  
ecën

Flamuri	Ngjyra	Shteti	Nënshtetësia	Gjuha
	e kuqe, e bardhë, blu	Shtete e Bashkuara të Amerikës	amerikan/ -e	anglisht
	e kuqe, blu	Angli	anglez/ -e	anglisht
	blu, e bardhë, e kuqe	Francë	francez/ -e	frëngjisht
	e zezë, e kuqe, e verdhë	Gjermani	gjerman/ -e	gjermanisht
	e bardhë, e kaltër	Greqi	grek/ -e	greqisht
	jeshile, e bardhë, e kuqe	Itali	italian/-e	italisht
	e kuqe, e bardhë	Kanada	kanadez/ -e	anglisht, frëngjisht
	e kuqe, e bardhë	Turqi	turk/ -e	turqisht
	e kuqe, e bardhë	Zvicër	zviceran/ -e	gjermanisht, frëngjisht, retromanisht, italisht

- Dardani:* Mësuese, në dhomën e miqve ne kemi flamurin shqiptar dhe bustin e Skënderbeut. Flamuri ynë është flamuri i Gjergj Kastriotit.
- Vesa:* Sa i bukur është flamuri shqiptar, kuq e zi! Ne kemi në shtëpi një fotografi të Nënë Terezës. Ajo është simboli i dashurisë për njerëzit.
- Redona:* Në shtëpinë tonë ne kemi ruajtur një xhubletë. Është shumë e bukur.
- Egini:* Gjyshi i babit tim ka kënduar me lahutë. Është si në përralla.
- Vesa:* Fan Noli ka shkruar për flamurin tonë:

*O Flamur gjak, o flamur shkabë,  
O vend e vatër, o nënë e babë,  
Lagur me lot, djegur me flakë,  
Flamur i kuq, flamur i zi.*

**Rekomandim didaktik 1:** Për të arritur përfshirjen e të gjithë nxënësve në veprimtarinë didaktike, mësuesi mund të përdorë mënyra të ndryshme të “vënies në skenë” të dialogut.

- a) Mësuesi mund të shkruajë në dërrasë emrat e personazheve që marrin pjesë në dialog dhe të inkurajojë nxënësit që të zgjedhin cilin rol dëshirojnë të marrin. Nxënësi shkruan emrin ngjitur me rolin e preferuar dhe përgatitet për të luajtur në skenë.
- b) Mësuesi mund të caktojë një “regjisor” (zakonisht nxënësin më të heshtur në grup), i cili do të zgjedhë partnerët dhe të drejtojë vënien në skenë të dialogut. Gjatë këtij organizimi mësuesi inkurajon nxënësit që të flasin shqip sa më shumë që të jetë e mundur, qoftë edhe me gabime.

## 1. Përgjigjuni pyetjeve.

- Cilat janë simbolet kombëtare shqiptare?
- Cilat janë simbolet kombëtare të vendit ku jetoni?
- Çfarë ngjyrash ka flamuri shqiptar?
- Çfarë na kujton Nënë Tereza?

2. Kërkoni informacion për flamurët që njihni dhe thoni emrin e vendit si quhen banorët e tij dhe gjuha e tyre.





### 3. Përgjigjuni pyetjeve.

Sa vende ke vizituar?

Me çfarë ke udhëtuar?

Të pëlqen bregdeti apo mali?

Me çfarë të pëlqen të udhëtosh?

**Rekomandim didaktik 2:** Mësuesi mund të jetë shumë krijues në organizimin e kësaj veprimtarie didaktike, Një mundësi është që të merret globi dhe nxënësit të gjejnë aty se ku janë trevat ku banojnë shqiptarë (Shqipëria - flamuri, Kosova - flamuri, Mali i Zi - flamuri, Maqedonia e Veriut - flamuri) dhe të përshkruajnë hartën, kryeqytetin, flamurin. Një tjetër metodë mund të jetë që mësuesi të tregojë flamujt e vendeve të ndryshme dhe nxënësit të përpiqen ta përshkruajnë secilin flamur, të gjejnë emrin e vendit dhe të kryeqytetit të tij. Një veprimtari e tillë jo vetëm do t'i inkurajojë nxënësit të përdorin fjalorin e mësuar në një situatë të re, por edhe do të ngjallë një interes të madh nëpërmjet ndjenjës së konkursit. Në një aspekt më të gjerë, nxënësit do të kuptojnë se si pjesë e një globi, ku pavarësisht se nga çfarë vendi vjen, secili komb dhe simbol ka nderin dhe vendin tij në bashkësinë e kombeve. Gjë kjo shumë e rëndësishme për edukimin qytetar të fëmijëve.



### Mësuese Teuta: Lexoni dialogët.

- Mirëdita! Si **quhesh**?
- Elira. Po ti, si e ke emrin?
- Paola.
- Si? Thuaje edhe një herë, të lutem.
- Quhem Paola.
- Gëzohem. Ti je spanjolle?
- Jo, unë jam nga Italia. Jam italiane. Ne flasim italisht.
- Po pse po shkon në Spanjë, për pushime?
- Jo, unë studioj në universitet.

#### 4. Renditini si duhet fjalitë në dialog si duhet dhe lexojini me zë të lartë.

- Ke ardhur në Shqipëri për turizëm?
- Po mirë, shihemi në universitet atëherë. Mirupafshim, Adora!
- Mirëdita, David! Si kalon?
- Unë jam amerikan, nga Hjustoni.
- Oh, më fal. Nga je ti, David?
- Mirëdita, Arbër!
- Përshëndetje!
- Mirë, faleminderit! Të prezantoj një shok nga Hjustoni.

- 
- Mirëdita! Për ku **jeni nisur**?
  - Për në Berlin.
  - Mund të ma **jepni pasaportën**, ju lutem?
  - Sigurisht. Urdhëroni!
  - A keni **bagazhe**?
  - Vetëm një **valixhe** të vogël.
  - Në rregull. Lëreni këtu.
  - Unë do të **ndaloj** tranzit në Romë. A duhet ta marr atje?
  - Jo, valixhja shkon direkt në Berlin. Rrugë të mbarë!
  - Faleminderit!

**Rekomandim didaktik 3:** Dialogët e mësipërm janë shumë interesante dhe japin mundësi konkrete për të organizuar veprimtari të bukura didaktike, pasi shumica e nxënësve i lidhin ato me përvoja personale nga udhëtimet që bëjnë për në atdhe. Mësuesi mund t’i shkruajë fjalët e personazheve në rripa të ndryshëm letre dhe nxënësit mund të lëvizin nëpër klasë duke pyetur dhe folur me njëri-tjetrin për të gjetur rendin e duhur të fjalëve në dialog. Pasi e kryejnë këtë, ato do të vënë dialogun në skenë dhe, së fundi, në varësi nga mosha, mund t’u kërkohet të shkruajnë në fletoret e tyre dialogun e plotësuar.

**5. Shikoni pamjet dhe përshkruajini. Tregoni se cili udhëtim ju pëlqen më shumë dhe pse.**



---

---

---

6. Për secilën fotografi thoni emrin e vendit, banorët dhe gjuhën e tij.



---

---

---



---

---

---



---

---

---



---

---

---

**Rekomandim didaktik 4:** Për këtë ushtrim, mësuesi mund të fillojë më një rifreskim të shpejtë të informacionit të marrë në këtë mësim, duke qenë se nxënësve do t'u duhet për të plotësuar informacionin që mungon në ushtrimet e mësipërme. Në vijim, mësuesi mund t'u japë nxënësve letër dhe shirit ngjitës dhe të kërkojë që secili të plotësojë ushtrimin për ta ngjitur pastaj në mur, duke krijuar kështu një "ekspozitë". Secili nxënës jo vetëm sheh punën e shokëve, por edhe mund të sugjerojë rregullime ose të bëjë pyetje për atë çka sheh.



## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

### 7. Renditni fjalët si duhet që të formojnë fjali.

angleze Lorela është nuk.  
nga më falni ju jeni?  
Shjao nga nga ju jeni Kina?  
autobus ajo me ka ardhur.  
aeroplani niset orar ç' në?  
ndalon ku tren ky?

### 8. Plotësoni dhe lexoni me zë dialogun.

*Stjuardesa:* Mirëdita! Mirë jeni? Ju jeni shqiptar?

*Arbri:* Shumë mirë, faleminderit! Po, jam \_\_\_\_\_

*Stjuardesa:* Po \_\_\_\_\_?

*Simona:* Jo, nuk jam shqiptare.

*Stjuardesa:* Nga \_\_\_\_\_?

*Simona:* Unë jam italiane.

*Stjuardesa:* Si quheni?

*Simona:* Simona Banfi.

*Stjuardesa:* Simona, më fal, por si e germëzon mbiemrin?

*Simona:* B.A.N.F.I

*Stjuardesa:* E qartë, faleminderit! Pse po vini në Shqipëri, për pushime?

*Simona:* Jo, për studime. Unë studioj gjuhë shqipe.

*Stjuardesa:* Gëzohem shumë. Qëndrim të këndshëm!

**Rekomandim didaktik 5:** Përsëri ushtrimet e mësipërme i krijojnë mundësi interesante mësuesit për “të vënë në skenë” situata të ndryshme që lidhen me bashkëbisedimin në udhëtim apo nxisin idenë e “zbulimit” të ndërtimit të fjalisë korrekte në gjuhën shqipe. Këto ushtrime ndihmojnë mësuesin për të krijuar veprimtari didaktike ndërvepruese, çka është e domosdoshme në këtë fazë fillestare të mësimit të gjuhës shqipe në Nivelin A1.

**9. Plotëso ditarin e Vesës me fjalët:** *pëlqejnë, malet, lundron, luajmë, biçikletat, udhëtim, sheh, aeroplan.*

I dashur ditar,

Tani jam në \_\_\_\_\_. Po udhëtoj për në Toronto, në Kanada. \_\_\_\_\_ është shumë i gjatë. Mua më \_\_\_\_\_ udhëtimet e gjata me tren. Më pëlqen të shoh \_\_\_\_\_, detin, qytetet, fshatrat. I bukur është edhe udhëtimi me anije. Anija \_\_\_\_\_ mbi det, dielli ndriçon dhe era fryn. Kur jam me shoqet, ne marrim \_\_\_\_\_ dhe shkojmë në park. Atje bisedojmë dhe \_\_\_\_\_ bashkë. Sa bukur është të udhëtosh!

**10. Plotëso fjalitë me foljet:** *quhem, studioj, udhëtoj.*

Unë \_\_\_\_\_ Arba. Po ti?  
Xhoni nuk \_\_\_\_\_ italian.  
Mua më pëlqen të \_\_\_\_\_ me tren.  
Ai \_\_\_\_\_ Kevin, ajo \_\_\_\_\_ Kaltra.  
Unë \_\_\_\_\_ anglisht, po ti \_\_\_\_\_ japonisht?  
Andrea \_\_\_\_\_ për në Spanjë për festa.

**11. Plotëso me mbiemrin dhe ndajfoljen e duhur.**

Aleksej është \_\_\_\_\_ dhe flet \_\_\_\_\_.  
Xian është \_\_\_\_\_ dhe flet \_\_\_\_\_.  
Xhoni është \_\_\_\_\_ dhe flet \_\_\_\_\_.  
Diego është \_\_\_\_\_ dhe flet \_\_\_\_\_.  
Dragana është \_\_\_\_\_ dhe flet \_\_\_\_\_.  
Kostas është \_\_\_\_\_ dhe flet \_\_\_\_\_.

**12. Plotësoni tabelën.**

Shteti	Kryeqyteti	Banorët	Gjuha	Simboli kombëtar

**Rekomandim didaktik 6:** Ndërtimi i njohurive për mënyrën se si ndërtohen disa ndajfolje në gjuhën shqipe në lidhje me kombësinë e individëve (Itali, italisht, italian; Suedi, suedez, suedisht etj.) është një veçanti e gjuhës shqipe, e cila në shumë raste nuk ndjek një rregull të përgjithshëm gjuhësor. Prandaj, në ushtrimet e mësipërme, mësuesi ka mundësinë e bukur të kërkojë që nxënësit të eksplorojnë për të gjetur mbiemrat dhe për t'i përdorur ata në formën e duhur. Edhe këtu mund të përdoret si dialogimi, ashtu edhe ndjenja e konkursit për ta bërë veprimtarinë edhe më interesante.

Shkruani emrat e mjeteve të udhëtimit dhe lidhni ato me foljet përkatëse.



fluturon

ecën

lundron




### 13. Plotësoni fjalëkryqin.

Horizontalisht

1. JETON NË ITALI
4. JETON NË SHQIPËRI
7. JETON NË KANADA
8. JETON NË FRANCË
9. JETON NË POLONI

Vertikalisht

2. JETON NË AMERIKË
3. JETON NË RUSI
5. JETON NË GREQI
6. JETON NË GJERMANI





➤ Ngjyrat në gjuhën shqipe

Shih: Ngjyrat për fëmijë shqip - YouTube

	e kuqe		e zezë
	e bardhë		e verdhë
	e kaltër		e gjelbër
	blu		portokalli
	lejla		bojëkafe
	gri		vjollcë
	jeshile		rozë


14. Plotësoni fjalitë me ngjyrën e duhur.

Unë shkoj në shkollë me autobusin e shkollës. Autobusi ka ngjyrë të \_\_\_\_\_. Kur koha është e mirë, qielli ka ngjyrë të \_\_\_\_\_, bari është i \_\_\_\_\_, rruga është \_\_\_\_\_.

Në dimër është ftohtë dhe dëborë \_\_\_\_\_ është kudo. Klasa jonë është e lyer me ngjyrë \_\_\_\_\_. Bankat janë \_\_\_\_\_ dhe dritaret janë të \_\_\_\_\_.



15. Shkruani ngjyrat  
në vendet bosh.



➤ Përemrat *ti, ju*.



- Si je ti, Alba? Ku po shkon?
- Mirë, faleminderit! Po shkoj në bibliotekë.



- Ju jeni, zoti Sokol?
- Po, unë jam.
- Është kënaqësi që po ju takoj.
- Edhe për mua, gjithashtu.

16. Shkruani dy dialogë të shkurtër: një bisedë me një shok dhe një me mësuesen.

---

---

---

---

---

**Rekomandim didaktik 7:** Ndërtimi i dialogut me përemrat vetorë “ti” dhe “ju” dhe, mundësisht, vënia e tij në skenë do të jetë me shumë vlerë, pasi në këtë mënyrë nxënësit, përveç fjalorit dhe gramatikës do të mësojnë edhe modalitetet e gjuhës shqipe dhe përdorimin e këtyre përemrave në regjistra të ndryshëm. Në aspektin gjuhësor kjo është shumë e rëndësishme, sepse ka mundësi që në gjuhën e vendeve ku jetojnë dhe mësojnë në shkollë (siç është rasti i gjuhës angleze), koncepti “ti” dhe “ju” nuk ekziston. Pra, mësuesi duhet të shpjegojë, përveç numrit njëjës të përemrit vetor “ti” dhe numrit shumës të përemrit “ju”, edhe faktin që në shenjë respekti për njerëz më të rritur apo në pozicione “autoritare duhet të përdoret “ju” në shenjë mirësjelljeje.




## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË

Që nga viti 1999 kur UNESCO-ja shpalli 21 shkurtin Ditë Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, çdo vit kudo nëpër botë organizohen manifestime kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim të ruajtjes dhe promovimit të gjuhëve amtare. Në vitin 2007, e njëjta ditë është pranuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara.



### *A e dini se...*

*Fjalta e parë e shkruar në gjuhën shqipe është e shkruar nga kryepeshkop Dmzot Pal Engjëlli, më 8 nëntor, të vitit 1462. Dmzot Pal Engjëlli ishte këshilltar dhe bashkëpunëtor i Gjergj Kastriotit.*



## *Fqjidhni disa nga vargjet e poezisë dhe recitohjini në klasë.*

### **GJUHA SHQYPE**

Porsi kanga e zogut t' verës,  
qi vallzon n'blerim të prillit;  
porsi i ambli fladi i erës,  
qi lmon gjit e drandofillit;  
porsi vala e bregut t' detit,  
porsi gjâma e rrfës zhgjetare,  
porsi ushtima e një tërmetit,  
ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare.  
Ah! po; â' e ambël fjala e sajë,  
porsi gjumi m' një kërthi,  
porsi drita plot uzdajë,  
porsi gazi i pamashtri;  
edhë ndihet tue kumbue;  
porsi fleta e Kerubinit,  
ka' i bien qiellvet tue flutruë  
n' t' zjarrtat valle t' amëshimit.  
Pra, mallkue njai bir Shqyptari,  
qi këtë gjuhë të Perëndis',  
trashigim, që na la i Pari,  
trashigim s' ia len ai fmis;  
edhe atij iu thaftë, po, goja,  
që përbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
qi n' gjuhë t' huej, kur s' asht nevoja,  
flet e t' veten e lën mbas dore.  
Në gjuhë shqype nanat tona  
qi prej djepit na kanë thânun,  
se asht një Zot, qi do ta dona;  
njatë, qi jetën na ka dhânun;  
edhe shqyp na thanë se Zoti  
për shqyptarë Shqypninë e fali,  
se sa t' enden stina e moti,  
do ta gzojn kta djalë mbas djali.  
Shqyp na vete, po pik' mâ para,  
n' agim t' jetës kur kemi shkue,

tue ndjekë flutra nëpër ara,  
shqyp mâ s'pari kemi kndue:  
kemi kndue, po armët besnike,  
qi flakue kanë n'dorë t'shqyptarëvet,  
kah kanë dekë kta për dhë të' t'Parvet.  
Në këtë gjuhë edhe njai Leka,  
qi'i rruzllim mbretnin s'i a, xûni,  
në këtë gjuhë edhe Kastriota  
u pat folë njatyne ushtrive,  
qi sa t'drisë e diellit rrota,  
kanë me kënë ndera e trimnive.  
Pra, shqyptarë çdo fës qi t'jini,  
gegë e toskë, malci e qyteta,  
gjuhën t'uej kurr mos ta lini,  
mos ta lini sa t'jetë jeta,  
por për të gjithmonë punoni;  
pse, sa t'mbani gjuhën t'uej,  
fisi juej, vendi e zakoni  
kanë me u mbajtë larg kambës s'huej,  
Nper gjuhë shqype bota mbarë  
ka me ju njohtë se ç'fis ju kini,  
ka me ju njohtë për shqyptarë;  
trimi n'za, sikurse jini.  
Prandaj, pra, n'e doni fisin,  
mali, bregu edhe Malcija  
prej njaj goje sod t'brohrisim:  
Me gjuhë t'veten rnoftë Shqypnia!

*Atë Gjergj FISHTA*

### FJALË TË URTA

Fjalë e huaj në gjuhë është si dhia  
ndër dhen.

(Naim Frashëri)



**PROJEKT:** Mblidhni fakte interesante për vende dhe gjuhë të ndryshme e diskutojini ato në klasë së bashku.

**Rekomandim didaktik 8:** Informacione të tilla interesante, si: për Imzot Pal Engjëllin, shkruesi i fjalisë së parë shqipe, apo fjalët e Naimit për gjuhën, janë gjithmonë të mirëpritura nga nxënësit. Këto informacione jo vetëm ndihmojnë në ruajtjen e gjuhës, por edhe shtojnë ndenjen e krenarisë dhe përkatësisë kombëtare. Edhe poezia e Atë Gjergj Fishtës është shumë e rëndësishme. Dikush mund të mendojë se është një poezi shumë e vështirë dhe e gjatë për nivelin A1, dhe kjo është e vërtetë. Por mësuesi me kujdes dhe në varësi të grupmohës mund të zgjedhë disa vargje, ose të bashkëpunojë me prindërit për të parë nëse nxënësit kanë dëshirë ta mësojnë këtë poemë-flamur për gjuhën shqipe.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
aeroplani	bojëkafe	bibliotekë
anija	bregdet	bisedë
autobusi	e bukur	dashuri
bagazh	i dashur	kujton
e bardhë	dhomë	lahutë
biçikleta	flas	ndaloj
blu	i gjatë	pasaportë
ecën	jeshil	ruaj
flamuri	i kaltër	stema
fluturon	të kuq	shoh
gri	kur	tranzit
e gjelbër	i shkurtër	udhëtoj
lahuta	mal	xhubleta
lejla	vend	
lundron	i verdhë	
makina	i zi	
motori	e vogël	
ngjyrë		
nisem		
portokall		
quhem		
rozë		
simbol		
treni		
valixhe		
vizitoj		
vjollcë		

**Rekomandim didaktik 9:** Duke pasur parasysh që mësimi i gjuhës shqipe të konsiderohet si një “magazinë me inventar”, në fund, mësuesi bën bilancin e njohurive të fituara në këtë mësim. Format për të punuar me fjalorin e ri, të përsëritur apo shtesë janë nga më të ndryshmet. Këtu do të sugjerohet në mënyrë të veçantë përdorimin e *quizlet.com*, pasi ky *website* gjeneron 6 ushtrime të ndryshme që lidhen me fjalorin e mësuar dhe për këtë mësuesit i duhet vetëm të shkruajë një palë “të dhëna gjuhësore” siç është përkufizimi i fjalës, kategoria gramatikore dhe fotoja shoqëruese.

# MËSIMI 9

*Dizatojmë dhe përdorim teknika të ndryshme  
artistike për të paraqitur vendin tonë  
Lundrojmë në internet*

## **Qëllimet mësimore:**

- a) Përdorim teknika të ndryshme artistike për të paraqitur vendin tonë
- b) Lundrojmë në internet
- c) Gramatikë: disa folje në kohën e tashme, të kryer dhe të pakryer, të mënyrës dëftore dhe në mënyrën urdhërore; ndajfolje kohe *dje, sot, nesër*.
- d) Punë e diferencuar: Objekte antike të trashëgimisë kulturore - piktogramet.

**LIDHJA ME KURRIKULËN**

*Një botë për të gjithë*

Integrimet      Profesionet

Objektivi mësimor: Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- **LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË:** Mësimi 9 na jep mundësinë që nëpërmjet artit figurativ nxënësit të flasin për vendlindjen e prindërve të tyre si dhe të mësojnë përdorimin e foljeve në mënyrën dëftore dhe urdhërore. Gjithashtu, fëmijët fillojnë të kuptojnë se interneti nuk përdoret vetëm për argëtim dhe lojëra digjitale, por edhe për të mësuar dhe hulumtuar informacion.
- **SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI:** Nëpërmjet lojërave gjuhësore dhe në mënyrë të veçantë nëpërmjet vizatimit dhe njohjes së formave të ndryshme gjeometrike, nxënësve u jepet mundësia për të shtuar fjalorin dhe shprehitë e tyre komunikuese në gjuhën shqipe.
- **GRAMATIKË:** Mësimi 9 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. Foljet përdor, lundroj, krijoj, pres, ngjis, di, mbaroj në mënyrën dëftore dhe urdhërore;
  - ii. ndajfoljet sot, dje, nesër;
  - iii. Fjalitë pohuese dhe mohuese.
- **NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Imazhet e piktogrameve dhe petroglifeve në Lepenicë dhe Rubik.
- **FJALORI:** vijë e drejtë, vijë e lakuar, vijë e thyer, drejtkëndësh, katror, trekëndësh, trapez, rreth, formë ovale, romb, laps i zi, lapsa me ngjyra, gomë, ngjites, penel, gërshërë, vizore, kompjuter, tastierë, ekran, maus, internet, postë/adresë elektronike.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Shumë nxënës e mësojnë gjuhën më lehtë përmes aktiviteteve krijuese të tilla, si: vizatimi, ngjyrosja dhe punimet dorës. Nxënësit e nivelit A1 do të preferonin orë mësimi të gjuhës përmes një përvoje të kënaqshme, e cila do ta dërgonte informacionin gjuhësor në kujtesën afatgjatë, duke "mobilizuar" të gjitha vatrat e të menduarit dhe të kuptuarit përmes shtimit të dendriteve të reja. Veprimtari të tilla didaktike përfshijnë aktivitete argëtuese dhe të këndshme, të tilla si: vizatimi, ngjyrosja dhe biseda, të cilat janë ideale për t'i motivuar nxënësit të mësojnë. Këto aktivitete përveçse argëtuese janë edhe mënyra mjaft të suksesshme në mësimin e gjuhës. Një mendësi e tillë didaktike mban në qendër të vëmendjes filozofinë, sipas së cilës:

- a) aftësitë e gjuhës së dytë duhet të ndërtohen natyrshëm dhe pa stres për nxënësit;
- b) mësuesi e përdor gjuhën në mënyrë domethënëse dhe të qëllimshme për botën e nxënësit;
- c) aftësitë e fituara mund të testohen në mënyra argëtuese, interesante dhe të larmishme, jo vetëm me provime.

Përdorni moton "Gati, Kupto, Vizato!". Gjithçka rreth vizatimit (vijat, pikat, shkarravitjet, gërvishtjet) është thjesht një argëtim për nxënësin. Kjo është veçanërisht rëndësishme në mësimin e gjuhës. Një mësues i mirë krijon një situatë të këndshme në klasë dhe nuk pret që nxënësit të prodhojnë skica të cilësisë "Da Vinci", por të bëjnë vizatime të thjeshta.

Ata thjesht duhet të kënaqen kur vendosin laps në letër!





## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOKJMË




*Mësuese Teuta:* Të dashur fëmijë, sot do të kënaqemi shumë. Do të vizatojmë me forma gjeometrike dhe do të lundrojmë në internet.



vijë e drejtë



vijë e lakuar



vijë e thyer



drejkëndësh



katror



trekëndësh



trapez



rreth



oval



romb



laps i zi



lapsa me ngjyra



ngjitës



penel



gërshërë vizore



kompjuter



tastierë



ekran



maus



internet



postë/adresë elektronike

*Dardani:* Mësuese unë **di** një poezi në italisht. Babi im e përktheu shqip për ne.

## 1. Shkruani fjalën që tregon figura ose vizatoni formën në vend të vijës së drejtë.

Jam ■ \_\_\_\_\_ dhe i përsosur  
si një pecetë e palosur  
po të zgjatem pak në anë  
një ■ \_\_\_\_\_ me mua ngjan.

Më kanë quajtur trekëndor \_\_\_\_\_  
me tre cepa në kurorë  
këta cepa me majë kulmojnë  
mos u tremb se nuk të shpojnë.

Jam një ● \_\_\_\_\_, jam rrumbullak  
i vij botës rreth e qark.  
Lind me diellin \_\_\_\_\_, këndoj këngën,  
në qiell ngjitem prapë me hënën \_\_\_\_\_.

## 2. Vizatoni format ose shkruani fjalët kur mungojnë.




Valët e detit janë si \_\_\_\_\_.

Katrori ka 4 vija identike.

*Vesa:* Babi im është piktor. Ai më ka mësuar të vizatoj kafshë me format gjeometrike. Po jua tregoj edhe juve si vizatoj me laps ujkun, iriqin dhe kaprollin.



## 3. Cilat forma përdorim për vizatimet e Vesës?



*Dardani:*

Mua më pëlqen shumë të ngjyros me lapsa me ngjyra.

**Rekomandim didaktik 1:** Pasi nxënësit janë prezantuar si me fjalorin, ashtu edhe me teknikat e thjeshta të të përdorurit të formave të thjeshta gjeometrike (katrori, trekëndëshi, vija e lakuar etj.), ata do të ndihen shumë të aftë për të krijuar skica të vizatimeve të tyre. Së pari, mësuesi u jep pak kohë nxënësve të praktikojnë në mënyrë individuale si vizatohen figurat që jep mësimi 9. Mësuesi modelon vizatimet vetë në dërrasë, duke i shoqëruar me fjali të thjeshta: Kur vizatojmë ujkun, fillojmë me një rreth. Pastaj me një trekëndësh bëjmë fytyrën. Pas kësaj, sipër rrethit bëjmë dy trekëndësha që janë veshët e ujkut. Me një formë ovale bëjmë syrin e ujkut dhe me dy vija të lakuara dhe trekëndësha të vegjël bëjmë gojën dhe dhëmbët. Në fund, me vija të thyera bëjmë flokët e ujkut. Pra, në këtë mënyrë, mësuesi edhe modelon vizatimin, edhe përsërit fjalët e reja duke i vënë në një kontekst të panjohur. Pas kësaj mësuesi i vendos nxënësit në çifte ku njëri vizaton, p.sh.: iriqin pjesë-pjesë dhe tjetri në çdo hap të vizatimit duhet të zbulojë cilën kafshë po vizaton shoku. Ai komenton: “Ti vizatove një rreth të madh dhe një të vogël. Mos po bën ujkun?”. Vizatuesi përgjigjet: “Jo, nuk është ujku” dhe shton edhe këmbët e vogla etj. Derisa shoku zbulon që ai po vizaton iriqin.

#### 4. Shkruani emrat e formave dhe ngjyrosni ato sipas mbiemrave.


ylli	_____	_____	_____	_____
i verdhë	bojëkafe	i kuq	portokall	vjollcë



*Vesa:* Mua më pëlqen shumë akuareli.

*Dardani:* Si e bën?

*Vesa:* Kjo quhet teknika e bojërave të ujit. Përdor penel që mban mirë ujin. Një punim në akuarel fillon dhe mbaron, por nuk mund të punohet pasi është tharë. Ngjyrat e akuarelit janë të tejdukshme. Kjo është një pikturë me akuarel.



*Redona:* Unë kënaqem me **kolazhin**. Është i bukur dhe i lehtë.

*Egini:* Çfarë është kolazhi?

*Redona:* Merr fotografi, fletë revistash, gjethe, lule e të tjera. I pret me gërshërë dhe i **ngjit**. Mbi këtë edhe vizaton, duke krijuar një figurë të re. Ky është kolazh i Egri Biçokut.



### 5. Përcaktoni nëse fjalitë janë të sakta apo të gabuara.

V

G

Redonës i pëlqen akuareli.

Për kolazhin përdorim gërshërë dhe ngjitës.

Akuareli bëhet me lapsa.

Akuareli nuk punohet pasi thahet.

Babi i Eginit është piktor.

Mbi kolazh mund të vizatosh.

Për akuarelin përdorim penel.



### 6. Përgjigjuni pyetjeve dhe përpiquni të bëni në klasë një kolazh ose një akuarel.

Kush dëshiron të ngjyrosë? \_\_\_\_\_

Kush bën kolazh? \_\_\_\_\_

Si bëhet akuareli? \_\_\_\_\_

Si bëhet kolazhi? \_\_\_\_\_

**Rekomandim didaktik 2:** Edhe në ushtrimet e mësipërme, objektivi i mësuesit është:

a) të kontrollojë se sa e kuptojnë nxënësit dialogun rreth llojeve të ndryshme të pikturave;

b) të kuptojë se cilët nxënës s'janë në gjendje të identifikojnë përgjigjet e sakta nga ato të gabuarat. Kjo shprehi për të klasifikuar apo identifikuar të saktën nga e gabuara i kalon caqet gjuhësore të mësimdhënies; ajo ushtron trurin dhe e aftëson atë për të menduar, zgjedhur dhe argumentuar përgjigjet që jep. Një mënyrë e tillë e përdorimit aktiv të trurit garanton kalimin e informacionit në kujtesën afatgjatë, pasi nxënësi lidh njohuritë e mëparshme me ato të reja, duke ndërtuar dendrite të reja që "mbajnë" fort informacionin në kujtesën afatgjatë, të gatshëm për ta përdorur kur t'i nevojitet. Vizatimi i përdorur në këto ushtrime i ofron mësuesit një mënyrë për të vlerësuar aftësitë e dëgjimit dhe leximit pa kërkuar të folurit dhe të shkruarit. Nxënësi mund të kuptojë atë që ka dëgjuar ose lexuar, por nuk është në gjendje ta komunikojë kuptimin e duhur në shqip. Nxitja e nxënësve për të vizatuar heq pengesat e komunikimit dhe eliminon frikën. Frika e paaftësisë mund t'i bëjë nxënësit të mos marrin pjesë në mësim nga frika e dështimit dhe e turpërimit para shokëve. Meqenëse vizatimi është më i lehtë sesa të folurit, një pjesë e frikës së tyre zhduket kur i lejojmë të vizatojnë. Vizatimi lejon që më shumë nxënës të përjetojnë sukses. Në këtë pikë, të gjithë e kuptojmë se ekzistojnë inteligjenca të shumëfishta (Multiple Intelligencies). Meqenëse vizatimi përdor inteligjencën trupore-kinestike më shumë sesa inteligjencën gjuhësore, që kërkohet në shumicën e rasteve, ai jo vetëm që lidh mësimin e gjuhës me aktivitetin kinestetik, por gjithashtu ndihmon nxënësit që kanë këtë lloj inteligjence të gjejnë sukses, i cili përndryshe nuk do të ishte i dukshëm tek kjo kategori nxënësish.



*Mësuese Teuta:* Ne mund të bëjmë punë të bukura edhe në kompjuter. Ka programe për dizajn dhe **pikturë**. Mund të përdorim edhe internetin për të mësuar më shumë. Mund të kërkojmë në motor kërkimi si "Google" ose mund t'i shkruajmë një **mesazh elektronik** mësueses apo shokëve. E dini se çdo ditë dërgojmë më shumë se 200 miliardë mesazhe në adresat e postës elektronike? Por kujdes, mos **lundroni** në internet vetëm!

*Egini:* Kompjuteri i parë ka qenë shumë i madh, sa një dhomë. Ai ishte si një makinë llogaritëse. Maudi i parë ishte prej druri.

*Redona:* Më 1958, Jack Kilby krijoi mikroçipin, që është i vogël, por mban shumë informacion. Më 1970, kompjuteri u bë më i vogël. Lojërat në kompjuter u bënë të njohura në 1980.

*Dardani:* Më 1989 Tim Berners-Lee krijoi “World Wide Web”, për të organizuar informacionin në internet.



## 7. Zgjidhni përgjigjen e saktë.

- *Kompjuteri i parë ka qenë sa:*
  - a. një libër;
  - b. një dhomë;
  - c. një telefon;
- *Çfarë mund të dërgojmë në internet?*
  - a. Një mesazh elektronik.
  - b. Një akuarel.
  - c. Një ekran.
- *Çfarë duhet për të bërë kolazh?*
  - a. Ujë.
  - b. Ngjitës.
  - c. Dëborë.
- *Çfarë ndodhi në vitin 1980?*
  - a. Filloi përdorimi i kompjuterit.
  - b. Filluan lojërat elektronike.
  - c. Filloi “World Wide Web”.

**Rekomandim didaktik 3:** Informacioni shumë interesant për historikun e zhvillimit të kompjuterit që nga mikroçipi i Jack Kilbit e deri tek WWW është shumë afër të interesave të nxënësve të sotëm. Ky moment interesant shfrytëzohet bukur nga mësuesi për të verifikuar se sa e kanë kuptuar nxënësit informacionin e dhënë në dialog. Mësuesi këtë mund ta bëjë ose duke përdorur formën e konkursit, ose duke përdorur shabllonin e lojës “Jeopardy”, siç e kemi shpjeguar në mësimet paraardhëse.



8. Shikoni fotot. Ndahuni në dy grupe në klasë dhe diskutoni për të mirat dhe të këqijat e teknologjisë.



**Rekomandim didaktik 4:** Duke pasur parasysh shumë raste, ku interneti përdoret nga kriminelët për të vjedhur informacion, për ngacmime digjitale që bëhen në mediat sociale të ndryshme etj., ushtrimi i mësipërm, në varësi të moshës së nxënësve, mund të shfrytëzohet si një rast për të krijuar një diskutim interesant në klasë. Në mënyrë të veçantë mësuesi mund të shpjegojë natyrshëm se funksioni i internetit (WWW) është shumë më i gjerë se sa vetëm për të krijuar një “kënaqësi/kuriozitet të çastit”. Ai mund të përdoret për të studiuar, hulumtuar dhe marrë informacione nga më të ndryshmet.





## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI



### 9. Korrigjoni dhe gjeni fjalën.

e r k n a

---

r o r t a k

---

v i e r z o

---

k o r e t j u m p

---

i t n r n e t e

---

g ë s h r r ë ë

---

**Rekomandim didaktik 5:** Ushtrimet e mësipërme ngjallin kërkueshmëri të nxënësve për të zbuluar fjalët sekrete ose fjalët që mungojnë në paragrafin e mësipërm. Mësuesi mund t’u japë disa minuta nxënësve të përgatiten për këtë ushtrim (punë individuale ose në çifte). Edhe sikur nxënësit të mos jenë në gjendje të gjejnë përgjigjet direkt që në provën e parë, kjo është njëfarë “përparësie” pasi mësuesi i inkurajon nxënësit që të shfletojnë mësimin për të zbuluar fjalën sekrete ose atë që mungon. Në këtë mënyrë nxënësi e përsërit edhe njëherë informacionin e ditës, por për nevojat e tij. Meqenëse kjo është një nevojë që nxënësi e kupton që i duhet, mësimi apo ushtrimi bëhet i qëllimshëm dhe nxit interesin individual të nxënësit. Kjo e kthen atë në partner të mësuesit për të nxënë e informacionit të ri.

## 9. Plotësoni me fjalët që mungojnë.

\_\_\_\_\_ i parë ka qenë shumë i madh, sa një \_\_\_\_\_. Ai ishte si një \_\_\_\_\_ llogaritëse. \_\_\_\_\_ i parë ishte prej druri.

Më 1958 Jack Kilby krijoi \_\_\_\_\_, që është i vogël, por mban \_\_\_\_\_ informacion. \_\_\_\_\_ në kompjuter u bënë të njohura më 1980.

Më 1989 Tim Berners-Lee krijoi “World Wide Web”, për të organizuar në internet.

## 10. Jepni përgjigje me fjali pohuese ose mohuese.

A ishte i vogël kompjuteri i parë? \_\_\_\_\_

A e përdorim internetin për informacion? \_\_\_\_\_

A e bëjmë akuarelin me kompjuter? \_\_\_\_\_

A dërgojmë më shumë se 200 miliardë mesazhe elektronike në ditë? \_\_\_\_\_

A mban pak informacion një mikroçip? \_\_\_\_\_



## 11. Lidhni vitin me ngjarjen.

1980	Tim Berners-Lee krijoi “World Wide Web”.
1970	Lojërat në kompjuter u bënë të njohura.
1989	Jack Kilby krijoi mikroçipin.
1958	Kompjuteri u bë më i vogël.

**Rekomandim didaktik 6:** Ushtimi i mësipërm shërben shumë natyrshëm për të zhvilluar të menduarit logjik tek nxënësit. Një ushtim i tillë i ndihmon ata të jenë në gjendje të rendisin në mënyrë kronologjike ngjarjet që ndodhën më 1958-1989 dhe si ndikuan ato në zhvillimin e kompjuterit, deri në aparatin elektronik që ato zotërojnë sot (I-pad, smartphone etj.)



## GRAMATIKË

### ➤ Disa folje në mënyrën urdhërore e dëftore

Mënyra dëftore, koha e tashme						
unë	përdor	lundroj	krijoj	pres	ngjis	di
ti	përdor	lundron	krijon	pret	ngjit	di
ai, ajo	përdor	lundron	krijon	pret	ngjit	di
ne	përdorim	lundrojmë	krijojmë	presim	ngjisim	dimë
ju	përdorni	lundroni	krijoni	prisni	ngjitni	dini
ata, ato	përdorin	lundrojnë	krijojnë	presin	ngjisin	dinë

Mënyra dëftore, koha e pakryer						
unë	përdorja	lundroja	krijoja	prisja	ngjisja	di
ti	përdorje	lundroje	krijoje	prisje	ngjisje	di
ai, ajo	përdorte	lundronte	krijonte	priste	ngjiste	di
ne	përdornim	lundronim	krijonim	prisnim	ngjisim	dinim
ju	përdornit	lundronin	krijonit	prisnit	ngjitnit	dinit
ata, ato	përdornin	lundronin	krijonin	prisnin	ngjisnin	dinin

Mënyra dëftore, koha e kryer						
unë	kam përdorur	kam lundruar	kam krijuar	kam prerë	kam ngjitur	kam ditur
ti	ke përdorur	ke lundruar	ke krijuar	ke prerë	ke ngjitur	ke ditur
ai, ajo	ka përdorur	ka lundruar	ka krijuar	ka prerë	ka ngjitur	ka ditur
ne	kam përdorur	kemi lundruar	kemi krijuar	kemi prerë	kemi ngjitur	kemi ditur
ju	kemi përdorur	keni lundruar	keni krijuar	keni prerë	keni ngjitur	keni ditur
ata, ato	kanë përdorur	kanë lundruar	kanë krijuar	kanë prerë	kanë ngjitur	kanë ditur

Mënyra urdhërore						
ti	përdor	lundro	krijo	prit	ngjit	di
ju	përdorni	lundroni	krijoni	pritni/ prisni	ngjitni	dini

## 12. Vini foljet në formën e duhur.

Unë (lundroj) \_\_\_\_\_ me mamën në internet për të marrë informacione.

Kujdes! Në internet (lundroj) \_\_\_\_\_ gjithmonë me prindërit!

Kur krijon një kolazh, (ngjis) \_\_\_\_\_ materialet me kujdes.

Ajo (ngjis) \_\_\_\_\_ shumë letra me ngjyra.

(pres) \_\_\_\_\_ letrat me gërshërë.

Ne e (di) \_\_\_\_\_ se kjo pikturë është akuarel.

Ju e (di) \_\_\_\_\_ që sot do të bëjmë piktorë.

Ne (mbaroj) \_\_\_\_\_ mësimin.

Kur ke ardhur ti, unë po (punoj) \_\_\_\_\_ ?

### 13. Plotësoni tabelën me format e sakta të foljeve.

unë	përdor			dija
ti		ke krijuar	lundro	
ai, ajo				
ne	përdorim			dinim
ju		keni krijuar		
ata, ato				

### 14. Zgjidhni dy folje që në kohën e tashme, veta I, njëjës mbarojnë me -j, dy me bashkëtingëllore dhe dy me zanore. Formoni nga një fjali me to.

---



---



---



---



---

**Rekomandim didaktik 7:** Përdorimi i saktë i kohëve të foljeve në gjuhën shqipe është një nga aspektet më sfiduese të gjuhës sonë. Prezantimi dhe ushtrimi i foljeve në kohën e kryer të mënyrës urdhërore nëpërmjet ushtrimeve të mësipërme nuk është i lehtë. Por, nëse mësuesi mbetet vetëm në aspektin pragmatik të përdorimit të këtyre foljeve, kjo do të sjellë një ndërgjegjësimit të hershëm praktik të nxënësve, i cili, shpjegimin e rregullave gramatikore të mirëfillëta, do ta marrë në mësimet e nivelit pasardhës.

#### ➤ Ndajfolje kohe

**dje sot nesër**

*Dje binte shi.*

*Sot është ditë me shi.*

*Nesër është e diel.*

**Tregoni ditë e javës.**

Dje ishte \_\_\_\_\_.

Sot është \_\_\_\_\_.

Nesër është \_\_\_\_\_.

### 15. Lidhni format e foljes që i përkasin së njëjtës vetë.

**ishim**

**ishte**

**ishin**

**isha**

**ishit**

**ishe**

**kam mësuar**

**keni mësuar**

**kemi mësuar**

**ke mësuar**

**ka mësuar**

**kanë mësuar**

## 16. Gjeni tri fjalët e fshehura.

P U S C I U C V Z P U I Q Q B  
E J G D X E U A T X R J B X H  
Z I A Q X R A H P J G I X S A  
S B P S D Q J Z W R H W S T V  
K D K F V M B W L C D I B J M  
Z L E K A M D I T U R H T S A  
P R Z V P Z K A L E I X I D M  
G V E P O R R K M A L X S R F  
L W R O E V G X M X D M S O D  
H B K F H T T O D Y H A F B P  
J U Q F J Y G S Z W A E V N F  
Y G M O D D V F S O R A V H B  
D E N F J N W S Z C Y D J F I  
O U A J T Y M Z D D K N O F Q  
P Z Z U J D V O Y S B Y A U D

Janë 3 folje në vetën e parë,  
numri njëjës: folja *di* në kohën  
e kryer, *pres* në kohën e pakryer  
dhe *punoj* në kohën e tashme,

**Rekomandim didaktik 8:** Ushtrimi i mësipërm rifreskon njohuritë empirike gramatikore nëpërmjet kësaj loje interesante gjuhësore. Niveli i vështirësisë së kërkesës në aspektin gramatikor është i vështirë, por mësuesi mund të zgjedhë që ta përdorë si punë të diferencuar për nxënësit më të përparuar ose të mos e bëjë si ushtrim.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *A e dini se...*

*Ndër imazhet më të vjetra në Shqipëri, janë piktogramet dhe petroglifet. Ato janë të pikturuara ose të gdhendura në gur dhjetëra mijëra vjet më parë.*

*Disa prej tyre ndodhen në fshatin Lepenicë të Vlorës, disa në Rubik të Mirditës.*

## FJALË TË URTA

*Një punë e bukur është më e dobishme se një mijë fjalë të bukura.*

**Rekomandim didaktik 9:** Në mbyllje të këtij mësimi interesant, mësuesi mund të organizojë një ekspozitë me pikturat e nxënësve, duke përdorur forma të ndryshme gjeometrike. Mësuesi kërkon që nxënësit përveç vizatimit të përfshijnë edhe fjalët shpjeguese për krijimet e tyre. Kur vijnë prindërit për të marrë nxënësit nga shkolla, mësuesi i fton ata të vizitojnë ekspozitën.



Këtu mund të shihni një dokumentar për “Shpellën e Shkruar të Lepenicës”:

“Alla ricerca dell autenticita” - Guva e Lepenicës dhe piktogramet e saj - YouTube



**PROJEKT:** Kërkoni teknika të ndryshme piktore dhe provoni të bëni një punë vetë. Silleni në klasë dhe tregoni si e realizuat.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
bojëra di drejtkëndësh ekran gërshërë gomë internet katror kompjuter krijoj lapsa lundroj marr mbaj mbaroj ngjis ngjitës oval penel përdor postë romb rreth tastierë trekëndësh (trekëndor) trapez vijë vizore	bëj bojëkafë i bukur i dashur dielli ditë fëmijë fotografi hëna i njohur jeshil kënaqem i lehtë mësoj portokall punoj qiell shumë i verdhë vetëm i zi	dizajn gjeometri iriq kaproll kulmoj kurorë i lehtë mikroçip organizoj pecetë program revistë teknikë thaj transparent ujk zgjatëm

**Rekomandim didaktik 10:** Në fund të mësimit, mësuesi kontrollon përvetësimin e fjalorit të ri, duke përdoruar ose *quizlet.com* ose skedina me foto që ua tregon nxënësve dhe kërkon që ata të gjejnë fjalën ose ta përdorin në një fjali të formuar prej tyre.





# MËSIMI 10

## *Objekte e histori antike Shtëpia ime, dhoma ime*

### **Qëllimet mësimore:**

- a) Objekte e histori antike
- b) Shtëpia ime, dhoma ime
- c) Gramatikë: ndajfolje vendi *afër, majtas, përpara, djathtas, larg, përballë, prapa*; numërorë rreshtorë I-X.
- d) Punë e diferencuar: “Gjetje arkeologjike”, “Mbretëreshë Teuta”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë*

Qytetërimi, historia      Unë dhe mjedisi im

Objektivi mësimor: Në fund të këtij mësimi, nxënësit do të përvetësojnë:

- LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË: Mësimi 10 do të na ndihmojë që të flasim për objekte dhe histori antike nga historia e trevave ku jetojnë shqiptarë. Ata do të mësojnë si të përshkruajnë dhomën dhe shtëpinë e tyre.
- SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI: Nëpërmjet përshkrimit të dhomës së tyre, fjalëkryqit dhe gjetjes së fjalëve që mungojnë, nxënësit zhvillojnë shprehitë e të shkruarit, por edhe argëtohen.
- GRAMATIKË: Mësimi 10 sjell këto aspekte gramatikore:
  - i. numërorët rreshtorë 1-10;
  - ii. ndajfoljet afër, larg, majtas, djathtas, përpara, prapa, përballë.
- NJOHIM TRASHËGIMINË TONË: Nxënësit do të njihen me zbulime arkeologjike dhe me historinë e Mbretëreshës Teuta.
- FJALORI: vilë, apartament, garazh, pishinë, tarracë, oborr, ballkon, dhomë gjumi, kuzhinë, dhomë ndenjeje, korridor, banjë, tavolinë ngrënieje, karrige, sobë gatimi, frigorifer, divan, kolltuk, bibliotekë, krevat, dollap rrobash, tryezë pune, dush, vaskë, lavaman.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Qasja didaktike e bazuar tek puna me një projekt për një temë të caktuar, ashtu si edhe qasja didaktike e bazuar në detyra të caktuara për nxënësit dhe qasja didaktike e bazuar në projekte mësimore, ka për qëllim të adresojë interesat reale të nxënësve, duke përshtatur gjuhën e përdorur në projekt me aftësitë dhe kompetencat që kanë nxënësit në nivelin A1. Zbatimi i kësaj qasjeje didaktike fillon duke përcaktuar një projekt, në përputhje me interesat dhe njohuritë që ka individi ose grupi i nxënësve. Por, çfarë do të bëjmë nëse kemi një klasë me nxënës që, ndoshta, nuk duan të vijnë te shkolla shqipe? Do të fillojmë me bërjen e një vlerësimi të interesave dhe temave që duan të dinë nxënësit. Ky vlerësim do të çojë në hartimin e një projekti gjithëpërfshirës që do të bëhet rezultati përfundimtar i semestrit ose i kursit. Projekti mund të ketë forma të ndryshme, që nga një prezantim i thjeshtë me gojë, e deri tek shfaqja në klasë. Sido që të jetë rasti, projekti duhet të përbëhet nga detyra individuale që i çojnë nxënësit drejt përvetësimit të objektivit mësimor sipas programit. Kur përdoret qasja didaktike me bazë projektin duhet bërë kujdes që kriteret tuaja të vlerësimit të jenë të qarta, në mënyrë që nxënësit të dinë se për çfarë vlerësohen.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOKJMË



*Mësuese Teuta:* Si jeni? Sot nuk do ta zhvillojmë mësimin në klasë, por *online*, në një platformë virtuale. Do të shohim si janë shtëpitë tona. Do të shohim edhe disa objekte antike të ilirëve.



**vilë**



**apartament**



**garazh**



**pishinë**



**tarracë**



**oborr**



**ballkon**



**dhomë gjumi**



**kuzhinë**



**dhomë ndenjeje**



**korridor**



**banjë**



**tavolinë  
ngrënieje**



**karrige**



**sobë  
gatimi**



**frigorifer**



**divan**



**kolttuk**



**bibliotekë**




**krevat**



**dollap  
rrobash**



**tryezë  
pune**



**dush**



**vaskë**



**lavaman**

Vesa: Vëllai im tani jeton në Itali. Ai është student dhe na ka dërguar një email.

*Të dashur prindër, e dashur Vesa!*

*Unë jam shumë mirë. Banoj me dy shokë në një apartament në katin e tetë. Shkoj çdo ditë në universitet. Apartamenti është shumë afër me bibliotekën. Palestra është pak larg. Në shtëpi janë 3 dhoma: një për mua dhe nga një për shokët e mi. Kur hyj nga dera e jashtme del përpara dhoma e ndenjes. Djathtas është kuzhina, majtas janë dy banja. Djathtas, pas kuzhinës është një korridor i gjatë. Aty janë dhomat. E para është dhoma e Simonit. Ai është anglez, por flet edhe italisht. Pastaj është dhoma ime. Në krahun e majtë është dhoma e Markos. Ai është italian, por flet edhe anglisht. Në fund të korridorit është një ballkon i vogël, jo si tarraca e madhe që kemi ne. Ballkoni tjetër, në kuzhinë, është më i madh. Në shtëpi flasim anglisht dhe italisht, por tani ata thonë edhe disa fjalë shqip.*

*Tani duhet të iki në mësim. Ju përqafoj fort,*

*Ermiri*



### 1. Përgjigjuni pyetjeve.

Kush e ka shkruar letrën?

Sa shokë banojnë në atë apartament?

Sa dhoma janë në shtëpi?

Sa ballkone janë?

Nga është Simoni?

Nga është Marko?



### 2. Lidhni variantet e sakta.

kuzhina

dhoma e ndenjes

apartamenti

ballkoni në kuzhinë

dhoma ime

është afër me bibliotekën

është e dyta

është përpara

është djathtas

është i madh

**Rekomandim didaktik 1:** Duke u orientuar me qasjen didaktike të mbështetur në projekte, ushtrimet e mësipërme i japin mësuesit mundësi të ndryshme për të krijuar projekte interesante.

a) Natyrisht, nxënësit janë të interesuar të mësojnë përmes bisedave të "rastësishme" në shqip, prandaj mësuesi mund t'u japë mundësi që të zgjedhin se si do ta bëjnë projektin, të shpjegojnë zgjedhjen e tyre dhe nëse do të punojnë individualisht apo me një/ shumë partner.

b) Për të rritur kërshtërinë e nxënësve, mësuesi përmend disa lloje projektesh: mund të përdorni kompjuterin për të gjetur pamje të shtëpisë së Ermirit dhe t'i përshkruani; mund të vizatoni dhomat dhe objektet në to, mund të ndërtoni shtëpinë e Ermirit me lego etj.

c) Mund të krijoni një dialog me "arkitektin" që ka ndërtuar shtëpinë e Ermirit në Itali ku klienti informon arkitektin për kërkesat e tij për shtëpinë e re dhe pastaj ta vini në skenë këtë dialog. Gjithë fokusi është që nxënësit duhet të prodhojnë diskutime specifike për pyetjet dhe përgjigjet e ushtrimeve të mësipërme. Secili nxënës do t'i përgatisë përgjigjet sikur të ishin situata të vërteta në shtëpinë ku ata banojnë



### 3. Gjeni e kujt është çdo shtëpi, pasi të lexoni përshkrimet.

#### Diskutoni së bashku.

*Egini:* Unë jetoj në një shtëpi me kopsht dhe pishinë. Ne kemi 4 dhoma gjumi dhe secila ka një banjë. Në hyrje kemi një dhomë ndenjeje të madhe. Atje është edhe kuzhina. Kemi edhe vend parkimi për makinat.

*Dardani:* Shtëpia ime është e vogël. Kur të shkoj në universitet, unë do të jetoj atje. Ajo ka një dhomë ndenjeje, kuzhinë, një dhomë gjumi, një banjë.

*Redona:* Shtëpia ime ka dy dhoma gjumi, një kuzhinë dhe një dhomë ndenjeje, një banjë dhe një ballkon.





#### 4. Këto janë dy shtëpi të çuditshme, njëra në Roskovec dhe tjetra në Prizren. Shikojini fotografitë dhe diskutoni së bashku. Cila ju pëlqen? Pse?



*Shihni dokumentarët dhe mësoni më shumë.*

<https://www.youtube.com/watch?v=QJ6M6S6RmE4>

[https://www.youtube.com/watch?v=uM\\_sKtC1uwg](https://www.youtube.com/watch?v=uM_sKtC1uwg)

#### 5. Tregoni si është shtëpia që dëshironi të keni.

**Rekomandim didaktik 2:** Në klasë, mësuesi mund të diskutojë me nxënësit për interesat e tyre për “strehim”, varësisht nga moshën e nxënësve. P.sh.:

a) Me nxënësit më të vegjël mund të përdoret projekt vizatimi (si në ushtrimin 3) i shtëpisë së tyre ku ata të skicojnë ku ndodhen dhomat, kuzhina, banja etj., dhe t’i përshkruajnë ato me fjalët e tyre.

b) Nxënësit më të rritur mund të gjejnë shumë interesante dy videot me shtëpitë në Prizren dhe Roskovec. Në këtë rast mësuesi mund të fillojë duke shfaqur videon dhe pastaj nxënësit diskutojnë dhe ndërtojnë modele shtëpish futuristike. Projekti i tyre përfundimtar është një raport që ata mund t’ia paraqesin “arkitektit” të tyre për miratim dhe të shpjegojnë kriteret që përdorën për të krijuar projektin futurist. Është shumë punë, por nxënësit do të ndihen të argëtuar dhe do të “harrojnë” që po flasin shqip, qoftë edhe me gabime, pasi këtu qëllimi është të zhvillohen aftësitë komunikuese.

*Redona:* Tani do t’ju tregoj si është dhoma ime.

Dhoma ime ka shumë diell. Muret janë të bardha. Përbalë derës është dritarja. Ajo ka perde lejla. Në **parvaz** është një vazo me lule. Djathtas derës është krevati. Te këmbët e krevatit është një karrige. Te koka e krevatit kam një **komodinë** të vogël. Në krahun e majtë të dritares është tryeza e punës dhe **prapa** tryezës gjendet një bibliotekë e vogël. Në fund të dhomës, **përbalë** krevatit është dollapi i rrobave.



*Egon Schiele*



## 6. Rilexoni tekstin dhe përcaktoni nëse fjalitë janë të sakta: (e vërtetë), G (e gabuar).

V

G

- Perdet e dhomës janë të bardha.
- Dhoma ime ka shumë diell.
- Dollapi rrobave është përballë dritares.
- Palestra është larg.
- Karrigia është te koka e krevatit.
- Tavolina e punës është majtas dritares.
- Në tavolinën e punës është një vazo me lule.

**Rekomandim didaktik 3:** Një nga temat më elementare që mund të përdoret për t'i bërë nxënësit të flasin dhe të japin mendime në shqip është strehimi. Shtëpia/strehimi është një nga ato temat universale që funksionon vërtet mirë në ndërtimin e shprehive të të folurit. Të gjithë kanë mendime të ndryshme se si duan të jetojnë. Kjo qasje me projekte te lidhura me shtëpinë mund të përdoret në shumë nivele e projekte për sa kohë që fjalori është përshtatur me aftësitë e nxënësve. Këtu mund të përmenden lojërat me role, ku njeri nxënës luan rolin e mësuesit dhe pasi lexohet paragrafi përshkruar i shtëpisë, lexon fjalinë dhe partneri thotë nëse përgjigja është e vërtetë (V) apo a gabuar (G); mund të përdoren pyetësorët që kërkojnë informacion përshkruar të shtëpisë, apo ushtrimet e përputhjes së figurës-fjalorit, duke përdorur modelin e fjalisë “Këtu shoh dhomën e gjumit... majtas është krevati etj.”. Këto janë disa nga aktivitetet që funksionojnë mirë me këtë temë.

## 7. Tregoni se ku ndodhen orenditë.

- Dushi ndodhet në:
  - a. kuzhinë;
  - b. banjë;
  - c. dhomë gjumi.
- Biblioteka ndodhet në:
  - a. dhomën e ndenjes;
  - b. banjë;
  - c. ballkon.
- Dollapi i rrobave ndodhet në:
  - a. kuzhinë;
  - b. banjë;
  - c. dhomë gjumi.
- Tryeza e ngrënies ndodhet në:
  - a. kuzhinë;
  - b. banjë;
  - c. dhomë gjumi.
- Divani ndodhet në:
  - a. dhomën e ndenjes;
  - b. banjë;
  - c. dhomën e gjumit.

## 8. Shikoni dhe diskutoni për këto dy piktura.



*Abdurrahim Buza*



*Guri Madhi*

**Rekomandim didaktik 4:** Ushtrimet e mësipërme mund të shërbejnë si një rast i mirë ku mësuesi u jep nxënësve pjesën e parë të fjalisë dhe u kërkon të bëjnë zgjedhjen më të mirë ndër disa zgjedhje të mundshme. Ky ushtrim mund të bëhet nga nxënësit në mënyrë individuale ose me një partner. Kurse pikturat e Abdurrahim Buzës dhe të Guri Madhit mund të përdoren jo vetëm për të përshkruar orenditë në dhomë, por edhe si një krahasim i pamjeve të dhomave tradicionale të ndenjes dhe atyre të sotme. Në këtë mënyrë nxënësit mësojnë edhe të bëjnë krahasime në kohë, edhe shijet estetike.



## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

9. Përshkruani dhomën që shikoni në fotografi.



---

---

---







---



## 10. Plotësoni fjalitë me fjalët që mungojnë.

Dhoma ime ka \_\_\_\_\_ diell. Muret janë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ derës është dritarja. Ajo ka perde \_\_\_\_\_. Në parvaz është një vazo me \_\_\_\_\_. Djathtas derës është krevati. Te këmbët e krevatit është një karrige. Te koka e krevatit kam një \_\_\_\_\_ të vogël. Në krahun e majtë të \_\_\_\_\_ është tavolina e punës dhe një \_\_\_\_\_ e vogël. Në fund të dhomës, përballë \_\_\_\_\_ është dollapi i rrobave.

## 11. Plotësoni fjalëkryqin. (Shkronjat dyshe vendosini në një kuti).



**Rekomandim didaktik 5:** Ushtrimet e mësipërme i japin shumë mundësi mësuesit për të bërë mini-projekte për të zgjidhur fjalëkryqet apo për të gjetur fjalët që mungojnë. Gjëja më interesante në këto ushtrime është mundësia e futjes së garës, lojës, konkursit, gjithmonë të parapëlqyera nga nxënësit që mësojnë një gjuhë të re.



➤ Ndajfolje vendi: *afër, larg, majtas, djathtas, përpara, përballë, prapa.*

12. Shikoni fotografinë e mëposhtme dhe shkruani ku ndodhen dhomat, duke përdorur ndajfoljet e vendit.



---

---

---

---


---

---

---

---

13. Shkruani ndajfoljet për çdo imazh.



---

**Rekomandim didaktik 6:** Gramatika, e domosdoshme për krijimin e fjalive të sakta, paraqitet përsëri në mënyrë shumë pragmatike. Mësimi i përdorimit të ndajfoljeve të vendit afër, larg, majtas, djathtas, përpara, përballë, prapa, si dhe numërorëve rreshtorë I-X paraqitet thjesht dhe pastaj praktikohet në ushtrimet që vijojnë. Mësuesi do të zgjedhë mënyrat më të përshtatshme si qasje didaktike me bazë projektin për këto ushtrime. Nxënësit mund të punojnë në çifte ose në grupe për të plotësuar ushtrimet e mësipërme.

➤ Numërorë rreshtorë I-X

1	një	I	i parë, e parë
2	dy	II	i dytë, e dytë
3	tre	III	i tretë, e tretë
4	katër	IV	i katërt, e katërt
5	pesë	V	i pestë, e pestë
6	gjashtë	VI	i gjashtë, e gjashtë
7	shtatë	VII	i shtatë, e shtatë
8	tetë	VIII	i tetë, e tetë
9	nëntë	IX	i nëntë, e nëntë
10	dhjetë	X	i dhjetë, e dhjetë

14. Plotësoni fjalitë me emërtimin e figurës dhe me numrin rreshtor që i përket asaj.

\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



\_\_\_\_\_ është në radhën \_\_\_\_\_.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *A e dini se...*



*Teuta ishte mbretëreshë ilire. Pas vdekjes së bashkëshortit, Agronit, në vitin 231 p.e.s., ajo u vu në krye të shtetit ilir e të ushtrisë dhe mbretëroi në vitet 230-228 p.e.s.*





Illirët janë paraardhësit e shqiptarëve. Arkeologët kanë zbuluar shumë objekte antike të tyre. Shikoni disa objekte që arkeologu Bep Jubani i ka gjetur në Çinamak, në Kukës.

Këto janë: enë, përkrenare, disa unaza, monedha ku shkruhet emri i fisit ilir të Labeatëve. (Labeatët jetonin në zonën e Shkodrës.)

Në fotografinë e fundit janë disa rruaza qelibari dhe qelqi. Në Greqinë dhe Romën e Vjetër qelibarin e quanin edhe lotët e Heliadës, vajzës së perëndisë së Diellit, Heliosit. Edhe illirët e nderonin Diellin.





**PROJEKT:** Kërkoni fakte interesante rreth antikitetit ilir dhe diskutojini së bashku.

### FJALË TË URTA

*Me një tra nuk mban shtëpia.*

**Rekomandim didaktik 7:** Mësuesi mund të inkurajojë nxënësit për të bërë një projekt si grup, ku disa nxënës mund të hulumtojnë në internet dhe të gjejnë zbulime të ndryshme arkeologjike nga trevat ku kanë jetuar shqiptarët/ilirët në antikitet. Këtë informacion ia përcjellin dikujt në grup që harton një dialog ndërmjet “arkeologut” dhe nxënësve që vizitojnë muzeun. Pas kësaj, të gjithë bashkë e vënë në skenë këtë dialog, duke e ilustruar me objektet antike që kanë grumbulluar në internet.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
afër	anglez	dërgoj
apartament	e bardhë	dush
ballkon	i dashur	fis
banjë	diell	iki
bibliotekë	i drejtë	kokë
dhomë	drejtkëndësh	krevat
divan	flas	lavaman
djathtas	formë	lule
dollap	italian	nderoj
frigorifer	jam	parvaz
garazh	katror	perde
gatim	krah	rroba
gjumë	i lakuar	rruaza
karrige	lejla	vazo
kolltuk	i madh	zbuloj
korridor	romb	
krevat	rreth	
kuzhinë	oval	
larg,	shkruaj	
majtas	shoh	
ngrënie	shok	
oborr	shqip	
përballë	trapez	
përpara,	trekëndësh (trekëndor)	
pishinë	i thyer	
prapa	vijë	
punë	i vogël	
rrobë		
sobë		
tarracë		
tryezë		
vaskë		
vilë		

**Rekomandim didaktik 8:** Në fazën e fundit të këtij mësimi, mësuesi mund ta përdorë përsëri qasjen didaktike të projektit, duke bërë tre nxënës si mësues ku secili bën inventarin e dijes për fjalorin e mësipërm (i ri, i përsëritur dhe shtesë). Mësuesi mund të ndërhyjë për të ndihmuar apo sqaruar fjalë të ndryshme problematike për nxënësit.

# MËSIMI 11

## *Kuzhina e shëndetshme e gjyshes Gatime të vendit ku jetoj Vizitë në një restorant*

### **Qëllimet mësimore:**

- a) Kuzhina e shëndetshme e gjyshes
- b) Gatime të vendit ku jetoj
- c) Vizitë në një restorant
- d) Gramatikë: koha e ardhme e mënyrës dëftore dhe koha e tashme e mënyrës lidhore; shkallët e mbiemrit.
- e) Punë e diferencuar: “Antikiteti ilir dhe ushqimet”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Një botë për të gjithë*  
*Të ndryshëm dhe të njëjtë Vendlindja Familja*



- **LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË:** Nxënësit do të mësojnë të flasim për ushqimet tradicionale të shijshme që gatuan gjyshja dhe si të përdorin ushqime të freskëta dhe të shëndetshme. Gjithashtu, ata do të mësojnë fjalorin dhe shprehjet e zakonshme që përdoren në restorant dhe kur i jepet porosia kamerierit.
- **SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI:** Dialogu dhe fjalori i paraqitur në këtë seksion të mësimin japin “receta” të gatimeve tradicionale (manti, qifqi, pashaqofte, fli etj.) të krahinave të ndryshme të trevave shqiptare. Kjo i jep mundësi mësuesit që të krijojë një orë mësimi ndërvepruese dhe interesante.
- **GRAMATIKË:** Mësuesi/mësuesja paraqet në mënyrë pragmatike/praktike foljet gatuj, ziej, shtoj, pjek, marr, vë, ha, në kohën e ardhme të mënyrës dëftore dhe në kohën e tashme të mënyrës lidhore, si dhe shkallët e mbiemrit.
- **NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Nëpërmjet kësaj rubrike nxënësit mësojnë se sipas Herodotit, në antikitet ka qenë e zhvilluar si bujqësia, ashtu edhe blegtoria. Gjithashtu, nxënësit mësojnë edhe fjalën e urtë “Gjella me kripë, kripa me karar.”
- **FJALORI:** dardhë, djathë, domate, fruta, gatime, gjalpë, gjellë, gotë, kripë, limon, lugë, luleshtrydhe, majonezë, mustardë, miell, mjaltë, mollë, oriz, patate, patëllxhan, pecetë, perime, pirun, pjatë, pjeshkë, qersh, salcë, selino, sheqer, spec, spinaq, tenxhere, thikë, tigan, vaj, vezë.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Një koncept shumë i suksesshëm që mund të përdoret në këtë mësim është ndihma për nxënësit që ata të mësojnë se si të bëjnë lidhje të tekstit të prezantuar nga mësuesi, me krijimin e imazheve në trurin e tyre. Ndhma që u jepet nxënësve për të bërë këto lidhje “fjalë-imazh në tru” është një teknikë efektive për përmirësimin e të kuptuarit dhe të përdorimit të gjuhës. Mësuesi duhet t’i japë nxënësit një bazë themelore për të përvetësuar atë që po lexojnë. Mësuesi mund të flasë apo të shfaqë një video në lidhje me konceptet e panjohura për nxënësit, para se t’i prezantojë ato në tekstin e mësimin. Në përdorimin e kësaj teknike është e domosdoshme të ndihmoni nxënësit të lidhin historinë apo dialogun e tekstit me përvojat e tyre personale. Për shembull, kur lexoni një libër për një djalë që merr një qenush të ri, pyesni nxënësit se kush ka një kafshë shtëpiake. Pyesni se ku e kanë marrë kafshën e tyre dhe si e kanë zgjedhur atë. Ose kur flisni për ushqimet tradicionale, pyetini nxënësit: “Cila është gjella më e mirë që ju bën gjyshja?”





## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



**Mësuese Teuta:** Të dashur nxënës, sot kemi një temë shumë “të shijshme”, do të flasim për gatime. Gjellët e gjyshes janë gjellët më të dashura.



perime



domate



spinaq



selino



patate



patëllxhan



spec



limon



djathë



gjalpë



vaj



majonezë



mustardë



vezë



salcë



oriz



kripë



mjaltë



sheqer



miell



fruta



mollë



pjeshkë



luleshtrydhe



portokall



dardhë



qershi



tenxhere



tigan



pjatë



lugë



pirun



thikë



gotë



pecetë

**Rekomandim didaktik 1:** Në zbatim të konceptit të përgjithshëm didaktik, mësuesi mund të fillojë me një videoklip në You Tube për të parë se si gatuhet tava e kosit apo byrekët e vegjël: [https://www.youtube.com/watch?v=L5wtfhK5CE4&ab\\_channel=JoomlaPlatform](https://www.youtube.com/watch?v=L5wtfhK5CE4&ab_channel=JoomlaPlatform) ose [https://www.youtube.com/watch?v=vZHmN8zFHME&ab\\_channel=RecetaGatimiNgaLida-CookWithLida](https://www.youtube.com/watch?v=vZHmN8zFHME&ab_channel=RecetaGatimiNgaLida-CookWithLida)

Në këto klipe nxënësit shohin mënyrën se si gatuhet kjo gjellë. Pas kësaj mësuesi u kërkon të lexojnë dialogun e mësipërm dhe të diskutojnë edhe për fjalët e reja. Përveç kësaj, mësuesi mund të ftojë dy prindër, të cilët do të sjellin përbërësit për gatimin e tavës së kosit apo të byreçkave dhe të pretendojnë ose të gatujnë (në bazë të kushteve) gjellët e mësipërme. Ndërkohë që prindërit gatujnë apo tregojnë ato që kanë sjellë, mësuesi shpjegon fjalorin. Kjo mënyrë interaktive i ndihmon nxënësit të krijojnë në tru imazhe të fjalëve dhe të veprimeve që po shpjegon mësuesi. Nëse keni ndonjë restorant shqiptar në zonën ku ndodheni, këtë mësim mund ta zhvilloni atje. Në këtë mënyrë, nxënësit do të kenë mundësinë të shikojnë nga afër se si bëhet përgatitja e ushqimeve në restorant, si dhe të praktikojnë fjalët që kanë mësuar.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDUJMË

**Vesa:** Mua më pëlqejnë të gjitha ushqimet, por gjellët e gjyshes i dua më shumë. Gjyshja ime jeton në fshat, atje ka fruta dhe perime të freskëta. Ajo gatuan ushqime të shëndetshme.

Kur shkoj te gjyshja, ajo bën menjëherë byrekë të vegjël. Disa me mish, disa me djathë, siç më pëlqejnë mua. Sa të mira janë edhe petullat e gjyshes!

Por gjella që më pëlqen më shumë është “tava e kosit”. Për ta gatuar, gjyshja thotë se duhet të marrësh: lëng mishi, kos të bardhë, vezë, pak oriz, pak miell dhe gjalpë.

Atë gjellë e quajnë edhe “Tavë Elbasani”.

1. Duhet të ziejmë mishin.
2. Mund të shtojmë pak oriz.
3. Bashkojmë vezët me miell dhe me kos.
4. I ziejmë pak dhe i pjekim me gjalpë.

**Dardani:** Gjyshja ime bën fli me vezë dhe gjalpë. Ajo e di që mua më pëlqen shumë. Është **gati** kur shkoj atje.



### 1. Përgjigjuni pyetjeve.

Kush gatuan më mirë në shtëpinë tuaj?

Të pëlqen të jesh kuzhinier?

Cila është gjella që do më shumë Vesa?

Çfarë i bën gjyshja Dardanit?

### 2. Cilat nga këto ushqime ju pëlqejnë? Cilat janë më të shëndetshme?



*Redona:* Mua më pëlqen të provoj gatime nga vende të tjera. Po ju tregoj disa:  
 Nga gatimet italiane më pëlqen pica (miell, djathë, salcë etj.).  
 Nga gatimet spanjolle më pëlqen paella (paella) (me peshq e oriz).  
 Nga gatimet amerikane më pëlqen ëmbëlsira brauni (brownie) (me miell, vezë, sheqer, çokollatë).  
 Nga gatimet gjermane më pëlqen shniceli (schnitzel) (kotoletë me mish dhe bukë të thekur).

### 3. Tani më thoni ju disa gatime të tjera.

### 4. Shikoni imazhin e mëposhtëm. Shefi i kuzhinës shkon të përgjigjet në telefon dhe rrëshqet mbi një lëkurë bananeje. Kush e tregon më bukur?



**Rekomandim didaktik 2:** Edhe ushtrimi i mësipërm i jep shumë mundësi mësuesit të ndihmojë nxënësit të krijojnë në tru imazhe të fjalëve dhe të koncepteve të përdorura në tekst. Mësuesi mund të organizojë një diskutim pse fëmijëve u pëlqejnë picat, paella-t, brownie-t, schnitzel-i etj. Nxënësit mund të ftohen që të gjejnë në hartë vendet ku këto lloj ushqimesh janë tipike/tradicionale. Një veprimtari tjetër interesante didaktike është që dikush të vizatojë aspekte të gatimit (nëse mësuesja nuk di të vizatojë mund të kërkojë ndihmën e nxënësve) dhe grupi të thotë se çfarë po vizatohet. Do të ishte shumë interesante që kuzhinieri që rrëzohet në lëkurën e bananes të vihej në skenë dhe të diskutohej se sa të kujdesshëm duhet të jemi që të mos hedhim plehra në tokë. Të gjitha këto veprimtari didaktike jo vetëm e bëjnë mësimin interesant për nxënësit, por edhe “skalitin” imazhe të koncepteve dhe njërive gjuhësore në trurin e nxënësit, gjë që e ruan informacionin gjuhësor në kujtesën afatgjatë.

Albulena dhe Dritoni do të shkojnë për darkë.

*Dritoni:* Ku do të shkojmë?

*Albulena:* Është ditëlindja jote. Zgjidh ti!

*Dritoni:* Mua më pëlqen të gatuaj, por më pëlqen edhe të shkoj në një restorant.

*Albulena:* Ti je kuzhinier shumë i mirë, por sot nuk duhet të lodhesh.  
*Dritoni:* Ne kemi ngrënë shumë mirë te restoranti kinez. Shkojmë atje?  
*Albulena:* Sot dua të shkojmë në restorant italian.  
*Dritoni:* Shumë mirë. Po i telefonoj. Në ç'orë të shkojmë?  
*Albulena:* Unë mbaroj punën në orën 6. Si thua për orën 8 e gjysmë?  
*Dritoni:* Po, shumë mirë është edhe për mua.

## 5. Rilexoni dialogët dhe përcaktoni nëse fjalitë janë të sakta: V (e vërtetë), G (e gabuar).

*Pse shkojnë për darkë Dritoni dhe Albulena?*

- Ka ditëlindjen Albulena.
- Është festë.
- Ka ditëlindjen Dritoni.

*Kush ka dëshirë të gatuajë?*

- Dritoni.
- Dritoni dhe Albulena.
- Albulena.

*Në çfarë restoranti shkojnë?*

- Kinez.
- Shqiptar.
- Italian.

*Në ç'orë do të shkojnë në restorant?*

- Në orën 6.
- Në orën 6 e gjysmë.
- Në orën 8 e gjysmë.

## Dritoni dhe Albulena shkojnë në restorant.

*Dritoni:* Mirëmbërëma! Unë ju kam telefonuar dhe kam rezervuar një tryezë për në orën 8 e gjysmë. Quhem Driton Gega.

*Kamerieri:* Mirë se erdhët! Tryeza juaj është afër me dritaren. Ju pëlqen?

*Dritoni:* Shumë mirë.

*Kamerieri:* Çfarë do të pini?

*Dritoni:* Unë i jap makinës, kështu që një birrë pa alkool, ju lutem.

*Albulena:* Edhe për mua njësoj, ju lutem.

*Kamerieri:* Kjo është menyja. Shikojeni dhe më thoni, ju lutem.

*Albulena:* Unë dua një supë me perime dhe lazanja.

*Dritoni:* Marrim edhe një antipastë me djathëra. Unë do të marr makarona me salcë domatesh dhe mish në skarë.

*Kamerieri:* Po ëmbëlsirë?

*Albulena:* Kam porositur unë për të dy ne. Është surprizë.

## 6. Rilexoni dialogët dhe përcaktoni nëse fjalitë janë të sakta: V (e vërtetë), G (e gabuar).

V

G

Albulena i ka telefonuar restorantit për një tryezë.

Tryeza është afër tarracës.

Të dy pinë limonadë.

Albulena porositi supë me perime.

Makaronat i porositën me salcë.

Dritoni porositi antipastë për Albulenën.

Ëmbëlsira është surprizë për Dritonin.

**Rekomandim didaktik 3:** Këtu mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të punojnë në çifte dhe të lexojnë dialogun me njëri-tjetrin. Pastaj mësuesi u jep kohë çifteve të gjejnë mjetet e nevojshme (telefon, pjatë, lugë, pirun etj.) dhe të përgatiten për të "vënë në skenë" dialogun e mësipërm. Mësuesi i nxit nxënësit të jenë sa më krijues, si në gjetjen e objekteve që u duhen për vënien në skenë, ashtu edhe në përdorimin e vetë dialogut. Meqenëse ky aktivitet mbështetet në veprimtarinë e shumë vatrave të trurit, pa dyshim që i ndihmon dukshëm nxënësit në krijimin e imazheve në tru.

## 7. Shikoni fotot, ndahuni në grupe dhe bëni dialogë si në shembullin e mësipërm.



### SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

**Egini:** Gjyshja ime bën një supë shumë të mirë me **qofte**. Quhet pashaqofte dhe e gatuan me mish, vezë, qepe, oriz, gjalpë, limon, kripë.

**Dardani:** Gjyshja ime gatuan manti. Sa të mira janë! Ajo Ajo i bën me mish, gjalpë, miell, kos, vaj ulliri, kripë.

**Vesa:** Gjyshja ime gatuan edhe qifqi. Ato janë si qofte, por me oriz, veze, kripë, vaj ulliri. Ato i gatuan në tigan dhe jo në tenxhere.






## 8. Ndreçni gabimet në tekst.

Egini thotë që gjyshja bën një supë shumë të mirë me perime.  
 Dardani thotë që gjyshja gatuan manti me limon.  
 Gjyshja e Dardanit hedh sheqer në manti.  
 Gjyshja e Vesës gatuan pashaqofte.  
 Qifqitë janë si makarona me oriz dhe gatohen në tenxhere.

## 9. Në fotot e mëposhtme përshkruhet një salcë me perime për makarona. Radhitni imazhet.

- Presim hudhrat dhe qepët dhe i hedhim në tigan.
- Presim perimet.
- I hedhim në tigan.
- I përziejmë në zjarr për 10 minuta.



## 10. Unë përgatis vetë tryezën. Shkruani çfarë vë përpara, majtas dhe djathtas.

---

---

---


---

---


---

---

---



## 11. Gjeni fjalët për çdo send.



**Rekomandim didaktik 4:** Ky mund të kthehet në një "konkurs interesant shpejtësie, ku mësuesi sjell të gjitha "takëmet" e tavolinës për dy personat dhe nxënësit konkurrojnë kush e shtron tavolinën më shpejt, duke folur dhe duke përshkruar çfarë po bëjnë. Një formë tjetër mund të jetë që përsëri shtrohet tavolina, por njëri nxënës flet dhe i tregon shokut çfarë të bëjë dhe shoku vepron sipas udhëzimeve të tij. Përsëri, këto veprimtari didaktike ndihmojnë në krijimin e imazheve në tru, por nën trysinë e elementit të lojës, gjë që e bën veprimtarinë edhe më interesante. Nxënësit mund të praktikojnë fjalët e reja dhe përmes krijimit të situatave të ndryshme, p.sh.: një dialog në një restorant mes klientëve dhe kamerierit.



**Koha e ardhme e mënyrës dëftore dhe koha e tashme e mënyrës lidhore e foljeve:**  
*gatuaj, ziej, shtoj, pjek, marr; vë, ha.*

unë	të gatuaj	të ziej	të shtoj	do të gatuaj	do të ziej	do të shtoj
ti	të gatuash	të ziesh	të shtosh	do të gatuash	do të ziesh	do të shtosh
ai, ajo	të gatuajë	të ziejë	të shtojë	do të gatuajë	do të ziejë	do të shtojë
ne	të gatuajmë	të ziejmë	të shtojmë	do të gatuajmë	do të ziejmë	do të shtojmë
ju	të gatuani	të zieni	të shtoni	do të gatuani	do të zieni	do të shtoni
ata, ato	të gatuajnë	të ziejnë	të shtojnë	do të gatuajnë	do të ziejnë	do të shtojnë

unë	të pjek	të marr	do të pjek	do të marr
ti	të pjekësh	të marrësh	do të pjekësh	do të marrësh
ai, ajo	të pjekë	të marrë	do të pjekë	do të marrë
ne	të pjekim	të marrim	do të pjekim	do të marrim
ju	të piqni	të merrni	do të piqni	do të merrni
ata, ato	të pjekin	të marrin	do të pjekin	do të marrin

unë	të ha	të vë	do të ha	do të vë
ti	të hash	të vësh	do të hash	do të vësh
ai, ajo	të hajë	të vërë	do të hajë	do të vërë
ne	të hamë	të vëmë	do të hamë	do të vëmë
ju	të hani	të vini	do të hani	do të vini
ata, ato	të hanë	të vënë	do të hanë	do të vënë

**12. Zgjidhni një folje që mbaron me -j (si: punoj), një folje që mbaron me bashkëtingëllore (si: marr) dhe një që mbaron me zanore (si: ha) dhe plotësoni tabelën.**

	Koha e tashme e mënyrës lidhore			Koha e ardhme e mënyrës dëftore		
<b>unë</b>						
<b>ti</b>						
<b>ai, ajo</b>						
<b>ne</b>						
<b>ju</b>						
<b>ata, ato</b>						

### 13. Vendosni fjalitë në formën e duhur.

Ne mund (mësoj) \_\_\_\_\_ shqip shpejt.  
Ata duhet (gatuaj) \_\_\_\_\_ sot në drekë.  
Nesër ai (marr) \_\_\_\_\_ një biçikletë.  
Ti mund (vë) \_\_\_\_\_ tryezën e punës majtas dritares.  
A (ha) \_\_\_\_\_ makarona ju?  
Elës i pëlqen (vizatoj) \_\_\_\_\_.  
Ti duhet (pi) \_\_\_\_\_ më shumë ujë.  
Pas një ore (shkoj) \_\_\_\_\_ në universitet.

#### ➤ Shkallët e mbiemrit

Shkalla pohore	Shkalla krahasore	Shkalla sipërore
i mirë	më i mirë (se)	shumë i mirë
i vogël	më i vogël (se)	shumë i vogël
i shijshëm	më i shijshëm (se)	shumë i shijshëm
	më i mirë (se)	shumë i mirë

### 14. Ktheni mbiemrat në shkallën krahasore dhe lidhini fjalët në fjali. Rishkruajini fjalitë, duke i kthyer mbiemrat në shkallën sipërore.

<i>peshku</i>	<i>i shijshëm</i>	<i>mishi</i>	<i>Peshku ishte më i shijshëm se mishi.</i>
kjo pikturë	e famshme	ai akuaarel	
dimri	i ftohtë	vera	
molla	e ëmbël	portokalli	
libri	interesant	loja	
<i>Peshku ishte shumë i shijshëm. / Peshku dhe mishi janë shumë të shijshëm.</i>			

**Rekomandim didaktik 5:** Mësuesi bën kujdes që ushtrimet gramatikore të mos bëhen barrë për nxënësit, por ata të ushtrohen në praktikë, prandaj në këtë fazë të mësimin të gjuhës nxënësit duhet vetëm të prezantohen me kohët e foljeve ose me shkallët e mbiemrave në mënyrë pragmatike, pa shpjegime teorike.





## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *A e dini se...*

*Bujqësia ishte shumë e zhvilluar në antikitet. Më 478 p.e.s. Herodoti, tregonte se rrotull Apalonisë kishte toka pjellore dhe ato zotëroheshin nga aristokracia vendase. Straboni shkroi për ullishtat dhe vreshtat e vendit.*

*Autorët antikë kanë shkruar se ishte e zhvilluar edhe blegtonia. Në zonat e Dardanisë bëhej edhe djathë "caseus dardanicus".*

*Në qytetet bregdetare ishte i zhvilluar peshkimi. Straboni shkruan se liqeni i Ohrit ishte vend ideal për tharjen e peshkut.*



**PROJEKT: Bëni listën e ushqimeve që duhet të blini dhe përfshini në të:**

1. diçka me kripë,
2. diçka të ëmbël,
3. mish ose peshk,
4. perime,
5. fruta,
6. bulmet.

### FJALË TË URTA

*Gjella me kripë, kripa me karar.*

**Shkëmbejeni listën tuaj me të shokut. Keni 10 minuta kohë për të gjetur një recetë gatimi. Në fund votoni gatimin më të mirë.**

**Rekomandim didaktik 6:** Ky projekt mund të kthehet në një veprimtari shumë interesante ku nxënësit të shkojnë vërtet në treg me prindërit dhe të blejnë: diçka me kripë, diçka të ëmbël, mish ose peshk, perime, fruta, bulmet. Ky aktivitet mund të regjistrohet p.sh.: në celular teksa fëmija përshkruan veprimet e tij: Tani bleva gjalpë, gjalpi është bulmet etj. Kjo veprimtari e regjistruar në kamera, të transmetohet në klasë ose në ekran nëse mësimi bëhet online. Nëse keni dyqane shqiptare në zonën ku banoni, ky aktivitet mund të zhvillohet në një dyqan shqiptar, ku nxënësit mund të bashkëbisedojnë me shitësit.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
byrek	amerikan	bashkoj
dardhë	djathtas	byrek
djathë	dritare	gati
domate	dua	gatime
fruta	gjerman	kos
gjalpë	gjyshe	majonezë
gjellë	italian	mustardë
gotë	majtas	oriz
kripë	marr	pashaqofte
limon	e mirë	patëllxhan
lugë	pëlqej	petulla
luleshtrydhe	përballë	porosit
miell	përpara	selino
mjaltë	prapa	spec
mollë	spanjoll	spinaq
patate	shumë	e shijshme
pecetë	shkoj	shtoj
perime	tryezë	telefonoj
petulla		vaj
pirun		zgjedh
pjatë		ziej
pjeshkë		
porosis		
qershi		
salcë		
sheqer		
tenxhere		
tigan		
thikë		
vezë		

**Rekomandim didaktik 7:** Puna me fjalorin vazhdon të mbetet momenti i vlerësimit të dijeve. Nëpërmjet inventarit të fjalëve apo shprehjeve të përvetësuara në këtë mësim, si nxënësi, ashtu edhe mësuesi shohin nivelin e dijeve dhe parandalojnë boshllëqet e mundshme që mund të krijohen nga nxënës të ndryshëm.

# MËSIMI 12

*Kujdesi për shëndetin  
Shkoj te mjeku. Shkoj te dentisti.*

## **Qëllimet mësimore:**

- a) Kujdesi për shëndetin
- b) Shkoj te mjeku.
- c) Shkoj te dentisti
- d) Gramatikë: koha e tashme, forma joveprore e mënyrës dëftore; përdorimi i disa trajtave të shkurtra të përemrit vetor.
- e) Punë e diferencuar: “Mjekja e parë shqiptare e diplomuar në SHBA”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN**      *Një botë për të gjithë*  
*Qytetërim shqiptar Të ndryshëm dhe të njëjtë Profesionet*


- **LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË:** Mësimi 12 ka si fokus mësimin e fjalorit që lidhet me shëndetin, vizitat tek mjeku apo dentisti. Në fund të këtij mësimi, nxënësi do të jetë në gjendje të kuptojë dhe të komunikojë për aspekte të thjeshta që lidhen me shëndetin.
- **SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI:** Në këtë bashkëbisedim mes mësueses dhe fëmijëve, nxënësit prezantohen me rregullat për një shëndet të mirë. Gjithashtu, ata shohin edhe dokumentarin interesant “Heronjtë e Shëndetit” të dubluar në gjuhën shqipe dhe pastaj u përgjigjen pyetjeve për përmbajtjen e dokumentarit. Kjo e kthen mësimin 12 në një përvojë interesante për fëmijët.
- **GRAMATIKË:** Koha e tashme dhe koha e kryer e mënyrës dëftore, forma joveprore; emër dhe mbiemër; përdorimi i disa trajtave të shkurtra të përemrit vetor.
- **NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Nxënësit dëgjojnë/mësojnë këngën “Elefanti tek dentisti” dhe këtu mësuesi/ja u flet edhe për Festivalin e Fëmijëve në Shkodër që bëhet çdo vit më 1 qershor. Një traditë e bukur për të festuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Gjithashtu, flitet edhe për vajzën e parë shqiptare që mbaroi studimet për mjekësi në Boston në vitin 1929, Dhimitra Tsina.
- **FJALORI:** i/e sëmurë, mjek/doktor, mjeke/ doktoreshë, infermier/e, dentist, farmacist, dhimbje koke, dhimbje barku, dhimbje dhëmbi, vras gjurin, djegie gryke, sëmundje, ilaçe/barna, gjilpërë, leukoplast, termometër, mikrob, sapun, helmohem, ftohem, kollitem, digjem, rrufë, temperaturë, dhëmb, dhëmballë, pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



*Mësuese Teuta:* Mirëmëngjesi! Më vjen keq, por sot nuk është Dardani. Ai është ftohur dhe nuk mund të vijë. Le të flasim për **shëndetin**, sëmundjet dhe vizitën te doktori ose te dentisti.



i/e sëmurë



mjek/doktor  
doktoreshë



mjeke/



infermiere



dentist



farmaciste



vras



djegie



sëmundje koke



barku



dhëmbi gjurin



gryke



ilace/barna




gjilpërë



leukoplast



termometër



mikrobe



sapun



helmohem



ftohem



kollitem



digjem



rrufë



temperaturë



dhëmb



dhëmballë



pastë dhëmbësh



furçë dhëmbësh

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Njohja e fjalëve të shkurtra dhe me frekuencë të lartë përdorimi luan një rol të rëndësishëm në të mësuarit e gjuhës shqipe. Megjithëse kjo njohje e fjalëve të thjeshta, njërrrokëshe nuk mund të zëvendësojë mësimin e fjalëve të panjohura në një tekst, njohja e disa fjalëve në mënyrë automatike ose në pamjen e parë, kontribuon në të kuptuarit pa mundim të fjalëve të thjeshta në Nivelet A1 dhe A2, sipas Kornizës Europiane të Gjuhëve. Dy gjuhëtarët dhe didaktët amerikanë Dolch dhe Fry pas një analize të kujdesshme dhe gjykimi profesional, krijuan dy lista me fjalët më të zakonshme, të njohura si “Fjalët e Çastit”. Lista “Dolch” përfshin lidhëzat, parafjalët, përemrat, ndajfoljet, mbiemrat dhe foljet, gjithsej 220 fjalë. Ai u referohej këtyre fjalëve si fjalë “mjet shërbimi”, sepse ato përdoren në të gjitha komunikimet, pavarësisht nga tema. Kurse lista “Fry” përfshin 1000 fjalë me frekuencë të lartë të ndara në 10 grupe. Këto fjalë quhen “Fjalët e çastit”, sepse nxënësi është në gjendje t’i identifikojë sapo i sheh. Mësimi i fjalëve të çastit u mundëson nxënësve që t’i përdorin këto fjalë me lehtësi. Cilat janë fjalët e çastit? 100 FJALËT ME FREKUENCË MË TË MADHE NË GJUHËN SHQIPE: të, e, dhe, atë, në, është, ti, se, ajo, ai, ishte, për, në, janë, si, me, e tij, ata, unë, në, të jetë, kjo, kanë, nga, ose, një, kishte, nga, fjalët, por, jo, çfarë, të gjitha, ishin, në, kur, tuajat, mundet, tha, atje, përdorim, një, secili, të cilat, ajo, bëj, si, e tyre, nëse, dua, lart, të tjera, rreth, jashtë, shumë, atëherë, ata, këto, prandaj, disa, asaj, do të, bëj, si, atij, në, koha, ka, shikoj, dy, tre, katër, më shumë, shkruaj, shko, shiko, numri, jo, mënyrë, mundet, njerëzit, imja, sesa, së pari, ujë, ka qenë, i thirrur, kush, vaji, rri, tani, gjej, e gjatë, poshtë, ditë, bëri, marr, eja, i bërë, mund, pjesë etj.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOKJMË

*Vesa:* Mësuese, unë kam parë një film të shkurtër për shëndetin. Filmi titullohet “Heronjtë e shëndetit”. A mund ta shohim tani?



<https://www.youtube.com/watch?v=s2GMXJ8-my4>



### 1. Shikoni filmin dhe përgjigjuni pyetjeve.

- Pse ishte në spital mamaja e Herrit?
- Kush po bën makarona?
- Çfarë i thotë gjithëjja Herrit të bëjë në fillim?
- Çfarë i tregon Zana e shëndetit Tedit?
- Çfarë bëjnë mikrobet kur hyjnë në trupin tonë?
- Si mund t'i ndalojmë mikrobet?
- Kur duhet të përdorim dezinfektues?

## Te doktori

*Dardani:* Mirëdita, doktor!

*Doktori:* Mirëdita! Kush jeni ju?

*Dardani:* Unë jam Albani. A jeni ju doktor Davidi?

*Doktori:* Po, unë jam. Çfarë problemi keni?

*Dardani:* Unë kam dhimbje koke dhe kollitem.

*Doktori:* A keni edhe temperaturë?

*Dardani:* Po, e kam temperaturën 37 e gjysmë.

*Doktori:* Mos u shqetësoni. Besoj se jeni ftohur pak. Këto ditë rri në krevat, hani supë e pini **çaj** me limon. Hani fruta dhe perime: mollë, portokaj, spinaq, speca, domate etj. Merrni në **farmaci** këto barna. Duhet t'i pini çdo 8 orë pas buke.

**Rekomandim didaktik 1:** Përdorimi i skedave/kartave indeks apo flash (copa të vogla kartoni ku shkruhen fjalët apo informacioni) është një mënyrë shumë e sigurt për të mësuar çdo fjalë, në veçanti “fjalët e çastit”. Kartat flash janë skeda të vogla shënimesh të përdorura për testimin dhe përmirësimin e kujtesës përmes praktikimit të informacionit. Ato përdoren zakonisht në të dyja anët, me fjalën e shkruar në njërin anë dhe me shpjegimin apo shembullin për fjalën në anën tjetër. Skedat mund të përfshijnë emra, fjalor, koncepte ose fjalë të çastit. Për shembull, në njërin anë të skedës mund të shkruhet: “uji”, kurse në tjetrën: “një lëng pa ngjyrë që vjen nga lumi dhe pihet”. Skedat përfaqësojnë një kategori informacioni që përpigemi të mbajmë mend, ta mësojmë dhe zotërojmë në një mësim apo temë të caktuar.

## 2. Rilexoni dialogët dhe përcaktoni nëse fjalitë janë të sakta: V (e vërtetë), G (e gabuar).

V G

Doktori quhet David.

Albanit i djeg gryka.

Albanit i dhemb edhe barku.

Doktori nuk e viziton.

Doktori i thotë që ka grip.

Albani duhet të rrijë në shtëpi.

Albani duhet të pijë katër barna në ditë.

Ai duhet të shkojë në farmaci.



### 3. Bëni një dialog me shokun, duke përdorur pyetje të ndryshme përfshirë edhe këto të mëposhtmet.

Si je?

Çfarë të dhemb?

A ke kollë?

A të djeg gryka?

Ke pirë ilaçe?

Mund të shkosh në farmaci?

### 4. Shikoni imazhin dhe tregoni çfarë ka djali.



### Te dentisti

*Lendita:* Mirëdita, doktor!

*Dentisti:* Mirëdita. Çfarë keni?

*Lendita:* Kam dhimbje dhëmballe.

*Dentisti:* Le të shohim. Hape gojën. Ke dhimbje pa pushim?

*Lendita:* Dje më pak, por sot pa pushim.

*Dentisti:* Ke pirë barna?

*Lendita:* Jo, nuk kam pirë.

*Dentisti:* Cila të dhemb?

*Lendita:* Dhëmballa e dytë majtas.

*Doctor:* Është prishur pak, por do ta rregullojmë.

*Lendita:* Tani? Shumë faleminderit!

*Dentisti:* Duhet t'i lash dhëmbët me furçë dhe pastë dhëmbësh pasi ha.

*Lendita:* Po, do të kem kujdes.



## 5. Përgjigjuni pyetjeve.

Ku shkon Lendita?

Pse shkon?

Sa ditë ka Lendita me dhimbje?

Ka pirë barna Lendita?

A do t'ia rregullojë dhëmballën dentisti?

**Rekomandim didaktik 2:** Me ushtrimin e mësipërm, mësuesi mund të praktikojë fjalorin që kanë mësuar nxënësit. Ai mund të përgatitë skeda me fjalët e personazheve të ndryshme. Nxënësit do t'i praktikojnë fjalitë, sipas rolit të tyre (dentist, pacient etj.) dhe pastaj mund të vënë në skenë secilin dialog të këtij mësimi.



## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

## 6. Lidhni pyetjet me përgjigjet dhe shënoni numrat sipas radhës.

Çfarë keni?

Po.

Keni temperaturë?

Në farmaci

Çfarë kam?

Për katër ditë.

A duhet të marr barna?

Jo, nuk kam.

Për sa ditë?

Më djeg gryka dhe më dhemb trupi.

Ku t'ia marr barnat?

Jeni ftohur.

## 7. Korigjoni gabimet, duke u bazuar te dialogu “Te dentisti”.

Lendita është te dentisti, sepse i dhemb dhëmbi i parë majtas.

Lendita ka pirë barna dhe dhimbja nuk i pushon.

Dentisti mendon se dhëmbi nuk është prishur.

Dentisti do ta vizitojë nesër.


Ai i thotë Lenditës t'ia lajë dhëmbët çdo javë me furçë dhe pastë dhëmbësh.

**Rekomandim didaktik 3:** Ky ushtrim mund të kthehet në një veprimtari didaktike shumë interesante, nëse mësuesi përgatit skeda: në një grup skedash vendos pyetjet dhe në një grup tjetër vendos përgjigjet. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në mënyra të ndryshme:

a) Nxënësit vendosen në çifte dhe duke punuar bashkë përshtatin pyetjen me përgjigjen e duhur.


b) Klasa mund të ndahet në dy skuadra ku njëra skuadër bën pyetjet dhe tjetra jep përgjigjen e duhur.

**8. Plotësoni skemën dhe formoni fjali, p.sh.: “dhimbje trupi” Më dhemb trupi/ Kam dhimbje trupi.**



**Rekomandim didaktik 4:** Mësuesi mund të japë udhëzime për plotësimin e fjalëkryqit në skeda dhe t’i vendosë nxënësit për të punuar në çifte. Njëri nxënës lexon udhëzimet dhe tjetri plotëson fjalëkryqin. Një veprimtari e tillë didaktike i ndihmon nxënësit të bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin për të zgjidhur fjalëkryqin, por njëkohësisht si pa kuptuar, edhe të përsërisin fjalorin e ri ose fjalët e çastit, sipas objektivit gjuhësor që vendos mësuesi për këtë orë mësimi.

**9. Plotësoni fjalëkryqin.**



**HORIZONTALISHT**

- 3. AJO QË NA SHET BARNAT
- 5. NA RREGULLON DHËMBËT

**VERTIKALISHT**

- 1. KUR QËNDRON GJATË NË DIELL
- 2. MAT TEMPERATURËN
- 4. I PI KUR JAM SËMURË

10. Përshkruani çdo foto me një fjali.



---



---



---



---



---



GRAMATIKË

Koha e tashme dhe koha e kryer e mënyrës dëftore, forma joveprore

*Kush e shqetëson vajzën? Unë shqetësohem për vajzën time.*

Veta	E tashme, veprorë	E tashme, joveprorë
unë	shqetësoj	shqetësohem
ti	shqetëson	shqetësohesh
ai, ajo	shqetëson	shqetësohet
ne	shqetësojmë	shqetësohemi
ju	shqetësoni	shqetësoheni
ata, ato	shqetësojnë	shqetësohen

**11. Zgjedhoni foljen *mësoj* në kohën e tashme, forma veprorë dhe joveprorë. Plotësoni tabelën dhe formoni dy fjali me secilën formë.**

Veta	E tashme, veprorë	E tashme, joveprorë
unë	mësoj	mësohem
ti		
ai, ajo		
ne		
ju		
ata, ato		

1 \_\_\_\_\_  
 2 \_\_\_\_\_

**Rekomandim didaktik 5:** Mësuesi si gjithmonë fokusohet në përdorimin praktik të foljeve në kohën e tashme dhe të kryer duke kaluar nga e njohura tek e panjohura, apo nga e thjeshta tek më e ndërlikuara. Kjo arrihet duke modeluar, së pari, me zgjedhimin e foljes “shqetësoj” dhe pastaj duke bërë të njëjtën gjë me foljen “mësoj”. Pas kësaj, ushtrimi 12 u jep mundësinë nxënësve për të zgjedhur në praktikë formën e duhur të foljes për të plotësuar fjalitë. Edhe në këtë rast, mësuesi mund të përdorë me sukses skedat duke vënë në një grup skedash përemrat vetorë, dhe në grupin tjetër format e ndryshme të foljeve dhe pastaj t’u kërkojë nxënësve të vendosin pranë njëra-tjetrës kartat e përemrave vetorë dhe foljeve, sipas përputhjes së tyre në vetë dhe numër.

**12. Vini foljet në formën e duhur.**

Unë po (mësoj) \_\_\_\_\_ me shkollën e re.  
 Ne po (mësoj) \_\_\_\_\_ një këngë të re.  
 Ai nuk e (dëgjoj) \_\_\_\_\_ çfarë po thua.  
 Zëri i mësueses nuk (dëgjoj) \_\_\_\_\_ mirë.  
 Era, pse (shqetësoj) \_\_\_\_\_ ?  
 Mua më (shqetësoj) \_\_\_\_\_ dëbora në rrugë.

### **Përdorimi i disa trajtave të shkurtra të përemrit vetor.**

Më dhemb gryka.

Të dhemb gryka.

I dhemb gryka.

Na dhemb gryka.

Ju dhemb gryka.

U dhemb gryka.

Më pëlqen muzika.

Të pëlqen muzika.

I pëlqen muzika.

Na pëlqen muzika.

Ju pëlqen muzika.

U pëlqen muzika.

### **13. Plotësoni vendet bosh me të gjitha vetat.**

\_\_\_ djeg dora.

\_\_\_ djeg dora.

\_\_\_ djeg dora.

\_\_\_ djeg dora.

\_\_\_ djeg dora.

\_\_\_ djeg dora.

### **14. Plotësoni fjalitë me formën e duhur të fjalës së dhënë.**

(unë) \_\_\_ më djeg dora. (ajo) \_\_\_ i dhemb dhëmballa. (ju) \_\_\_ lexoi mësuesja një vjershë. (ne) \_\_\_ vjen keq. (ata) \_\_\_ pëlqen të lexojnë. (ti) \_\_\_ dëgjoj mirë, kurse Anën jo.

**Rekomandim didaktik 6:** Me shumë kujdes, mësuesi/ja mund të përgatisë disa skeda. Në një grup skedash shkruan përemrat vetorë, dhe në grupin tjetër vendos trajtat e shkurtra. Nxënësit vendosen në çifte dhe diskutojnë se cilën formë të përemrit duhet të përdorin në secilën situatë konkrete që do t'i lexojnë njëri-tjetrit. Këtu gjithë "sekreti" i mësuesit është të krijojë situata ku nxënësit përfshihen në veprimtari ndërvepruese.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË

Dëgjoni dhe përpiquni ta këndoni së bashku këngën “Elefanti te dentisti”.

<https://www.youtube.com/watch?v=N4ibJXydmAQ>



### *A e dini se...*

*Dhimitra Tsina ishte vajza e parë shqiptare që u diplomua në Amerikë. Aja i përfundoi studimet për mjekësi me rezultate të shkëlqyera, në Universitetin e Bostonit, më 1929.*

*Njoftimin e dha gazeta “Dielli”, organ i Federatës Panshqiptare të Amerikës “VATRA”, në qershor të vitit 1929. Diplomimi në mjekësi i vajzës së parës shqiptare në SHBA ishte një ngjarje e rëndësishme për vajzat shqiptare. “Dielli” shënon se ajo ishte vajza e parë shqiptare në botë që bëhej mjekë.*



**PROJEKT:** Pyesni gjyshet tuaja për bimët mjekësore që përdorin ato. Bëni një prezantim në klasë me rezultatet e kërkimeve.

### FJALË TË URTA

*Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku.*

**Rekomandim didaktik 7:** Trevat shqiptare janë shumë të pasura me bimë të ndryshme mjekësore, si: sherbelë, çaj mali, kamomil, boronicë etj. Mësuesi mund të organizojë një projekt ku nxënësit të gjejnë këto bimë mjekësore dhe të hulumtojnë për përdorimin e tyre. Pastaj ata mund të krijojnë një poster me fotot dhe informacionin dhe të hapin një ekspozitë si klasë. Çdo nxënës do të prezantojë gjetjet e tij për bimët mjekësore.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
barna	bark	dezinfektues
bark	bëj	gjilpërë
çaj	domate	leukoplast
dentist	dhëmb	laj
dhëmb	film	mjek
dhëmballë	fruta	pasi
dhëmb	ha	rregulloj
dhimbje	kokë	sapun
digjem	laj	
djegje gryke	mama	
doktor	majtas	
farmaci	mollë	
farmacist	perime	
ftohem	pi	
furçë dhëmbësh	portokall	
gju	pushim	
helmohem	specë	
i sëmurë	spinaq	
ilaç	supë	
infermiere	trup	
kollitem		
mikrobe		
pastë		
rrufë		
sëmundje		
shëndet		
temperaturë		
termometër		
vras		

**Rekomandim didaktik 8:** Së fundi, mësuesi së bashku me nxënësit bëjnë bilancin e punës së tyre, duke bërë një inventar të fjalorit të mësuar. Kjo mund të arrihet shumë bukur duke përdorur teknologjinë, si p.sh.: programin *Quizlet.com*. Në këtë program mësuesi shkruan fjalë, jep përkufizimin dhe zgjedh një foto për të ilustruar fjalën, ndërsa vetë programi krijon skedat ku nxënësi mund të kontrollojë njohuritë e tij në përvetësimin e fjalorit të këtij mësimi.



# MËSIMI 13

## *Sënduku i gjyshes (histori të vjetra)* *Dollapi im i rrobave*

### **Qëllimet mësimore:**

- a) Sënduku u gjyshes (histori të vjetra).**
- b) Dollapi im i rrobave.**
- c) Gramatikë: përemra pronorë.**
- d) Punë e diferencuar: Studio “Marubi”.**

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Mësimi, puna, loja...*

*Të ndryshëm dhe të njëjtë Profesionet Koha e lirë*

- **LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË:** Mësimi 13 vjen si një fllad i këndshëm me histori të vjetra që gjyshet dhe gjyshërit u tregojnë fëmijëve, si dhe me një fjalor të bollshëm për rrobat që përdorin nxënësit. Në këtë mësim interesant, mësuesi mund të shfrytëzojë aspektin emocional (dashuria për gjyshen) dhe të krijojë interes të vetë nxënësit (për veshjet, rrobat) për të arritur objektivin e madh – nevojën për mësimin e gjuhës shqipe.
- **SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI**
- **GRAMATIKË:** Fokusi gramatikor janë ndajfoljet e mënyrës, të kohës, ndajfoljet pyetëse dhe përemrat pronorë.
- **NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Informacioni shumë interesant për fototekën “Marubi” do ta ndihmojë mësuesin/mësuesen të “sjellë” virtualisht Shqipërinë në klasën e tij/saj nëpërmjet fotove të personaliteteve më të shquara shqiptare të fotografuara nga Pietro, Kel dhe Gegë Marubi që në vitin 1856, vetëm 17 vjet pasi francezi Louis Daguerre bëri fotografinë e parë me kamera.
- **FJALORI:** afrohem, atlete, bluzë (me mëngë të gjata), bluzë (me mëngë të shkurtra) këmishë, çantë, çizme, çorape, doreza, e mbështjellë, fije ari, fund, fustan, golf, i qepur, kanotiere, kapele, kapuç, këpucë, kostum, nxjerr, pallto, pantallona, pantofla, peshqir, qëndis, rroba banje, shall, syze dielli, xhaketë, xhinse, xhup.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Mënyra më e suksesshme për mësimin e një gjuhe të huaj është kur mësimdhënia mbështetet tek potenciali i të gjithë trurit dhe jo vetëm i kujtesës së nxënësit. Kjo do të thotë që mësuesi duhet të aktivizojë çdo vatër të trurit dhe të lidhë informacionin e secilës vatër për të krijuar “dendritet”, rrjetin lidhës të dijes në tru. Përpunimi i të gjithë informacionit të depozituar në trurin e nxënësit është domosdoshmëri në mësimdhënie. Truri vepron më shumë si një sitë sesa si një sfungjer gjatë përpunimit të informacionit të ri. Nxënësit që mund të kryejnë një detyrë të re mësimore mirë, duke e lidhur atë me përvoja të mëparshme, me mjete pamore, muzikë etj., ka të ngjarë ta ruajnë atë informacion në kujtesën afatgjatë. Rishikimi i materialit të ri gjuhësor para mësimin është një gjë e mirë dhe tregues se sa është mbajtur informacioni në kujtesën afatgjatë. Rritja e kohës së vëmendjes për një detyrë rrit mbajtjen më gjatë të fjalëve të reja në tru. Shkalla me të cilën një nxënës mban informacionin në kujtesën afatgjatë nuk është e lidhur ngushtë me inteligjencën e nxënësit, por me aftësinë e mësuesit për të angazhuar gjithë vatrat e nxënies në tru dhe jo vetëm kujtesën.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



*Mësuese Teuta:* Mirëmëngjesi, të dashur fëmijë! Sot është ftohtë. Ju jeni veshur shumë bukur, por jeni veshur trashë. Kur është ngrohtë, ne vishemi lehtë.

*Le të flasim sot për veshjet tona dhe dollapin e veshjeve.*



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



xhup



pallto



shall



kapuç



doreza



këpucë



çizme



golf



triko



këmishë



xhaketë



xhinse



pantallona



fustan



fund



bluzë



atlete



çorape



kanotiere



syze dielli



kapelë



rroba banje



pantofla



peshqir



çantë

*Vesa:* Unë kam lexuar një tregim të bukur që e ka shkruar Adelina Mamaqi.

U afrova te sënduku. Atje ishin **thesaret** e disa brezave të familjes sonë. Gjyshja i merrte një nga një dhe më tregonte se i kujt ishte një bllok shënimesh, një tufë lulësh të thara apo kush ishte në fotografi. M’i tregonte dhe i vinte mbi krevatin e saj me shumë kujdes.

Pasi i nxori të gjitha, në fund të sëndukut ishte edhe diçka e mbështjellë me të bardhë.

– Ja, këtë kërkoja! – foli gjyshja dhe më shikoi me buzëqeshje.

– Hape! E kam ruajtur për ty.

U emocionova. Ç’ të shihja! Ishte një **kostum** i vogël popullor i kuq, **i qëndisur** me **fije ari**. Ishte vërtet një thesar.

– Provoje, – tha gjyshja. E kam ruajtur për ty...

Këtë kostum ia kishte qepur gjyshja, gjyshes sime, në ditën e ngritjen së Flamurit, më 28 Nëntor 1912. Ajo ishte 10 vjeç.

... Dëgjo, zemra e gjyshes, kjo është dhurata më e çmuar. Ruaje si sytë e ballit. Ky kostum dhe ky flamur mbeten brez pas brezi, ashtu si liria.

*(sipas Adelina Mamaqit)*

**Rekomandim didaktik 1:** Çdo fëmijë në diasporë ka parë kostume kombëtare nga krahina të ndryshme dhe është mahnitur jo vetëm me bukurinë e tyre, por edhe me shumëllojshmërinë për një vend të vogël si Shqipëria. Mësuesi në këtë moment ka rastin të evokojë këto kujtesa dhe emocione të fëmijëve nga përvojat e mëparshme (koncerte, filma, dasma, festa e flamurit, festa e Kosovës etj.) për të lidhur në trurin e nxënësve objektet që kanë parë me emërtimin e tyre në fjalorin e këtij mësimi. Tregimi shumë interesant nga Adelina Mamaqi është sa emocional, aq edhe i thjeshtë për t’u kuptuar. Mësuesi mund t’i ndajë nxënësit në grupe, ku njëri grup bën pyetjet dhe tjetri përgjigjet dhe pastaj ndërrojnë rolet. Njëkohësisht, nxënësit inkurajohen që të ndajnë edhe përvojat e tyre personale në momente të ndryshme kur kanë veshur apo kanë parë bukurinë e kostumeve tona kombëtare. Kjo lidhje me përvojat personale e ndihmon nxënësin të “lidhë” vatrat e të nxënit në trurin e tij dhe e kalon informacionin e ri gjuhësor në kujtesën afatgjatë.



## 1. Përgjigjuni pyetjeve.

I kujt është sënduku?  
Çfarë ka në sënduk?  
Çfarë është mbështjellë me të bardhë?  
Çfarë ngjyre ka kostumi i gjyshes?  
Kur e ka veshur gjyshja kostumin?

## 2. Plotësoni pyetjet ose përgjigjet.

*Dardani:* Vesa, a e ke ti një fustan si ai?

*Vesa:* \_\_\_\_\_.

*Vesa:* Po ti, Dardan, \_\_\_\_\_?

*Dardani:* \_\_\_\_\_ kam lahutën e gjyshit.

*Egini:* Redona, \_\_\_\_\_?

*Redona:* Po, kemi disa kujtime. Mua \_\_\_\_\_ pëlqejnë shumë disa lugë dhe një krehër antik.

*Egini:* I përdorni ju lugët?

*Redona:* Jo, \_\_\_\_\_, mami i ka në dollap. Po ti Egin çfarë ke?

*Egini:* Unë kam kostumin popullor të Dibrës. Gjyshi im ishte nga \_\_\_\_\_.

**Rekomandim didaktik 2:** Nxënësve u jepet kohë të plotësojnë ushtrimin dhe pastaj të lëvizin nëpër klasë dhe flasin me shokët për të parë nëse plotësimet e tyre janë të sakta. Në këtë mënyrë mësuesi e ndihmon nxënësin të jetë i qetë, sepse po “zbulon” vetë saktësinë e përgjigjeve. Gjithashtu, edhe në rastet kur mund të ketë përgjigje të gabuar, ai nuk ndihet i turpëruar, sepse e korrigjon vetë ose është shoku që ia jep përgjigjen e saktë, jo mësuesi. Nxënësi që jep përgjigjen e saktë ndihet mirë nga ana emocionale, sepse ndihmoi shokun dhe të dy bashkë mund të punojnë edhe për ta pasuruar dialogun e mësipërm. Kjo ndjenjë pozitive bashkëpunimi është e domosdoshme në situatat kur mësohet një gjuhë e huaj. Pas “ndërtimit” të këtyre marrëdhënieve shoqërore, mësuesi mund t’i bashkojë edhe nxënësit që nuk e njohin njëri-tjetri, apo ata që janë të ndrojtur dhe t’i ndihmojë të vënë në skenë dialogun e mësipërm.

3. Gjeni tre emra që mund të lidhen me këta mbiemra.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ i qëndisur

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ i bardhë

\_\_\_\_\_

4. Lexoni tekstet, ngjyrosni figurat dhe gjeni 3 veshje të tjera me ato ngjyra në figurë.

1

Unë kam vënë kapele të gjelbër.



2

Çfarë ka veshur Egini?



Ka veshur xhinse, këmishë të verdhë dhe ka vënë kapelë.

3

Çfarë ka vënë Redona?



Ka vënë një kapelë lejla.

a



b



c







## 5. Diskutoni për stinën dhe veshjet e fëmijëve.



*Redona:* Kjo është një  
fotografi e motrës sime.

*Vesa:* Kjo është një fotografi  
e vëllait tim.



## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

### 6. Plotësoni vendet bosh.

Veshja që më pëlqen më shumë është \_\_\_\_\_.

Kur shkoj në një festë vesh \_\_\_\_\_.

Kur shkoj në shkollë vesh \_\_\_\_\_.

Në dimër kam ftohtë dhe vesh \_\_\_\_\_.


Në pranverë dhe vjeshtë vesh \_\_\_\_\_.

Në verë vesh \_\_\_\_\_.


Kur shkoj në plazh vesh \_\_\_\_\_.

## 7. Ngjyrosni dhe gjeni fjalën që mungon.

b = bojëkafe    g = jeshile    o = portokall  
 p = lejla        r = e kuqe    y = e verdhë



- 1 Ai ka veshur \_\_\_\_\_ portokalli .
- 2 Ai ka veshur \_\_\_\_\_ të verdhë.
- 3 Ai ka veshur \_\_\_\_\_ lejla.
- 4 Ai ka veshur \_\_\_\_\_ bojëkafe.
- 5 Ai ka veshur \_\_\_\_\_ jeshile.



## 8. Gjeni fjalën: këmishë, kapelë, syze, doreza, rroba banje, çorape.

I vini në duar. \_\_\_\_\_

I vishni në këmbë. \_\_\_\_\_

I vini në sy kur ka diell. \_\_\_\_\_

E vë në kokë. \_\_\_\_\_

E vesh poshtë xhaketës. \_\_\_\_\_

I vesh në pishinë. \_\_\_\_\_




9. Renditni e rrethoni shkronjat si duhet që të formojnë fjalë.

unfd  
fustan  
lfgo  
çizme  
elëkap  
ëpkucë


Ç	I	Z	M	E	Ë	K	M
C	G	K	A	U	S	K	Z
Z	O	F	U	N	D	Ë	S
J	L	U	V	J	Ç	P	Z
L	F	S	D	O	H	U	M
N	S	T	S	J	B	C	G
O	K	A	P	E	L	Ë	X
Ë	X	N	M	J	T	H	G


10. Vini numrat te secila figurë.



11. Plotësoni fjalitë, duke shkruar fjalën që emërton figurën.

U afrova te  \_\_\_\_\_.



Na i tregonte dhe i vinte mbi  \_\_\_\_\_ e saj me shumë kujdes.



Ishte një  \_\_\_\_\_ popullor i kuq, **i qëndisur me fije ari.**



Ishte vërtet një  \_\_\_\_\_.


Ky kostum dhe ky  \_\_\_\_\_ mbeten brez pas brezi, ashtu si liria.

12. Emërtoni për çdo foto stinën me të cilën lidhet dhe përshkruani veshjen.

a  

b  

c  



**Rekomandim didaktik 3:** Të gjitha ushtrimet e mësipërme japin shumë mundësi interesante për një komunikim mes nxënësve. Kjo mund të fillohet nga diskutimet për “modën” deri tek paraqitja figurative e dizenjove nga ndonjë “fashionisteje” që mund të ketë klasa. Gjithashtu, mësuesi mund t’u kërkojë nxënësve të sjellin artfakte të ndryshme nga vendlindja (çifteli, kukulla me kostume kombëtare etj.) dhe të përshkruajnë bukuritë e kostumeve apo veglave muzikore kombëtare; ku i kanë parë për herë të parë; emocionet nga ndonjë koncert apo festim në diasporë etj. Një veprimtari e tillë didaktike, jo vetëm përforcon lidhjen me vendin amë, por edhe shton krenarinë kombëtare. Në aspektin e mësimdhënies, evokimi i emocioneve apo kujtimeve dhe përvojave të mëparshme dhe lidhja e tyre me leksikun e temës konkrete, shton dendritet dhe siguron dërgimin e informacionit gjuhësor në kujtesën afatgjatë.

**Përemra pronorë**

shoku im	shokët e mi	shoqja ime	shoqet e mia
shoku yt	shokët e tu	shoqja jote	shoqet e tua
shoku i tij (ai) shoku i saj (ajo)	shokët e tyre	shoqja e tij (ai) shoqja e saj (ajo)	shoqet e tyre

dhëmbi im	dhëmbët e mi	shoqja ime	shoqet e mia
dhëmbi yt	dhëmbët e tu	shoqja jote	shoqet e tua
dhëmbi i tij (ai) dhëmbi i saj (ajo)	dhëmbët e tyre	shoqja e tij (ai) shoqja e saj (ajo)	shoqet e tyre

**13. Plotësoni tabelën me përemrin e duhur.**

dita ime	ditët e mia	libri im	librat e mi
adresa ime	adresat e mia	kompjuteri im	kompjuterët e mi
dorë	duart	syri	sytë
këmba	këmbët	krahu	krahët

**14. Plotësoni si në shembull:** *Unë jam në shtëpi. Shtëpia ime është e bukur.*

Ajo ka një kompjuter. Kompjuteri \_\_\_\_\_ është i ri.

Ju jeni në klasë. Klasa \_\_\_\_\_ është e madhe.

Ne do të vijmë me makinë. Makina \_\_\_\_\_ është gri.

Ai ka djegur krahun. Krahun \_\_\_\_\_ është skuqur.

Unë kam dhimbje dhëmbi. Dhëmbi \_\_\_\_\_ është prishur.

Ata shkuan te shokët. Shokët \_\_\_\_\_ jetojnë në bregdet.


Ti ke flokë të bukur. Flokët \_\_\_\_\_ janë të gjatë.

Ato duan të këndojnë disa këngë. Këngët \_\_\_\_\_ më pëlqejnë shumë.

**Rekomandim didaktik 4:** Mënyra se si janë ndërtuar ushtrimet gramatikore të mësipërme, i jep mundësi mësuesit që të japë informacionin gramatikor për ndajfoljet e mënyrës, të kohës dhe pyetëse, si dhe përemrat pronorë në mënyrë praktike pa i mbingarkuar nxënësit me shpjegime teorike për gramatikën e gjuhës shqipe. Këtu mësuesi mund të prezantojë vetë modelin e saktë gramatikor dhe pastaj të ftojë nxënësit të ndjekin.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### ***A e dini se...***

*Studio “Marubi” është e para studio e fotografisë në Shqipëri, në vitin 1856, nga italiani, Pietro Marubbi. Pas vdekjes së mjeshtrit Marubbi, studion e trashëgoi djali i birësuar i familjes Kodheli nga fshati i Zadrimës, Keli. Ai, më pas, do të thirrej nga njerëzit e qytetit si Keli i Marubit dhe kështu ai do të quhej përgjithmonë Kel Marubi, në nder të mjeshtrit të madh. Duke trashëguar studion dhe mbiemrin e mjeshtrit, në vitin 1907, Kel Marubi e quajti studio “Dritëshkroja Marubbi”.*

*Pas vdekjes së Kelit “Dritëshkroja Marubi” u drejtua nga djali i tij, Gegë Marubi, i cili kishte mbaruar studimet për fotografi në shkollën e parë të filmit dhe fotografisë së Vëllezërve Lumierë në Francë.*

*Mësoni më shumë: Marubi National Museum of Photography*

Disa fotografi historike nga studio “Marubi”:



Në këtë fotografi historike janë shkrimtarët e mëdhenj shqiptarë: Atë Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Asdreni dhe Lasgush Poradeci.

**FJALË TË URTA**

*Gjykon puna, s’gjykon guna.*

**Rekomandim didaktik 5:** Mësuesi mund të flasë për muzeun “Fototeka Marubi” dhe bashkë me nxënësit të hulumtojnë në këtë *website* <https://marubi.gov.al> ku do të gjejnë jo vetëm foto të mrekullueshme të personazheve historike të marra nga Pietro, Kel dhe Gegë Marubit në vitet 1885, por edhe kostume të bukura kombëtare të atyre viteve. Kjo veprimtari didaktike mund të lidhet si me faktin që çdo familje ka të ruajtura foto “bardhë e zi”, ashtu edhe me faktin që para 150 vitesh, një shqiptar, Gegë Marubi, ka studiuar fotografi me vëllezërit Lumiere në Francë. Diskutimi mund të vazhdojë edhe në progresin e teknologjisë, që sot jo vetëm kemi fotografi me ngjyra, por edhe që ato mund t’i bëjmë nëpërmjet celularit.



**PROJEKT: Kërkoni në shtëpi fotografi të vjetra veshjesh tradicionale dhe paraqitini në klasë.**



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
afrohem	i bardhë	afrohem
atlete	diell	bllok
bluzë	dimër	brez
çantë	ditë	breza
çizme	djeg	e çmuar
çorape	dollap	fije ari
doreza	dorë	liria
fund	dhëmb	lule
fustan	dhimbje	mbeten
golf	flamur	i mbështjellë
i qepur	fotografi	nga
kanotiere	gjysh	një
kapele	këmbë	shënim
kapuç	kokë	shkrimtare
këmishë	krah	thesar
këpucë	krevat	tufë
kostum	i kuq	
e mbështjellë	lexoj	
nxjerr	lugë	
pallto	pishinë	
pantallona	plazh	
pantofla	pranverë	
peshqir	sënduk	
qëndis	stinë	
rroba banje	sy	
syze dielli	tregoj	
shall	verë	
xhaketë	vjeshtë	
xhinse		
xhup		



**Rekomandim didaktik 6:** Duke dashur të bëjë një bilanc të qartë të progresit gjuhësor të nxënësit, mësuesi mund të punojë me fjalorin e mësuar në mënyra të ndryshme për të parë si njohuritë e fituara nga nxënësit, ashtu edhe ndonjë boshllëk që ka nevojë të adresohet dhe të shpjegohet më qartë nga mësuesi. Me një veprimtari të tillë, mësuesi parandalon çdo “hendek” të mundshëm që mund të krijohet në dijet e nxënësve.



# MËSIMI 14

*Koha e lirë dhe aktivitetet e mia*

*Pasioni im*

## **Qëllimet mësimore:**

- a) Koha e lirë dhe aktivitetet e mia
- b) Pasioni im
- c) Gramatikë: mbiemra prejfoljorë; disa pjesëza: *dot, vetëm, fare.*
- d) Punë e diferencuar: “Opera e parë shqiptare”

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Mësimi, puna, loja.*

*Koha e lirë Loja*

- **LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË:** Mësimi 14 u jep mundësi nxënësve që të flasin për kohën e tyre të lirë dhe pasionet e tyre. Në këtë këndvështrim, kjo temë jo vetëm është interesante, por edhe nga ana emocionale i gjen nxënësit të gatshëm për ta diskutuar për interesave të tyre.
- **SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI:** Nëpërmjet ushtrimeve interesante, si: plotësimi me fjalët që mungojnë apo gjetja e fjalës në anagramet e dhëna, mësuesi mund të përdorë bukur ndjenjën e lojës apo të konkursit në mënyrë që nxënësve t'u jepet mundësia të flasin me njeri tjetrin, siç është tema e pasioneve të tyre.
- **GRAMATIKË:** Në një mënyrë shumë të thjeshtë mësuesi u shpjegon nxënësve që disa fjalë kanë më shumë se një kuptim apo përdorim. Ndoshta në këtë stad të mësimit të gjuhës shqipe, nxënësit janë të aftë të kuptojnë edhe një shpjegim të thjeshtë, si: folja tregon një veprim apo gjendje, por disa folje mund të kryejnë edhe funksionin e mbiemrit që përshkruan cilësitë e emrit, si p.sh.: djalë i menduar.
- **NJOHIM TRASHËGIMINË TONË:** Opera "Mrika" është opera e parë shqiptare që shënoi një sukses dhe përparim të mrekullueshëm të zhvillimit të muzikës serioze shqiptare. Muzika ka qenë dhe mbetet pasioni i shumë shqiptarëve.
- **FJALORI:** *ara, bëj eksperimente, dëgjoj muzikë, dot, fara, fare, i bie veglave muzikore, i preferuar, kitarë, korr, kujdesem për kafshët, lexoj libra, luaj lojëra tavoline, luaj me shokët, luaj në kompjuter, mbaj mend, mbetem, mbjell, merrem me sport, orkestrinë muzikore, peshkoj, rritem, rrumbullak, shëtis në park, shoh televizor, vegla muzikore, vetëm, violinë, violonçel.*

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Kushdo që punon në arsim e di rëndësinë e gjetjes së mënyrës më efektive për të transmetuar dijet. Mësimi i bazuar në tru është një metodë e përparuar e mësimdhënies që synon të rrisë shpejtësinë dhe efikasitetin e të mësuarit. Shkencëtarët kanë kryer studime për të zbuluar se si mëson truri i njeriut. Rezultati i punës së tyre, i njohur si mësimdhënie e bazuar në tru, është duke u përdorur për të hartuar orë mësimore që promovojnë një mësim të shpejtë dhe efikas. Të kuptuarit e këtyre metodave i ndihmon mësuesit të përshtatin stilet e tyre të mësimdhënies, sipas nevojave të studentëve të tyre. "Zbulimi" i mënyrës se si mëson çdo nxënës, lejon mësuesin të zgjedhë metodat më të përshtatshme për grupin e tij të nxënësve. Përfitimet e të mësuarit në bazë të trurit janë njohur tashmë nga Fakultetet e Mësuesisë që janë përgjegjës për trajnimin e mësuesve të rinj. Pra, le të përqafojmë dhe të nxitim të mësuarit me bazë trurin.



## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



*Mësuese Teuta:* Mirëdita! Mirë se u kthyet në klasë! Kemi bërë disa ditë pushim dhe na mori malli. Sot mund të tregojmë se si e kaluam kohën në këto ditë pushimesh.



lexoj libra



dëgjoj muzikë



i bie veglave muzikore



merrem me sport




shëtis në park



shoh televizor



luaj lojëra tavoline



luaj në kompjuter



peshkoj



luaj me shokët



bëj eksperimente



kujdesem për kafshët

*Dardani:* Më pëlqen shumë koha e lirë. Mund të bëj shumë aktivitete. Dua të jem gjithmonë fëmijë, si Pitër Pani. **Mbaj mend** që ai tregonte: “Unë dëgjova kur mami dhe babi bisedonin se çfarë do të bëhesha kur të rritesha. Ndërsa unë nuk dëshiroj të **rritem**. Dua të **mbetem** i vogël dhe të luaj.”

*Egini:* Ha-ha-ha, Dardan! Sa shumë të pëlqen të luash. Unë dua të rritem shpejt. Mua më pëlqejnë eksperimentet në laborator. Më pëlqen të **merrem** me shkencë.

*Vesa:* Do t’ju them dy gjëegjëza. Kush i gjen?

Ara e bardhë, fara e zezë,  
e mbjell me dorë, e korr me gojë?



(fleta e shkruar)

Rrumbullak-strumbullak,  
shtatë vrima rreth e qark.

(koka)


*Redona:* Mua më pëlqen shumë një poezi për **veglat muzikore**.

Në klasën tonë kemi  
një **orkestrinë gazmore:**


**Kitara**  e **violina**   
e vegla frymore.

Mëngjes dhe pasdite

mbi **piano**  Bardhi ngeli;  
nga Lola vogëlushe,

m'i madh është violonçeli .

Dhe Yllkën, në çdo provë,  
e gjeni me violinë;

Ermali ka një trombë ,

Arbani një klarinë .

Por fort mos na **qortoni**,  
në gjetshi një të metë;  
ne, nesër do të jemi  
artistë të vërtetë

(Adelina Mamaqi)



## 1. Përgjigjuni pyetjeve.

Cila është përgjigjja e gjëgjëzave të Vesës?

A do Dardani të rritet shpejt?

Çfarë i pëlqen të bëjë Eginit?

Cilat vegla muzikore janë në poezinë e Redonës?

A mendoni dhe ju si Pitër Pani?

## 2. Shikoni figurën dhe diskutoni për aktivitetet që bëjnë fëmijët.



**Rekomandim didaktik 1:** Veprimtaria didaktike më e suksesshme në mësimin e një gjuhe është padyshim bashkëbisedimi. Bashkëveprimi me të tjerët e zhvillon trurin e nxënësit. Planifikimi i projekteve dhe aktiviteteve në grupe, si brenda dhe jashtë klasës, i ndihmon nxënësit të mësojnë nga njëri-tjetri. Bashkëpunimi është një mënyrë shumë efektive për të mësuar. Në ushtrimet e mësipërme, mësuesit i jepet mundësia t'i inkurajojë nxënësit për të marrë pjesë në bashkëbisedim:

a) Pasi nxënësit lexojnë dialogun së bashku, njërit i jepet roli i “mësuesit”, i cili do të bëjë pyetjet dhe tjetri luan rolin e nxënësit, i cili jep përgjigjet.

b) Mësuesi mund t'i shkruajë gjëgjëzat në skeda dhe përgjigjen së bashku me një arsyetim për të (p.sh. përgjigje është “Koka” sepse në kokë kemi 7 shqisa). Këto skeda vendosen përmbys mbi tavolinë, nxënësit zgjedhin skedën dhe në bazë të saj të bisedojnë me njëri-tjetrin.

c) Duke përdorur poezinë e Adelina Mamaqit, nxënësit mund të flasin për veglat e ndryshme muzikore (në qoftë se nuk kanë fjalor të mjaftueshëm, mund t'i vizatojnë veglat) dhe të japin preferencat e tyre me një “arsyetim” të shkurtër pse një vegël e caktuar është vegla e tyre e preferuar.

## Koha e lirë

*Mësuese Teuta:* Le të diskutojmë së bashku për kohën e lirë. Egin, ti je një student që do të bëhesh mjek, kurse Redona është një stiliste.

### **Egini dhe Redona udhëtojnë në avion dhe i kanë karriget pranë.**

*Egini:* Mirëdita! Unë jam Egini. Jam student në mjekësi. Po udhëtoj për punë.

*Redona:* Mirëdita! Unë jam Redona dhe jam stiliste. Unë udhëtoj shumë. Më pëlqen të shoh vende të reja, ngjyra të reja për veshjet e mia. Po ti, çfarë bën në kohën e lirë?

*Egini:* Unë nuk kam shumë kohë të lirë. Studioj dhe punoj. Kur jam pushim, i bie pianos dhe shkoj të peshkoj në breg të lumit.

*Redona:* Unë udhëtoj, vizitoj muze dhe galeri. Më pëlqejnë pikturat. Shoh si kanë jetuar njerëzit.

### **Vesa dhe Dardani janë shokë shkolle dhe bisedojnë për pasionet e tyre.**

*Vesa:* Dardan, a luan shah ti? Mua më pëlqen shumë kjo lojë.

*Dardani:* Po, luaj. Duhet të luajmë së bashku. Unë shpesh dal shëtitje ose shoh pak televizor. Po ti, Vesa, çfarë bën në kohën e lirë?

*Vesa:* Unë dëgjoj muzikë dhe kujdesem për kafshët. Dy herë në javë notoj në pishinë.

### **3. Përcaktoni: e saktë apo e gabuar?**

**V G**

Egini është student.

Eginit i pëlqen të notojë.

Redona është stiliste.

Redona udhëton shumë.


Vesa dhe Dardani janë shokë shkolle.

Dardanit i pëlqen të dëgjojë muzikë.

Vesa shkon të notojë një herë në javë.

Dardani del shëtitje.

#### 4. Bisedoni me shokët për pasionet tuaja.



**Rekomandim didaktik 2:** Mësimi nëpërmjet bashkëbisedimit rrit kujtesën afatgjatë dhe ndërton dendrite në trurin e nxënësit, gjë që e vendos informacionin gjuhësor në kujtesën afatgjatë, të gatshëm për ta përdorur kur paraqitet nevoja për t'u shprehur. Nxënësit që kanë rastin të ndajnë njohuritë me bashkëmoshatarët e tyre zbulojnë se mund të “depozitojnë” më shumë informacion në kujtesën afatgjatë. Inkurajimi i nxënësve për t'i dhënë mësim njëri-tjetrit e bën të nxënët më efektiv sesa në rastin kur bashkëbisedimi mungon apo përqendrohet vetëm tek një bashkëbisedim me mësuesin. Mënyra si e kalojnë kohën e lirë dhe cilat janë pasionet e tyre janë tema shumë interesante për nxënësit. Kështu, nëse mësuesi u jep mundësi që ata të diskutojnë pasionet e tyre në nivelin e “interesit” të përbashkët dhe karakteristik për grupmoshën e tyre, nxënësit do të kenë shumë gjëra për të thënë, dhe gjuha do të përdoret vetëm si një mjet për të shprehur ndjenjat dhe pasionet e tyre. Kjo, do të rrisë motivimin e nxënësve për të bashkëbiseduar me njëri-tjetrin, sepse kanë se çfarë të thonë.

#### 5. Dëgjoni këngën “Do, Re, Mi” dhe tregoni me pak fjali për çfarë flet teksti i saj.

Do Re Mi [Me Tekst] | Këngë për fëmijë - YouTube

*Do, re, mi; do, re, mi xhaxhi ç' bën në piano ti?  
Thur një këngë për ju fëmijë, ta këndojmë tok të gjithë.  
Anë e mbanë, në fushë e mal, në koncert në festival...!  
Re, mi, do; re, mi, do, xhaxhi këngën ma mëso!  
Ta këndojmë anë e mbanë, ku punojnë prindërit tanë,  
dhe fëmijët kur këndojnë, duarartët i gëzojnë...!  
Mi, do, re; mi, do, re, notat thurin këngë të re.  
Pranverë kjo kënga jonë, porsì zogu fluturon.  
Jeta jonë është pranverë, ndaj këndojmë ne përherë!*



**Rekomandim didaktik 3:** Sipas gjetjeve të shkencës që studion neuro-plasticitetin, aftësia e trurit për të qenë një tru i “zhdërvjellët” i përshtatet metodave interesante të mësimdhënies. Sipas këtyre gjetjeve shkencore, 3 janë mënyrat më universale për të motivuar trurin për të nxënë: a) muzika; b) dashuria (me një partner që e flet gjuhën që po mësohet); c) humori. Pra, duke përdorur këngën e mësipërme, mësuesi do të fitojë vëmendjen dhe motivin e nxënësve. Mësuesi mund të përdorë këtë link: <https://www.youtube.com/watch?v=dO12cusUd5Y> për të mësuar këngën, e cila i ka titrat në gjuhën angleze (gjë që i ndihmon nxënësit që jetojnë në vende anglishtfolëse të kuptojnë përmbajtjen e këngës. Nga ana tjetër, duke përdorur një variant tjetër me tekstin shqip, [https://www.youtube.com/watch?v=iXCz3wmg\\_7M&t=26s&ab\\_channel=K%C3%ABng%C3%ABp%C3%ABrf%C3%ABmij%C3%AB](https://www.youtube.com/watch?v=iXCz3wmg_7M&t=26s&ab_channel=K%C3%ABng%C3%ABp%C3%ABrf%C3%ABmij%C3%AB) mësuesi mund të shkruajë tekstin e këngës në shqip dhe të heqë të gjitha fjalët që kanë mësuar nxënësit, duke lënë boshllëqe në tekst, të cilat duhet t’i plotësojnë nxënësit duke dëgjuar këngën. Një mënyrë tjetër, në funksion të objektivit gjuhësor që ka mësuesi, mund të hiqen foljet që përdoren në këngë dhe të kërkojë që nxënësit t’i plotësojnë ato.



## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

**6. Plotësoni vendet bosh me fjalët: breg, muzikë, stiliste, dal, notoj, shah, shoh, veshjet, student, bie, shoqet.**

Jam \_\_\_\_\_ në mjekësi.

Unë jam Redona dhe jam \_\_\_\_\_. Më pëlqen të shoh vende të reja, ngjyra të reja për \_\_\_\_\_ e mia.

Kur jam pushim, i \_\_\_\_\_ pianos dhe shkoj të peshkoj në \_\_\_\_\_ të lumit.

Dardan, a luan \_\_\_\_\_ ti?

Unë shpesh \_\_\_\_\_ shëtitje ose \_\_\_\_\_ pak televizor.

Unë dëgjoj \_\_\_\_\_ dhe flas me \_\_\_\_\_.

Dy herë në javë \_\_\_\_\_ në pishinë.

**7. Formoni fjalë me gerrat e dhëna dhe tregoni veprimin përkatës.**

ahsh



Le të \_\_\_\_\_

rbjoaë



Le të \_\_\_\_\_

jukotemp



Le të \_\_\_\_\_

teekrispemen



Le të \_\_\_\_\_



**Rekomandim didaktik 4:** Përfitimet e të mësuarit në bazë të trurit janë njohur tashmë nga ata që janë përgjegjës për trajnimin e mësuesve të rinj në fakultetet e mësuesisë. Në mënyrë të veçantë, mësuesit trajnohen të përdorin konceptin e lojës në mësimin e gjuhës së dytë. Me ushtrimet e mësipërme mësuesi mund të krijojë lojëra interesante, si për plotësimin me fjalët që mungojnë, ashtu edhe me anagramet (shkronjat e ngatërruara që “fshehin” fjalën sekrete). Nxënësve mund t’u jepet një numër fjalësh, duke përfshirë edhe fjalët që mungojnë në fjalitë e mësipërme dhe nxënësi (ose vetëm, ose me një partner) zgjedh se cilat fjalë janë më të përshtatshme për të plotësuar fjalitë e ushtrimit. Kurse për ushtrimin me anagrame, nxënësit mund të vendosen në çifte dhe së bashku të zbulojnë fjalën sekrete të fshehur në anagram: rojktpiu – pikturoj.

### 8. Plotësoni me *i pëlqen* / *nuk i pëlqen*.

Redonës \_\_\_\_\_ të shoh vende të reja.

Eginit \_\_\_\_\_ të udhëtojë.

Vesës \_\_\_\_\_ të qëndisë.

Dardanit \_\_\_\_\_ të shohë televizor.

Redonës \_\_\_\_\_ të rrijë në një vend.

Vesës \_\_\_\_\_ të kujdeset për kafshët.

### 9. Shkruani me tri fjali çfarë ju pëlqen të bëni në kohën e lirë.

---



---



---


### 10. Në krah të fotografisë vini emrin e veglës muzikore dhe shkruani dy fjali me veglat që ju pëlqejnë.

Në klasën tonë kemi një orkestrinë gazmore:

\_\_\_\_\_  e \_\_\_\_\_ 



dhe vegla frymore.

Mëngjes dhe pas \_\_\_\_\_  mbi \_\_\_\_\_ Bardhi ngeli;

nga Lola vogëlushe, \_\_\_\_\_  m’i madh është violonçeli \_\_\_\_\_.

Dhe Yllkën, në çdo provë,

e gjeni me violinë;

Ermali ka një trombë \_\_\_\_\_  Arbani një \_\_\_\_\_ .

---



---



---



---



---



---

**Rekomandim didaktik 5:** Tani që nxënësi ka krijuar një bagazh fjalori të pasur për temën “koha e lirë dhe pasionet e mia”, mësuesi mund të ndërtojë forma bashkëbisedimi ku nxënësit i kërkohet që ato njohuri të fituara t’i përdorë në praktikë. një veprimtari didaktike interesante mund të jetë “Shih & Thuaj”: Një nxënës e sheh fjalën në skedë dhe e thotë teksta e nënvizon me gishtin e tij. Sapo dëgjon fjalën, partneri tjetër e vizaton, p.sh. kitarë - Këtu mësuesi fillon t’i kushtojë vëmendjen e duhur Leximit dhe Drejtshkrimit. Nxënësi thotë fjalën dhe e germëzon, nxënësi tjetër e shkruan dhe e lexon fjalën përsëri.

## abc GRAMATIKË

### ➤ Mbiemra që formohen nga folje

<b>lexoj</b>	kam <b>lexuar</b>	libër (libri) <b>i lexuar</b>	letër (letra) <b>e lexuar</b>
<b>shkruaj</b>	kam <b>shkruar</b>	bllok (blloku) <b>i shkruar</b>	histori (historia) <b>e shkruar</b>
<b>mendoj</b>	kam <b>menduar</b>	djalë (djali) <b>i menduar</b>	vajzë (vajza) <b>e menduar</b>
<b>zgjedh</b>	kam <b>zgjedhur</b>	sport (sporti) <b>i zgjedhur</b>	lojë (loja) <b>e zgjedhur</b>
<b>gëzoj</b>	kam <b>gëzuar</b>	shok (shoku) <b>i gëzuar</b>	shoqe (shoqja) <b>e gëzuar</b>

### 11. Plotësoni fjalëkryqin. (Shkronjat dyshe vendosen në një kuti.)

**Horizontalisht**

3 MBIEMËR QË VJEN NGA FOLJA "QENDIS"

4 MBIEMËR QË VJEN NGA FOLJA "MËSOJ"

5 MBIEMËR QË VJEN NGA FOLJA "ZGJEDH"

**Vertikalisht**

1 MBIEMËR QË VJEN NGA FOLJA "GËZUJ"

2 MBIEMËR QË VJEN NGA FOLJA "SHKRUAJ"

3 MBIEMËR QË VJEN NGA FOLJA "PUNUJ"

### FJALË TË URTA

*Fëmija është bilbili i shtëpisë.*

**Rekomandim didaktik 6:** Ushtrimet gramatikore do t'i ndihmojnë nxënësit që të ndërtojnë fjali të sakta, sipas modelit të mësuar. Mësuesi duhet t'i ndihmojë nxënësit që të krijojnë imazhe të këtyre fjalëve në trurin e tyre. Një veprimtari didaktike e rekomanduar mund të jetë "Shkrimi në ajër": Një nxënës thotë fjalën e duhur, pastaj shkruan shkronjat në ajër duke imituar fjalën e mësuar. Mund të përdoret edhe "Shkrimi mbi tryezë": Nxënësi i shkruan shkronjat mbi tryezë, së pari duke parë dhe më pas duke mos parë fjalën në tekst apo në shënimet e tij. Veprimtari të tilla i ndihmojnë nxënësit të përmirësojnë njohuritë dhe aftësinë për të kuptuar, duke përmirësuar edhe kujtesën pamore. Ky variacion metodash nga ana e mësuesve e bën më të lehtë përvetësimin gradual të informacioneve të "vogla" në një mënyrë të paharrueshme dhe interesante për nxënësit, veçanërisht ata në moshë më të vogël.

**12. Shkruani sipas shembullit:** *Unë kam mësuar mësimin. – mësim i mësuar.*

Ai e ka **dëgjuar** këngën. – këngë \_\_\_\_\_

Ne kemi **zgjedhur** librin. – libër \_\_\_\_\_

Ju e keni **luajtur** këtë muzikë. – muzikë \_\_\_\_\_

Ato e kanë **parë** filmin. – film \_\_\_\_\_

Ti ke **treguar** një përrallë. – përrallë \_\_\_\_\_

Ata kanë **kaluar** një vit atje. – vit \_\_\_\_\_

➤ **Disa pjesëza: fare, vetëm, dot.**

Unë nuk e dua **fare** dimrin. – Unë nuk e dua dimrin.

Unë do të mësoj **vetëm** një poezi. – Unë do të mësoj një poezi.

Unë nuk shkoj **dot**. – Unë nuk mund të shkoj.

**13. Vini pjesëzën: fare, vetëm, dot.**

Unë flas \_\_\_\_\_ një gjuhë.

Redona nuk i bie \_\_\_\_\_ pianos.

Dardanit nuk i pëlqen \_\_\_\_\_ të këndojë.

Egini nuk udhëton \_\_\_\_\_, sepse punon.

Ajo shkon në bibliotekë \_\_\_\_\_ kur ka kohë.

Vesa ka blerë \_\_\_\_\_ një fustan.

Ai nuk e ha \_\_\_\_\_ supën.



## 14. Zgjidhni përgjigjen e saktë.

### 1. Piter Pani dëshiron:

- të rritet dhe të punojë;
- të mbetet i vogël dhe të luajë;
- të zgjedhë çfarë të bëhet kur të rritet.

### 2. Eginit i pëlqen:

- të merret me sport;
- të rritet dhe të merret me shkencë;
- të mbetet i vogël dhe të luajë.

### 3. Redona është:

- studente;
- stiliste;
- mjeke.

### 4. Redonës i pëlqen një poezi për:

- veglat muzikore;
- kafshët;
- lojërat e fëmijëve.

**Rekomandim didaktik 7:** Duke udhëhequr nxënësit në ushtrimet e mësipërme, mësuesi jo vetëm i ndihmon ata për të bërë një bilanc të njohurive të tyre, por edhe të ndërtojnë besimin tek vetja se tashmë i kanë njohuritë e mjaftueshme për të komunikuar në shqip. Kjo mënyrë i ndihmon ata ta shohin mësimin ë gjuhës shqipe me një sy optimist dhe u shton dëshirën për të mësuar gjuhën shqipe.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *A e dini se...*

*Opera e parë shqiptare “Mrika” e kompozitorit të shquar shqiptar Prenk Jakova (1917–1969) me libret të shkrimtarit Llazar Siliqi, u shfaq më 1 dhjetor të viti 1958, në Teatrin Migjeni të Shkodrës.*

*Provat bëheshin herë në shtëpinë e kulturës (më vonë, filarmonia e qytetit), herë në teatrin “Migjeni”, derisa më 27 nëntor u bë prova gjenerale. Më 1 dhjetor 1958, u dha shfaqja e operës që pati një sukses të madh.*

*Drama muzikore u vu me sukses nga trupa e Shkodrës. Suksesi ishte jo vetëm për kompozitorin, por edhe për libretistin Llazar Siliqi, regjisorin Andrea Skanjeti, këngëtarët, korin, valltarët dhe orkestrën.*

### FJALË TË URTA

*Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku*



**PROJEKT:** Kërkoni në shtëpi fotografitë vjetra veshjesh tradicionale dhe paraqitini në klasë.

**Rekomandim didaktik 8:** Nxënësit mund të mos jenë të interesuar në muzikën operistike, por mësuesi mund ta paraqesë shfaqjen e operës “Mrika” si një arritje të muzikës shqiptare që e vendosi artin shqiptar në të njëjtin nivel me fqinjët në fushën e muzikës serioze. Kjo qe një arritje e suksesshme për artin shqiptar.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
arë	afrohem	bëj
dot	bluza	bie
farë	çantë	eksperimente
fare	fund	dëgjoj
i preferuar	funde	kafshë
kitarë	fustane	kompjuter
korr	golf	kujdesem
kthehem	lexoj	luaj
mbetem	libër	lojëra
mbjell	e mia	mbaj
muzikor	nxjerr	marr
orkestrinë	qëndis	mend
park	veshje	muzikë
peshkoj		sport
rritem		shah
rrumbullak		shoh
shëtis		shok
vegël		tavolinë
vetëm		televizor
violinë		
violonçel		

**Rekomandim didaktik 9:** Në mënyrë që të parandalojë krijimin e boshllëqeve në njohuritë e nxënësve, mësuesi duhet të përdorë forma të ndryshme për të bërë bilancin e mësimit të fjalorit të ri. Vëmendje e veçantë i kushtohet listës së fjalëve në fjalorin e ri, ndërsa mund t' u kërkohej nxënësve të shpjegojnë fjalët në listën e fjalorit të përsëritur.

# MËSIMI 15

*U prezantoj shokëve vendin tim  
Lulet dhe kafshët që dua më shumë*

## **Qëllimet mësimore:**

- a) U prezantoj shokëve vendin tim
- b) Lulet dhe kafshët që dua më shumë
- c) Gramatikë: lakimi i emrave në rasën emërore dhe kallëzore; disa parafjalë të rasës kallëzore *mbi, për, në, me* dhe emërore *nga, te, tek*.
- d) Punë e diferencuar: “Flora e Shqipërisë”, “Sabiha Kasimati”.

**LIDHJA ME KURRIKULËN** *Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë*  
*Vendlindja Banimi dhe vendbanimi*

- LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDOJMË: Mësimi 15 i jep mundësi nxënësve që të mësojnë fjalorin e nevojshëm për të folur për mjedisin dhe njohuritë e tyre mbi florën dhe faunën e pasur të vendit tonë.
- SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI
- GRAMATIKË: Lakimi i emrave në rasën emërore dhe kallëzore; parafjalë të rasës kallëzore mbi, për, në, me dhe emërore nga, te, tek.
- NJOHIM TRASHËGIMINË TONË: Nxënësit do të mësojnë fakte për florën e pasur të Shqipërisë dhe për Sabiha Kasimati, iltilogia e parë shqiptare.
- FJALORI: ariu, çakalli, delja blegërin, derri, dhelpra, dhia, dreri, gadishulli i Ballkanit, gjarpri, gjeldeti, gjeli, globi, bota, gomari, i papjekur, kafshë të egra, kafshë shtëpiake, kali hingëllin, karafili, kontinent-Europa, lepuri, lopa, lulebora, luledelja, macja mjaullin, margarita, marr vesh, pjergull, pula kakaris, qeni leh, rosa, vilet e rrushit, vjollca, zogu cicërin.

**Koncepti i përgjithshëm didaktik:** Një praktikë e sukseshme për ta kthyer mësimin në një veprimtari sa më ndërvepruese është organizimi i mësimin të drejtuar nga nxënësit. Orët e mësimin të drejtuara nga nxënësit janë për mësuesit një mënyrë krijuese për të bashkëvepruar dhe për të kryer diskutime në klasë. Inkurajimi i nxënësve për të ndryshuar rolet dhe për t’u bërë mësues gjatë ditës jo vetëm që i ndihmon ata në fitimin e besimit për përvetësimin e gjuhës, por gjithashtu sjell një këndvështrim të ri në klasë.

Mësuesi mund t’i bashkojë nxënësit në grupe me nga 5 vetë, të cilët më pas japin mësim me radhë një temë të re çdo ditë. Kjo strategji mësimore ndihmon edhe nxënësit e tjerë, të cilët mësojnë jo vetëm nga “guximi” i shokut të tyre, por edhe marrin pjesë në diskutim në një nivel ku ata ndihen të qetë dhe mirë me veten.





## LEXOJMË, KUPTOJMË DHE BISEDQJMË



*Mësuese Teuta:* Përshëndetje, të dashur nxënës! Ne nuk duam vetëm njëri-tjetrin, por e duam edhe natyrën, kafshët dhe lulet. Le të njohim dhe të prezantojmë natyrën e bukur të vendit tonë.



LULEBQRE

LULEDELE

TRINDAFIL

ZAMBAK

TULIPAN

MARGARITA

KARAFIL

VIOLLÇE

glob - bota kontinent – Europa gadishull - Balkani



kafshë të egra




kafshë shtëpiake



qeni leh



macja mjaullin



delja blegërin



kali hingëllin



pula kakaris



zogu cicërin



*Vesa:* Mua më pëlqen të flas për vendin tim. Shqipëria ndodhet në Gadishullin Ballkanik, në kontinentin europian. Në Shqipëri mund të shohësh plazhe të mrekullueshme, male të larta, lumenj, liqene dhe shumë surpriza natyrore për çdo turist.



*Mësuese Teuta: Ne kemi folur edhe më parë për qytetet e bukura të vendit tonë. Dardan, Egin dhe Redona, tani na prezantoni ju Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi.*

### **1. Plotësoni shkurt përshkrimet.**

*Dardani:* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Egini:* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Redona:* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### **Diskutoni për kuptimin e proverbave.**

*Ikën macja, luajnë minjtë.*

*Qeni që leh, nuk kafshon.*

*Mos u fshih si macja pas gotës.*

**Rekomandim didaktik 1:** Mësuesit inkurajojnë të mësuarit, duke vënë në qendër të vëmendjes nxënësin dhe duke e që të marrë pjesë në vendimmarrje për mënyrën më të mirë të organizimit të një ore mësimi, duke besuar në aftësinë e tyre për të udhëhequr një diskutim apo veprimtari didaktike në klasë dhe duke kujtuar se si ndihet të mësuarit. P.sh.: për veprimtarinë e mësipërme, nxënësi “mësues” mund të bashkëpunojë me mësuesin paraprakisht duke freskuar njohuritë e marra në mësimin 4 (ku nxënësit përshkruanin qytete të ndryshme shqiptare), gjë që do ta ndihmojë atë të fillojë diskutimin në klasë duke inkurajuar Redonën apo Eginin që të shfletojnë shënimet e tyre nga ai mësim dhe të prezantojnë qytete të bukura të trevave ku jetojnë shqiptarët.



Mësuese Teuta: E mbani mend shprehjen “Bën si dhelpra me rrushin”. Kjo shprehje vjen nga një përrallë antike.

*Një dhelpër e uritur kishte dalë të kërkonte ushqim. Ec e ec... Dhelpra u gjend para një pjergulle. Rrushi ishte i pjekur e kishte marrë një ngjyrë blu të thellë. Mjaltë ishte bërë. Por pjergulla ishte e lartë. Dhelpra besonte shumë tek vetja. Kërceu me sa fuqi kishte, por nuk arriti asnjë nga **vilet e rrushit**. U hodh e u hodh dhelpra, por vilet e rrushit nuk i arrinte dot. U hodh edhe një herë dhe kur s’i arriti, tha: “Është rrush fare **i papjekur**”.*

**3. Thoni një fjali për çdo vizatim, diskutoni dhe vëri në radhë veprimet.**

		
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
		
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
_____	_____	
_____	_____	
_____	_____	

**Rekomandim didaktik 2:** Përgatitja e orës se mësimit me në qendër nxënësit e përfshin nxënësin-mësues në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimet për orën e mësimit. Përfshirja e nxënësve në këto vendimmarrje u jep atyre më shumë punë e përgjegjësi, gjë që mund t’i kthejë nxënësit në “partner” të formulës mësimdhënie-mësimnxënie. Mësuesit duhet të ndihen rehat me ndryshimin e stilit të tyre të mësimdhënies: nga “Bëj si them unë” në “Bazuar në nevojat tuaja, le të zhvillojmë bashkë dhe zbatojmë një plan veprimi”. Për ushtrimin e mësipërm, mësuesi mund ta ndihmojë nxënësin-mësues që ta krijojë vetë kronologjinë e ngjarjeve në fabulën e dhelpërës dhe rrushit dhe pastaj të drejtojë diskutimin e shokëve që ata t’i vendosin në radhën e duhur veprimet që ndodhin tek fabula duke iu referuar figurave të dhëna më lart.

#### 4. Lidhni shprehjen me kuptimin.

- |                          |                                     |
|--------------------------|-------------------------------------|
| - mjaltë ishte           | a. të ecësh shumë                   |
| - ec e ec                | b. flet keq kur s'e arrin dot diçka |
| - i uritur               | c. ishte shumë i ëmbël              |
| - si dhelpira me rrushin | d. i hahet shumë                    |

#### 5. Dëgjoni këngën “Sa do të doja një qenush” dhe përgjigjuni pyetjeve.

Kenge per femije Sa do te doja nje qenush me tekst ne shqip - YouTube

Sa do të doja një qenush!  
Ti qenushin e ke **frikë**  
Sa do të doja dhe një mace!  
Maces ti i thua “Ik!”.

Unë qenushin s'e kam frikë  
maces unë i them “Mos ik!”.  
Sa do doja t'i shikoja **rreth e rrotull** në shtëpi!

Po kur qeni më **vërsulet**?  
Rri në vend mos u **largo**.  
Po kur macja pranë me ulet?  
Përkëdhele, mos e ngacmo.

Kur më vrap qeni largohet,  
nuk marr vesh si është kjo punë  
Unë ushqej, macja largohet.  
mjau-mjau-mjau e hum-hum-hum.

Kafshët jo mos i **ngacmoni**  
a dëgjoni, o fëmijë  
ju t'i **mbroni** e t'i doni  
e t'i **mbani** në shtëpi.

Nga fëmijët ata **presin**  
t'i **ushqejnë** e t'i mësojnë,  
miq të mirë ata do mbesin 2x  
ku mes njerëzve do të jetojnë. 2x  
mjau-mjau-mjau e hum-hum-hum

Unë macen e **kam xhan**,  
po një qen po më **mungon**  
mjau-mjau-mjau e hum-hum-hum,  
nuk marr vesh se çfarë po thotë.

## 6. Përgjigjuni pyetjeve.

Çfarë dëshiron djali në këngë?  
Pse ka frikë?  
Si bëjnë macja dhe qeni?  
Çfarë presin kafshët nga fëmijët?  
Cili mund të vërsulet?  
Cilën ka xhan?  
Çfarë nuk kupton?

**Rekomandim didaktik 3:** Lejoni nxënësin-mësues që të marrë pjesë në vendimmarrje për këtë orë mësimi. Vendosja e nxënësve në qendër të mësimnxënies kërkon bashkëpunimin e tyre. Ata kanë nevojë për një zë në planifikimin e mësimi që të kuptojnë se pse, çfarë dhe si formohen përvojat e të mësuarit. Kjo përvojë do ta bëjë orën e mësimi me dinamike dhe reale, sepse plani mësimor hartohet nga vetë nxënësi. Natyrisht, mësuesi do ta ndihmojë nxënësin me ide të ndryshme gjatë përgatitjes për mësim, p.sh.: për këngën “Sa do të doja një qenush”, mësuesja e ndihmon nxënësin të identifikojë fjalët më të rëndësishme në këngë. Në vend që t’i shpjegojë ato si fjalor i ri në mënyrën tradicionale, mësuesi e ndihmon nxënësin që të përgatisë kopje të tekstit të këngës në të cilin janë hequr fjalët që ranë dakord. Pastaj, nxënësi përgatit disa grupe fletësh me fjalët që mungojnë dhe ua jep shokëve, të cilët do të dëgjojnë këngën dhe do të vendosin një nga fjalët e listës në vendet bosh tek teksti i këngës. Të gjithë marrin pjesë dhe krijohet një ambient me nivel stresi minimal, gjë e domosdoshme për funksionimin e sistemit neokortekst në tru.













## SHKRUAJMË DHE ARGËTOHEMI

## 7. Përcaktoni nëse është e saktë apo e gabuar.

Qeni mjaullin.  
Zogu cicërin.  
Pula kakarit.  
Kali blegërin.  
Qeni vërsulet.  
Ujku leh.  
Macja është kafshë shtëpiake.  
Delja është kafshë e egër.

V G

8. Lidhni lulet dhe kafshët me emrat e tyre dhe tregoni cila ju pëlqen më shumë.

	trëndafil		ari
	luledielli		mace
	margaritë		lopë
	tulipan		derr
	zambak		zog

9. Në këngën për qenin dhe macen gjeni fjalë me kuptim të ngjashëm me fjalët e mëposhtme.

- kuptoj \_\_\_\_\_
- ikën \_\_\_\_\_
- largohet \_\_\_\_\_
- mos ik \_\_\_\_\_
- afër \_\_\_\_\_
- e dua shumë \_\_\_\_\_
- qen i vogël \_\_\_\_\_

10. Gjeni dhe rrethoni emrat e luleve, pasi t'i renditni geramat si duhet.

marritaga	B	A	I	Q	C	T	U	C	P
edelull	D	H	Z	A	M	B	A	K	U
ndalitrëfi	T	R	Ë	N	D	A	F	I	L
llcavjo	S	C	V	J	O	LL	C	A	G
bazakum	I	V	S	V	K	O	X	C	D
	R	Z	S	D	L	R	J	F	T
	LL	E	L	E	D	E	L	U	L
	L	V	B	F	Y	Z	X	U	D
	M	A	R	G	A	R	I	T	A

**Rekomandim didaktik 4:** Materiali që mësohet në një orë të tillë mësimi i përfshin të gjithë nxënësit pasi janë ata vetë që zgjedhin fokusin e përmbajtjes (nën drejtimin didaktik të mësuesit). Lërin interesat e tyre të drejtojnë përmbajtjen e dhënë që ata të zhvillojnë aftësitë dhe konceptet. Për shembull, kur mësojnë të shkruajnë në mënyrë bindëse, disa nxënës mund të dëshirojnë të zërthejnë reklamën, detajet e produkteve, pikëpamjet për çështje sociale etj. Strategjia më e mirë është thjesht të pyesësh nxënësin-mësues se si duan ta eksplorojnë këtë temë shokët e tij. Filloni me një ide të asaj që ata duan të bëjnë dhe dialogoni së bashku për të përputhur interesat e tyre me aftësitë dhe konceptet që ka mësuesi si objektiv. Ushtrimet e mësipërme janë tipike për këtë lloj strategjie, nisur nga nuanca e lojës në to. Nxënësi-mësues mund të organizojë një konkurs ku njëra skuadër tregon foton e kafshës apo të lules dhe tjera gjen fjalën e përshtatshme; mund të vendosë skuadrat në garë kush e plotëson më shpejt fjalëkryqin etj.

**abc** **GRAMATIKË**

➤ **Lakimi i emrave në rasën emërore dhe kallëzore**



<b>emërore</b>	mace	macja	mace	macet
<b>kallëzore</b>	mace	mace-n	mace	macet
<b>emërore</b>	Një mace kaloi rrugën. Macja kaloi rrugën. Disa mace kaluan rrugën. Macet kaluan rrugën.			
<b>kallëzore</b>	Vesa mori një mace. Vesa mori macen. Vesa mori disa mace. Vesa mori macet.			


<b>emërore</b>	qen	qeni	qen	qentë
<b>kallëzore</b>	qen	qeni-n	qen	qentë
<b>emërore</b>	Një qen kaloi rrugën. Qeni kaloi rrugën. Disa qen kaluan rrugën. Qentë kaluan rrugën.			
<b>kallëzore</b>	Vesa mori një qen. Vesa mori qenin. Vesa mori disa qen. Vesa mori qentë.			



## 11. Plotësoni tabelën me format e rasës kallëzore.

em.	një djalë	djali	disa djem	djemtë	një vajzë	vajza	disa vajza	vajzat
kall.								
em.	një qengj	qengji	disa qengja	qengjat	një dele	delja	disa dele	delet
kall.								
em.	një zambak	zambaku	disa zambakë	zambakët	një vjollcë	vjollca	disa vjollca	vjollcat
kall.								
em.	një zog	zogu	disa zogj	zogjtë	një rosë	rosa	disa rosa	rosat
kall.								
em.	një lepur	lepuri	disa lepuj	lepujt	një mace	macja	disa mace	macet
kall.								

## 12. Plotësoni fjalëkryqin.



### HORIZONTALISHT

- 
- 'MACET' NË RASËN KALLËZORE
  - 'PULAT' NË RASËN KALLËZORE
  - 'LIBRI' NË RASËN KALLËZORE

### VERTIKALISHT

- 
- 'ZAMBAKU' NË RASËN KALLËZORE
  - 'QENI' NË RASËN KALLËZORE
  - 'DELJA' NË RASËN KALLËZORE

### FJALË TË URTA

*Nuk bëhet stan me dhi të egra.*



**Rekomandim didaktik 5:** Besoni në aftësinë e nxënësve për të udhëhequr punën për një ushtrim gramatikor, si më sipër. Jepuni nxënësve mundësinë të marrin përsipër aktivitetet, edhe kur ata mund të mos i kenë të gjitha aftësitë e duhura gjuhësore apo të përmbajtjes, pasi mësuesi do të jetë aty për ta ndihmuar. Edhe nëse nxënësit janë të vegjël në moshë ata kanë njëfarë përvoja, sepse kanë parë modele mësimdhënieje dhe mësimnxënieje në shkollat e tyre. Për ushtrimet e mësipërme, nxënësi-mësues mund të bëjë pyetjen e modelit: Unë them fjalinë “Mace kalon rrugën”, a është kjo fjali korrekte? Në këtë moment, ai u kërkon shokëve të kontrollojnë tabelën e mësipërme dhe të thonë: Po ose Jo .

### 13. Ktheni emrat në rasën kallëzore.

Unë e kam frikë (qeni) \_\_\_\_\_.

Djali lexon (librat) \_\_\_\_\_.

Vajza mori (lule) \_\_\_\_\_.

Kush i solli (karafilat) \_\_\_\_\_?

Zogu hëngri (bari) \_\_\_\_\_.

Egini po përkëdhel (macja) \_\_\_\_\_.


➤ Parafjalë të rasës kallëzore *mbi, për, në, me* dhe emërore *nga, te, tek*.

### 14. Vini parafjalën që mungon.

Nesër do të shkoj \_\_\_\_\_ gjyshja. Do të dal \_\_\_\_\_ shtëpia  
 \_\_\_\_\_ orën 5 pasdite. Do të marr edhe një tufë \_\_\_\_\_ lule  
 \_\_\_\_\_ gjyshen. Ajo i vë lulet gjithmonë \_\_\_\_\_ tryezë.

### 15. Shkruani parafjalën e duhur dhe shoqërojeni me një emër si në shembull.

*Molla në \_\_\_\_\_ kuti*





\_\_\_\_\_ kuti



\_\_\_\_\_ shtëpia



\_\_\_\_\_ gjyshja



\_\_\_\_\_ çokollatë

**Rekomandim didaktik 6:** Se si do të demonstrohet të mësuarit, varet nga mënyrat e ndryshme që nxënësi-mësues planifikon me ndihmën e mësuesit. Ofroni një larmi opsionesh bazuar në ato që dini për nxënësit tuaj. Një qasje e sigurt është të ofroni tri mundësi. Mësuesi harton dy opsione bazuar në atë që shumica e nxënësve mund të dëshirojnë të bëjnë. Zgjedhja e tretë është një opsion i hapur: nxënësit propozojnë opsionin e tyre. Nëse një propozim plotëson objektivat mësimore që ka vënë mësuesi, ndoshta me disa negociata, nxënësve u hapet “dritë jeshile”. Disa shembuj përfshijnë përdorimin e prezantimit përmes mjeteve të mediave sociale ose bërja e pikturave apo posterave.



## NJOHIM TRASHËGIMINË TONË



### *Ae dini se...*

*Flora e Shqipërisë përbën 30% të florës së Europës, me më shumë se 3200 lloje. Në raport me sipërfaqen e vendit, flora e Shqipërisë është një nga më të pasurat në Europë.*

*Bimësia rritet edhe në shtratin e deteve pranë brigjeve. Njihen rreth 60 lloje bariqtesh ose bimësh detare me lule, nga të cilat 5 lloje rriten në Mesdhe.*

**Sabiha Kasimati** lindi në Edirne më 1912 (viti i pavarësisë), ishte vajza e një mjeku, me origjinë nga Libohova, që ushtronte zanatin e tij si mjek në Turqi. Është ihtiologia e parë shqiptare, në një periudhë kur ende nuk kishte një përmbledhje të faunës dhe të florës ekzistuese në vend.

Diktatura i mori jetën, por sot vepra e saj studiohet dhe njihet kudo.



**PROJEKT: Kërkoni dhe gjeni se cilat janë kafshët dhe bimët në zhdukje.**

**Rekomandim didaktik 7:** Mësimdhënia, natyrisht, luan një rol qendror në arsim. Sidoqoftë, në arsimin bashkëkohor ka pak dyshime se fokusi është zhvendosur nga mësimdhënia (pra roli i mësuesit në klasë) tek të mësuarit (pra sa përfiton nxënësi). Adoptimi i një qasjeje edukative që i vendos nxënësit në qendër të procesit ka fituar popullaritet jo vetëm ngaqë u ofron nxënësve (nën drejtimin e tërthortë të mësuesit) zgjedhjen e asaj se çfarë dhe si mësojnë, por edhe sepse qasja e tij e pavarur gjithashtu i pajis ata me aftësitë kryesore në të cilat do të mbështeten më vonë në jetë. Kjo arrihet duke u ofruar nxënësve përgjegjësi më të madhe për të mësuarit e tyre, duke inkurajuar më shumë bashkëpunim brenda klasës, duke siguruar që të mësuarit të bëhet sa më aktiv dhe kuptimplotë. P.sh.: Projekti i propozuar më lart “Kërkoni cilat janë kafshët dhe bimët në zhdukje”, na jep mundësi që nxënësit të hulumtojnë në internet, të gjejnë një dokumentar, të shohin revistat “National Geographic” ose të organizojnë një ekskursion në Kopshtin Botanik apo Zoologjik të qytetit.



## FJALORI

Fjalor i ri	Fjalor i përsëritur	Fjalor shtesë
ari çakall dele derr dre dhelpër dhi i egër gomar gjarpër gjeldeti gjel kafshë kalë karafil lepur lopë luleborë luledele mace margaritë pulë i papjekur qen rosë rrush shtëpiak vile vjollcë zog	antik dot dua fare i lartë liqene lumenj mal mbaj mbjell mend i mrekullueshëm natyrë plazh pjek pres rreth rritem turist ushqej vetëm vend	blegërin bota cicërin delja frikë gadishull glob hingëllin kam kontinent kakariz kalë leh macja marr mjauillin mungoj ngacmoj rreth rrotull pula vesh pjergull qeni xhan zogu

**Rekomandim didaktik 8:** Përfitimet e mësimit të drejtuar nga nxënësit janë të qarta. Sidoqoftë, adoptimi i kësaj qasjeje për të mësuarit përballet me shumë sfida, veçanërisht në kontekstin e shkollave në diasporë, të cilave u kërkohet gjithashtu të “lundrojnë” në nivele të ndryshme gjuhësore, me mosha, besime kulturore dhe prejardhje të ndryshme. Thënë kjo, ekzistojnë disa mënyra të thjeshta dhe efektive për të lehtësuar të mësuarit e drejtuar nga nxënësit dhe për të ndihmuar nxënësit të kenë më shumë epërsi mbi mësimnxënien e tyre. Konkretisht, në bërjen e bilancit të fjalorit të përvetësuar, nxënësit mund të vendosen në çifte dhe së bashku të rishikojnë tekstin dhe të identifikojnë se cilat nga ato fjalë janë në fjalorin e tyre të ri, cilat janë në fjalorin e përsëritur dhe cilat në fjalorin shtesë.

